

Nr. 43
VITI 2024



**UNIVERSITETI
"EQREM CABEJ"
GJIROKASTËR**

**kërkime
universitare**

**BULETINI SHKENCOR
SCIENTIFIC JOURNAL**



UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

BULETINI SHKENCOR "KËRKIME UNIVERSITARE"

Viti XXXV i botimit (43)

2024/1

ISSN: 2226-082X

**PUBLIKUAR NGA UNIVERSITETI “EQREM ÇABEJ”
GJIROKASTËR**

BULETINI SHKENCOR “KËRKIME UNIVERSITARE”

**Botim periodik
Viti XXXV, Nr. 43
2024/1**

SCIENTIFIC JOURNAL “UNIVERSITY RESEARCH”

**Periodical
Year XXXV, Nr. 43
2024/1**

**PUBLISHED BY “EQREM ÇABEJ” UNIVERSITY
GJIROKASTËR**



BOTUES

**Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë
Lagjja “18 Shtatori”, rruga “Studenti” 6001, Gjirokastrë**

Copyright © - Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë

Të gjitha të drejtat e botimit dhe ribotimit janë të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë. Asnjë material nuk mund të riprodhohet, kopjohet, ripublikohet, modifikohet pa respektuar të drejtën e autorit.

ISSN: 2226-082X

EDITOR IN-CHIEF

Prof. dr. Jaho Cana

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokaštër

Rruga “Studenti” 6001, Gjirokaštër

www.uogj.edu.al

Tel: +355 8426 3408

EDITORIAL BOARD

1. Prof. dr. Gëzim Sala

2. Prof. dr. Shyqyri Hysi

3. Prof. dr. Lavdi Hasani

4. Prof. asoc. Valbona Duri

5. Prof. asoc. Merita Shehu

6. Prof. asoc. Joana Taçi

7. Prof. asoc. Sadik Malo

8. Prof. asoc. Maria Agolli

9. Prof. asoc. Enkela Caca

10. Prof. asoc. Drita Luzo

11. Prof. asoc. Irena Boboli

12. Doc. Dr. Isidor Kokalari

Korrektuesi në gjuhën shqipe

Prof. asoc. Spiridhulla Poçi

Korrektuesi në gjuhën angleze

Dr. Arben Gaba

Koordinator Administrativ

Prof.asoc. Lorenc Koçiu

PËRMBAJTJA

HISTORI DHE TRASHËGIMI

<i>Ermir Gjinishi</i>	Marrëdhëniet fetare midis Turqisë dhe Shqipërisë: Bashkëpunim dhe tension	6
<i>Bektash Mema</i> <i>Griselda Shehu</i>	Bektashinjtë e Prefekturës së Gjirokastrës në Luftën Nacionalçlirimtare	21
<i>Dhimitër Çondi</i> <i>Erin Pitt (SHBA)</i> <i>Andi Canaj</i> <i>Migen Shametaj (SHBA)</i>	Koinoni kaon i Malçanit dhe bashkësia kaone	27
<i>Dhimitër Çondi</i> <i>Erin Pitt (SHBA)</i> <i>Andi Canaj</i> <i>Migen Shametaj (SHBA)</i>	Kaonia: vështrim historik dhe arkeologjik	41

JURISPRUDENCË

<i>Ermal Baze</i> <i>Leonard Sala</i>	Qasje krahasuese në kulturën juridike mesjetare të shqiptarëve të veriut: Statutet e Shkodrës dhe Kanuni i Lekë Dukagjinit në sfondin historik	52
<i>Fatjon Malaj</i> <i>Leonard Sala</i>	Terrorizmi si koncept, shkaqet e lindjes, qëllimi, taktikat dhe strategjitë e tij	69

GJUHË DHE LETËRSI

<i>Merita Gjokutaj-Shehu</i>	“Komploti” i Ben Blushit, një roman ndryshe, larg traditës që jemi mësuar të lexojmë	81
<i>Merita Gjokutaj-Shehu</i> <i>Anastasia Kuro</i>	Gjuha dhe letërsia për fëmijë	86
<i>Mirela Saraçi</i>	Tradita dhe moderniteti në romanin “Agonia”	92
<i>Spiridhulla Poçi</i>	Kultura gjuhësore dhe roli i medias në edukimin gjuhësor të shoqërisë	98

<i>Spiridhulla Poçi</i> <i>Anastasia Kuro</i>	Kontribute dhe përpjekje në rrugëtimin për zhvillimin dhe konsolidimin e gjuhës letrare shqipe	108
<i>Laureta Konomi</i>	Krizat sociale dhe morale të një shoqërie në tranzicion	118
<i>Donika Boboli – Koçi</i> <i>Aleksandër Boboli</i>	Gjuha greke në zonën e minoritetit etnik grek në shqipëri-statusi real i gjuhës greke dhe shqipe në këtë zonë	125
<i>Evanthia Baruta</i> <i>Sofia Delijorgji</i> <i>Edlira Çimi</i>	Edukimi në minoritetin etnik grek në ditët e sotme, struktura dhe karakteristikat e tij	135
<i>Mirela Koça</i> <i>Lorena Dedja</i>	Ndjeshmëria poetike e poetes greke Maria Polidhuri	146
<i>Zeqir Zeqirllari</i>	Koha leksikore: koha ciklike dhe cikli jetësor	157

SHKENCAT SOCIALE DHE TË EDUKIMIT

<i>Valbona Caushi</i> <i>Eralda Zhilla</i>	Inteligjenca emocionale dhe roli i saj ne edukim	167
<i>Julinda Dika/Manja</i> <i>Eralda Zhilla</i>	Ndikimi i aktivitetit fizik në performancën e punës së punonjësve – rishikim literature	175
<i>Kiduina Zaka</i> <i>Artemisi Shehu</i>	Tiparet e personalitetit dhe burnout tek infermierët	184

SHKENCAT EKONOMIKE DHE TURIZMI

<i>Lutfi Gaba</i> <i>Rovena Bega</i>	Turizmi i qëndrueshëm dhe indikatorët e qëndrueshmërisë	193
---	--	------------

MARRËDHËNIET FETARE MIDIS TURQISË DHE SHQIPËRISË: BASHKËPUNIM DHE TENSION

Ermir Gjinishi
Instituti i Studimeve Evropiane
Universiteti i Tiranës
e-mail: gjinishi73@yahoo.com

Abstrakt

Religjioni është një stacion i rëndësishëm në traditën dhe kujtesën e një pjesë të madhe të shoqërive në Evropë, por jo vetëm. Në Ballkan, megjithëse modelet religjioze nuk janë unike apo simetrike, karakteristike në shumë vende është influenca e religjionit përtej kultit fetar, duke i dhënë atij shpesh funksione ekstrareligjioze. Si element prezent në formësimin e kulturës dhe identitetit individual e grupor, si faktor ndikues në të gjitha shoqëritë, religjioni krijon tipologji/modele të ndryshme, të cilat orientojnë mënyrat e ndikimit të tij. Diskutimi dhe polemikat koncentrohen kryesisht mbi atëçfarë mund të sjellë përkatësia religjioze e strukturuar kulturalisht të feja, fetaria dhe fetarizmi, në marrëdhënie mes individesh, grupesh, kulturash, popujsh apo shtetesh. Sindikon ajo në botëkuptimin individual/grupor? Po nëvendimarrje politike? Çfarë pasojash sjell inkorporimi religjioz në veprimtarinë publike? A mund të krijojë tension shoqëror eksportimi i modeleve religjioze nga një vend në tjetrin? Për tëvlerësuar saktë këto interferime, është e udhës të merret parasysh hapësira dhe kufizimet e ndërveprimit religjioz, karakteri kulturor i shoqërive si dhe traditat e tyre fetare.

Lëvizjet bashkëkohore transnacionale religjioze kanë tendencë të kapërcejnë kufijtë dhe ta orientojnë religjionin në analet politike. Vendi ynë nuk është i imunizuar nga ky fenomen, por një qasje serioze e shtetit shqiptar, do të ishte kontrolli i aktivitetit të fondacioneve religjioze në Shqipëri, referuar ligjit shqiptar. Kjo do të ruante traditën e modelit shqiptar dhe do të minimizonte rriskun e interferimeve fetare në politikë, ekonomi dhe çështjet e sigurisë.

Fjalë kyçe: *religjion, lëvizjet transnacionale, islami politik, lëvizja gjeniste.*

Abstract

Religion has been a basic factor of the tradition and memory of most European societies, and not only them. Although models of religion are not unique or symmetrical in the Balkans, what is characteristic in many countries is the impact of religion beyond the religious cult, often giving it extra-religious functions. As an element that helps to shape the individual

and group identity and culture, as well as an influencing factor in all societies, religion creates different typologies/models, which guide its methods of influencing. There is debate and controversy over what contribution religious affiliation which is culturally structured in religion, religiosity and religiousness can make to relations between individuals, groups, cultures, peoples or states. How does it affect the individual/group mindset? What about its effect on political decision-making? What are the consequences of religious incorporation into public activity? Can exporting models of religion from one country to another create social tension? In order to accurately assess these interferences, it is advisable to take into account the space and limits of religious interaction, the cultural nature of societies, as well as their religious traditions.

The contemporary transnational religious movements are inclined to crossborders and direct religion towards annals of politics. Our country is not immune to this phenomenon and the Albanian state can take a serious approach and control the activity of religious organisations in Albania, pursuant to Albanian law. This would preserve the tradition of the Albanian model and reduce the risk of religious interference in politics, economy and security issues.

Keywords: *religion, transnational movemensts, political islam, gulenist movement.*

1. Religjioni si dimension kulturor

Kultura, si mënyrë e të jetuarit përmbledh zakonet, traditat, besimet të një grupi të caktuar njerëzish në një periudhë kohe të caktuar. Ajo është mënyra e jetës, por njëkohësisht mënyra e vlerësimit të saj brenda një grupi, një shoqërie, pse jo të një kombi. Për këtë arsye, dimensionin religjioz brenda identitetit kulturor është pjesë e rëndësishme për shumicën e njerëzve. Antropologu britanik Edward Taylor, në vitin 1871, solli një moment të rëndësishëm në historinë e konceptit të kulturës me përkufizimin e saj si: “një tërësi e përbërë e cila përfshin njohuritë, besimet, artin, moralin, traditën, ligjin, dhe të gjitha aftësitë dhe zakonet e tjera të përfuara nga njeriu si pjesëtar i shoqërisë”.¹

Pavarësisht dhjetëra përkufizimeve, kultura mund të përcaktohet shkurtimisht si tërësi besimesh, idesh, traditash, ritesh, zakonesh, të cilat e bëjnë të dallojë një popull nga një tjetër. Njëherazi, këto janë dhe veçori dalluese ndërmjet grupesh, shoqërish, komunitetesh. Rëndësia e këtyre veçorive rritet nëse i shohim ato si produkt historik, i cili mbart prej shekujsh mënyrat e të perceptuarit, mendimet, besimet, metodat e arsytimit, mënyrën e jetesës. Brenda këtij perceptimi, referuar prezencës së religjionit si pjesë e kulturës, por jo i vetmi tregues i saj, Roland Robertson shprehet se nuk mund të kuptohet plotësisht pozita e fesë dhe e njerëzve fetarë, pa konsideruar më

¹Edward Taylor (1924) *Primitive Culture*, New York, Brentano's, P.1.

parë karakterin kulturor specifik të shoqërisë dhe mënyrën si e komportojnë dimensionin religjioz brenda saj.²

2.Ndërveprimi religjioz dhe laicizmi: modele asimetrike

Peter James Stanford në librin e tij “50 Religious Ideas You Really Need To Know”, e fillon analizën e tij në botën religjioze me këto fjalë: “*Cilido e ka një mendim mbi fenë. Ai mund të jetë pozitiv, mund të jetë negativ, por rrallë është asnjans*”.³ Qartësimi mbi hapësirat reale të veprimit religjioz, natyrën dhe tendencat e tij në strukturat shoqërore, është një proces vazhdimësie, ndërsa interferimi i ndikimeve religjioze në aktorë të tjerë e bën atë një fenomen kompleks.⁴

Shoqëritë mund të ndajnë ngjashmëri mbi përkatësinë fetare të tyre, por modeli që krijojnë jo domosdoshmërisht është i njëjtë, sepse faktorë të tjerë historik, etnik, zakonor, kulturor, ideologjik...etj, ndikojnë në modelimin e saj. Ashtu sikurse mund të ndajnë përkatësi fetare të ndryshme, por modelet shoqërore janë të ngjashme. Nëse do të shkonim në një ilustrim praktik, lehtësisht do të vinim re diferencat fluide të modeleve religjioze që krijohen në shtete të ndryshme. Turqia laike i paguan imamët nga buxheti i shtetit me statusin e nëpunësit, sikurse në Danimarkë pastorët paguhen nga shteti. Polemikata e nxehta mbi vellon (shaminë) në laicizmin francez, janë të pakuptimta për shekullarizmin amerikan. Vendimi i Gjykatës së Lartë në SHBA më 2011, i cili refuzoi kërkesën e një grupi ateistësh për heqjen e motos kombëtare të vendosur nga kongresi i parë gjatë luftës civile më 1864 “In God We Trust”, është “non-sense” për Francën. Kjo nuk i bën këto vende më pak laike, por modeli laik i tyre ka specifika të veçanta të cilat përcjellin perspektiva të ndryshme historike e kulturore të rolit të religjionit. Konflikti i sotëm në Ukrainë sjell një tjetër formë të ndërveprimit religjioz. Ndryshe nga Turqia, e cila trashëgon një ndarje të thellë midis laikëve dhe fetarëve ku religjioni shpesh bëhet objekt i debatit politik, në Shqipëri, që në shpalljen e pavarësisë së vendit, është përcaktuar pozita laike e shtetit. Edhe në kushtetutën e post 90-tës, përcaktohet pozita asnjansë e shtetit në çështjet fetare si ente autonome të pavarura në administrimin e institucioneve të tyre.⁵ Fetarët, laikët, ateistët, kanë të njëjtin qëndrim ndaj laicitetit të shtetit. Institucionet, grupet apo organizatat fetare, nuk kanë ndërmarrë ndonjë iniciativë për të ndryshuar statukuonë. Vlerësimi i shqiptarëve për lidhshëpin politik nuk bazohet në premisa religjioze.

Kjo asimetri, mbi gjithçka ka arsye konceptuale dhe historike. Analistët e “The Economist”, Micklethwait dhe Woodridge, arsyetojnë se ajo lidhet

²Peter Byer & Lori Beaman (2007), *Religion Globalization and Culture*, Leiden-Boston, P. 35-56.

³Peter Stanford (2012) *50 Ide Fetare Që duhet ti dije cdo njeri*, Plejad, Tiranë, fq.3.

⁴John Hutshinson & Antony.D.Smith, (1996) *Ethnicity*, Oksford University Press, P.5.

⁵*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë* (2017), Neni 10, Tiranë, fq.7.

kryesisht me zhvillimet historike specifike për secilin shtet, të cilat diku shfaqin një lloj skepticizmi, dhe diku janë “entuziaste” mbi rolin e religjionit. Sipas arsyesimit të tyre, evropianët që nga koha e iluminizmit janë përpjekur ta kufizojnë fenë në sferën publike, për pasojë i shohin me mëdyshje transformimet religjioze aktuale. Ndërsa amerikanët i trajtojnë fetë si pjesë integrale e kombit të tyre. Asimetria e shfaqur nuk nënkupton një Evropë jofetare, por një Evropë ku feja gjallon brenda kontureve të caktuara kulturore e historike.⁶

Gjatë shekullit të kaluar, në Perëndim ka pasur një konflikt tripolësh midis profesionistëve sekularë, protestantëve dhe katolikëve. Zgjidhjet e këtyre konflikteve historike krijuan modele të ndryshme institucionale. Ndarja "shtet-kishë" në Hollandë, ku ka një kishë shtetërore, ndryshon nga shteti krejtësisht laik i Francës, apo me fetarizmin në SHBA. Megjithatë, zgjidhja nuk është përfundimtare dhe unike. Ajo është realizuar brenda kornizave institucionale ku ndodhin episodet.⁷

3.Ndikimi i religjionit përtej altarit: Legjitimimi religjioz

Religjioni është një fenomen shumë dimensional. Argumenti se besimet fetare ndikojnë në botëkuptimet e njerëzve, ka një bazë të gjërë në literaturën e shkencave shoqërore. Këto referenca tregojnë se historikisht asnjë burim tjetër i kuptimeve kulturore nuk i ka ofruar aq shumë përgjigje nevojave njerëzore për të zhvilluar një identitet, sa religjioni. Për rrjedhojë, religjioni shpesh shfaqet në thelb të identitetit individual e grupor. Përgjithësisht, botëkuptimet e shumicës së individëve nuk kufizohen vetëm nga përkatësia e tyre fetare. Por, edhe nëse religjioni përbën vetëm një element ndikues midis shumë të tjerëve, fuqia e tij nuk mund të neglizhohet.⁸

Pavarësisht se legjitimiteti i shtetit në kohët moderne mbështetet në burime të shumta, legjitimimi religjioz mbetet faktor me ndikim për një pjesë të konsiderueshme shtetesh. Megjithëse se shumica e shteteve në botë konsiderohen demokratike dhe gjysmëdemokratike, ndikimi i fesë vazhdon të jetë domethënës. Disa shtete e trajtojnë religjionin si pjesë të ideologjisë së tyre kombëtare ose si një element të kësaj ideologjie. Një studim mbi politikat fetare të 177 shteteve tregon se në praktikë mbështetja zyrtare e një feje të vetme është e zakonshme. Nga ky studim, 41 shtete (23.1%) kanë fe zyrtare, dhe 44 shtete (24.8%), megjithëse nuk deklarojnë një fe zyrtare, mbështetin një fe më shumë se të tjerat. Nga ana tjetër, gjetjet e studimit tregojnë se të gjitha shtetet ose përpiqen ta përdorin religjionin për të

⁶Eliezer B. Rafael & Yitzhak Stenberg (2010), *World Religions and Multiculturalism - A dialectic Relation*, Leiden-Boston, P.41-62. Fernand Braudel, Gramatikë e qytetërimeve, SHLKTiranë, 2005, fq, 337.

⁷Peter Byer & Lori Beaman (2007), *Religion Globalization and Culture*, Leiden-Boston, P. 35-56.

⁸Nukhet A. Sandal & J.Fox (2013), *Religion in International Relations Theory*. Routledge, USA, P. 12.

legjitimuar politikat e shtetit ose i frikësohen fuqisë së tij. Veç kësaj, disa hulumtime tregojnë se tradita fetare ndikon në masën, se sa autoritare apo demokratike janë qeveritë, dhe si reflekton kjo në krijimin e aleancave.⁹ Referuar këtyre të dhënave, çdo tjetërsim i modelit religjioz apo zëvendësimi i tij me një tjetër reflekton në tjetërsimin e aspekteve të tjera strukturore të shoqërisë.

Vetëdija religjioze në Ballkan mund të shihet si refleksion i zhvillimeve religjioze në mbarë Evropën. Në Ballkan, konteksti sociopolitik ka përcaktuar pozicionin e religjionit brenda shoqërive. Në pjesën më të madhe të vendeve ballkanike, instrumentalizimi politik i religjioneve ka qenë në funksion të realizimit të projekteve nacionaliste. Ndryshe nga shqiptarët të cilët identitetin kombëtar nuk e veshën me ngjyra religjioze, te kroatët, serbët, boshnjakët dhe grekët, identiteti religjioz për afrohet me vlerat e identitetit kombëtar. Në Ballkanin multireligjioz, projekti shekullarizues, për disa vende nuk ishte prioritet, për disa të tjera po. Prandaj në shumë aspekte, shoqëritë e Ballkanit janë tepër fragmentare në rrafshin e perceptimeve. Rilindja e religjionit në Ballkan përgjithësisht shfaqet si thirrje për mbrojtjen e vlerave autentike të komuniteteve. Nisur nga karakteristikat specifike, shqiptarët janë i vetmi popull në rajonin e Ballkanit ku vetëdija nacionale nuk është formësuar apo identifikuar nisur nga përkatësia fetare. Që do të thotë, çdo tendencë për të huajtur modelin fetar, hap debate kulturore e identitare më të gjëra.¹⁰

Studimet tregojnë se implikimet religjioze mund të reflektojnë në vendimmarrje politike brenda apo jashtë vendit për disa arsye. Edhe nëse botëkuptimi i një politikbërësi nuk është plotësisht fetar, përsëri feja mund të ndikojë në procesin e vendimmarrjes së tij. Guner argumenton se udhëheqësit e shtetit dhe vendimmarrësit mund t'i japin kuptime realiteteve duke vlerësuar politikën nëpërmjet optikës së tyre religjioze. Veç kësaj, përkatësia fetare e zgjedhësve mund t'i vendosë kufizime politikbërësve në vendimmarrjet e tyre. Është një veprim i pamatur për politikbërësit, të ndër marrin veprime që bien ndesh me besimet, vlerat dhe moralitetet që vlerësohen prej zgjedhësve të tyre.¹¹ Pra, influenca e religjionit në vendimmarrjet politike ka të bëjë me nivelin e legjitimitetit fetar brenda një shoqërie dhe hapësirat e ndikimit të tij.

Kështu, midis laicizmit politik dhe laicizmit social ka dallime esenciale. Laicizmi politik i referohet politikës dhe institucioneve publike, ndërsa ai social lidhet me vlerat dhe qëndrimet. Shumica e shteteve demokratike kanë negociuar lirinë e fesë nga ndërhyrjet e shtetit, duke i lejuar komuniteteve fetare jo vetëm lirinë e besimit (adhurimit), por edhe lirinë për t'u organizuar

⁹Po aty.

¹⁰M. Vickers.(2008) *Islam in Albania*, Defence Academy of the United Kingdom. E. Temaj, (2019) “*CENTRUM International Scientific Journal*”, Skopje, f.64-73.<https://centrum.mk/?s=centrum+12>

¹¹Nukhet A. Sandal & J.Fox (2013), *Religion in International Relations Theory*. Routledge, USA, P. 12,

në shoqëri politike dhe civile¹². Në Shqipëri këta kufij fluide shpesh bëhen pjesë e debateve të nxehta publike të cilat më së shumti reflektojnë trashëgiminë ateiste përballë tendencave për ndryshime ekstrakulturore e historike të imponuara, sesa analizën e mbështetur në modelin referues historik ose trendet bashkëkohore.

4. Ndryshimet politike pas 90-ës: Fillimi i marrëdhënieve fetare me Turqinë

Fillimi i marrëdhënieve fetare midis Shqipërisë dhe Turqisë vjen pas ndryshimeve politike të periudhës postkomuniste. Me hapjen e vendit, komunitetet fetare filluan vetorganizimin e brendshëm dhe marrëdhëniet me institucionet homologe jashtë vendit, në një moment ekstremisht të vështirë, në mungesë totale të infrastrukturës fetare. Në këtë suazë, vjen dhe hapja e Komunitetit Musliman Shqiptar. Deri në vitin 2011, KMSH-ja kishte vetëm 4 marrëveshje bashkëpunimi zyrtare.¹³Vizioni i tyre qartëson sinkretizimin e kulturës me akademizmin burimor dhe perspektivën evropiane të vazhdimësisë. Marrëveshja e parë e KMSH-së me institucionet homologe jashtë vendit i përket asaj me Dijanetin turk. Ajo përfshinte kryesisht bashkëpunimin institucional, bursa studimi dhe trajnim klerikësh. Mesa duket, afërsia gjeografike, klima e marrëdhënieve të mira mes dy vendeve, ndikuan në këtë bashkëpunim dypalësh mes institucioneve homologe.

Prezenca e fondacioneve turke në Shqipëri ka qenë e kufizuar krahasuar me ato të vendeve të tjera. Pesë fondacione: “SemaFoundation” (Lëvizja Hizmet), “IstanbulFoundation”, “Vakfi islamik shqiptaro-turk”, dhe më vonë në 2006 “ALSAR” (The alternative of the future), kanë qenë aktive në Shqipëri gjatë këtyre 30 viteve. Aktiviteti i tyre shtrihet në arsim, botime librash dhe aktivitete kulturore e humanitare. Në vitin 1996 Agjensia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA) filloi aktivitetin e saj në Shqipëri, i cili u shtri edhe në trashëgiminë religjioze. Ajo ka restauruar 10 objekte kulti të cilat gëzojnë statusin “monument i trashëgimisë kulturore” dhe mbikëqyr ndërtimin e xhamisë së Namazgjahut.¹⁴

Nga të gjitha fondacionet turke në Shqipëri, më aktivja shfaqet “Lëvizja Hizmet”, e cila e nisi aktivitetin e saj në vitin 1993 me hapjen e Fondacionit Gülistan dhe një vit më pas, Fondacionin Sema. Përgjatë viteve, aktiviteti i

¹²S.Turner (2010) *Religion in a Post-Secular Society*, P.651-653.

A.Stepan (2000) *Journal of Democracy nr.11*, Religion, Democracy, and the Twin Tolerations, P.37-57.

* 1-Marrëveshje me DIJANET në Turqi, 2- Marrëveshje me Universitetin e Al-Azhatit Kairo, 3-Marrëveshje me “Faculty of Islamic Call” të Tripolit, 4- Marrëveshje me “European Institute for Human Science” në Francë, European Muslim Union.

¹⁴Gazeta e re (2022) *TIKA ringjalli objektet dhe veprat e trashëgimisë osmane në Ballkan*, <https://gazetaere.com/tika-ringjalli-objektet-dhe-veprat-e-trashegimise-osmane-ne-ballkan/>

saj fillimisht u shtri kryesisht në fushat e arsimit (fetar dhe laik), me 12 shkolla. Lëvizja Hizmet ka në administrim 5 medrese, atë të Kavajës, Korçës, Beratit, Elbasanit, Tiranës dhe në vitin 2011 në bashkëpunim me KMSH-në hapi Kolegjin Universitar Bedër. Aktiviteti i saj nuk u kufizua vetëm në fushën e arsimit. Ajo e zgjeroi aktivitetin me një numër OJQ-sh dhe OJF-sh, media vizive dhe online, blogje, shtëpi botuese, kompani biznesi etj¹⁵, duke importuar strukturën e modelit të saj në vendin tonë.

5-Nga bashkëpunimi në tension

Gjatë dy dekadave të para, marrëdhëniet fetare mes institucioneve homologe të dy vendeve ishin ndër më të mirat, por viti 2010 shënon një kthesë të rëndësishme. Në vitin 2010 fillon depërtimi i lëvizjes “Hizmet” në organet e KMSH-së, e cila që në fillim krijoi situata të tensionuara. Organet lokale dhe qendrore të KMSH-së së bashku me besimtarët reagues publikisht dhe zyrtarisht për kapjen e institucionit të tyre nga kjo lëvizje. U vu në dijeni edhe Ambasada e Republikës Turke e cila e kaloi me heshtje situatën. Ndoshta, marrëdhëniet e Gylenit me qeverinë turke atë kohë, ishin më të forta se shqetësimi i besimtarëve shqiptarë.¹⁶ Përfshirja e politikës në këtë proces e ngarkoi edhe më shumë situatën. Ishte hera e parë që shteti ndërhyri në një institucion fetar. Kapja e KMSH-së nga lëvizja gyleniste u bë me mbështetjen e drejtpërdrejtë të ish-ministrit të Brendshëm z. Lulzim Basha. Me sa dukej, kishte një dakortësi të heshtur edhe politike për atë që po ndodhte. Kapja e institucionit vertikalisht dhe shtrirja horizontalisht nëpër qytete, që një proces plot kundërshti, i cili vazhdon të thellohet¹⁷.

Arsyeja themelore e këtij refuzimi lidhet me strukturën hermetike e përjashtuese të “tjetrit”, fragmentarizimin e bashkësisë fetare, qëllimet dhe deformimet doktrinarë të lëvizjes, të cilat kanë çuar në ekstrem të huajtjen e myslimanëve në habitatin e tyre kulturor, social dhe historik. Fetë janë të lidhura ngushtë me sensin e tyre të kohës dhe hapësirës përmes interpretimeve të zhvillimeve historike, të teksteve të shenjta, adhurimeve,

¹⁵Olsi Shehu, (2017) *Influenca e FETÖ-s në Ballkan*, Anadolu Agency.

<https://www.aa.com.tr/sq/gunun-basliklari/influenca-e-feto-s-n%C3%AB-ballkan-/617549?amp=1>

Fatjon Cuka, (2017) *Nga Shqiperia duhen marre te gjitha masat e nevojshme kunder FETO-s*, Anadolu Agency.

<https://www.aa.com.tr/sq/balkan/nga-shqip%C3%ABria-duhen-marr%C3%AB-t%C3%AB-gjitha-masat-e-nevojshme-kund%C3%ABr-feto-s/861421>

<https://www.aa.com.tr/sq/balkan/p%C3%ABrp%C3%ABlitjet-e-fundit-t%C3%AB-feto-s-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-/821184>

¹⁶ E-Zani (2012) “KMSH kërcënon imamin e xhamisë së medresesë”, Tiranë.

<https://www.e-zani.org/2012/03/15/kms-h-kercenon-imamin-e-xhamise-se-medresese/>

¹⁷Ylli gurra (7 korrik 2019) “KMSH u kap nga Gylenistet” Gazeta Shqiptarja.com.

<https://shqiptarja.com/video/kms-h-u-kap-nga-gylenistet-shkarkohet-myftiu-i-tiranes-ylli-gurra>

tempujve, gjuhëve dhe treguesve të tjerë kulturor autentik. Për vetë fizionominë dhe natyrën e saj, lëvizja gyleniste e ka të pamundur të ndjekë traditën shqiptare. Jo vetëm për shkak se promovon kultin e një individi i cili nuk i përket realitetit shqiptar, por mbi të gjitha, ajo nuk është produkt i zhvillimeve sociokulturore shqiptare. Tipari bazik që formëson modelin fetar shqiptar është kultura e përbashkët që bashkon myslimanët, të krishterët dhe jobesimtarët, ndërsa modeli gylenist fragmentar e shkëput bashkësinë fetare myslimane nga kjo kulturë. Nga ana tjetër, për sa kohë që produkti i saj fetar e kulturor, nuk është i konsumueshëm nga pjesët e shoqërisë, çdo formë e të huajtjes së bashkësisë së besimtarëve do të reflektojë më gjërë.¹⁸

Komunitetet fetare tradicionale në Shqipëri janë të angazhuara në problematika që i përkasin bashkësive të tyre në nivel nacional, ndërsa lëvizjet religjioze transnacionale të gjeneratës së re, siç është dhe lëvizja gyleniste, dallohen nga përpjekjet për rindërtim identitar, të cilat nisin nga individi dhe synojnë krijimin e një komuniteti global, që mëshiron synime politike të ofruara si zgjidhje fetare. Oliver Roy thekson se këto lëvizje të reja fetare, synojnë ta shkëpusin fenë nga rrënjët kulturore dhe ta riformatojnë atë në funksion të axhendave të tyre. Sipas tij, paradoksi i këtij ri-islamizimi është se duke shtuar “strehëzat e formimit” (rrjetet e shkollave fetare private) ku cektësia e dijeve fetare mbushet me ideologji indoktrinuese dhe duke lënë mënjanë parashtrimin fetar në dorë të kujtdo, ai ndihmon në delegjitimimin e institucioneve tradicionale, nxit krizën e autoritetit dhe zhvillimin e individualizmit fetar, duke krijuar një neo-fundamentalizëm ex-territorial, i cili vë në dyshim objektivat e lëvizjes¹⁹.

Një sondazh i vitit 2015 nga IDM-ja përcjell shqetësimet mbi institucionin më të lartë mysliman në vend, KMSH-në. Sipas këtij sondazhi, KMSH-ja ka humbur kredencialet morale dhe profesionale në sytë e besimtarëve. Shumica e besimtarëve besojnë se klerikët e komunitetit të tyre nuk kanë formimin e duhur fetar. Vetëm 21% e të anketuarve mendojnë se klerikët e KMSH-së kanë formim fetar të mjaftueshëm. Sipas sondazhit KMSH-ja nuk ka në kontroll objektet e kultit. Ndërkaq, 51% e besimtarëve praktikantë besojnë se dinjiteti i komunitetit fetar dhe tradita shqiptare e besimit, është nën kërcënim. Autoriteti i kontestuar i tij, divergjencat e fshehura brenda KMSH-së, potenciali i tyre për të krijuar boshllëk mes autoriteteve fetare

¹⁸O.Roy(2010) *Holy Ingorance: When Religion and Culture Part Ways*, Oxford University Press, Oxford.

ArjolGuni,(2019) *Nevoja për një traditë të re diskursive në Shqipëri*, ResPublica, Tirane.

<http://www.respublica.al/2019/07/28/nevoja-p%C3%ABr-nj%C3%AB-tradit%C3%AB-t%C3%AB-re-diskursive-n%C3%AB-shqip%C3%ABri>

Ermir Gjinishi, (2017) *A ka ardhur koha për një marrëdhënie të re midis fesë dhe shtetit*, Gazeta Mapo, Tiranë.

¹⁹ Olivier Roy,(2004) *Globalized Islam: The Search for a New Ummah*,New York: Columbia University Press, p.7;90;103.

dhe komunitetit të besimtarëve, vlerësohen si nxitësit e shfaqjes së ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri²⁰.

6-Gylenizmi, tipologji e lëvizjeve transnacionale të ri-islamizimit: Midis islamit politik dhe shtetit paralel

Lëvizja gyleniste, me prezencën e saj në afro 150 vende të ndryshme të botës, klasifikohet ndër lëvizjet transnacionale të ri-islamizimit. Fenomenet e brendshme lokale të cilat nuk janë të kufizuara nga kufijtë shtetërorë cilësohen transnacionale. E ndërsa, në pjesën më të madhe të botës, fundamentalizmi fetar po bëhet një faktor gjithnjë e më i rëndësishëm si në politikën e brendshme ashtu edhe atë ndërkombëtare, islami politik ndoshta është shembulli më i dukshëm, por jo i vetmi, i këtij fenomeni²¹.

Si formulë e islamit politik, ndryshe nga simotrat e saj “Vllazëria myslimane” në Egjipt, “Nahda” në Tunizi etj, Gylenistët nuk provojnë futjen në politikë nëpërmjet zgjedhjeve, por ndikimin në politikë dhe krijimin e strukturave paralele në shtet²². Sipas M.Slootman dhe J. Tillie, organizimi sekret strukturor, promovimi i figurës së liderit, rekrutimi, izolimi brenda grupit, veçimi nga persona që mendojnë ndryshe, janë tipare të organizatave fundamentaliste të cilat bazohen në manipulim fetar dhe i shërbejnë kauzave jofetare²³.

Tendenca e deformimit deri në tjetërsim të kufirit mes fesë zyrtare (institucionale) dhe asaj jozyrtare (jashtë institucionale), nëpërmjet strukturave okulte, përtej refuzimit fetar, shkakton keqkuptime edhe për shkak të depërtimit të njëra-tjetra, çka e komplikon thellë dimensionin e lirisë fetare në aspektin/kufirin ligjor. Si fenomen global, trendi i përhapjes së grupeve fetare jozyrtare, ka qenë dhe mbetet shqetësim i zhvillimeve moderniste në SHBA dhe Evropë, për arsye të implikimit religjioz në procese joreligjioze. Në eksperiencën të hidhura, SHBA-ja dhe Evropa janë përballur me të tilla organizime, të cilat, nga promovimi i antisemitizmit, janë shndërruar në lëvizje raciste, mizogjiniste, deri dhe shoviniste.

²⁰Instituti për demokraci dhe ndërmjetësim IDM, (2015) *Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri*, Tiranë, fq 37-94.

Aleksandra Bogdani (23 Mars 2016) “*Shqipëria përballet me rrezikun e luftëtarëve xhihadistë në hije*”, apo ‘*ujqve të vetmuar*”, Gazeta Tema. <https://www.gazetatema.net/2016/03/23/shqiperia-perballet-me-rrezikun-e-luftetareve-xhihadiste-ne-hije-apo-ujqve-te-vetmur/>

²¹Jonathan Fox& Shmuel Sandler (2004) *Bringing religion into international relations*, Palgrave Macmillan, NY, Ch 5. Peter Losonczy, Aakash Singh, (2010) *Religion Challenges and the Prospect of Democracy*, continuum International Publishing Group, London, Joaquim Carvalho (ed.), (2007). *Religion and power in Europe: Conflict and Convergence*. Pisa: Pisa University Press.

²²Kryesia e çështjeve fetare të Turqisë, (2018) *Organizata FETO sipas dëshmive të veta*, Ankara.

²³M. Slootman& J.Tillie (2006) *Process of radicalisation*, Institute for Migration and Ethnic Studies, Universiteit von Amsterdam.

Përgjithësisht, lëvizjet okulte janë cilësuar antidemokratike, shkelëse të lirive politike e fetare, përfshirë dhe lirinë e shprehjes. Nëse s'do të ishin kështu, s'kanë arsye llogjike pse të jenë okulte²⁴.

Nga vendet e Ballkanit, Shqipëria është vendi ku lëvizja gyleniste është më aktive. Tensioni mes besimtarëve shqiptar dhe lëvizjes përfshin edhe faktor të tjerë veprues, çka e bën edhe më të komplikuar situatën. Organizata, për vite me radhë, ka arritur të ketë ndikim në biznes, politikë, media dhe ekonomi, me një performancë jo pa u vënë re. Lidhjet e errëta të bizneseve të organizatës me kompani "offshorë", heshtja e shtetit ndaj afëra korruptive, monopoli në shërbimin mjekësor privat dhe intimidimi i medias për të heshtur ndaj skandaleve korruptive, mbeten njollë e zezë në opinionin publik shqiptar²⁵.

Viti 2011 shënon majën e intensitetit të aktiviteteve në Shqipëri. Pas marrjes së KMSH-së, lëvizja po përgatitej të hidhte një hap tjetër. Shpалosjen e përparësive të lëvizjes me shtrirjen e ndikimit të rrjetit në institucionet e shtetit dhe shoqërinë civile. Një seri konferencash e simpoziume të organizuara nga Universiteti Epoka dhe Prizmi, angazhuan akademikë, intelektualë, qeveritarë dhe njerëz të medias, në promovimin e ideve të Gylenit dhe "nevojën për konfigurime të reja në politikën shqiptare". Mbështetja e Aleancës Kuq e Zi, një forcë populiste e krijuar rishtazi me ngjyra nacionaliste e fetare, hapi një debat të nxehtë në publik mbi islamin politik dhe ndikimin turk në politikën shqiptare si platformë e neo-otomanizmit në Ballkan, ndërsa polemikat mbi depërtimin e rrjetit në strukturat e sigurisë, institucionet e drejtësisë dhe politikë, si rrezik i kapjes së shtetit, arritën deri në parlamentin shqiptar. Deputeti Blushi akuzonte se 10% e drejtuesve të policisë ishin gylenistë.²⁶

²⁴Charles H. Lippy (1994) *Being Religious, American Style: A History of Popular Religiosity in the United States*, Greenwood Publishing Group.

AndreVauchez, (1993) *The Laity in the Middle Ages: Religious Beliefs and Devotional Practices*, University of Notre Dame Press.

²⁵ Gazeta Telegraf (15 tetor 2017) *Sorros është pronari i Spitalit Amerikan, e bleu me kredi*, Tiranë.

<http://telegraf.al/aktualitet/sorros-eshte-pronari-i-spitalit-amerikan-e-bleu-me-kredi/>

Ivana Dervishi (21.06.2017) *Padia kundër Shëndet Plus, Spitali Amerikan i Ofron reklama kundrejt "lënies rehat"* Reporter.al.

<https://www.reporter.al/padia-kunder-shendet-plus-spitali-amerikan-i-ofroi-reklama-gazetes-kundrejt-lenies-rehat><https://www.voal.ch/zjarri-vdekjeprures-ne-spitalin-amerikan-drejtori-ne-ministri-se-dinim-se-qendra-e-dializes-ishte-atje/>

<http://publik.live/spitali-amerikan-300-mije-euro-tender-pas-operimit-te-nenen-aneta-rama/>

<https://www.voal.ch/zjarri-vdekjeprures-ne-spitalin-amerikan-drejtori-ne-ministri-se-dinim-se-qendra-e-dializes-ishte-atje/>

<http://pamfleti.net/falsitet-ne-spitalin-amerikan-99-shi-klodian-allajbeu-mashtro-pacientet-nga-122-mjeke-119-jane-mjeke-spitalesh-shqiptare-2-greke-dhe-1-turk/>

²⁶Alfred Lela, (2012) *Projekti Neo-otoman, Aleanca Kuq e Zi, parti turke*, Revista Mapo, Tiranë.

Përtej traditës fetare shqiptare, lëvizja gyleniste arriti në njëfarë mase të eksportoje në Shqipëri modelin e saj, duke na dhënë një tjetër rast praktik në qasjet teorike të cilat përcaktojnë se lëvizjet transnacionale religjioze kanë tendencë të kapërcejnë kufijtë dhe ta orientojnë religjionin në analet politike kur: 1-grupet fetare kanë mbështetje apo influencë në vendimarrjen e qeverive, 2-për shkak të efektit të difuzionit. “Rebelimi” në një vend, mund të frymëzojë grupe të ngjashme që jetojnë diku tjetër, për të bërë të njëjtën gjë²⁷. Për këto arsye, ekzistenca e modelit fetar shqiptar, në dimensionin e tij historik e kulturor, është e kërcënuar. Por, ndërhyrja politike për të zëvendësuar influencën gyleniste në KMSH me një tjetër influencë të huaj, do të sjellë të njëjtat probleme. KMSH-ja ka nevojë emergjente t’i rikthehet traditës së origjinës së tij, nëpërmjet një procesi transparent, si entitet autonom, referuar instrumenteve të tij ligjore, statutit dhe rregulloreve përkatëse.

7-Dualizmi midis Gylenit dhe Erdoganit

Deri në korrik të 2016 ishte e vështirë të bëhej diferenca midis gylenistëve dhe shtetit turk. Lëvizja “Hizmet” kishte arritur të krijonte opinionin se aktiviteti i saj mbështetej nga shteti turk. Pas grushtit të shtetit më 15 korrik 2016, tensioneve me karakter fetar, iu shtua tensioni politik. Nxitimi i KMSH-së për të përjashtuar përfshirjen e organizatës “Gylen” në tentativën e grushtit të shtetit, madje, deri dhe mohimin e ekzistencës së saj si lëvizje, vulosi anësinë e përfshirjes së tij në këtë marrëdhënie mes dy vendeve, duke prekur konturet e laicizmit të shtetit shqiptar. Ky është rasti i vetëm në historinë e Shqipërisë kur religjioni bëhet pjesë e axhendave politike²⁸. Ndërkohë, trysnia e dyfishtë, nga Ankaraja (për të dorëzuar eksponentët gylenistë), dhe Brukseli (mosnjohjen e lëvizjes si autor të grushtit të shtetit), përcaktuan sjelljen relativisht dualiste të Tiranës zyrtare. Standardi i dyfishtë, me depërtimin e ndonjë individi të kërkuar nga autoritetet turke dhe refuzimi për të shkuar më tej, për shkak të trysnisë së Brukselit, tregon mungesën e seriozitetit të qeverisë shqiptare e cila reflekton pozita konjunkturale.

Tensioni mes dy vendeve, reflekton negativisht në zhvillimet e brendshme shqiptare. Në aspektin politik, për arsye partiake, opozita shqiptare i kundërvihet kërkesave të Turqisë mbi gylenistët, duke injoruar efektin e

Gazeta Tema (12 maj 2015), *Blushi bën politikë me “Gylenistët”/ Në librin e tij i sulmon, ndërsa në Kuvend i merr në mbrojtje*. Tiranë.

²⁷ John Baylis, Steve Smith & Patricia Owens (2010), *“The Globalization of World Politics: An Introduction to International Relations”*, Oxford University Press.

Jonathan Fox, (2007) *Religion, Politics and International Relations: The Rise of Religion and the Fall of the Civilization Paradigm as Explanations for Intra-State Conflict*, Cambridge Review of International Affairs.

²⁸Skënder Bruçaj (21 janar 2022) *Për të ardhur keq që Xhamia e Et'hem Beut u përdor për axhendën politike të një shteti të huaj*. <https://www.zeriamerikes.com/a/6407311.html>

kapjes së KMSH-së dhe ndikimin e pritshëm në të huajtjen e kulturës shqiptare. Kritikkat politike ndaj autoritarizmit të Presidentit Erdogan apo personalizimit të marrëdhënies së Kryeministrit shqiptar me të, nuk mund të këmbehen me dakortësinë e produktit gylenist në Shqipëri.

Për opinionin publik, debati mediatik mbi vlerat e Gylenit dhe autoritarizmin e Erdoganit, është krejt jashtë thelbit dhe kontekstit shqiptar. Vizualisht, ai ka prodhuar dy blloqe militantësh, erdoganistë dhe gylenistë, duke krijuar hapësira për implikime të ndërlikuara.

Në aspektin fetar, burim i këtyre tensioneve, treguesit përkeqësohen gjithnjë e më tepër. Nominimi mediatikisht i refuzuesve të lidërshiptit të KMSH-së si erdoganistë dhe atyre mbështetës të tij gylenistë, importon në realitetin shqiptar huajtjen kulturore dhe identitare me efekte të tjera vepruese. Raporti Evropian mbi Islamofobinë (SETA) publikuar më 2022, i cili perfshin 31 vende evropiane, tregon për rritjen e islamofobisë në Shqipëri, por dy tregues tërheqin vëmendjen: 1-Islamofobia dhe turkofobia janë të lidhura, thuajse, në nivele ekuivalente. 2-Promovohen në portale lajmesh, rrjete sociale apo platforma, të cilat përdoren kryesisht nga intelektualë, gazetarë, politikanë dhe figura publike. Një pjesë e tyre, pakënaqësitë ndaj qeverisë dhe kryeministrit Rama, ia atribuojnë marrëdhënies së personalizuar me Erdoganin, ndërsa një pjesë tjetër, (referuar skandalit të rrjedhjes dhe publikimit të të dhënave personale në dhjetor të 2021-it) figurojnë të paguar nga fondacionet gyleniste. Gjithsesi, pjesa më e madhe e kritikëve ndaj personalizimit të marrëdhënive mes dy liderëve dhe akuzave të ndërsjellta Erdogan-Gylen, nuk reflektojnë preferenca anësie, por thjesht mobilizojnë aspekte të kontestuara në qasjen e tyre kritike. Me pak fjalë, tensionet e adresuara keq, kanë krijuar një ambient abuziv në aspektin politik, kulturor, fetar dhe identitar, i cili me gjasë do të zgjasë për sa kohë shteti turk do ta ketë prioritet goditjen e rrjetit gylenist brenda dhe jashtë Turqisë.

Një qasje serioze e shtetit shqiptar, përtej ekzagjërimeve populiste dhe abuzive, do të ishte kontrolli i aktivitetit të këtyre fondacioneve në Shqipëri, referuar ligjit shqiptar. Kjo do të minimizonte interferimet e çështjeve fetare në marrëdhëniet mes dy vendeve, do të sfumonte pikëpyetjet mbi tendencat e huaja të të huajtura, do të zbardhte dyshimet rreth akuzave të hedhura mbi destinacionin e financave të organizatës dhe do rikthente komunikimin normal midis dy shteteve që respektojnë kushtetueshmërinë laike të shtetit. Megjithatë, retorika dhe diskuri religjioz duhet të limitohet edhe më tej në marrëdhëniet dypalëshe. Ai nuk mund të jetë shtrati që kushtëzon bashkëpunimin midis dy vendeve.

Referenca

A.Stepan (2000) *Journal of Democracy nr.11*, Religion, Democracy, and the Twin Tolerations.

Aleksandra Bogdani (23 Mars 2016) “Shqipëria përballet me rrezikun e ‘luftëtarëve xhihadistë në hije’, apo ‘ujqve të vetmuar’”, Gazeta Tema.

- Alfred Lela, (2012) *Projekti Neo-otoman, Aleanca Kuq e Zi, parti turke*, Revista Mapo, Tiranë.
- Andre Vauchez, (1993) *The Laity in the Middle Ages: Religious Beliefs and Devotional Practices*, University of Notre Dame Press.
- Arjol Guni, (2019) *Nevoja për një traditë të re diskursive në Shqipëri*, ResPublica, Tirane.
- Charles H. Lippy (1994) *Being Religious, American Style: A History of Popular Religiosity in the United States*, Greenwood Publishing Group.
- E. Temaj, (2019) “CENTRUM International Scientific Journal”, Skopje.
- Edward Taylor (1924) *Primitive Culture*, Brentano’s, NewYork.
- Eliezer B. Rafael & Yitzhak Stenberg (2010), *World Religions and Multiculturalism-A dialectic Relation*, Leiden-Boston.
- Enes Bayrakli & Farid Hafëz (2020) *Islamophobia in Albania*, European Islamophobia Report.
- Ermir Gjinishi, (2017) *A ka ardhur koha për një marrëdhënie të re midis fesë dhe shtetit*, Gazeta Mapo, Tiranë.
- E-Zani (2012) “KMSH kërcënon imamin e xhamisë së medresesë”, Tiranë.
- Fatjon Cuka, (2017) *Nga Shqipëria duhen marrë të gjitha masat e nevojshme kundër FETO-s*, Anadolu Agency.
- Fernand Braudell, Gramatikë e qytetërimeve, SHLK Tiranë 2005.
- Gazeta Telegraf (15 tetor 2017) *Sorros është pronari i Spitalit Amerikan, e bleu me kredi*, Tiranë.
- Gazeta Tema (12 maj 2015), *Blushi bën politikë me “Gylenistët”/ Në librin e tij i sulmon, ndërsa në Kuvend i merr në mbrojtje*. Tiranë.
- Gazeta e re (2022) *TIKA ringjalli objektet dhe veprat e trashëgimisë osmane në Ballkan*,
- Instituti për demokraci dhe ndërmjetësim IDM, (2015) *Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri*, Tiranë.
- Ivana Dervishi (21.06.2017) *Padia kundër Shëndet Plus, Spitali Amerikan i Ofron reklama kundrejt “lënies rehat”* Reporter.al.
- Joaquim Carvalho (ed.), (2007). *Religion and power in Europe: Conflict and Convergence*. Pisa: Pisa University Press.
- John Baylis, Steve Smith & Patricia Owens (2010), “*The Globalization of World Politics: An Introduction to International Relations*”, Oxford University Press.
- John Hutshinson & Antony. D. Smith, (1996) *Ethnicity*, Oksford University Press.
- Jonathan Fox & Shmuel Sandler (2004) *Bringing religion into international relations*, Palgrave Macmillan, NY.
- Jonathan Fox, (2007) *Religion, Politics and International Relations: The Rise of Religion and the Fall of the Civilization Paradigm as Explanations for Intra-State Conflict*, Cambridge Review of International Affairs.

Kryesia e çështjeve fetare të Turqisë, (2018) *Organizata FETO sipas dëshmime të veta*, Ankara.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (2017), Neni 10, Tiranë.

M. Slooman&J.Tillie (2006) *Process of radicalisacion*, Institute for Migration and EthnicStudies, Universiteit von Amsterdam.

M. Vickers. (2008) *Islam in Albania*, Defence Academy of the United Kingdom.

Nukhet A. Sandal& J. Fox (2013), *Religion in International Relations Theory*. Routledge, USA.

O. Roy (2010) *Holy Ingorance: When Religion and Culture Part Ways*, Oxford University Press, Oxford.

Olivier Roy, (2004) *Globalized Islam: The Search for a New Ummah*, New York: Columbia University Press.

Olsi Shehu, (2017) *Influenca e FETÖ-s në Ballkan*, Anadolu Agency.

Peter Byer&Lori Beaman (2007), *Religion Globalization and Culture*, Leiden-Boston.

Peter Losonczy, Aakash Singh, (2010) *Religion Challenges and the Prospect of Democracy*, continuum International Publishing Group, London,

Peter Stanford (2012) *50 Ide Fetare Që duhet ti dijë cdo njeri*, Plejad, Tiranë.

S.Turner (2010) *Religion in a Post-Secular Society*.

Skënder Bruçaj (21 janar 2022) *Për të ardhur keq që Xhamia e Et'hem Beut u përdor për axhendën politike të një shteti të huaj*, Zeri Amerikes.

Ylli gurra (7 korrik 2019) "KMSH u kap nga Gylenistët" Gazeta Shqiptarja.com.

Burime elektronike

<http://pamfleti.net/falsitet-ne-spitalin-amerikan-99-shi-klodian-allajbeu-mashtron-pacientet-nga-122-mjeke-119-jane-mjeke-spitalesh-shqiptare-2-greke-dhe-1-turk/>

<http://publik.live/spitali-amerikan-300-mije-euro-tender-pas-operimit-te-nenen-aneta-rama/http://telegraf.al/aktualitet/soros-eshte-pronari-i-spitalit-amerikan-e-bleu-me-kredi/>

<http://www.respublica.al/2019/07/28/nevoja-p%C3%ABr-nj%C3%AB-tradit%C3%AB-t%C3%AB-re-diskursive-n%C3%AB-shqip%C3%ABri>

<https://centrum.mk/?s=centrum+12>

<https://gazetaere.com/tika-ringjalli-objektet-dhe-veprat-e-trashegimise-osmane-ne-ballkan/>

<https://shqiptarja.com/video/kmshe-u-kap-nga-gylenistet-shkarkohet-myftiu-i-tiranes-ylli-gurra>

<https://www.aa.com.tr/sq/balkan/nga-shqip%C3%ABria-duhen-marr%C3%AB-t%C3%AB-gjitha-masat-e-nevojshme-kund%C3%ABr-feto-s/861421>

<https://www.aa.com.tr/sq/balkan/p%C3%ABrp%C3%ABlitjet-e-fundit-t%C3%AB-feto-sn%C3%AB-shqip%C3%ABri-/821184>

<https://www.aa.com.tr/sq/gunun-basliklari/influenca-e-feto-s-n%C3%AB-allkan/617549?amp=1>

<https://www.e-zani.org/2012/03/15/kmsh-kercenon-imamin-e-xhamise-se-medresese/>

<https://www.gazetatema.net/2016/03/23/shqiperia-perballet-me-rrezikun-e-luftetareve-xhihadiste-ne-hije-apo-ujqve-te-vetmur/>

<https://www.reporter.al/padia-kunder-shendet-plus-spitali-amerikan-i-ofroi-reklama-gazetes-kundrejt-lenies-rehat/>

<https://www.voal.ch/zjarri-vdekjeprures-ne-spitalin-amerikan-drejtori-ne-ministri-se-dinim-se-qendra-e-dializes-ishte-atje/>

<https://www.voal.ch/zjarri-vdekjeprures-ne-spitalin-amerikan-drejtori-ne-ministri-se-dinim-se-qendra-e-dializes-ishte-atje/>

<https://www.zeriamerikes.com/a/6407311.html>

www.islamophobiaeurope.com

Islamophobia@setav.org

BEKTASHINJTË E PREFEKTURËS SË GJIROKASTRËS NË LUFTËN NACIONALÇLIRIMTARE

Bektash Mema¹, Griselda Shehu²

¹Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore,

e-mail: bekmema@yahoo.com

²Fakulteti Ekonomik, Universiteti “Eqrem Çabej”

e-mail: griselda.shehu@yahoo.com

Abstrakt

Sipas dokumentacionit historik, gjatë luftës antifashiste, pjesa më e madhe e klerikëve bektashjanë nuk pranuan pushtimin Ata u orjentuan dhe u rreshtuan kundër okupatorit. Mbi këto premisa u ngrit edhe qëndrimi i bektashinjëve në qarkun e Gjirokastrës, i cili u karakterizua nga një pjesëmarrje shumë dimensionale. Veprimtaritë konsistonin në organizimin e besimtarëve bektashian dhe jo vetëm në luftën kundër okupatorit; të qëniet e institucioneve bektashiane si ambiente të sigurta për strehimin e luftëtarëve, për diskutimin e tematikave të luftës në zhvillim e sipër, marrjen e vendimeve përkatëse për zhvillimet e mëpasme etj.

Po të bënim një krahasim me prefekturat e tjera, nuk është vështurë të konstatojmë një dominancë bektashiane. Duke e përgjithësuar fenomenin, të krijohet mundësia të evidentosh tipare dhe specifikë, të cilat japin origjinalitet, sikundër i japin një vend të veçantë në historinë e luftës antifashiste në këtë qark. Kjo spjegohet edhe me faktorë të natyrës sasiore e cilësore, organizative e programore.

Fjalët kyç: *Besimi bektashian, Lufta Nacionalçlirimtare, Gjirokastra, Balli Kombëtar*

Abstract

According to historical documentation, during the anti-fascist war, most of the Bektashian clerics did not accept the invasion. They oriented themselves and lined up against the occupier. The position of the Bektashi in the Gjirokastra district was also based on these premises, which was characterized by a multidimensional participation. The activities consisted in the organization of the Bektashi believers and not only in the fight against the occupier; being Bektashi institutions as safe premises for sheltering fighters, for

discussing the themes of the ongoing war, making relevant decisions for subsequent developments, etc.

If we were to make a comparison with other prefectures, it is not difficult to ascertain a Bektashi dominance. By generalizing the phenomenon, it is possible to highlight features and specifics, which give originality, as well as giving it a special place in the history of the anti-fascist war in this region. This is also explained by quantitative and qualitative, organizational and programmatic factors.

Key words: *Bektashi religion, Lufta NacionalÇlirimtare, Gjirokastra, Balli Kombëtar*

Qëndresa e popullit shqiptar ndaj okupimeve dhe sundimeve të huaja zë një vend të veçantë në historinë e kombit tonë. Duke e orientuar çështjen drejt rolit dhe vendit të komuniteteve fetare, konstatohet se kontributi i klerit bektashi ka qenë present në të gjitha ngjarjet kur çështja kombëtare është vënë në rrezik. Rrënjët e këtij orientimi gjenden te prirja fetare edhe drejt objektivash me karakter kombëtar.

Sipas dokumentacionit historik, në rrjedhën e periudhave, bektashizmi karakterizohet nga një veprimtari origjinale dhe e pasur në linjën e kombëtarizimit.

I tillë ishte qëndrimi i bektashinjve edhe gjatë luftës antifashiste. Pjesa më e madhe e klerikëve bektashianë nuk pranuan pushtimin¹. Ata u orientuan dhe u rreshtuan kundër okupatorit.

Mbi këto premisa u ngrit edhe qëndrimi i bektashinjve në qarkun e Gjirokastrës, i cili karakterizohet nga një pjesëmarrje shumëdimensionale në luftën antifashiste. Veprimtaritë konsistonin në organizimin e besimtarëve bektashianë dhe jo vetëm në luftën kundër okupatorit; të qenit e teqeve si ambiente të sigurta për strehimin e luftëtarëve, për diskutimin e tematikave të luftës në zhvillim e sipër, marrjen e vendimeve përkatëse për zhvillimet e mëpasme etj.

Veprimtaria antifashiste në Prefekturën e Gjirokastrës u zhvillua në përputhje me rrethanat e zhvillimit të luftës, gjatë okupimit italian dhe gjerman, të cilat mbartin brenda tyre premisa jo të njëjta.

Gjatë pushtimit italian duhen marrë në konsideratë themelimi i dy organizatave, FNÇ-së dhe BK-së, të cilat në mënyrë programore morën përsipër zhvillimin e luftës kundër okupatorit, përmes bashkimit të të gjitha

¹Akademi e Shkencave e Shqipërisë, *Histori e Popullit Shqiptar*, vol. IV, Tiranë, 2009, f. 31.

forcave anitfashiste, për një Shqipëri të lirë, të pandashme, indipendente e demokratike, deri dhe bashkimin e Kosovës me Shqipërinë².

Pra, përpara bektashinjve qëndronin dy organizata, dy alternativa që pretendonin rivendosjen e pavarsisë dhe vendosjen e një regjimi demokratik, të cilat krijuan një farë konfuzioni për orientim të bektashinjve. Pjesa dërmuese e klerikëve u orientuan drejt FNC-së, ndërsa të tjerë drejt BK-së, pas të cilëve, edhe në qarkun e Gjirokastrës, shkuan institucione e besimtarët e tyre.

Pavarësisht kësaj situatë, në qarkun e Gjirokastrës, deri në fund të vitit 1942, pati një bum në aspektin numerik të të angazhuarëve në luftën antifashiste, të organizuar në çeta, si dhe në ngritjen e këshillave nacionalçlirimtare, që funksiononin, pothuajse, në çdo fshat³, në pjesën dërmuese të të cilave përfaqësoheshin dhe bektashinjve.

Deri në momentin kur zhvilloi punimet konferenca e Mukjes, bektashinjve e qarkut u bënë pjesë e të dy organizatave, për të cilat angazhimi në luftën kundër okupatorit ishte një realitet. Kjo konfirmohet edhe nga Konferenca e Parë e Vendit, mars 1943, në dokumentet e së cilës flitej edhe për formacione të BK-së që kishin "...luftuar dhe vazhdojnë të luftojnë...kundër okupatorit"⁴.

Dështimi i Marrëveshjes së Mukjes, shkëputja e zogistëve nga FNC-ja dhe krijimi prej tyre i organizatës Lëvizja e Legalitetit, bashkëpunimi i tyre dhe i segmenteve të tjera nacionaliste me pushtuesin gjerman, krijuan një situatë vështirësuese për bektashinjve.

Megjithatë, konstatohet fenomeni i rritjes së luftëtarëve në radhët e Frontit Nacionalçlirimtar. Në gjysmën e parë të vitit 1943, vetëm në nënprefekturën e Tepelenës u organizua masivisht popullullsia përmes përfshirjes në grupet e armatosura të fshatrave të angazhuar në çetat e batalionet vullnetare territoriale, si dhe në këshillat antifashiste që vepronin në çdo fshat⁵.

Për bektashinjve e qarkut të Gjirokastrës po zhvilloheshin dy realitete, me ndryshesa midis tyre. Nga njëra anë ishte shumica e bektashinjve e përfshirë në Frontin Nacionalçlirimtar, i cili vazhdoi luftën edhe kundër okupatorit gjerman. Nga ana tjetër ishte pakica që aderonte brenda Ballit Kombëtar, e karakterizuar nga një tkurrje e luftës antifashiste, deri dhe në bashkëpunim me okupatorin gjerman.

Nëse do t'u referoheshim teqeve me një aktivitet të pasur në luftën antifashiste, do të veçonim ato të Rabijes, të Gllavës, të Turanit, të Matohasanaj, të Bençës, të Harakupit⁶, të Frashërit etj.

²Po aty, f. 57, 59.

³Po aty, f. 57.

⁴Po aty f. 62.

⁵BenardZotaj, *KontributiipopullittëTepelenësgjatëLuftëssëDytëBotërore*, nëGazetaTelegraf, 10 shtator, 2018.

⁶Nuri Cuni, NaimDëra, *BektashizminëTepelenë*, Tiranë, 2023, f. 196-197, 183, 221, 227, 236,238.

Po të bënim një krahasim me prefekturat e tjera, nuk është vështirë të konstatojmë një dominancë bektashiane. Duke e përgjithësuar fenomenin, të krijohet mundësia të evidentosh tipare dhe specifika, të cilat japin origjinalitet, sikundër i japin një vend të veçantë në historinë e luftës antifashiste në këtë qark. Kjo shpjegohet edhe me faktorë gjithëprefektural të natyrës sasiore e cilësore, organizative e programore, që janë ideuar, trajtuar, vendimuar e programuar në teqet bektashiane në rrjedhën e viteve.

Së pari duhet përmendur aspekti numerik i teqeve të cilat kapnin numrin 50 nga 180 në rang vendi⁷. Natyrshëm që tërësia e tyre dhe e klerikëve që i drejtonin apo ushtronin aktivitet në to, flitnin për dominancë numerike, e cila u bë pjesë aktive për të përcjellë te besimtarët, por jo vetëm, rrezikun e fashizmit.

Së dyti, teqetë bektashiane të prefekturës së Gjirokastrës vinin me një përvojë të pasur në çështjen kombëtare. Duhet veçuar teqja e Frashërit⁸ dhe e Koshtanit⁹, si vatra të njohura të veprimtarisë atdhetare gjatë Rilindjes, me ndihmesë të çmuar në përhapjen e gjuhës shqipe, si qendra me rëndësi organizative, ku u zhvilluan mbledhje e kuvende ndërkrahinore, deri dhe kongrese kombëtare si ai i Koshtanit.

Këto kontribute ishin një vlerë madhore kombëtare dhe bektashiane dhe, si të tilla, kanë shërbyer si udhërrëfyes për bektashinjtë në ngjarjet e mëvonshme, veçanërisht për luftën antifashiste, kur po rrezikohej çështja e pavarsisë së vendit.

Midis teqeve bektashiane të prefekturës, pjesëmarrëse në luftën antifashiste del në plan të parë teqja e Rabies, e drejtuar nga Baba Abaz Memushaj¹⁰. Ishte një klerik patriot, i cili e kishte kthyer teqen në vatër të zjarrit atdhedashurie, i bindur, se pa lirinë e atdheut nuk është e plotë as liria e besimit fetar¹¹. Si e tillë teqja u bë një nga objektivat kryesore goditëse të okupatorit italian.

Më 17 korrik 1943, u sulmua nga forcat territoriale të zonës, një batalion fashist italian i vendosur në territorin e teqesë, i cili pasi la shumë të vrarë, si dhe të gjithë municionin që dispononte, mundi të çante rrethimin.

Pas kësaj goditje, komanda italiane arriti në përfundimin se kjo teqe ishte një nga bazat e forta të luftës kundëritaliane në zonë, ndaj vendosi të hakmerret. Rreziku nga dita në ditë po bëhej më prezent. Rreth 350-400 muhaxhirë të zonës u grumbulluan në teqe për t'u mbrojtur¹². Më 23 korrik 1943, regjimenti italian vrau barbarisht Baba Abaz Memushin, 5 dervishë dhe 26

⁷AQSH, F. 482, dos. 117, fl 1, viti 1931.

⁸Fjalori Enciklopedik Shqiptar, vol III, Tiranë, 2009, f. 1434, 2681-2682.

⁹ Bektash Mema, Xhezo Cana, *Shkolladheklubënvilajetin e Janinës/Teqja e Koshtanit, vatërdijejedheatdhetarie*, Tiranë 2018, f.38-40.

¹⁰Nuri Cuni, Naim Dëra, vepër e cituar, f. 227.

¹¹Feti Zeneli, Gazeta "Tema", 23 korrik, 2023.

¹²Po aty.

persona tjetër¹³, pa përfshirë djegiet dhe plaçkitjet e ndryshme në fshat e fshatrat përreth.

Kjo ngjarje, nga prefekti i kohës, Rasim Babameto, vlerësohej si më e madhja për nga numri i viktimave të shkaktuara prej pushtuesit italian, jashtë frontit të luftës. Njëherazi, si vrasje masive dhe në mënyrë mizore, është përgjithësuar edhe si “Masakra e Teqes së Rabijes” dhe është krahasuar shpesh me masakrën e Qerbelasë. Një reagim i menjëhershëm, shumë i ndjer dhe i vërtet erdhi nga populli, përmes homazhit të vargjeve: Pa dëgjoni o Shqiptarë, në Rabie çfarë u bë / Njëzet e shtatë të vrarë, si në Qerbela u bë...¹⁴.

Por masakra nuk solli efektet që priste komanda italiane. Përkundrazi, u rrit ndjeshëm numri i pjesëmarrësve në qëndresën ndaj pushtuesit, sikundër u kalua në zhvillime të avancuara organizative e politike. Strukturat e FNÇ-së në zonë, në të cilat bënë pjesë dhe përfaqësues të bektashizmit, u ristrukturuan për të kaluar në një fazë më të avancuar të luftës. Në një sërë takimesh të zhvilluara në treva të ndryshme të Tepelenës si në atë të Krahësit, Buzit, Dervenit, si dhe në qendër në Tepelenë, mori jetë formimi i një batalioni, në përbërje të të cilit u përfshinë çeta "Naim Frashëri", çeta "Selam Musai" që vepronin në nënprefekturën e Tepelenës¹⁵ dhe formacione të tjera.

Në morinë e takimeve për krijimin e batalionit, përmes debatesh, u diskutua edhe çështja e emërtesës së batalionit si dhe e drejtuesve kryesor të tij. Shumica e pjesëmarrësve ranë në një emërues të përbashkët që batalionit t'i jepej emri "Baba Abaz", kurse drejtimi i tij t'i besohej klerikut tjetër bektashian, Baba Fejzo, i teqesë së Harakopit, me zëvendës intelektualin bektashi të teqes së Toçit, Zenel Shehu. Këto zhvillime ishin tregues për atë që bektashinjtë kishin bërë në kuadrin e luftës antifashiste, për reputacionin që kishin siguruar, por edhe për besimin që kishin për vazhdimësinë, duke i konsideruar ata një nga faktorët parësor në suksesin e luftës.

Vlerësimet për institucionet dhe klerikët bektashian, i gjejmë edhe në periudhën e parë të Pasçlirimit. Kryesia e Këshillit Nacionalçlirimtar i dha Teqes së Rabijes “Medaljen e Trimërisë”, me motivacionin "...shembull qëndrese dhe vetmohimi në luftra të ndryshme kundër okupatorit"¹⁶. Në rrjedhën e kohës, në periudhën Komuniste e Poskomuniste, kjo ngjarje thjesht është përkujtuar në raste përvjetorësh, ku janë prezantuar ndonjë kumtesë shkencore apo shkrime në publicistikë, të cilat, në tërësinë e tyre, qëndrojnë larg vlerave historike që ajo mbart. Masakra e Rabijes është e krahasueshme me të tjera në rang vendi ku duhen përmendur ajo e Borovës, Pezës etj, ku vëmendja e pushteteve qendrore e vendore ka qenë më e

¹³Nuri Cuni, Naim Dëra, vepër e cituar, f. 227.

¹⁴Feti Zeneli, Gazeta “Tema”, 23 korrik 2023.

¹⁵Benard Zotaj, *Kontributi i popullit të Tepelenës gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Gazeta Telegraf, 10 shtator 2018.

¹⁶AQSH, Fondi i komunitetit bektashian, dos. Nr. 4, viti 1946.

fokusuar, por edhe më të ngjashme në kuadrin e Luftës së Dytë Borërore. Do të veçonim atë të fshatit Oradur në krahinën e Limozhit, Francë, kur më 10 qershor 1944 nazistët gjermanë masakruan 643 civilë, fshat të cilin presidenti francez i kohës, Charl De Gol e shndërroi në muze¹⁷.

Duke marrë në konsideratë vlerat shumëdimensionale të masakrës së Rabijes, ngritja e një muzeu të tipit Oradurit, i cili, për nga vlerat antifashiste, por dhe bektashiane, do të jetë pamëdyshje një destinacion turistik nga më të kërkuarit jo vetëm për zonën, por për mbarë vendin.

Nuk do ta ekzagjeronim të pohojmë se bektashinjtë e prefekturës së Gjirokastrës gjatë gjithë harkut kohor të zhvillimit të Luftës Antifashiste, ishin një faktor i dallueshëm mobilizimi shpirtëror, kulturor, shoqëror, kombëtar e politik, me një vend të merituar për rivendosjen e pavarsisë dhe instalimin e një regjimi demokratik.

¹⁷Feti Zeneli, Gazeta “Tema”, 23 korrik, 2023.

KOINONI KAON I MALÇANIT DHE BASHKËSIA KAONE

Dhimitër Çondi¹, Erin Pitt (SHBA)², Andi Canaj³, Migen Shametaj (SHBA)⁴

¹Universiteti “Eqrem Çabej”

e-mail: dhimitercondi@gmail.com

Abstrakt

Arkeologjia na ndihmon për të parë procesin e organizimit të Kaonisë, jo vetëm të qyteteve, por dhe të territorit përreth tyre të organizuar në një centralizëm hierarkik të qartë. Të dhënat e përfituara tregojnë se Kaonia ndahet nga Mali i Gjerë në dy territore. Në secilën nga këto territore kemi qendrën e vet administrative – politike. Foinike në perëndim dhe Antigonea në lindje, korrespondojnë me ndarjen reale etnike brenda etnosit kaon. E njohur kjo nga fondet epigrafike ku strukturat politike në nivele të ndryshme është norma e qeverisjes në Koinonin e Epirotëve (232 – 170 p.Kr.), ndoshta edhe më përpara. Duke mos pasur të dhëna burimore për Kaonin do të bëjmë paralelizma me territoret përreth saj, në organizimin hierarkikë të tyre, për të cilat ka burime epigrafike. Organizimi i tyre, ne etnos, i cilësuar shpesh si Koinon që përbën një kuadër më të gjerë dhe më të mirë në përshtatje ndaj jetës baritore, që bënte një pjesë e rëndësishme e popullsisë. Territoret Kaone kanë struktura të njëjta administrative territoriale. Në qendër të organizimit janë qytetet e fuqishme të vendosura në lartësi jo të mëdha dhe përreth tyre në zona më të vogla fiziko-gjeografike ngrihen qytezat e fortifikuara që kanë ngjajshmëri me qytetin e madh, se janë të fortifikuara, por kanë sipërfaqe më të vogla dhe lartësi më të madhe të lidhura dhe të komunikueshme me fushat përreth, si edhe qytetet e mëdha.

Fjalët kyç: arkeologji, Koinoni i Epirotëve, Kaon

Abstract

Archaeology allows us to observe how Chaonia was organized, with the cities and surrounding area arranged in a distinct hierarchical centralism. According to the data obtained, Chaonia is separated into two regions from the Wide Mountain. Each of these regions has a political and administrative center of its own. The actual ethnic split within the Chaonian ethnos is represented by Foinike in the west and Antigonea in the east. This is known from the epigraphic sources, where the Epirote League (232–170 BC) or possibly earlier had political organizations at various levels as the standard of governance. Since we lack precise data on Chaonia, we shall compare it to the surrounding regions, which have epigraphic sources for its hierarchical structure. Their organization, in ethnos, known as Koinon, provides a more comprehensive and improved structure for adjusting to the pastoral lifestyle, which was a significant aspect of the people. The territorial administrative structures of Chaonia territories are identical.

Powerful cities at low elevations form the organization's core, and around them in smaller physical-geographical areas, fortified towns are built. These towns are similar to the big city in that they are fortified, but they have higher elevations and smaller areas that are connected to and communicate with both the large cities and the surrounding plains.

Keywords: *archaeology, Koinon of the Epirotes, Kaon*

Arkeologjia na ndihmon për të parë procesin e organizimit të Kaonisë, jo vetëm të qyteteve, por dhe të territorit përreth tyre, të organizuar në një centralizëm hierarkik të qartë.

Të dhënat e përfituara tregojnë se Kaonia ndahet nga Mali i Gjerë në dy territore. Në secilën nga këto territore kemi qendrën e vet administrative – politike. Foinike në perëndim dhe Antigonea në lindje korrespondojnë me ndarjen reale etnike brenda etnosit kaon. E njohur kjo nga fondet epigrafike ku strukturat politike në nivele të ndryshme është norma e qeverisjes në Koinonin e Epirotëve (232 – 170 p.Kr.), ndoshta edhe më përpara. Duke mos pasur të dhëna burimore për Kaonin do të bëjmë paralelizma me territoret përreth saj, në organizimin hierarkik të tyre, për të cilat ka burime epigrafike.

Organizimi i tyre, në etnos, i cilësuar shpesh si *Koinon* që përbën një kuadër më të gjerë dhe më të mirë në përshtatje ndaj jetës baritore, që bënte një pjesë e rëndësishme e popullsisë. Territoret Kaone kanë struktura të njëjta administrative territoriale. Në qendër të organizimit janë qytetet e fuqishme të vendosura në lartësi jo të mëdha dhe përreth tyre në zona më të vogla fiziko-gjeografike ngrihen qytezat e fortifikuara që kanë ngjajshmëri me qytetin e madh, se janë të fortifikuara, por kanë sipërfaqe më të vogla dhe lartësi më të madhe të lidhura dhe të komunikueshme me fushat përreth, si edhe qytetet e mëdha.

Në të dy territoret adaptohen të njëjtat struktura. Krahas një kryeqendre të përbashkët që ishte Foinike vijojnë dhe dy qytete të mëdha për çdo territor, Foinike e Antigonea. Më pas vijnë tri vendbanimet e fortifikuara që janë me sipërfaqe më të vogla se qytetet, si: Malçani dhe Melani për luginën e Drinosit, që kanë rreth tyre fortifikime të banuara, Paleomanastro e Ripës për Foiniken dhe Selo, Labovë e Ktizmata për luginën e Drinos. Për të plotësuar edhe më mirë tablonë e kontrollit të territorit shërbenin fortesat ose kullat e vrojtimit me karakter thjesht ushtarak në pozicione shumë strategjike për kontroll pamor të kufijve të territorit dhe rrugëkalimeve, si: Vagalat, Shën Gjini, Duka për Foiniken dhe Lekël e Ktizmata për luginën e Drinosit. Këto të fundit për vetë pozicionin e vendndodhjen kanë vlerë për hartën gjeografiko – administrative e politike për periudhën antike të Kaonisë. Këto fortifikime nuk janë thjesht në shërbim të nivelit territorial, por atij etnik për Koinonin Kaon.

Gjurmimet dhe sondazhet arkeologjike, të bëra vitet e fundit në një nga zonat më të pasura me vendbanime të fortifikuara pranë kryeqendrës kaone, Foinike, krijon mundësi të zgjerojmë të dhënat mbi këtë koinon, si dhe fatin e këtyre qytezave në periudhën antike.

Nëpërmjet studimit dhe botimit të materialit fortifikues urbanistik, arkitektonik e arkeologjik duam të plotësojmë disa aspekte pak të njohura të historisë politike dhe shoqërore të këtij koinoni. Pikësëpari, lidhja e këtyre fortifikimeve me një bashkësi të caktuar politike. Organizimi politik dhe shoqëror i kësaj bashkësie është një problem tjetër i rëndësishëm që arrihet nëpërmjet analizës dhe krahasimit të materialit arkeologjik të dalë nga gërmimet në qendrat e tjera të kësaj bashkësie.

Këto qyteza kanë tërhequr prej kohës vëmendjen e studimeve të arkitekturës antike, të cilët për mungesë të gërmimeve, studimet mbi fortifikimet kanë qenë kufizuar në përmendjen e teknikës së ndërtimit¹. Sondazhet arkeologjike në Malçan e Ripës japin mundësi që të trajtohet më gjerësisht ky aspekt i rëndësishëm i arkitekturës së këtyre qytezave dhe të shihet në një kuadër më të gjerë në raport me shtresat kulturore, arkitekturën shoqërore, organizimin politik etj.

Mikrozonat gjeografike të lidhura me vendbanimet antike japin mundësi që brenda trevës Kaone të veçohen disa nënndarje: zona qendrore, me Foiniken, Onhezmin, Metoqin e Çukën ku mbizotëronin zonat pjellore të lumenjve Kalasë e Bisticë. Fushën e begatë të rrjedhës së poshtme të Pavllës e liqenin e Butrintit i zotëronte qyteti antik i Butrintit, Çuka e Aitoit e Malathrea. Muri i Demës, Karalibeu e kulla e Vagalatit kontrollonin luginën të vogla, si dhe rrugët që i përshkonin ato. Krijonin një ndarje territoriale midis dy koinoneve, Foinikës dhe Butrintit. Bregdeti Jon përfshihet në qytezën e Himarës e Qafa e Pazarit (Hundecovë).

Malçani me Paleomanastron e Ripësit krijonin një koinon në luginën e sipërme të lumit Pavlla, që kontrollonin krahas luginës edhe rrugët. Karakteri blegtoral i këtij koinoni e shpreh nivelin kulturor e arkitekturor i qytezave.

Një nivel të lartë ekonomik, arkitekturor e kulturor evidentojmë në koinonin e Antigonesë në luginën pjellore të Drinos. Krahas qyteteve të Antigonesë e Melanit janë edhe qytezat e Leklit, Labovës e Selosë që kontrollonin rrugët që kalonin në këtë luginë.

Në këtë sistem mbrojtës, roli kryesor i Foinikës del nga pozita qendrore e saj, emërtimi i koinonit me emrin e vetë qytetit, cetralizimi i prerjeve të monedhave në këtë qytet, si dhe potenciali arkitekturor, urbanistik, kulturor e politik të Foinikes në Kaoni. Njëkohësisht qendrat e mëdha qytetare si Antigonea, Butrinti, Sopotit e Malçani kishin autonominë e tyre brenda koinonit kaon². Kjo bëri që në një kohë shpërbërjeje të koinonit kaon, Butrinti të dilte si një njësi politike më vete, që identifikohet me koinonin e Prasaibëve. Gërmimet arkeologjike në Foinike, Butrint, Antigone, Sopot,

¹ L.M. Ugolini, *Albania Antica I*. N.G.L. Hammond, Epirus, Dh. Budina, Harta arkeologjike e Bregdetit Jon dhe Pellgut të Delvinës, Iliria I, Tiranë, 1971, fq. 275-337. Dh. Budina, Harta arkeologjike e luginës së Drinosit "Iliria", Tiranë, 1974, 3, fq. 344-379. A. Baçe, Vështrimi mbi qendrat e banuara dhe mesjetare në luginën e Drinos (Gjirokastër) "Monumentet", Tiranë, 1972, 4, fq. 103-131.

²N.Ceka, Fortifikimet antike të bashkësisë Byline, Iliria, 1940, 1, fq. 99-144.

Melan, Malçan etj., krijojnë mundësi të trajtohet gjerësisht ky aspekt i rëndësishëm i arkitekturës së qendrave qytetare kaone dhe të shihet në një kuadër.

Malçani³

Qyteza antike shtrihej mbi kodrën që mban sot emrin Ilias, një formacion gëlqeror me lartësi 650 metra, në jugperëndim të fshatit Malçan. Një qafë e vogël e ndan nga veriu me malin e Zimarit. Nga jugu e perëndimi kalon përroi i thellë i Shkallës dhe lugina e ngushtë e Orosit. Nga lindja, jugu e perëndimi kodra përfundon në një thepisje të theksuar që vështirëson ngjitjen për në qytezë dhe që mund të realizohet vetëm nga ana verilindore.

Relievi i kodrës përmbushte një varg kërkesash të rëndësishme për ndërtimin e një qyteze antike. Së pari, sipërfaqet e përshtatshme e të mjaftueshme për ndërtimin e banesave e ndërtesave shoqërore në tarracat e shpatit veriperëndimor e juglindor të përshtatshme për banim⁴. Tarracat, si edhe në qytetet e tjera të Kaonisë përforcoheshin nga mure mbështetës, të ndërtuara me blloqe gurësh. Humnerat, pjerrësia e thellë që pret tri anët veriperëndimore të kodrës, si dhe bjertjet e menjëhershme buzë formacioneve gëlqerore në anën jugore dhe jugperëndimore krijojnë një mbrojtje natyrore për sipërfaqen e banesave dhe lehtësonin fortifikimin e saj. Nga lartësia e kodrës së Ilias vështrimi kap një sipërfaqe të gjerë që përbënte në kohën antike sipërfaqen e këtij koinoni. Territori përreth kodrës është kodrinor me lartësi mesatare rreth 300 metra mbi nivelin e detit, mjaft i përshtatshëm për frutikulturë e drithëra dhe malor për blegtorinë.

Planimetria

Malçani është fortifikimi më i madh i këtij koinoni. Ai është ndërtuar, duke rrethuar ato pjesë të kodrës më të rrezikuara nga ndonjë sulm i mundshëm. Kryesisht ana lindore dhe veriore. Me një perimetër prej 1000 metra dhe sipërfaqe 110.400 m². planimetria është e thjeshtë, në formën e një trekëndëshi⁵.

Sistemi fortifikues në Malçan ruhet sot në gjendje relativisht të mirë që lejon një studim të tij. Karakteristikë themelore e fortifikimit në Malçan është mungesa e akropolit. Thjeshtësia e linjës së trasesë së mureve dhe një numër relativisht i madh i elementeve mbrojtëse dhe funksionale. Traseja e mureve me gjerësi 3.50 metra i përshtatet terrenit, duke u përforcuar me kulla mjaft pranë njëra-tjetrës në zonën e butë veriore e lindore.

Teknika e ndërtimit

³ L.M.Ugolini, Albania Antica I, N.G.L. Hammond, Epirus, Dh. Budina, Harta arkeologjike e Bregdetit Jon dhe Pellgut të Delvinës, Iliria I, Tiranë 1971, fq. 275-337. Dh. Budina, Harta arkeologjike. . . .309 – 311. Dh. Çondi, Phoinike IV, Bologna, 2005.

⁴ A. Baçe, V. Bushati. Vështrim mbi banesën prehistorike shqiptare në Iliri dhe Epir. “Monumentet”, 1989, 2, fq. 37-39.

⁵ Dh. Çondi, Phoinike IV, Bologna, 2005.

I gjithë fortifikimi antik i Malçanit është realizuar me teknikën katërkëndëshe izodomike. Struktura e murit formohet nga dy paretet blloqesh të punuara dhe mbushjes prej gurësh mesatarë e të vegjël të papunuar. Të dy paretet mbështeteshin mbi një themel prej blloqesh të papunuar të dala 0.10-0.20 metra përpara fasadës së murit. Në mjaft raste, muri mbështetet drejtpërdrejt mbi shkëmbin e punuar, duke u përputhur me fasadën e murit. Lidhja e strukturës sigurohej nëpërmjet mureve ndarëse, transversale, të vendosura 2.50-3 metra larg njëri-tjetrit. Gjerësia prej 0.45 metra e tyre përbëhej prej një blloku të vetëm. Blloqet skajore të mureve ndarëse lidhen në mënyrë të alternuar në të dy paretet e murit.

Gjerësia e murit rrethues është 3.50 metra, ndërsa në pjesën shkëmbore në përfundim ai ngushtohet deri në 2 metra. Fasada e murit ka një trajtim izodomik me blloqe katërkëndëshe e sipërfaqe ballore të gufmuar. Në të gjitha qoshtet e kullave ndeshen kanalet e peshimit.

Kullat

Janë në një numër të madh, 16 kulla të vendosura vetëm në krahun lindor e verilindor, më të ekspozuara nga sulmet. Ato janë të një tipi të veçantë. Janë të vendosura pranë njëra-tjetrës, në hyrje, kthesat e trasesë e të shkëputura në funksionin e hyrjeve.

Kullat kanë ndërtim të njëjtë. Formë katrore me brinjë 6.50 metra. Paretet anësore përbëhen nga dy radhë blloqesh të punuara me gjerësi 0.95 metra që veshin një mbushje me gurë të mëdhenj të papunuar që lidhet me paretet nga muret tërthore që përshkojnë kullën. Blloqet skajore të këtyre mureve dalin të alternuara në fasadë.

Fasadat e kullave janë të ndërtuar me blloqe kuadratike, me faqe të rrafshhtë dhe rreshtim izodomik në lartësi. Në këmbët e kullës ruhen gjurmët e vijave të peshimit. Vendosja e kullave në një terren të pjerrët bënte që midis pragut të hyrjes dhe fundit të fasadës të kishte një disnivel prej 2.3 metra.

Në fortifikimin e Malçanit kullat kanë funksion mbrojtje që shprehet nga vendosja e tyre në pjesën e mureve më të ekspozuara ndaj sulmeve. Kjo shprehet në përforcimin e mureve anësore të kullës, që kanë gjerësinë e dy blloqeve (0.95 m), në ndryshim nga gjerësia e një blloku të paretëve të murit rrethues.

Ky tip kulle në Malçan përfaqësohet nga ndërtimet mbi korridoret e hyrjeve me gjerësi 1.60 dhe 2.80 metra. Kjo kullë është e përhapur në Kaoni e të gjithë Epirin⁶ (Foinike, Butrint etj.).

Hyrjet

Të tri hyrjet janë ballore, të realizuara nga ndërprerja e trasesë së murit dhe të mbrojtura nga 1 ose 2 kulla. Ky tip hyrjeje, me kulla në krahë të tyre dhe

⁶ N. Ceka, Fortifikimi antik i Butrintit dhe i territorit të Prasaibëve. "Monumentet" 12, Tiranë, 1976, f. 26 – 30. Dh. Budina, Foinike në kërkimet e reja arkeologjike, "Iliria", 1986 – 1, f. 115.

ato mes dy kullave kanë një përdorim të gjerë në qytetet kaone⁷, si: në Antigone, Butrint, Lekël, Matohasanaj etj.

Hyrja dy është më e madhja e më e ruajtura. E vendosur në anën verilindore, në pjesën më të ulët të qytetit, siguron lidhjen me territorin përreth, kryeqendrën Fonike e qytezat fqinje Ripësi e Palomanastrio. Hyrja mbrohet nga dy kulla simetrike të vendosura në të dy anët e saj. Ato kanë format drejtkëndëshi të rregullt me përmasa 5.80 x 5 m, 5.80 x 4 m. Korridor i hyrjes, i formuar nga muret anësore të kullave, është i gjatë 7 metra, ndërsa gjerësia 2.85 metra. Në distancën prej 3.20 metra ka gjurmët e 3 radhë shkallëve të lidhura konstruktivisht me muret anësore, të cilët kanë të gdhendura gropat ku fiksohej lloji i portës.

Hyrja 1. E mbrojtur nga dy kulla të vendosura në dy anët e saj përbrenda mureve rrethues, në anën veriore, pjesa më e lartë shkëmbore e qytetit. Ka një gjerësi 1.60 metra dhe një korridor të gjatë 6.50 metra. Hyrja për vetë terrenin shëmbor është realizuar me shkallare. Në gjatësinë prej 3 metra të korridorit, ruhet pragu monolit i portës me elementet e fiksimit majtas saj, që tregon se porta mbyllej me një kanat të vetëm.

Hyrja 2. Ndodhet në anën lindore të qytetit e mbrojtur nga një kullë e vendosur në të majtë të saj. Ka luajtur rolin e një porte kundërsulmi, por dhe të një komunikimi me nekropolin e qytetit që shtrihej në shpatin lindor të kodrës. Pozicioni i vendosjes së hyrjes është i fshehur nga vështrimi i sulmeve të mundshme. Korridor i me gjatësi 3 metra, zgjerohej nga 0.95 metra në hyrje në 1.20 metra në fund të tij. Gjerësia e vogël e hyrjes na lejon të mendojmë se mbulimi i saj ka qenë bërë me arkitrarë guri.

Hyrjet ballore përsosen nga fundi i shek. IV p.e.s. dhe kryesisht në fillim të shek. III p.e.s. kur lidhen me tipin e hyrjeve ballore të vendosura midis dy kullave, si në Butrint⁸ e Antigone⁹.

Urbanistika e banesat në Malçan

Urbanistika

Malçani është një qytet pa akropol, i vendosur në një pllajë kodre. Mungesa e arkropolit në një qytet të ndërtuar “ex novo”, siç është Malçani, shpreh, gjithashtu, një koncept të caktuar urbanistik, kur akropoli ende nuk përbënte një pjesë organike në trajtimin e hapësirës brenda mureve. Kjo është tipike për tërë qytetet epirote të shek. IV p.e.s., në rastet ku mungonte një bërthamë e vjetër e qytetit, rreth së cilës të zgjerohej pjesa e re e tij, në rastin e Butrintit apo Foinikes.

⁷ N. Ceka, Po aty. f.26 – 30. Dh. Budina. Antigonea, “Iliria” II, Tiranë 1972, f. 255 – 361. A. Baçe, Kullat, dhëmbëzimet dhe platformat, për artileri të fortifikimeve në Iliri. Monumentet, 1987, 2, f. 5 – 55. A. Baçe, Vështrim mbi qendrat e banuara antike dhe mesjetare në luginën e Drinosit (Gjirokastrë), “Monumentet”, Tiranë, 1972, 4, f. 103 – 131.

⁸ N. Ceka. Fortifikimi ... f. 27 – 48.

⁹ Dh. Budina, Antigonea... f. 255- 361.

Ekzistenca në Malçan e një ideje urbanistike është akoma herët për të dhënë një mendim të plotë. Gërmimet e viteve të fundit¹⁰ dhe vrojtimet e kujdesshme na dhanë elemente të rëndësishme për të. Më të sigurt jemi për ndarjen e sipërfaqes prej 11 ha të qytetit në ato kryesore: shoqërore, të banuar dhe e rezervuar (eukorioni).

Zona e banuar zë 2/3 e sipërfaqes me shtrirje në pjesën qendrore veriore e shpatet që zbresin drejt verilindjes. Euhorioni zinte diçka më pak se ½ dhe shtrihej në krejt pjesën juglindore të kodrës. Ai ka shërbyer si rezervuar për strehimin e popullsisë fshatare përreth me krejt pasurinë e tundshme të saj në rast rreziku.

Nga gërmimet e vrojtimit sipërfaqësore të kryera nga ana jonë evidentuam të dhëna për tipologjinë dhe mënyrën e vendosjes së banesave, ku parimi themelor është ai mbi bazë terrace me dalje nga rruga kryesore¹¹. Janë të vendosura njëra pas tjetrës në disnivele nga veriu në jug dhe në të njëjtin drejtim, e kondicionuar kjo nga terreni.

Zbatimi i sistemit ortogonal është bazuar në kriterin për strigas, që presupozon krijimin e insulave të zgjatura me dy radhë shtëpish midis rrugëve kryesore¹². Format jo të rregullta të terrenit me kurrize, shpate e pjerrësi të ndryshme kanë bërë që sistemi ortogonal të gjejë një zgjidhje të veçantë. Ai siguron shfrytëzimin sa më të plotë të sipërfaqeve të banuara dhe qarkullimin më të lehtë midis tyre apo ndërmjet zonave të qytetit. E arritur nga orientimi i insulave, duke eliminuar vështirësitë e terrenit. Kemi dy plati. Aksin qendror e përbën plati katër, që zë pjesën qendrore të kodrës dhe më të përshtatshme për banim. Ajo ka gjerësi 100 m dhe lidhet drejtpërdrejt me platinë e 13-të. Largësia prej 40 metra midis dy platiave na jep gjerësinë e mundshme të insulave të anës.

Nga gjurmët e mureve vihen re se insulat ndahen midis dy radhë banesash që kanë gjerësi 34 ose 35 metra. Kjo presupozon dhe ekzistencën e rrugicave ndarëse midis tyre, të cilat shërbenin për mbledhjen e ujërave apo kufizimin e zjarreve të mundshme.

Gjurmët që ruhen dëshmojnë se ritmi i insulave dhe i rrugëve përsëritet pa dyshim drejt veriperëndimit.

Qyteti intensitetin më të madh të banimit e pati në shek. III-II p.e.s. Në antikitetin e vonë, kjo pjesë u braktis plotësisht dhe mbeti jashtë murit rrethues të kësaj kohe. Shembullin më të afërt me Malçanin në zbatimin e kritereve urbanistike në qytetet kaone e gjejmë në Antigone. Ky qytet na jep si terminus të sigurt vitin 297 p.e.s.

¹⁰ Dh. Çondi, Raport gërmimi në Malçan, viti 1989, 1990. Arkivi i BASH-së, Sarandë.

¹¹ A. Baçe, V. Bushati, Vështrim mbi banesën prehistorike shqiptare në Iliri dhe Epir. "Monumentet", Tiranë, 1989, 2, f. 37 – 39.

¹² W. Hoepfner – E.L. Schöndner. Haus und Stadt im Klassischen, Munchen, 1986, fq.34.

Duke qëndruar në një ambient epirot, kriteret urbanistike të Malçanit reflektojnë dhe ndryshimet që ndodhën në organizimin hapësinor të qyteteve epirote.

Paleomanastri (Karoq)¹³

Qyteza e dytë për nga madhësia në trevën e këtij koinoni është vendbanimi që ngrihet në kodrën e Paleomanastrit, 3 km në perëndim të fshatit Karoq. Ajo është vazhdimi i vargut malor të Këlcyrës që shtrihet pranë Ripësit e përfundon në veri dhe lindje me një shpat shkëmbor mjaft të thepisur ku rrjedh një degë e thellë dhe e ngushtë e lumit Pavlla. Në anën jugore shtrihet lugina e Manehorit dhe përroit Vranja që derdhet në lumin Pavlla.

Pozicioni dominues i kodrës me lartësi 457 metra ku ngrihet qyteza, kap një hapësirë të gjerë vrojtimi nga veriu, jugu dhe perëndimi, duke kontrolluar krejt sipërfaqen e territorit që përfshihej nën juridiksionin e saj.

Planimetria e qytezës, me sipërfaqe 4 ha dhe perimetër 530 m, i përshtatet formës katërkëndëshe që kapet në kreshtën shkëmbore të kodrës në veri dhe lindje, për t'u varur në shpat të saj që shkon nga jugu e perëndimi. Disa tarraca natyrore përmbushin një varg kërkeshash të rëndësishme për ndërtimin urbanistik të qytezës në antikitet.

Qyteza e Paleomanastrit karakterizohet nga mungesa e akropolit dhe e kullave¹⁴. Traseja e mureve i përshtatet terrenit nëpërmjet kthesave me kënd të gjerë, mjaft larg njëra-tjetrës në zonat e rrafshëta të anës lindore e perëndimore. Apo përdorimi i kthesave kënddrejta në distanca të shkurtra, në ngjitjen e anës jugore, ku shënohet një linjë në formë dhëmbësh sharre. Tipike janë shtatë dhëmbëzimet e anës jugore, që shërbejnë njësoj si në Foinike¹⁵ etj., për të shtuar qëndrueshmërinë e murit.

Muri fortifikues me gjerësi 2.50 metra ndiqet në të gjithë gjatësinë e tij me teknikën katërkëndëshe izodomike. Struktura e murit formohet nga dy parete prej blloqesh me forma paralelepipedi dhe mbushjes prej gurësh mesatarë e të vegjël të papunuar. Të dy paretet mbështeteshin mbi një themel në shkëmbin natyral të përgatitur për këtë qëllim. Lidhja e strukturës sigurohej nëpërmjet mureve ndarëse transversale, të vendosura 2.50-3 metra larg njëri-tjetrit. Fugaturat ndërmjet blloqeve ndjekin rregullisht vijën horizontale dhe vertikale. Një veçanti e këtij fortifikimi që nuk e ndeshim në fortifikimet e tjera, është alternimi i rreshtave të blloqeve me trashësi të ndryshme ku krahas blloqeve me trashësi 0.45 m kemi edhe blloqe paralelepipedi me trashësi më të hollë, si rezultat i shtresave në gurorë.

¹³ N. G. L. Hammond, Epirus, Dh. Budina, Harta arkeologjike ... f. 313 – 314. Dh. Çondi, Phoinike IV, Bologna, 2005.

¹⁴ N. Ceka, Fortifikimi antik i Butrintit dhe i territorit të Prasaibëve, "Monumentet" 12, Tiranë, 1976, f. 29-30.

¹⁵ Dh. Budina, Foinike në kërkimet e reja arkeologjike, "Iliria", Tiranë, 1986 – 1, f. 115.

Hyrjet

Janë dy, ballore të realizuara nga ndërprerja e trasesë së murit rrethues. Ajo kryesore ndodhet në anën jugore rreth. 3.3 metra larg kthesës së parë, me gjerësi 2.20 metra. Ka korridor të thellë 5.50 metra në të dy anët e të cilit ngrihen dy trakte muresh me lartësi 2.60 metra. Ai në të djathtë të hyrjes merr elemente arkitekturore të portës me qemer, e ngjashme me ato të Çukës së Aitoit, Malathresë e të vilës në fshatin Çukë.

Hyrja jugperëndimore me gjerësi 1.70 metra ballore, me korridor të realizuar nga zgjatja e mureve që ruajnë lartësinë 2.38 metra e krahut të majtë e 2.10 metra e krahut tjetër. Njëpërmjet kësaj hyrjeje qyteza komunikonte me luginën e Manaehorit.

Në mungesë të gërmimeve nuk mund të shprehemi plotësisht për sistemin urbanistik dhe banesat në Paleomanastër. Traktet e mureve të fuqishme, tarracimi dhe ato të banesave që ruhen në sipërfaqe, flasin për platformat dhe banesat e organizuara mbi bazë tarrace njëra pas tjetrës në disnivele nga lindja në perëndim, me dalje nga rrugët kryesore e drejtim veri-jug. Karakteristikë kjo për gjithë qytetet kaone, si: Foinike¹⁶, Çukë e Aitoit, Sopot, Malçan etj.

Materiali arkitektonik dhe ai arkeologjik që është mjaft i varfër e vendosin qytezën e Pleomanastrit të njëkohshme me dy qytezat e tjera të këtij koinoni. Njëkohësisht, për nga rëndësia dhe funksioni renditet e dyta pas qytezës së Malçanit që kryente funksionin e kryeqendrës së koinonit.

Qyteza e Ripësit¹⁷

Kodra e Ripësit me kuotë 510 metra ndodhet 2.5 km në juglindje të fshatit Zminec, në krahun e djathtë të rrjedhjes së sipërme të lumit Pavëll. Qafa e ngushtë e Qesarajt në veri e lidh me malin Xhendilla. Në perëndim, në rrëzë të kodrës, është përroi i thellë e i ngushtë i Sinosit, që krijon një thyerje të pakalueshme shkëmbore. Pjesa jugore, më pak e mbrojtur nga natyra, është përforcuar me mure fortifikues. Kushtet gjeografike, mbrojtja strategjike dhe roli dominues mbi zonën përreth realizuan ngritjen e kësaj qyteze. Sipërfaqja prej 3 ha e vendbanimit shtrihet në dy tarraca natyrale të përshtatshme për ndërtim. Planimetria në formë të përafërt katërkëndëshe ku alternohet shkëmbi i thepisur natyral me fortifikimin e anës jugore e lindore të kodrës.

Qyteza e Ripësit është pa akropol e kulla, me trase të drejtë e të gjatë 200 m dhe një numër relativisht të vogël të elementeve mbrojtëse dhe funksionale. Traseja e mureve i përshtatet terrenit njëpërmjet kthesave me kënd të gjerë e të drejtë mjaft larg njëra-tjetrës në lindje, verilindje e juglindje. Ana perëndimore e pafortifikuar nga një rënie e gjatë shkëmbore dhe mjaft e thepisur.

¹⁶ Dh. Çondi, Urbanistika dhe banesat me peristil në Foinike. “Monumentet”, Tiranë, 2004, f. 36 – 48.

¹⁷ N. G. L. Hammond, Epirus. Dh. Budina, Harta, f. 307. Dh. Budina, Kalaja e Ripësit, “Iliria” I, Tiranë 1972, f. 69 – 79. Dh. Çondi, Foinike IV, Bologna, 2005.

Hyrja kryesore e qytezës gjendet në anën juglindore, në drejtim të qafës nga kalonte rruga kryesore. Ajo është e vendosur në mesin e gjatësisë së murit juglindor. Ka korridor të thellë, i realizuar nga zgjatimi i dy mureve, njëri në pjesën e brendshme e tjetri në të jashtmen, me gjerësi 1 metër. Elementet arkitekturore flasin për një hyrje të ngjashme me të Liqenit e të Luanit në qytetin antik të Butrintit.

Një hyrje e dytë rreth 1 metër e gjerë dhe 3 metra e thellë, në murin verilindor shërbente për lëvizje të kufizuara ose si portë sulmi. Është ballore, me korridor sa gjerësia e murit.

Periudha e parë e ndërtimit përfaqësonte, pothuajse, në të gjithë planimetrinë e fortifikimit. Trakti më i ruajtur gjendet në anën juglindore me gjatësi 125 metra e trashësi 2.50-3 metra, ndërsa lartësia shkon nga 0.70-40 metra. Muri formohet nga dy Parete me blloqe gëlqerore të punuara dhe mbushje me gurë të vegjël dhe mesatarë. Lidhja e mbushjes me paretet realizohet me anë të mureve transversale, të vendosura çdo 2.50 metra. Fasada është punuar me blloqe trapezore dhe tepër rrallë poligonale, të vendosura në rreshta, ku linjat horizontale, të të cilave thyhen vazhdimisht për shkak të lartësisë së pabarabartë të blloqeve. Për plotësimin e hapësirave që krijohen midis tyre janë përdorur gjerësisht plotësimet me gurë të vegjël apo bëhen shkallëzime në sipërfaqet horizontale të blloqeve. Si themel i murit ka shërbyer drejtpërdrejt shkëmbi natyral ose sipërfaqja e përgatitur më përpara për këtë qëllim.

Për nga teknika, muri ka ngjashmëri me fortifikimet e tjera Epirote, si Çuka e Aitoit, Paleomanastro etj., të datuara në fund të shek. IV para Krishtit.

Periudha e dytë përfaqësohet nga një bastion (kullë) e ngritur në pjesën e jashtme të murit në skajin verilindor të qytezës. Ka formën e gjysmërrethit me një diametër prej 20 metra. Trashësia është 1.60 metra dhe lartësia 2.20 metër, i palidhur konstruktivisht me muret fortifikuese. Muri formohet nga blloqe gurësh më të vegjël dhe më pak të punuar. Kemi të bëjmë me trakte të rindërtuara ku janë përdorur blloqe të periudhës së parë, duke i përpunuar me çekan faqen e jashtme për unifikimin e fasadës. Të njëkohshme me këtë janë edhe muret me gjerësi 1.70 m që rrethojnë sheshin e vogël të majës së qytezës, duke mos u lidhur konstruktivisht me murin rrethues. I njëjti kontruksion me bastionin në juglindje, në anën e jashtme të murit rrethues. Rrethimi i mësipërm krijonte ndoshta një vend për mbrojtjen e fundit të banorëve të qytezës, në kuptimin e një akropoli të vogël.

I kësaj periudhe është dhe një pjesë e murit në jugperëndim të qytezës. Arkitektura dhe teknika e ndërtimit flasin për një periudhë më të vonshme shek. II-I para Krishtit.

Për elementet urbanistike dhe banesat të dhënat e deritanishme nuk hedhin dritë të mjaftueshme. Gërmimet e ardhshme do të plotësojnë këto elemente të pazbuluara deri tani.

Materiali fortifikues, ai arkeologjik e numizmatik e datojnë Ripësin në fund të shek. IV para Krishtit, duke pasur zhvillimin më intensiv të jetës në shek. III-II para Krishtit, e shprehur kjo në krejt territorin e Epirit.

Si në të gjitha koinonet kaone edhe koinoni i Malçanit ka të njëjtën strukturë territoriale dhe si kryeqendër ka qytetin e Malçanit. Vendbanimet e fortifikuara janë Paleomanastro e Ripësi. Gjithashtu, ekzistojnë edhe vendbanime të hapura, të lidhura me shfrytëzimin e territorit si vendbanime me karakter bujqësor dhe blegtoral.

Vendbanimi i hapur Kapricë¹⁸ (Cerkovicë)

Ky vendbanim ndodhet në jugperëndim të malit Shtrina, duke zbritur poshtë në drejtim të përroit “Kallamioni”. Në disa tarraca takohen mure që formojnë ambiente të ndryshme të ndërtuara me blloqe gurësh. Shumica e ambienteve janë shkatërruar duke u kthyer në grumbuj blloqesh të copëtuara. Në sipërfaqe të tarracave takon fragmente tjegullash helenistike dhe romake, parete pitosash masive, fragmente qeramike të lyera me vernik të zi si dhe mjaft gurë peshash në formë konike. Datohet në periudhën helenistike dhe romake (III-II p.Kr. dhe I-II m.Kr.).

Vendbanim i hapur Palospitia¹⁹ (Cerkovicë)

Ky vendbanim ndodhet në veriperëndim të fshatit Cerkovicë, rrëzë malit Raqi, në vendin e quajtur Paleospitia. Në këtë vendbanim ruhen gjurmët e mureve të ndërtuara me blloqe gurësh të mëdhenj me përmasa 1 x 0, 63 m, 0,66 x 0, 49 m etj. Në sipërfaqe ka qeramikë helenistike. Datohet në shek. II – III p.Kr.

Vendbanim i hapur Pikadhuli²⁰ (Cerkovicë)

Vendbanimi i Pikadhulit ndodhet në veri të Paloespitos dhe ka gjurmë muresh me blloqe gurësh në forma të rregullta pralelepipedi. Në sipërfaqe ka fragmente qeramike helenistike. Datohet në shek. III – II p.Kr.

Një strukturë tjetër janë banesat e fortifikuara – vila, me vlerë prodhuese dhe rezidenciale, të rrethuara me mure e të ngritura në kodra pranë fushës, që kishin funksion bujqësor dhe blegtoral, duke shfrytëzuar pasuritë natyrore të territorit.

Ato ngrihen pranë arterieve kryesore të rrugëve duke realizuar dhe funksionin e kontrollit të tyre.

Banesa e fortifikuar-vilë në Cerkovicë, Panaja

Pozicioni gjeografik

Lugina e sipërme e lumit “Pavla”, që krijon një zonë fiziko-gjeografike të veçantë në antikitet, me qytezën e Malçanit dhe vendbanimet e fortifikuara Paleomanastro e Ripës. Pikat e kontrollit të territorit, si Shëngjini e Duka

¹⁸ Dh. Budina, Harta . . . f. 311. Dh. Çondi, Sërvej në zonën e Malçanit 1989 -1990, Raport në ABSH, Sarandë.

¹⁹ Dh. Budina, Po aty, f. 312. Dh. Dh. Çondi, Sërvej në zonën e Malçanit 1989 - 1990, Raport në ABSH, Sarandë.

²⁰ Dh. Budina, Po aty, f. 312. Dh. Dh. Çondi, Sërvej në zonën e Malçanit 1989 - 1990, Raport në ABSH, Sarandë.

dhe vendbanimet bujqësoro-blegtorale, të vendosura në kodra të ulëta (vilat e fortifikuara) në Cercovicë (Panaja) krijojnë një koinon të veçantë nën juridiksionin e Foinikes.

Pranë fshatit Cercovicë, në një kodër të vogël, por zotëruese, në një sipërfaqe të përshtatshme për bujqësinë dhe masive malore, me kullota të pasura, ruhen gjurmët e një banese të fortifikuara-vilë²¹, e cila u vizitua nga ana jonë, me gjithë dëmtimin e riparueshëm²², si rezultat i ndërtimit të një kishe, e quajtur “Panaja”, në të cilën janë përdorur materialet e banesës antike.

Mbi sipërfaqen e kodrës gjendet i shpërndarë një material i konsidrueshëm arkeologjik, i periudhës helenistike dhe asaj romake. Ky material flet për dy fazat e ndërtimit: faza e parë në shek. III-I p. Kr dhe ajo e dytë në shek. I-III m. Kr.

Faza e parë e ndërtimit (shek. III-I p. Kr.)

Arkitektura

E theksojmë se nuk janë kryer gjurmime arkeologjike, por të dhënat që kemi vijnë nga një mbikëqyrje sipërfaqësore dhe nga thëniet e më të moshuarve. Më e ruajtur është arkitektura e ndërtesës kryesore, nga e cila më të qartë janë traktet verilindorë dhe juglindorë, ndërsa dy traktet e tjera janë mjaft të dëmtuara. Këto trakte muresh ngrihen në qendër të sipërfaqes së kodrës, duke krijuar një katror, me dimensione 11 x 11 metra.

Muret janë ndërtuar me blloqe gurësh gëlqerorë, me forma paralelepipedit, të punuara me mjaft kujdes. Ai është dygurësh, me trashësi 1 metër. Nëpër kënde ka gjurmët e vijave të peshimit. Në sipërfaqen përreth nuk ka gjurmë të murit perimetrik. Kodra konfigurohet në formën e një katërkëndëshi me dimensione të përafërta me vilat e gërmuara nga ana jonë në Kaoni²³.

Materiali arkeologjik, i mbledhur në sipërfaqe, plotëson së bashku me arkitekturën kronologjinë e fazës së parë të ndërtimit.

Faza e dytë e ndërtimit (shek. I-III m. Kr.)

Për periudhën e dytë të jetës, atë romake, nuk kemi elemente arkitektonike. Kjo dëshkohet nga materiali arkeologjik, qeramika e periudhës romake, e mbledhur në sipërfaqe të banesës, që përfaqëson një numër të konsiderueshëm fragmentesh në një sasi më të madhe se ajo helenistike, gjë që shpreh rritjen e aktivitetit ekonomik të saj në fazën e dytë, atë romake.

²¹ Dh.Budina, Harta arkeologjike e Bregdetit Jon dhe e Pellgut të Delvinës, “Iliria” I, 1971, f. 311 (e konsideruar një tempull i ngjashëm me atë të Metoqit (vilën).

²² Me qëllim verifikimin e të dhënave të Budinës dhe krahasimi që bëhej me Vilën e Metoqit, të cilën e konsideronte Tempull, shkruam gjatë periudhës së gërmimit në Malcan, në vitin 1989 dhe evidentuam një banesë të fortifikuar-vilë. Raporti: “Gërmimi në Malcan”, 1989-991, ABA, Sarandë.

²³ Dh.Condi, Banosat..., f. 168-175.

Gërmimet e nevojshme arkeologjike në këtë banesë do të japin elemente të reja arkitekturore, kulturore e të aktivitetit social-ekonomik të saj në një territor ku mbizotëron ekonomia blegtorale²⁴.

Koinoni i Malçanit bën pjesë në territorin perëndimor të Kaonisë dhe ishte në juridiksionin të Koinonit Qendror të Foinikes. Ai kishte një autonomi në veprimtaritë e këtij territori. Si kryeqendër e këtij Koinoni ishte qyteti i Malçanit, si një vendbanim i fortifikuar dhe qytezat e Paleomanastros e Ripësit, si fortifikime të banuara. Ky koinon duke qenë në territorin kufitar të Kaonisë me Thesprotinë e kishte të domosdoshme ndërtimin në lartësi strategjike të pikave kufitare të vrojtimit me fushëpamje të gjerë të fortesave dhe kullave që kontrollonin dhe vrojtonin kufirin dhe rrugëkalimet e territorit ku ato ngriheshin. Këto fortesa dhe kulla vrojtimi nuk kishin karakter thjesht territorial të tribuve ku ndodheshin, por edhe karakter etnik në funksion të Kaonisë.

Fortesa e Dukës²⁵ (Zminec)

Ngrihet mbi kodrën e Dukës pranë fshatit Zminec ku ekzistojnë gjurmët e një fortifikimi të vogël. Kodra është shkëmbore dhe ka një sipërfaqe të sheshtë në majë të saj. Përreth sheshit ruhen gjurmët e një muri rrethues të realizuar nga blloqe antike, me forma të rregullta paralelepiedi e të një muri të hershëm, që është i shkatërruar plotësisht. Nga forma e blloqeve të copëtuara, fortesa datohet në shek. III p.Kr. Ajo ka shërbyer me funksione vrojtimi e kontrolli të kufirit si dhe kontrollonte kalimet në këtë territor kufitar midis koinonit kaon dhe atij thesprot.

Fortesa e Shën Gjinit²⁶ (Karroq)

Ndodhet rreth 3 km në juglindje të fshatit Karroq. Sot duken muret e një forte me formë katërkëndëshe kënddrejtë me gjatësi 80 m dhe gjerësi rreth 40 m. Pjesa perëndimore është mjaft e thepisur dhe shërben si kufi lindor i luginës së Kalcidës, që arrin në afërsi të Paleomanastros. Nga jugu dhe juglindja kalon përroi “Vranja” që kalon në Greqi. Muret që rrethojnë kodrën me gjatësi 60 metra, trashësi 2,21 metra e lartësi 1,3 metër janë ndërtuar me blloqe gurësh të mëdhenj, me forma paralelepiedi me përmasa 2,5 x 0,6 m, 1,4 x 0,45m. Ka ngjashmëri për nga teknika e ndërtimit me muret e Malçanit, Butrintit e Paleomanastron etj. Datohet në shek. III p.Kr. Edhe kjo fortesë ka kryer të njëjtën funksion si ajo e Dukës, pra, të kontrollit dhe vrojtimit të kufirit dhe rrugëkalimeve.

²⁴ Dh. Condi, Koinoni i Malçanit, Simpoziumi II Ndërkombëtar “Epiri antik, Kaonia”, Gjirokastër, 2005. (Në proces botimi); Dh. Condi, Il sito fortificato di Malcani e il Koinon dei Kaoni, PHOINIKE IV, f. 149-156.

²⁵ Dh. Budina, Harta . . . f. 307. Dh. Çondi, Sërvej në zonën e Malçanit 1989 -1990, Raport në ABSH, Sarandë.

²⁶ Dh. Budina, Harta . . . f. 312. Dh. Çondi, Sërvej në zonën e Malçanit 1989 -1990, Raport në ABSH, Sarandë.

Nuk kemi material epigrafik për mënyrën e funksionimit politiko – administrativ të këtij koinoni dhe lidhjet me atë qendror të Foinikes. Por nisur nga analogjia e bërë me fqinjët ku ka burime epigrafike, këto tribu kishin organizimin e tyre autonom administrativ dhe përfaqësoheshin drejtpërsëdrejti në nivelet më të larta. Ata kanë formë organizative territoriale të vogla me magjistratët e tyre (Prostatët), që integrohen brenda komuniteteve më të mëdha.

KAONIA: VËSHTRIM HISTORIK DHE ARKEOLOGJIK

Dhimitër Çondi¹, Erin Pitt (SHBA)², Andi Canaj³, Migen Shametaj (SHBA)⁴

¹Universiteti "Eqrem Çabej"
e-mail: dhimitercondi@gmail.com

Abstrakt

Kaonia zë gjithë zonën e bregdetin jonian, duke nisur nga lumi Thiamis (Kallamas), deri në malet Akrokeraune (Karaburun), në veri lumi Aaos (Vjosa), i cili ndan Kaonët nga Ilirët; në lindje Kaonët janë fqinj me Parauejt në luginën e mesme të lumit Aaos midis degës së Sarandaporos dhe grykave të Aaos mbi Tepelenë; më në juglindje, Kaonët janë fqinjë me Molosët, ndërsa në jug, janë Thesprotët, që ndajnë me Kaonët krahinën e Kestrinës, e cila shtrihet midis luginës së Thiamisit dhe asaj të Pavlës. Kaonët jetojnë kryesisht përreth dy pellgjeve lumore, luginës së Drinosit në lindje dhe luginës së Bisticës, e cila përfundon në jug me liqenin e Butrintit. Secili nga këto pellgje, në antikitet, kish një kryeqendër të tijën: qyteti i Antigonesë ishte e pellgut të Drinos, ndërsa ai i Foinikes ishte qendër e pellgut të Bisticës.

Fjalët kyç: Aaos, Vjosa, Butrint, Kaoni, Akrokeraune

Abstract

Chaonia occupies the entire area of the Ionian coast, starting from the river Thiamis (Kallamas), up to the mountains Akrokeraune (Karaburun) in the north the river Aaos (Vjosa), which separates the Chaonians from the Illyrians; to the east the Kaons were neighbored by the Parauei in the middle valley of the (Aaos) Vjosa river between the tributary of the Sarandopor and the gorges of (Aaos) Vjosa above Tepelena; to the southeast, the Chaonians were neighbored by the Molossians, while in the south, there were the Thesprotians, who shared with the Chaonians the province of Kestrina, which lies between the valley of Thiamis and that of Pavla. The two river basins that the Chaonians primarily inhabited are the Bistrice valley, which empties into Lake Butrint in the south, and the Drinos valley in the east. In ancient times, each of these basins had a capital city: the Drino basin had the city of Antigone, while the Bistrice basin had the city of Foinike.

Keywords: Aaos, Vjosa, Butrint, Kaoni, Akrokeraune

1. Kuadri gjeografik

Kaonia zë gjithë zonën e bregdetin jonian, duke nisur nga lumi Thiamis (Kallamas), deri në malet Akrokeraune (Karaburun), në veri lumi Aoos (Vjosa), i cili ndan Kaonët nga Ilirët; në lindje Kaonët janë fqinj me Parauejt në luginën e mesme të lumit Aoos midis degës së Sarandaporos dhe grykave të Aoos mbi Tepelenë; më në juglindje, Kaonët janë fqinjë me Molosët, ndërsa në jug, janë Thesprotët, që ndajnë me Kaonët krahinën e Kestrinës, e cila shtrihet midis luginës së Thiamisit dhe asaj të Pavlës. Kaonët jetojnë kryesisht përreth dy pellgjeve lumore, luginës së Drinosit në lindje dhe luginës së Bisticës, e cila përfundon në jug me liqenin e Butrintit. Secili nga këto pellgje, në antikitet, kish një kryeqendër të tijën: qyteti i Antigonesë ishte e pellgut të Drinos, ndërsa ai i Foinikes ishte qendër e pellgut të Bisticës. Në organizimin e territorit të Kaonisë vërehen ngjashmëri me elemente të polis-it grek, i cili karakterizohet nga qendra përkatëse qytetare, nga territori përkatës fshatar (hora), si edhe nga kalatë përkatëse, të cilat mbyllnin kalimet në territorin e qytetit.

Organizimi i tyre në etnos, i cilësuar shpesh si *Koinon*, përbën një kuadër më të gjerë dhe më të mirë në përshtatje me jetën baritore, që bënte një pjesë e rëndësishme e popullsisë. Edhe në rastin kur koinoni shkoi drejt shpërbërjes, ai ruajti kuadrin e një organizimi më të ngushtë, siç është edhe rasti i Prasaibëve, të vendosur përreth zonës së Butrintit.

Si qyteti i Foinikes, ashtu edhe ai i Antigonesë, asnjëherë nuk u përpoqën të bëhen polise autonome: ata mbetën në gjirin e bashkësisë së Kaonëve deri në pushtimin romak.

2. Kuadri historik

2.1. Prehistoria

Falë kërkimeve dhe studimeve arkeologjike në fushën e prehistorisë, që janë ndërmarrë gjatë viteve të fundit në territorin e Kaonisë (Luginën e Drinosit, Bregdetin Jon dhe territoret përreth Butrintit¹), është bërë i mundur grumbullimi i një materiali të konside-rueshëm, i cili na jep informacion të bollshëm lidhur me këtë periudhë. Si rezultat, janë identifikuar një sërë qendrash të reja të paleolitit të mesëm, të lartë dhe mezolitit. Krahas

¹F. Prendi, Mbi rezultatet e gërmimeve në fshatin Vodhinë të rrethit të Gjirokastrës, Buletini për shkencat shoqërore 1 (1956), f.180-188. Tumat në fshatrat Kakavi e Bodrisht të rrethit të Gjirokastrës. Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, seri e Shk. Shoq. (1959), f. 190-211 Dh. Budina, Tuma e Çepunës (Gjirokastër), Buletini arkeologjik, 1969, f. 49-55. L.M. Ugolini, Albania Antica I: Ricerche archeologiche, Roma, 1927. D. Mustili, La civiltà prehistorica dell'Albania në revista D'Albania, 1, 1940. N.G.L. Hammond, Epirus; M. Korkuti, K.Petruso, Gërmimet arkeologjike të viteve 1992-1994 në shpellë të Konispolit, "Iliria" 1996 1-2 f. 209-224. J.Koci, Fortifikimet parahistorike në bregdetin Kaon, "Iliria" 1991,1-2, f. 39-61. I.Gjipali Kërkimet arkeologjike për prehistorinë e hershme në Shqipërinë Jugore. Simpoziumi ndërkombëtar "Epiri Antik" (Kaonia), Gjirokastër, 2005, në proces botimi.

vendbanimeve të njohura, si: Xarra, Shën Marina e Konispolit, kanë dalë në dritë edhe pika të reja², si Diaporiti, Shën Dhimitri, Kalivo, Ksamil, Kepi i Stillos, Mursia, Butrinti, Meso-potami, Velahova, Dhrovjani, Malçani, Paleomanastër, Lazarat, Dervician, Goranxi, Vanis-tër, Haskovë, Dhuvjan, Sofratikë, Himarë, Kastri, Valtore, Borsh, Çorraj etj. Këto vendbanime dëshmojnë për gjurmët e jetës në Kaoni, të cilat datojnë shumë më herët se epoka e metaleve (bronx, hekur), që njiheshin deri më tani. Për sa u takon gjurmëve të periudhave të bronxit dhe hekurit në territorin Kaon, ato shprehen nga një numër i konsiderueshëm forti-fikimesh dhe varrezash tumulare.

Duke u nisur qoftë nga materiali i paktë arkeologjik, qoftë nga teknika e ndërtimit të mure-ve rrethues apo forma planimetricke në fortifikimet parahistorike të bregdetit, është e mundur të veçohen tri tipe të tri fazave evolutive³. Gjatë periudhës së hershme dhe të mesme të bronxit (Kukum I-II, Ngura I Armeridha e Çipi) vërehen fortifikime, të cilët përqendrohen në kodra të ulëta buzë detit, duke qenë, kështu, të mbrojtur nga natyra edhe me linja të thjeshta muresh. Këto fortifikime kanë karakter blegtoral dhe shoqërohen nga gjurmë të pakta banesash brenda mureve rrethues.

Për sa u takon periudhës së vonë të bronxit (Badhër, Karos I, Sopot, Kukum I-II, Himarë, Katafiqi), fortifikimet janë të vendosur në kodra të larta, me mure të qëndrueshme, të gjera e të larta. Edhe në këtë rast ato kanë karakter blegtoral. Këto të dhëna mbështetnin mendimin e shprehur në lidhje me vendbanimin e Badhrës⁴, i cili konsiderohet si vendstrehim për bashkësinë dhe pasurinë e përbashkët (bagëtinë). Jeta e njerëzve zhvillohej jashtë fortifikimit (banesat jashtë fortifikimit). Gjatë periudhës së bronxit të vonë, në zonën bregdetare vërehen një dendësi fortifikimesh, të cilat janë të shpërndara në mënyrë uniforme përgjatë vijës bregdetare, me qëllim kontrollimin e rrugëve, shfrytëzimin e kullotave dhe mbrojtjen krahinore. Periudha e hekurit të hershëm (Karos II, Gjashnjari) është një fazë më e zhvilluar. Ajo karakterizohet nga një teknikë e përparuar në ndërtimin e mureve. Përsëri ndërtimet kanë karakter blegtoral dhe raporti me banesat vazhdon të jetë i njëjtë me atë të periudhës II. Vazhdimësia e fortifikimeve nga periudha e bronxit të hershëm, në atë të hekurit të hershëm në bregdet, si dhe numri i tyre i konsiderueshëm, dëshmon për përqendrimin e Kaonëve në këtë territor bregdetar e të begatë. Vendbanime të fortifikuara, të ngjashme me ato të bregdetit Jon, të ndërtuara në lartësi dhe me karakter blegtoral, kemi dhe në territorin përreth Foinikes. Në këtë kuadër na vjen në ndihmë rasti i vendbanimit të fortifikuar të Qirofleksit dhe të Shqevit, në zonën e pellgut të Rëzomës⁵.

²Kërkimet sërvejnë në këto rrethe, që vazhdojnë edhe sot, janë kryer nga I.Gjipali.

³J.Koçi, Fortifikimet parahistorike...f. 58 dhe literatura e cituar prej tij.

⁴M.Korkuti, Die siedlungen der späten Bronze und der frühen Eisenzeit in süd-Albanien, Südosteuropa zwischen 1600 und 1000 v.20, 5 CHR, Berlin, 1982.

⁵A. Nanaj, Vendbanimet parahistorike të Kaonisë. Butroti. Tiranë, 1988, f.213-236.

Vendbanimi i Vagalatit, Navaricës, Koqinolitharit dhe Pecës në pellgun e Delvinës⁶. Vendbanime të fortifikuara, të ngritura, pothuajse, në të gjitha zonat e trevës kaone, në për-gjithësi janë të vendosura në vende të larta, për të siguruar një mbrojtje natyrore të pakalu-eshme. Ato kanë shërbyer si strehime për bagëtinë dhe në rast rreziku edhe për banorët e bashkësisë. Krejt ndryshe paraqitet situata e vendbanimeve të së njëjtës periudhë, por kësaj here në luginën e Drinosit, e cila si zonë fushore, karakterizohet nga vendbanime të hapu-ra⁷. Përqendrimi i tyre vërehet kryesisht në krahun e majtë të lumit, në pllajën që krijon Mali i Gjerë duke zbritur në luginë. Mund të përmenden këtu vendbanimet e periudhës së bronzit në Shën Dhimitër, Grapsh, si dhe një sërë vendbanimesh tumulare. Për sa i takon periudhës së parë të hekurit, mund të përmenden tumat e Vodhinës, Kakavisë, Bodrishtës dhe e Çepunës.

2.2. Periudha Arkaike e Klasike

Të dhënat e deritanishme që lidhen me zhvillimin e territorit kaon gjatë periudhës arkaike dhe klasike, fatkeqësisht janë tepër të varfra. Shkak për këtë është mungesa e gërmimeve arkeologjike. Falë hulumtimeve, këto periudha janë evidentuar në Akropolin e Butrintit, ku gërmimet arkeologjike na japin një material arkeologjik të konsiderueshëm⁸.

Akropoli i Butrintit karakterizohet nga një fortifikim që zë gjithë suprinën e kodrës. Ky fortifikim, që ngrihet mbi një vendbanim më të hershëm, ka një pozicion strategjik në majë të kodrës dhe dallohet për kushte të favorshme natyrore. Prania e kanalit të Vivarit dhe e liqenit të Butrintit favorizonin një portë të sigurt në këtë territor. Gërmimet arkeologjike kanë evidentuar qeramikë që datohet në fundin e periudhës së bronzit dhe në fillimin e asaj të hekurit. Megjithatë, nuk zotërojmë ende elementet e nevojshme për përcaktimin e qartë të tipit të vendbanimit.

Materiali i lëvizshëm arkeologjik, siç është rasti i qeramikës korintike, dëshmon se, të pak-tën prej fundit të shek.VIII p.Kr., duket të kenë nisur kontaktet me botën korintike⁹, thuajse, në të njëjtën kohë me themelimin e Korkyrës. Krahas materialit të pasur arkeologjik, mjaft interes paraqet dhe zbulimi i gjurmëve të një tempulli arkaik, kryesisht bazamentet e kolonave të tij, që datohen në periudhën arkaike. Krahas kontakteve të para me Korinthin, duke nisur nga shek. VII p. Kr e në vijim, do të dominojnë marrëdhëniet me Korkyrën, e cila ruan njëkohësisht marrëdhënie të forta jo vetëm me Butrintin, por me krejt territorin kaon, siç e dëshmon dhe prania e qeramikës së Korkyrës, e zbuluar në shumë qendra të Kaonisë. Padyshim,

⁶I.Gjipali, Kërkime sërveje...

⁷N.Ceka, Lindja e jetës qytetare tek Ilirët e jugut, "Iliria" 1983, 2, f.146.

⁸Ekspedita arkeologjike shqiptaro-greke, 1990-1994, e drejtuar nga N.Ceka e K.Haxhis, me pjesëmarrjen e A.Nanajt, P.Dukelis e Dh.Çondit.

⁹K.Haxhis, Raport paraprak mbi enët e baltës të zbuluara në Akropolin e Butrintit, "Iliria", 1998, 1-2, f.227-230.

Butrinti është nyja e kontaktit të Korfuzit me territorin kaon. Ky qytet, gjatë kontakteve me Korkyrën, kalon nga një vendbanim i thjeshtë, në një qendër të organizuar dhe rifortifikuar (shek.V) dhe ka funksionin e kontrollit të kanalit të Korfuzit, të rrugëve detare, si dhe të lidhjeve tregtare me prapatokën kaone. Krahas fragmenteve të qeramikës korkyrase, shumë të përhapura në territorin kaon, kemi edhe një element tjetër, i cili lidhet me zbulimin rishtazi të një varri në Ksamil, pranë ishujve, mënyra e ndërtimit të të cilit dhe inventari përkatës e lidhin ngushtësisht me Korkyrën.

Zbulimi i këtij varri hedh hipotezën e pranisë së një limani në Ksamil, dëshmi e raporteve tregtare të Korkyrës me Kaoninë. Kjo të çon në përfundimin e përfshirjes së këtij bregdeti në periudhën arkaike e klasike nën kontrollin e ishullit të Korfuzit. Fakti i shfrytëzimit të Butrintit dhe bregdetit, nga ana e Korkyrës, si urë lidhëse me territorin kaon, përforcohet nga prania si e Murit të Demës, i cili fortifikon anën veriore të gadishullit të Ksamilit, ashtu edhe e fortifikimeve të Karalibeut dhe Vagalatit, duke e shkëputur këtë territor nga Kaonia dhe duke e kaluar përkohësisht në varësi të ishullit të Korkyrës. Teknika e ndërtimit të Murit të Demës e dallon atë nga fortifikimet kaone. Gjithashtu, këto ndryshime plotësohen dhe nga prania e fragmenteve të pakta qeramike, që datohen gjatë periudhës klasike, rreth gjysmës së dytë të shek.V p. Kr. Pa dyshim, fakti që kjo pjesë e bregdetit, deri në shek. IV p. Kr., është në varësi të Korkyrës, ishte një shqetësim i vazhdueshëm i Kaonëve, të cilët u përpoqën për ta shkëputur nga Korfuzi, duke mundësuar kalimin e saj nën juridiksionin e tyre. Sondazhet e bëra në gadishullin e Ksamilit¹⁰, kanë dhënë material të paktë arkeologjik për periudhën arkaike e klasike, por që, siç u tha edhe më sipër, njohuritë tona plotësohen në një farë mase nga zbulimi i varrit të Ksamilit, në shtator të 2008¹¹.

Krahas këtyre pikave të referimit, plotësimi i kuadrit historik bëhet dhe nga gjetjet e pakta në Borsh¹², Labovë¹³ dhe, së fundi, në Matomarë¹⁴. Materiali arkeologjik, i dalë në këto vendbanime, ka ngjashmëri me atë të Butrintit, si për sa i takon kronologjisë, ashtu dhe prejardhjes. Mendojmë se kontaktet e Kaonisë me Korkyrën duhet të kenë qenë edhe më të drejtpërdrejta, nëpërmjet rrugëve detare me Foiniken, Borshin etj. Por pika më e rëndësishme e kontaktit të Kaonisë me Korkyrën ishte Butrinti, liqeni dhe limani i Ksamilit.

¹⁰Dh.Çondi, Gjetje arkeologjike nga rrethi i Sarandës, "Iliria", VII-VIII (1977-1978), Tiranë, 1979, f.339-346.

¹¹Dh.Çondi, Një varr arkaik në Ksamil. Material i depozituar në aktet e simpoziumit ndërkombëtar "Epiri antik, Kaonia" Universiteti i Gjirokastrës, 2005, në proces botimi.

¹²J. Koçi, Gërmime arkeologjike të vitit 1986 : Borshi, "Iliria", 1986, 2, f.162.

¹³V. Qirjaqi, Gërmime arkeologjike të vitit 1986: Labova, "Iliria", 1986, 2 f.161.

¹⁴E.Giorgi, J.Bogdani, Rezultatet e gërmimeve në Matomarë 2007, Raport.

Për sa i takon organizimit politiko-shoqëror të Kaonëve në këtë periudhë, të dhënat vijnë nga Tukididi¹⁵ dhe Pseudo-Skylaksi¹⁶. Këta autorë na dëshmojnë se Kaonët, së bashku me epirotë të tjerë, banonin në fshatra, duke krijuar vendbanime të hapura, në ndryshim nga grekët e civilizuar, të cilët jetonin në polise të fortifikuara.

2.3. Kaonët gjatë shek. V-IV p. Kr.

Dëshmitë e para nga autorët antikë, lidhur me Kaonët vijnë nga Tukididi¹⁷, i cili i përmend ata në kuadrin e ngjarjeve të luftës së Peloponezit, në vitin 429. Kaonët krijojnë një *ethnos* politik, të sigurt dhe kalojnë nga një formë qeverisjeje monarkie në një formë qeverisjeje me përfaqësues (pa mbret). Pushteti është i përqendruar në duart e dy prostatave, të cilët zgjidheshin çdo vit nga familjet princërore. Sipas dëshmisë së Strabonit¹⁸, Kaonët dhe Molosët, në gjysmën e dytë të shek. IV p. Kr., ishin dy tributë më të fuqishme ndër tributë epirote, të cilat dominonin mbi gjithë të tjerat, duke u alternuar në pushtet, Kaonët të parët dhe më pas Molosët. Tukididi¹⁹ flet për qëllimet ekspansioniste të Ambrakisë, e cila, duke përfituar nga lufta e Peloponezit, në vitin 430 p. Kr. dhe me mbështetjen e Kaonëve dhe barbarëve të tjerë në afërsi, synonte të pushtonte qytetin e Argosit. Sipas dëshmisë së Tukididit²⁰, Kaonët, në vitin 429 p. Kr., ishin në krah të Ambrakisë, në mbështetje të Korin-thit, koloni e të cilit ishte Ambrakia. Kaonët, të pozicionuar kundër Korkyrës dhe në favor të Korinthit, kërkonin kufizimin e influencës së Korkyrës në këtë pjesë të bregdetit Jon.

Marrëdhëniet e drejtpërdrejta midis Kaonëve dhe Ambrakisë flasin për një epërsi të Kaonëve mbi Thesprotët, sidomos në zonën Jugore, ku si kufi verior i Thesprotisë shërben lumi “Thiamis” (Kallama)²¹. Ndërkohë, Kestrina, e cila përfshihet brenda luginës së Pavllës dhe Kallamas, i konsideruar si rajon thesprot, është në duart e Kaonëve. Një veçori që i dallon Kaonët nga Epirotët e tjerë, që zëvendësimi i mbretit me Prostatin, që zgjidhej çdo vit. Ësh-të e vështirë të përcaktohet se në ç’datë fillon supremacia e Kaonëve në Epir. Megjithatë, në fillim të luftës së Peloponezit, dominimi kaon në Epir është ekzistues. Në vitin 429, Kaonët janë aleatët më të mirë të Peloponezit²². Të konsideruar si luftëtarët më të mirë, janë ata që organizuan sulmin²³. Gjatë luftës së Peloponezit, ishulli i Korkyrës u përfshi nga lufta civile midis aristokratëve dhe demokratëve, prej së cilës qyteti pësoi dëmtime të mëdha. Ka mundësi që nga fundi i shek. V ose fillimi i

¹⁵ Tukididi II, 80,5.

¹⁶ Pseudo-Skylaksi 28.

¹⁷ Tukididi II, 80,5.

¹⁸ Straboni VII,7,5.

¹⁹ Tukididi II, 68,9.

²⁰ Tukididi II, 80,3.

²¹ Tukididi I, 46,4.

²² Tukididi II 81,3.

²³ Tukididi II, 81,4.

shek. IV p. Kr, Korkyra humb kontrollin që ajo zotëronte mbi Butrintin dhe Ksamilin: të dy këto qendra u kalojnë Kaonëve.

Për sa u takon institucioneve të Kaonëve, Tukididi²⁴ jep të dhëna të sakta në lidhje me to. Në vitin 429, si Kaonët ashtu edhe Thesprotët, dallohen nga etnitë e tjera, pasi kanë një mbret. Këta janë dy popuj fqinjë, në afërsi të Korkyrës, hoqën dorë nga monarkia dhe u vunë nën regjimin e poliseve. Zhdukja e figurës së mbretit ndoshta nuk është një fenomen shumë i hershëm në Kaoni, pasi sovrani zëvendësohet nga dy magistratë të përvitshëm. Prostatët vijnë nga familje princërore: nga ajo e Photyos dhe e Nikanori. Institucionet në Kaoni nuk kufizohen vetëm nga ata dy Magistratë. Pushteti legjislativ është në duart e Asamblesë Popullore, puna e së cilës përgatitet nga një këshill. Për këtë periudhë nuk kemi asnjë dokument që të japë informacion mbi funksionin e këtyre institucioneve. Shek. IV p. Kr është një periudhë me mjaft rëndësi për historinë e Epirit. Nëpërmjet harmonizimit të të dhënave të përfituara nga burimet historike, epigrafike (Lista e Theorodokoi të Epidaurit dhe Argos) dhe arkeologjike, bëhet i mundur rindërtimi i historisë politike dhe vendbani-meve antike.

Të dhënat për gjysmën e parë të shek. IV p. Kr. janë të ngjashme me informacionin që jep Tukididi në lidhje me tributë kryesore epirote që jetojnë kryesisht në fshatra të hapura dhe të pafortifikuara. Situata politike ka ndryshuar: Molosët kanë marrë një pjesë të vogël të bregdetit midis Thespotisë dhe territorit të Ambrakisë, siç konfirmohet nga një e dhënë e vitit 372 p. Kr., sipas së cilës Senofonte flet për Alketen që ndihmoi në transportimin e fshehtë në Korfuz të një grupi Spartano prej 600 peltastë, të cilët drejtoheshin nga Stesicle. Flet për forcimin e pozitave të Molosëve në Epirin. Megjithatë mbetet e pakuptimtë mos-përfshirja në burime e emrit të Butrintit dhe e portit në gadishullin e Ksamilit, që, me sa duhet, ose janë ende nën kontrollin e Korkyrës, ose sapo kanë kaluar në duart e Kaonëve. Rënia e fuqisë së Korkyrës, para mbarimit të luftës së Peloponezit, rreth gjysmës së parë të shek. IV p. Kr, ishte një periudhë krize, e cila vërehet edhe në rastin e Butrintit, i cili merr formë urbane, i fortifikuar me mure të fuqishme rrethuese, në fundin e shek. IV p. Kr.

Në listën e Theorodokëve të Epidaurit (365-311 p. Kr.), ku Theorodokët e Epirit datohen rreth viteve 365-359 p. Kr., dëshmohet për përfshirjen në festat e Panhelenikëve të atyre që më parë ishin tribu barbarë. Në këtë periudhë emri i Apeiros ka vlerë gjeografike. Ndërsa sipas listës së Theorodokëve të Argosit (330 p.Kr.), Theorët vizitojnë Apeirosin, Foiniken dhe Korkyrën. Tashmë Apeiros nuk është më një emër i përgjithshëm gjeografik, por emri i një shteti. Kaonët vazhdojnë të pavarur, por rëndësi ka fakti se përmendet për herë të parë qyteti i Foinikes, i cili është përfaqësues në nivel etnik. Përmendja e Foinikes në këtë listë përputhet dhe me rezultatet e përfuara nga gërmimet arkeologjike.

²⁴ Tukidid II 80,5.

Të dhënat epigrafike na sqarojnë një situatë, që nga pikëpamja arkeologjike nuk është shu-më e qartë për momentin. Mbishkrimi i “Pllakës së Dodonës”, që datohet rreth viteve 330-320 p.Kr., dëshmon për kryeqendrën e Kaonisë. Përmbajtja e këtij mbishkrimi ka sjellë mjaft diskutime për domethënien e termit “Polis” që ndeshet aty, i cili mund të kuptohet si qytet, por edhe me domethënie më të gjerë - shtet apo komunitet. Është më e mundshme që termi “Polis” të tregojë përgjithësisht një shtet, pa specifikuar formën e saj tradicionale, që është Koinoni. Në qoftë se ky tekst i referohet qytetit të Foinikes, nuk do të ishte e nevojshme vënia e emrit të qytetit, kur mbishkrimi gjendet në Dodonë, shumë pranë Foinikes. Njëkohësisht, flitet për lëvizjen e një tempulli, atij të Athinasë që i përkiste gjithë etnosit dhe jo vetëm qytetit të Foinikes. Identifikues është fakti se epigrafi i referohet një etnie, asaj të Kaonëve. Gërmimet dhe gjurmimet arkeologjike të realizuara në Foinike dhe Butrint dëshmojnë se këto qendra në gjysmën e dytë të shek. IV p. Kr karakterizohen nga një sistem urban me mure rrethuese të kodrave, fakt që dëshmohet plotësisht nga të dhënat epi-grafike dhe historike të kësaj periudhe.

Muret rrethuese në zonën lindore të Foinikes i përkasin strukturës kryesore të qytetit ose kryeqendrës së Kaonisë. Edhe në Luginën e Drinosit filloi ngritja e vendbanimeve të forti-fikuara, si: kalaja e Labovës. Por dhe shumë qendra të fortifikuara të shek. III p. Kr. duhet të kenë një fazë të parë në shek. IV. Studimet dhe gërmimet e mëtejshme do të hedhin dritë mbi fortifikimin e Kalivosë dhe Melanit. Kaonia, që nga mesi i shek. V p. Kr., është një etnos i kompletuar politikisht, siç vërehet edhe në strukturimin dhe në mënyrën e orga-nizimit të territorit. Kemi qendra të fortifikuara administrative e politike të territorit, si dhe qendra të forta ekonomike si Foinike, e drejtuar nga deti, me Butrintin dhe Onhezmin, ku për fat të keq mungojnë gërmimet për këtë periudhë. Ky organizim i ri në Epir dhe në Kaoni krijoi terrenin e përshtatshëm për prerjen e monedhave të veta në vitet 360-330, të cilat rilidhen me traditën epirote dhe kanë mbishkrimin XA (ONQON). Këto dëshmojnë se Kaonët, në gjysmën e shek. IV p. Kr, kanë luajtur një rol të veçantë jo vetëm nga ana poli-tike, siç evidentohet nga të dhënat epigrafike, por dhe ekonomike.

2. 4. Bashkimi i Kaonëve me Molosët në një shtet epirot

Kalimi i Kaonëve nga të pavarur në integrimin e tyre në shtetin e drejtuar nga dinastitë e Ajakidëve, ka kaluar në disa faza. “Mbishkrimi i Dodonës” në pllakë bronxi, i datuar në vitet 317-297 p.Kr., jep të dhëna mjaft interesante. Aty nuk flitet për një simahi të thjesh-të - aleancë ushtarake - , por për një aleancë më komplekse, në bazë të së cilës aleatët kanë të drejtë të akordojnë çlirimin nga taksat për një të huaj në të gjithë territorin e Epirit. Nuk kemi vetëm një aleancë ushtarake, të specifikuar, por dhe një vendimmarrje ekonomike. Pra, kemi kalimin nga një aleancë ushtarake dhe më pas një formë sympolitea më të qënd-rueshme.

Periudha gjatë gjithë shek. III dhe gjysmës së parë të shek II p. Kr, është një periudhë e begatë për Kaoninë dhe Epirin, pasi karakterizohet nga një nivel i lartë prosperiteti. Të dhënat arkeologjike flasin për zhvillimin e vendbanimeve dhe të sistemit urbanistik. Gjatë kësaj periudhe Foinike arrin kulmin e zhvillimit të saj si në sistemin e saj fortifikues, ashtu dhe në zhvillimin urbanistik. Gjatë kësaj periudhe ndërtohet qyteti i Antigonesë dhe organi-zohet agoraja e Butrintit. Kësaj kohe i përket edhe lindja e vendbanimeve të reja të forti-fikuara, ndërsa ato të ndërtuara në shek. IV p. Kr. strukturohen sipas modelit të qyteteve të mëdha. Qyteti i Foinikes, në fillim të shek. III, si rezultat i grumbullimit të popullsisë së territorit, kthehet në një qytet mjaft të madh, me sipërfaqe prej 50 ha. Vërehet rindërtimi i mureve fortifikuese, ndërtimi i tempullit, teatrit dhe mjaft objekteve të tjera publike e private. Foinike, si kryeqendra e Kaonisë, luan tashmë një rol të rëndësishëm, si në pikë-pamje politike në shtetin e Epirit, ashtu dhe në plan ndërkombëtar. Zhvillim pati dhe qyteti i Butrintit, megjithëse qendër e vogël. Pozicioni strategjik i jep një rol të rëndësishëm brenda Kaonisë. Në luginën e Drinos Piroja ndërton qytetin e dytë për nga madhësia të Kaonisë, Antigonenë, me një sipërfaqe prej 45 ha dhe me sistem të rregullt urbanistik hypodamik. Të dy qytetet ndanin midis tyre administrimin e territorit kaon, që ndahen nga Mali i Gjerë. Secili qytet kishte në administrim territorin e vet.

Nga gërmimet dhe hulumtimet arkeologjike rezulton se kemi vazhdimësi të jetës nga Monarkia (gjysma e shek. IV-232 p.Kr.) deri në periudhën Republikane të Koinonit epirot (232-170). Me mjaft vlerë për këtë periudhë janë të dhënat numizmatike, që vijnë nga qendrat kryesore, prerjet e reja monetare²⁵. Kjo periudhë karakterizohet nga një zhvillim dhe gjallërim ekonomik, që shprehet dhe me prerjet monetare, ku një element i veçantë ësh-të prerja e monedhës me monogramin XA me legjendën XA (ONΩON), një seri me shtrirje të shkurtër kohore, e hedhur në qarkullim pas shpërbërjes së Koinonit të Epirotëve 170 p. Kr, por jo për një kohë të gjatë. Foinike, kryeqendra e etnosit Kaon, pas shpërbërjes së Koinonit Epirot, është e gatshme të marrë drejtimin e Epirit, si në rastin e situatës politike të fundit të shek. IV p. Kr, përpara hyrjes së saj në shtetin epirot.

Periudha e lulëzimit dhe zhvillimit në shek. III-II p. Kr, që pasqyrohet nga numizmatika, përputhet dhe me materialin arkeologjik, të zbuluar nga gërmimet. Këtë del konkluzioni se kemi një rritje të popullsisë në qytet dhe territorin përreth ku rolin kryesor politik dhe ekonomik e luajnë qytetet.

2. 5. Koinoni i Prasaibëve

Me rëndësi historike është lufta e tretë Maqedonase-Romake, e vitit 168 p. Kr, ku Filipi V i Maqedonisë pësoi humbjen përfundimtare. Pas kësaj Roma

²⁵ Sh.Gjongecaj, Nuovi dati numismatici da Phoinike. Phoinike III 2005, f. 161-179; Sh. Gjongecaj, La circolazione delle monete a Phoinike, Phoinike IV 2007, f.167-175.

vendos kontrollin mbi bregun lindor të Epirit, për vetë qëndrimin e diferencuar që mbajtën epirotët në këtë konflikt, ku pjesa perëndimore, aleate e Romës dhe ajo lindore, aleate me Filipin V të Maqedonisë. I ndryshëm ishte dhe qëndrimi i Romës, e cila veproi me egërsi ndaj pjesës së Epirit, aleate e Maqedonisë, duke shkatërruar plotësisht 70 qytete dhe duke kthyer në skllëvër 150.000 Epirotë²⁶. Kaonia, si aleate e Romës, nuk u prek, por kaloi nën kontrollin e Karopsit, që, me mbështetjen e Romës, vendosi një regjim diktatorial dhe persekutues, me qendër qytetin e Foinikes²⁷. Ky shtet u emërtua *To koinon ton Epiroton ton peri Foinikon*, që del nga një mbishkrim nderi dhe sipas Polibit²⁸. Me vdekjen e Karopsit në vitin 156 p. Kr, ky shtet riorganizohet, duke u emërtuar *Koinon ton Epiroton* (koinoni i tërë epirotëve)²⁹. Kjo ishte koha kur Roma krijoi në këtë territor disa shtete të pavarura. Ato u ngritën mbi qendra të vogla, jo me rëndësi në Federatën e Epirotëve, por që, gjithsesi, e dobësuan autoritetin e qendrave të mëdha. Dëshmitë epigrafike tregojnë për krijimin e Koinonit të pavarur të Prasaibëve, me qendër Butrintin. Ky proces drejtohej nga Magjistrët romakë, të cilët mbronin interesat e Romës. Ky shtet përfaqësonte një organizim të pavarur, si nga Kaonët në veri dhe nga Thesprotët në jug.

Krijimi i Koinonit të Prasaibëve në një territor që nuk u përfshi në shkatërrimet romake, ndihmon për të ngritur hipoteza të rëndësishme mbi arsyet e shkëputjes së këtij territori nga administrimi i Foinikes. Një nga versionet më të besueshme që dëshirojmë të paraqesim është lidhja e ngjarjeve me një revoltë të mundshme në këtë territor të Koinonit të Epirotëve, e drejtuar kundër tiranisë së njohur të Karopsit. Ka të ngjarë që kjo të ketë çuar në krijimin e shtetit të ri e të pavarur, por edhe të pakontrolluar nga Foinike. Në të mirë të kë-saj teze vijnë edhe mbishkrimet e zbuluara në Butrint. Ato dëshmojnë edhe për atë se shteti i ri, i njohur si Koinoni i Prasaibëve, kishte në përbërjen e vet përmbajtje shumënike, si: Kaonë, Thesprotë e Molosë. Të dhënat epigrafike, gjithashtu, janë një argument më shumë i asaj që struktura e këtij shteti të ri ishte e njëjtë me atë të Koinonit të Epirotëve, ku hasen elementë strukturorë e administrues, si: Magjistra. Ai ishte shtet autonom në territorin e tij lokal. Një shekull më vonë, Butrinti kthehet në një koloni, si nga Cezari, ashtu edhe nga Augusti. Koinoni i Prasaibëve shënon për Kaoninë një ndarje territoriale dhe një shpërbërje të strukturave të kontrollit, si rezultat i revoltave dhe shkatërrimit të Antigonesë, gjë që vërtetohet nga gërmimet arkeologjike në këto qendra. Shkatërrimi i Antigonesë nga Paul Emili, i cili nuk e preku Kaoninë, tregon për mundësinë më të madhe të vetëshkatërrimit të saj, pas luftës së tretë Maqedonase-Romake.

Këto ngjarje çuan në shpërbërjen graduale të Koinonit të Epirotëve, si pjesa e territorit përreth Butrintit që kalon e pavarur. Por edhe territori i luginës së

²⁶ Polibi XXX, 7.

²⁷ Polibi XXVII,15.

²⁸ Polibi XXXII, 14.

²⁹ Syll, 654.

Drinos mbetet pa udhëheqje pas shkatërrimit të Antigonesë. Qyteti i Foinikes mbetet me një territor të zvogëluar rreth saj. Ajo humbet autoritetin e saj etnik (Kryeqendër e Kaonëve), duke u reduktuar thjesht në qytet të Foinikasve, që pasqyrohet dhe në prerjet e para monetare, me legendën FOINEIKAIQN³⁰.

Kaonia, një zonë me kushte shumë të favorshme gjeografike e klimaterike dhe me një jetë qytetare të zhvilluar e komplekse, ku shfaqen qartë të gjitha etapat, në të cilat është zhvi-lluar procesi i urbanizimit, ofron një material të pasur arkeologjik për të studiuar një feno-men tepër interesant e origjinal për trevën, që lidhet me “Banesat e fortifikuara-Vila”.

Burimet historiko-epigrafike dhe të dhënat arkeologjike tregojnë se territori kaon ndahet në dy pjesë nga Mali i Gjerë. Në secilën nga këto sipërfaqe ka nga një qytet të madh, që kryen funksionin administrativ e politik në nivel rajonal në gjysmën e vet të territorit: Foinike në perëndim dhe Antigoneja në lindje. Mikrozonat gjeografike, të lidhura me vendbanimet antike, japin mundësi që brenda trevës kaone të veçohen disa nënndarje: zona qendrore, me Foiniken, Onhezmin e banesat e fortifikuara-vila në Çumpar, Çukë e Metoq. Mbizotëronin zonat pjellore të lumenjve Kalasë e Bistricë. Fushën e begatë të rrjedhjes së poshtme të Pavlës dhe liqenin e Butrintit i zotëronte qyteti antik i Butrintit, Çuka e Ajtoit e Vila e Malathresë. Gjithashtu, në periudhën romake gërmimet arkeologjike në fushën e Vrinës e Diaporit kanë evidentuar vila luksoze romake, të pajisura me terma, shatrivane e dysheme të shtruara me mozaikë. Muri i Demës, Karalibeu e Kulla e Vagalatit kontrollonin luginën të vogla, si dhe rrugët që i përshkonin ato. Mali i Milesë, si një pengesë natyrore, ndante këtë territor nga luginën e rrjedhjes së mesme të lumit Pavla, ku pranë fshatit “Vagalat”, në Dobër, ruhen rrënojat e një banese të fortifikuar-vilë. Bregdeti Jon përfshihej në qytezën e Hima-rës, Sopotit (Borshit), Qafa e pazarit e banesat e fortifikuara-vila në fshatin Borsh e Luko-vë.

Qyteza e Malçanit, me Paloemanastron, Ripësin e banesën e fortifikuar-vilë në Cerkovicë, krijonin një territor në luginën e sipërme të lumit “Pavla”, që kontrollonin, krahas luginës, edhe rrugëkalimet.

Një nivel të lartë ekonomik, arkitekturor e kulturor kishte territori i Antigonesë në luginën pjellore të Drinos. Krahas qyteteve të Antigonesë e Melanit, qytezat e Leklit, Labovës e Selosë, që kontrollonin rrugët që kalonin në këtë luginë, janë edhe banesat e fortifikuara-vilë në fshatrat “Jergucat”, “Goricë” e “Lazarat”.

³⁰ Sh.Gjongecaj, La circolazione...f.172.

QASJE KRAHASUESE NË KULTURËN JURIDIKE MESJETARE TË SHQIPTARËVE TË VERIUT: STATUTET E SHKODRËS DHE KANUNI I LEKË DUKAGJINIT NË SFONDIN HISTORIK.

Ermal Baze¹, Leonard Sala²

¹Fakulteti Histori-Filologjisë, Universiteti i Tiranës

e-mail: ermal.baze@unitir.edu.al

²Bashkia Gjirokastrë

e-mail: leonardgezimsala@gmail.com

Abstrakt

Qëllimi i artikullit është të krahasojë të drejtën pozitive dhe të drejtat zakonore në Shqipërinë e Veriut gjatë mesjetës së vonë për nga gjeografia dhe sfondi historiko-juridik. Sistemi juridik bazohet në të drejtën pozitive të Statutit të Shkodrës, ndërsa Kanuni i Lekë Dukagjinit është burimi i së drejtës zakonore. E drejta pozitive dhe e drejta zakonore bashkëjetuan në Shqipërinë e Veriut derisa u krijua shteti modern, kohë në të cilën secili kishte zonën e vet të ndikimit. E para u respektua në zonat e brendshme malore dhe e dyta u respektua në qytet dhe në zonat e zhvilluara bujqësore. Natyrisht, nuk ka dallim absolut midis dy sistemeve juridike, sepse ato ndërvepruan dhe ndikuan njëri-tjetrit, dhe gjatë gjithë kohës, aspekte të së drejtës zakonore shpesh gjetën rrugën e tyre në të drejtën pozitive. E gjithë kjo lidhet me hapësirën në të cilën jetuan dhe ndërvepruan, dhe procesi me të cilin njerëzit nga rajonet malore mund të migrojnë në zonat urbane ndikohet gjithashtu nga zakonet që ata sollën me vete në statutet e qytetit. Si në të drejtat zakonore ashtu edhe të drejtën pozitive. Për më tepër, artikulli përqendrohet në mënyrën se si dy monumente juridike mesjetare reflektojnë dhe ndikojnë në shoqërinë shqiptare sot. Statutet e Shkodrës dhe Kanuni i Lekë Dukagjinit janë burimet parësore dokumentare të përdorura për shkrimin e artikujve.

Fjalë kyçe: *Ligj pozitiv, e drejtë zakonore, Statutet e Shkodrës, Shqipëria mesjetare*

Abstract

The purpose of the article is the comparison in the geographical context and the historical-legal background between positive law and rights in the Northern Albania of the late Middle Ages. The legal system is based on the positive law of Shkodra from the Statutes, while the legal system of customary law is from the Canon of Lekë Dukagjin. In the case of Northern Albania, positive law and customary law coexisted until the moment of the

creation of the modern state, where each had its own action. The first operated in the city and in the developed agricultural areas, while it was in the interior mountainous areas. Of course, it is not a question of a clear dichotomy, since both of these legal systems interfered and influenced each other and, in many cases, elements of customary law have become part of positive law over time. The neighborhood with its populations, all this is as well as the process that can be of the penetration of the inhabitants of the mountainous areas towards the urban ones is also from a penetration of the customary norms, which they brought with them to the pages of the statutes of the cities. in a norm of positive law and those customary rights. Also, the perspective of the articles focuses on the reflection and impact on today's Albanian society of two legal monuments from the Middle Ages. The main documentary sources for the realization of the articles are the Statutes of Shkodra and the Canon of Lekë Dukagjin.

Keywords: *Positive Law, Customary Law, Statutes of Shkodra, Medieval Albania*

Epoka romake i la trashëgim Evropës Mesdhetare e Perëndimore një rrjet të qëndrueshëm qendrash urbane. Me rifillimin e jetës urbane në Evropën Perëndimore, duke nisur prej shekujve X, XI e më pas, vazhduan jetën shumë qytete antike dhe u formuan nga e para shumë të tjera.¹ Risia më e madhe në panoramën e organizimit politik të qytetit, ishte dalja në dritë e formave të reja të qeverisjes, që njihen në shkencën e historisë mesjetare me emrin e përgjithshëm të komunave.² Komuna ishte organizëm i administrimit dhe i vetëqeverisjes i ngritur nga vetë banorët e qytetit, dhe, që në disa raste, do të çonte në krijimin e entiteteve të pavarura politike në lidhje me pushtetin e senjorëve feudalë e të mbretërve të ndryshëm evropianë.

Krijimi i komunave ishte një ngjarje me rëndësi në historinë e Evropës dhe përfshiu gati të gjitha qendrat e ringjallura (duke filluar prej shekujve X – XI), në të gjitha zonat e urbanizuara me tradita që vinin nga Antikiteti dhe që e përjetuan atë krejtësisht nga e para.³ Një afirmim të veçantë dhe një zhvillim shumë të madh, institucioni i komunës do të arrinte në qytetet e Italisë Qendrore e Veriore në fillim të shekullit XIII,⁴ të cilat do të reflektonin dhe do të ushtronin ndikimin e tyre edhe në vendet e Adriatikut Lindor. Në fakt, në Evropën mesjetare, statutet e komunave qytetare

¹Jacques Le Goff, *Qytetërimi i Perëndimit Mesjetar*, përktheu në shqip Nasi Lera (Tiranë: Toena, 1997), 97 – 98.

²Roberto S. Lopez, *Lindja e Europës*, përktheu në shqip Kujtim Ymeri (Tiranë: Dituria, 2012), 281. Pierre Milza, *Historia e Italisë*, përktheu në shqip Asti Papa, Sonila Kora, Nasi Lera, Mariana Ymeri (Tiranë: Dituria, 2012), 224.

³Thoma Murzaku, Abaz Mullai, Gëzim Sala, *Historia e Mesjetës* (shek.V – XIII) (Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar 2003), 325.

⁴Giorgio Cracco, *L'Europa E Il Mondo* (Dal Medioevo Ad Oggi), vol. II, Societa Editrice Internazionale, Torino: Officine Grafiche SEI, 1980, f. 115.

mishëronin formën më të përpunuar të ligjshmërisë. Statutet ishin produkt i një shoqërie të organizuar në formën më të lartë, e cila vetëqeverisej nga ligjet dhe nga institucionet e veta, të zgjedhura në mënyrë demokratike nga asambleja e qytetarëve të lirë me të drejta social – politike.

Po ashtu, edhe në qytetet bregdetare shqiptare të fasadës së Adriatikut Lindor, shprehja më e lartë e organizimit komunal në Mesjetë ishin statutet, të cilat përmbledhnin aktet normative që rregullonin në tërësinë e tyre organizimin e funksionimin e qytetit, si dhe marrëdhëniet midis qytetarëve, midis tyre dhe shtetit, midis vetë qytetit dhe ambientit rrethues. Nga të dhënat e deritanishme del se, përgjatë shekullit XIV, pjesa më e madhe e qyteteve shqiptare të bregdetit të Adriatikut Lindor, si Durrësi, Shkodra,⁵ Drishti,⁶ Ulqini (1376), Tivari (1369)⁷ dhe Budva (1349 – 1351) ishin pajisur me statute.⁸ Statutet e Durrësit u nxorën jashtë përdorimit dhe humbën gjatë sundimit të Topiajve në qytet (1368 – 1392). Disa vite pas kalimit të qytetit nën protektoratin venecian (1392), më 1398, u gjetën 35 kapituj të këtyre statuteve, që ruheshin në kuvendin françeskan të qytetit.⁹ Gjithashtu, krahas statuteve të qyteteve, sipas ndikimeve e modeleve të së drejtës kishtarë të botës katolike perëndimore,¹⁰ në komunën e Drishtit ekzistonin edhe “Statutet dhe Urdhëresat e Kapitullit të Kishës Katedrale të

⁵*Statuti di Scutari della prima metà del secolo XIV con le addizione fino al 1469*, (a cura di Lucia Nadin, traduzione in albanese a cura di Pëllumb Xhufi, con saggi introduttivi di Giovan Batista Pellegrini, Oliver Jens Schmitt e Gherardo Ortalli), (Roma: Viella, 2002), kreu 50.

⁶Giuseppe Valentini, *Statuti personal në Shqipëri në epokën e Skënderbeut*, përktheu në shqip Dritan Thomollari (Tiranë: Plejad, 2007), 46, 168. Edmond Malaj, *Historia dhe fizionomia e një qyteti mesjetar shqiptar: Drishti* (Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike – Instituti i Historisë, 2015), 131.

⁷Oliver Jens Schmitt, *Das venezianische Albanien (1392 – 1479)* (München: Verlag Gmb, 2001). Shfrytëzuar sipas botimit në gjuhën shqipe: Oliver Jens Schmitt, *Arbëria Venedike (1392 – 1479)*, përktheu Ardian Klosi (Tiranë: K & B, 2007), 110: Sipas O. J. Schmitt, statutet e Durrësit, Ulqinit dhe Tivarit kanë humbur. Për Ulqinin e për Tivarin u bë përpjekja që të rindërtohen ato duke u mbështetur në lutjet e komunave drejtuar Venedikut në shekullin XV. Kristo Frashëri, *Historia e qytetërimit shqiptar* (Nga kohët e lashta deri në fund të Luftës së Dytë Botërore), (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2008), 82.

⁸*Statuta et Leges Civitatis Buduae, Civitatis Scardoniae, et Civitatis et Insulae Lesinae*, përgatitur nga prof. Simeonis Ljubic (Zagrabiae: Officina Societatis Typographicae, 1882 – 3).

⁹*Historia e Popullit Shqiptar*, vëllim I (Iliret, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI – vitet 20 të shek. XIX), (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, 2002), 266.

¹⁰ Bianca Betto, *IL Capitolo Della Basilica Di S. Marco In Venezia: Statuti E Consuetudini Dei Primi Deceni Del Sec. XIV* (Padova: Editrice Antenore, MCMLXXXIV).

Drishtit”,¹¹ një dokument me vlerë i gjysmës së dytë të shekullit XV (12 janar 1468),¹² që pasqyron organizimin e jetës klerikale brenda këtij kapitulli.¹³ Respektimi i statuteve të qyteteve të Shqipërisë adriatikase do të vazhdonte edhe gjatë protektoratit venecian.¹⁴ Venediku kur mori në mbrojtje qytetet bregdetare shqiptare në vitet 1392 – 1479, premtoi respektimin e statuteve të tyre, madje, ky ishte një nga kushtet e dorëzimit.¹⁵

1. Përmbajtja dhe rëndësia e Statuteve të Shkodrës

Hulumtimi historik jo rrallë herë i pozicionon studiuesit e disiplinave shoqërore përballë situatave interesante. Mund të duket e çuditshme që një tekst i përmendur afërsisht para një shekulli dhe që nuk përmbante më shumë se dhjetë fjalë, të bëhej më vonë shkak për impenjimin e një grupi të tërë studiuesish, e të kthehej në një vëllim të konsiderueshëm studimor. Pikërisht në vitin 1907, “Bibliografia statuteve” e hartuar nga Leone Fontana, na bën me dije për ekzistencën e një statuti juridik të qytetit të Shkodrës.¹⁶ Citimi lidhur me këtë statut ishte fare i shkurtër. Duke përmendur me radhë emrat e lokaliteteve të ndryshme sipas rendit alfabetik, Fontana shkruante edhe këtë: “*Scutari* (Albania). *Statuto di Scutari* (Statuti i Shkodrës). *Ms. Museo Civico Correr Venezia* (Muzeu qytetës Correr i Venecias)”.¹⁷ Ky shënim që nuk zinte as një gjysmë rreshti, ishte gjithçka e shkruar për herë të parë deri atëherë, rreth tekstit të këtij statuti.

Në bibliotekën e muzeut Correr të Venecias, midis kodeve juridike të përmbledhjes *Cicogna* (lejleku) me numër 295, gjendej dorëshkrimi origjinal i Statuteve të Shkodrës, që datonte qysh në fillim të viteve 1500;¹⁸ ndërsa vetë nyjet e statuteve zënë fill qysh në dhjetëvjetëshat e parë të shekullit

¹¹*Statuta Et Ordinationes Capituli Ecclesiae Cathedralis Drivastiensis* (Statutet dhe Urdhëresat e Kapitullit të Kishës Katedrale të Drishtit), përkthyer nga latinishtja në shqip nga Musa Ahmeti dhe Etleva Lala (Tiranë: OMBRA GVG, 2009).

¹² Musa Ahmeti, Etleva Lala, “Koha dhe rrethanat e dorëshkrimit,” në *Statutet dhe Urdhëresat e Kapitullit të Kishës Katedrale të Drishtit*, 19.

¹³ Malaj, *Drishti*, 353. Teuta Shala Peli, *Drishti në Mesjetë* (Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2016), 64.

¹⁴*Acta et Diplomata Res Albaniae Mediae Aetatis Illustrantia*, (collegerunt et digesserunt Dr. Ludovicus de Thalloczy, Dr. Constantinus Jirecek et Dr. Emilianus de Sufflay), volumen II, (Annos 1344 – 1406 continens), Vindobonae MCMXIII, ribotim, (Tiranë, Prishtinë: “Dukagjini” – Pejë, 2002), dok. nr. 480, 484, 610. Giuseppe Valentini, *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV*, vol. I – XXV, (München: R. Trofenik, 1967 – 1979), vol. II, dok. nr. 630. *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë*, vëllimi II, dok. nr. 100, faqe 171 – 172.

¹⁵Aleks Luarasi, *Shteti dhe e drejta shqiptare në epokën e Skënderbeut* (Tiranë: Shtëpia Botuese “Luarasi”, 1998), 103.

¹⁶Gherardo Ortalli, “Gli statuti, tra Scutari e Venezia”, te sfondi i artikujve hyrës në: *Statuti di Scutari della prima metà del secolo XIV con le addizione fino al 1469* (Roma: Viella, 2002), 9.

¹⁷Ibid.

¹⁸Ibid.

XIV.¹⁹ Sikurse ndodh shpesh, ku rastësia dhe pasioni i njerëzve të veçantë luajnë rol më të madh se sa logjika e përparimit studimor, pas afro pesë shekujsh, dy studiues të ndryshëm, me qëllime studimi krejtësisht të ndryshme, pa u njohur fare mes tyre, janë gjendur pothuajse në të njëjtën kohë duke studiuar këtë kod të shkurtër juridik, që deri atëherë nuk e kishte tërhequr kurrë vëmendjen e ndonjë kërkuesi shkencor. Gjuhëtarja italiane Luçia Nadin, nisur nga interesa gjuhësore dhe albanologu zviceran Oliver Jens Schmitt për kërkime historike, ishin të parët që zbuluan dhe shfletuan në vitin 1997 këtë dorëshkrim mesjetar, i cili për meritë të tyre filloi të fokusohet si një material dokumentar tepër interesant²⁰ për rindërtimin e aspekteve historike të periudhës paraosmane në kryeqendrën e Arbërisë së Veriut.

Dokumenti origjinal është shkruar në pergamen dhe përmban dyzet faqe. Në krye ai paraqet stemën e qytetit, e cila është e riprodhuar në këtë mënyrë: përmbi shqiponjën dykrerëshe, majtas, shihet një shkabë krenare, që duket sikur simbolizon të shkuarën e lavdishme të qytetit, ndërsa në të djathtë i gëzohet një kocke një qen lypsar, që, sikurse mendojnë edhe studiuesit, metaforizon gjendjen e nënshtruar të Shkodrës pas pushtimit turk.²¹

Gjuha me të cilën janë shkruar Statutet e Shkodrës është venecianishtja e shekullit XV.²² Teksti është kopjuar me dorë nga njëfarë Marino Dulcich, sikurse thamë në fillim të shekullit XVI.²³ Rreth personalitetit të kopjuesit të tekstit sot nuk dihet asgjë e saktë, madje, as edhe përkatësia e vërtetë etnike e tij, duke pasur parasysh se ishte një kohë e intrigave dhe trazirave të mëdha sociale. Nuk mund të thuhet prerazi, as nëse Dulcich ka vendosur vetë të merret me kopjimin e dorëshkrimit apo të kenë vendosur të tjerët për të. Ka të ngjarë që Dulcich të jetë bazuar mbi një raport të çfarëdoshëm pune në kancelarinë e Republikës së Shën Markut dhe, për çdo rast i lejohej të merrte si model tekstin statutor “nga origjinali i vjetër”, i cili ruhej në arkivin e Këshillit të të Dhjetëve.²⁴ Ishte më se e logjikshme që një kopje e statutit shkodran të ruhej midis shkresave zyrtare me interes publik, edhe pse për fat të keq deri tani nuk është evidentuar asnjë gjurmë prej tij.

Nga ana tjetër, ky tekst e kishte humbur ndjeshëm rëndësinë e tij pas pushtimit osman të Shkodrës (1479) dhe ky fakt mund ta ketë bërë edhe më të lehtë humbjen apo zhdukjen e dokumentit në fjalë. I rëndësishëm është fakti se kopja e bërë me një kujdes të tillë deri në “afeksion”, paraqet

¹⁹Ibid.

²⁰Lucia Nadin, Luigi Za, “Sugli antichi Statuti della citta di Scutari,” në: *Studiuesit italianë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare* (Universiteti i Shkodrës: Shkodër: Volaj, 1997), 41 – 45.

²¹ Ortalli, “Gli statuti, tra Scutari e Venezia,” 22.

²² Sipas shqipëruesit të Statuteve të Shkodrës, medievistit Pëllumb Xhufi, në *Historia e Popullit Shqiptar*, vëllim I, 266.

²³Ortalli, “Gli statuti, tra Scutari e Venezia,” 21.

²⁴Ibid, 22.

karakteristika mjaft interesante rreth kodit juridik të qytetit të Shkodrës në fillim të mesjetës së vonë.²⁵

I jashtëzakonshëm për të mbajtur gjallë një kujtim historik, statuti na paraqitet si një libërth shumë i mirëmbajtur nga forma, por aspak luksoz në krahasim me librat e bukur prej pergamene që prodhoheshin ende në atë periudhë. Mbi të gjitha, ai nuk përmbante asnjë udhëzim të veçantë përdorimi. I shkruar dhe i ruajtur me një kujdes gati prekës, i rregullt dhe i saktë, por në të njëjtën kohë jashtëzakonisht i ngatërruar në përmbajtje, shpesh herë ai do të cilësohej si “i gabuar” dhe i “paplotë”.²⁶ Në fakt, dëshmia e vetme që ka mbërritur deri te ne, ndoshta kopja e fillimit të viteve 1500, nuk përmban asnjë përgjigje konkrete dhe të drejtpërdrejtë.

Në vitin 2002, nën kujdesin L. Nadin, shoqëruar me studime të saj, të historianëve Oliver J. Schmitt e Gherardo Ortalli, gjuhëtarit Giovan Battista Pellegrini dhe me një përkthim shqip nga medievisti Pëllumb Xhufi u botuan në Romë Statutet e Shkodrës, të cilat janë vendosur tashmë në qarkullim të gjerë shkencor. Pasi i studion në të gjitha aspektet Statutet e Shkodrës, fuqia e tyre rezulton sot më e madhe nga sa mendohej. Sipas përcaktimit të O. J. Schmitt, Statutet e Shkodrës janë një “monument i vërtetë i Shqipërisë mesjetare” e pse jo dhe më shumë se kaq, përderisa përmbajtja e tyre i tejkalon kufijtë e realitetit shqiptar dhe përbën rëndësi të veçantë për historinë e të gjithë bregut lindor të Adriatikut dhe marrëdhënieve të tij me Venecian ashtu edhe me superfuqitë e zonës, në kuadrin e ekuilibrave të mëdhenj ndërkombëtarë.²⁷

Ky dokument gëzon privilegjin e të qenurit teksti legjislativ më i vjetër i hartuar në territorin shqiptar, që ka mbërritur deri në ditët e sotme.²⁸ Statuti juridik i Shkodrës është një dëshmi e qartë organike e asaj Shqipërie bregdetare me qendra urbane, kaq e ndryshme nga modelet dhe stereotipet që ende edhe sot vë në dukje L. Nadin, rrezikojnë të ndrydhin gjithë realitetin shqiptar brenda logjikës së “vendit të shqiponjave” dhe “kulturave të malit”.²⁹ Gjithashtu, ky dokument na përcjell kujtimin e një ndërthurjeje të jashtëzakonshme të kulturave dhe popujve, të marrëdhënieve dhe konflikteve, si dhe është dëshmia e një shtresëzimi zhvillimesh dhe qytetërimesh nëpërmjet një eksperience shumë shekullore.³⁰

Analizat e hollësishme të O. J. Schmitt na japin drejtime të qarta për kohën dhe klimën historike, në të cilën u hartuan Statutet e Shkodrës. Për datimin dhe klasifikimin e tyre përcaktuese është vendndodhja e tyre në mjedisin

²⁵ Ortalli, “Gli statuti, tra Scutari e Venezia”, 22.

²⁶ Ibid.

²⁷ Oliver J. Schmitt, “Un monumento dell’ Albania medievale: Gli Statuti di Scutari,” te sfondi i artikujve hyrës në: *Statuti di Scutari della prima metà del secolo XIV con le addizione fino al 1469* (Roma: Viella, 2002), 26.

²⁸ Ortalli, “Gli statuti, tra Scutari e Venezia”, 10.

²⁹ Nadin “Il testo *statutario*”, 47.

³⁰ Ortalli, “Gli statuti, tra Scutari e Venezia”, 12.

kulturor të qytetit të Shkodrës, Dalmacisë dhe Perandorisë Serbe.³¹ Mënyra se si janë përmbledhur ligjet dhe normat, të cilat kanë mbërritur në atë formë deri në ditët e sotme, rezulton se Statutet e Shkodrës janë hartuar në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XIV.³² Një moment historik tepër i rëndësishëm që duhet përmendur për këtë datim, është periudha kur Stefan Dushani, mbreti i shtetit serb të Rashës, kishte vendosur nën kontrollin e tij pjesën më të madhe të Shqipërisë mesjetare me përjashtim të qytetit të Durrësit.³³ Në këtë periudhë, hyri në përdorim titulli perandorak i “*Carit*”, përpara se vetë Stefan Dushani të kurorëzohej solemnisht me këtë titull ditën e Pashkëve në vitin 1346, duke braktisur titullin e mbretit, i cili vazhdonte të përmendej i pandryshuar në tekstin e Statuteve të Shkodrës.³⁴ Deri në momentin që flasim, është e sigurt se jemi përpara vitit 1346 dhe, si rrjedhim përpara majit të vitit 1349, kur gjatë një kuvendi të mbajtur në Shkup, Dushani paraqiti Zakoniku – n, kodin e tij të ligjeve me anë të të cilit synonte t’i jepte një bazë juridike më solide Perandorisë Serbe.³⁵ Zakoniku ishte një sistem normash juridike që duheshin zbatuar jo vetëm në hapësirën serbe, por edhe në territoret e pushtuara në Maqedoni, Thesali, Epir dhe në Arbëri.³⁶

O. J. Schmitt këmbëngul se Statutet e Shkodrës kanë qenë hartuar më përpara se Zakoniku i Dushanit, duke u mbështetur në dy argumente të rëndësishme dhe të pakundërshtueshme. Së pari, te Statutet e Shkodrës sundimtari serb përmendet gjithmonë me titullin “mbret” (Miser lo Re; lo Re) dhe asnjëherë me titullin perandor. Prej kësaj mund të vijmë në përfundimin se ky statut ekzistonte qysh përpara kurorëzimit të Stefan si car (perandor) dhe para botimit të Zakonikut. Si *terminus ante quem* do të vlejë viti 1346. Kështu Statuti i Shkodrës është një monument i përcaktimeve ligjore dhe i gjuhës në Shqipërinë e Veriut në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XIV.³⁷ Një argument i dytë për datimin do të ishte prania e normave të së drejtës penale te Statutet e Shkodrës, të cilat nuk kishin arsye që të shfaqeshin në një hapësirë të kufizuar të përdorimit të tyre, në rast se në të njëjtën kohë kishte hyrë në fuqi dhe vepronte Zakoniku.³⁸

Statutet e Shkodrës përbëhen nga 279 kapituj, të cilët janë të renditur në bazë të përmbajtjes sipas blloqesh tematike.³⁹ 268 kapitujt e parë i përkasin dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit XIV, 6 shtojca viteve 1391 – 1393⁴⁰ si

³¹ Schmitt, “Un monumento dell’ Albania medievale: Gli Statuti di *Scutari*,” 29.

³² Ibid.

³³ Ortalli, “Gli statuti, tra *Scutari* e *Venezia*”, 11.

³⁴ Schmitt, “Un monumento dell’ Albania medievale: Gli Statuti di *Scutari*,” 30.

³⁵ Ortalli, “Gli statuti, tra *Scutari* e *Venezia*,” 11.

³⁶ Ibid.

³⁷ Schmitt, *Arbëria Venedike*, 113.

³⁸ Schmitt, “Un monumento dell’ Albania medievale: Gli Statuti di *Scutari*,” 31.

³⁹ Në fakt vetëm 278 kapituj janë me tekste të plota, pasi kreut 66 që titullohet “*Mbi shitjen e mishit me peshë*” i mungon krejtësisht përmbajtja. (E. Baze).

⁴⁰ *Statuti di Scutari*, kreu 269, 270, 271, 272, 273, 274.

dhe pesë dispozita të periudhës veneciane 1457 – 1469.⁴¹ Rëndon një statut përbëhet nga dispozita ligjore të renditura pak a shumë pas orientimesh përmbajtësore, të cilat plotësohen me shtojca në radhë sipas rendit kronologjik, më së shumti vendime këshilli ose dëshmi privilegjesh të zotit të vendit.

Megjithatë një vijë e qartë organizuese mund të vihet re vetëm në tërësi, pasi në mënyrë të përsëritur futen midis ndarjeve kryesore tematike edhe dispozita nga fusha të tjera. Pas disa kapitujsh hyrës që kanë të bëjnë me të drejtën shtetërore, duke qenë se rregullojnë marrëdhënien me mbretin serb si zot të vendit,⁴² vijon një radhë e gjatë dispozitash për ndërtimin e shtëpisë, pronësinë dhe qiranë e shtëpive si dhe mbajtjen e mullinjve, furrave dhe tavernave.⁴³

Një pjesë e dytë përmban përcaktime lidhur me punën në ara, në vreshta dhe në pentari.⁴⁴ Kushtet e punës dhe rrogat janë objekt i një sërë kapitujsh të tjerë.⁴⁵ Kushtetuta e mirëfilltë e qytetit së bashku me asamblenë popullore, këshillin, gjykatësit, zyrat e ndryshme publike, detyrimin e shërbimit ushtarak dhe çështjet komunale, si pajtitë e peshat bëjnë pjesë në një grup të posaçëm kapitujsh.⁴⁶ Pas këtyre vijojnë nyjet për gjykatësit dhe procedurat gjyqësore, për shembull lidhur me dëshmitarët dhe dëshmitë e ndryshme me shkrim,⁴⁷ pozitën juridike të klerikëve dhe të peshkopit,⁴⁸ si dhe kapituj të veçantë që bëjnë fjalë, “mbi dokumentin e borxhit”,⁴⁹ “mbi të drejtën e pronës mbi shtëpinë, shkallaren, hajatin, vreshtën bahçen, ullishten, lajthishtën e toka të tjera”,⁵⁰ “mbi kontestimin e vendimit”,⁵¹ “mbi dhënien e vendimit”,⁵² “mbi mandatin e funksionarëve”,⁵³ dhe “mbi borxhet e të huajve”.⁵⁴

Mjaft të hollësishëm janë paragrafët mbi të drejtën civile⁵⁵ dhe për të drejtën penale,⁵⁶ e cila ndahet në norma penale të pjesës së përgjithshme dhe norma penale të pjesës së posaçme. Në statut normat me karakter penal të pjesës së përgjithshme nuk janë të vendosura në një sistem më vete, por ato mund të

⁴¹Ibid, kreu 275, 276, 277, 278, 279.

⁴²Ibid, kreu 1 – 7.

⁴³Ibid, kreu 8 – 30.

⁴⁴Ibid, kreu 31 – 48.

⁴⁵Ibid, kreu 49 – 84.

⁴⁶Ibid, kreu 88 – 109.

⁴⁷Ibid, kreu 110 – 143 me plotësime 277 – 278.

⁴⁸Ibid, kreu 144 – 145; 148; 154 – 155.

⁴⁹Ibid, kreu 146.

⁵⁰Ibid, kreu 149.

⁵¹Ibid, kreu 150.

⁵²Ibid, kreu 151.

⁵³Ibid, kreu 152.

⁵⁴Ibid, kreu 153.

⁵⁵*Statuti di Scutari*, kreu 156 – 159.

⁵⁶Ibid, kreu 200 – 276.

konstatohen nëpërmjet analizës së normave penale të pjesës së posaçme.⁵⁷ Sistemi i normave të pjesës së posaçme është i ndërtuar sipas llojeve të veprave penale, por ky rregull nuk respektohet gjithmonë, sepse ka mjaft norma penale të shpërndara nëpër krerë të ndryshëm.⁵⁸ Për çdo kundravajtje ndaj dispozitave të statutit janë përcaktuar gjoba kryesisht në vlerë monetare,⁵⁹ që ndahen përgjysmë midis kontit (mëkëmbësit të mbretit serb) dhe komunës qytetare ose kontit dhe të dëmtuarit ose paditësit.

Në Statutet e Shkodrës mungojnë dispozitat ligjore që flasin për organizimin dhe zhvillimin e tregtisë. Kjo ndoshta për faktin, se tregtia ishte një degë tepër e rëndësishme dhe delikate e ekonomisë mesjetare, që kërkonte një vëmendje më të madhe dhe një mbrojtje e siguri publike më të fortë, të cilën mund ta garantonte vetëm pushteti qendror që në rastin konkret ishte mbretëria serbe. Mungesa e nyjeve në lidhje me veprimtarinë tregtare në Statutet e Shkodrës mund të jetë “kompesuar” me ekzistencën e dispozitave tregtare në Zakonikun e Stefan Dushanit, i cili përmbante edhe ligjet dhe urdhëresat e mëparshme mbretërore.⁶⁰

Baza e Statuteve të Shkodrës ka qenë “e drejta romane”, e cila u trashëgua si një model në të gjitha komunat qytetare të zhvilluara përgjatë Adriatikut Lindor. Qysh prej krijimit të Perandorisë Romake të Lindjes në vitin 395 me kryeqytet Konstandinopolin, në viset perëndimore të Ballkanit vijonin të ekzistonin zona që me doket e tyre, dhe sidomos me organizimin e tyre administrativ, u kundërviheshin praktikave dhe ligjeve lindore.⁶¹ Këto ishin

⁵⁷Statutet e Shkodrës, Komiteti i pajtimit mbarëkonbëtar, përgatitur nga prof. Ismet Elezi, (Tiranë: Ilar, 2003), 61.

⁵⁸Ibid, 62.

⁵⁹ (Monedha që përmendet më shpesh në Statutet e Shkodrës është *hyperperi*. Në vitin 1092, perandori bizantin Aleks I Komnen ndërmori një rivlerësim drastik të sistemit monetar bizantin, duke futur një monedhë ari të re, *hyperperin* (që do të thotë shumë e përpunuar dhe e pastër). Kjo monedhë e re ishte e të njëjtit standard (pesha 4. 45 gram ar) me solidus – in, por përmbante më pak ar (20. 5 karatë në vend të 24) falë riciklimit të monedhës së mëparshme të zhvleftësuar. *Hyperperi* qëndroi monedha standard prej ari për aq kohë sa Bizanti pushoi së stampuari monedha prej ari në mesin e shekullit XIV. Vlera e kësaj monedhe erdhi duke rënë me kalimin e viteve, derisa në fundin e shekullit XIV, pesha e saj qe shumë larg peshës fillestare. Emri *hyperper* u përshtat në forma të ndryshme në Europën Perëndimore, (ku në latinisht = perperum, italishten mesjetare = perpero) dhe në vendet slave të Ballkanit (perper; iperpero, etj.).

⁶⁰Stojan Novaković, *Kodeksi i Stefan Dushanit carit serb 1349 dhe 1354*, Beograd, 1898, (dorëshkrim në Arkivin e Institutit të Historisë, Tiranë, përkthyer nga D. Jojiç), fl. 37 – 38: “Është e lehtë të kuptohet një gjë e tillë kur shikohet se mjaft nene të Kodeksit fillojnë me fjalët “urdhër mbretëror”. (Më tej, *Kodeksi i Stefan Dushanit*).

⁶¹Averil Cameron, *Bizantinët*, përktheu në shqip Kujtim Ymeri(Tiranë: Dituria, 2008). Tek ky libër, kapitulli 2: “Bizanti që ndryshon formë: prej Antikitetit të vonë deri më 1025”, f. 49 – 75. Kapitulli 3: “Bizanti që ndryshon formë: prej vitit 1025 deri më 1453”, 77 – 105.

zona ku vazhdoi të ruhej tradita romane në viset perëndimore ballkanike. Një vis të tillë e pati përfaqësuar Shkodra, si një territor që nga njëra anë nuk ishte vendosur plotësisht nën pushtetin qendror bizantin dhe, nga ana tjetër, nuk ishte pushtuar në mënyrë të përhershme prej dyndjeve barbare dhe sllave.

Përkundër një stereotipi të historiografisë perëndimore mbi Mesjetën ballkanike, do të kujtoj që në kësi rajonesh periferike të Bizantit⁶² kishte jo dy forma politike organizimi, sikurse është menduar, por tri modele qeverisjeje: forma e parë ishte ajo e mirëfillta e Perandorisë Bizantine, e cila vijonte të qeveriste qoftë edhe duke bashkëpunuar me prijësa barbarë; forma e dytë ishte ajo e vetë barbarëve, që shtinin në dorë territore të caktuara të Ballkanit duke u bërë në mënyrë graduale “vendës”,⁶³ forma e tretë ishte ajo e “viseve romane”, sikurse paraqitet Shkodra, e cila organizohej sipas modelit të ri të komunës qytetare dhe qeverisej në bazë të statuteve juridike.

Ky model i ri i organizimit të qeverisjes së qyteteve kishte të bënte me dobësimin e autoritetit bizantin në periferinë e tij evropiane, një dobësim që kishte filluar që prej shekullit VIII për të mbërritur kulmin me fundin e shekullit XII dhe fillimin e shekullit XIII, kur pas pushtimit latin të Kostandinopojës më 13 prill 1204 provincat periferike u shkëputën nga Bizanti dhe, thuajse, u shkërmoqën. Ishte brenda logjikës së procesit historik, që dobësimi i pushtetit qendror perandorak të shoqërohej me zhvillimin e komunave qytetare ku popullsia e qyteteve si Shkodra filluan të vetëorganizoheshin dhe të vetëmbroheshin.

Këtë model e përfaqësonin në veri të Adriatikut Lindor qytetet e tipit dalmatin të qeverisura në bazë të statuteve ligjore si, Kotorri, Budva, Tivari, Ulqini dhe Drishti. Në këto kushte të reja të realitetit historik, nën tryshinë gjithnjë e më të theksuar të ndikimit perëndimor, këto komuna qytetare filluan të konsolidonin institucionet dhe mënyrën e administrimit të tyre. Në kapërcyell të shekujve XIII – XIV, kur Bizanti po përjetonte një krizë të pashmangshme politiko – sociale, ndjesia e autonomisë qytetare në rajonet e Adriatikut Lindor mbetej e paprekur, pavarësisht nëse ndërroheshin mbretërit apo perandorët ose autoriteti epror në përgjithësi. Një gjë e tillë dëshmohej në Statutet e Shkodrës, duke iu referuar herë “mbretit Stefan”,⁶⁴ herë “perandorit”⁶⁵ e më vonë “kontit kapiten”⁶⁶ ose “proveditorit”,⁶⁷ që përfaqësonin Republikën e Shën Markut.

E përvijuar në një territor të caktuar dhe e organizuar me ligje kushtetuese, komuna qytetare e Shkodrës paraqitet si një dukuri relativisht e re e mesjetës

⁶²*Historia e Popullit Shqiptar*, vëllim I, 174.

⁶³Maria Rosaria Venittelli, *Storia del diritto Medievale e Moderno* (Napoli: Edizioni Giuridiche Simone, 2001), 31.

⁶⁴*Statuti di Scutari*, kreu 1, 2, 3, 31, 55, 85, 92, 99, 224, 225.

⁶⁵Ibid, kreu 274.

⁶⁶Ibid, kreu 277, 278, 279.

⁶⁷Ibid, kreu 275.

së vonë në hapësirën e Arbërisë Veriore. Statutet e saj nuk ishin ndonjë krijim origjinal i qytetarisë shkodrane të gjuhës romane, por shumë më tepër i botës dalmate të ndikuar prej Italisë.⁶⁸ Shkodra përfaqësonte një nga hallkat jugore të zinxhirit të komunave dalmate me parime të ngjashme ligjore dhe me orientimin kryesor për nga deti.⁶⁹

2. Përmbajtja e Kanunit të Lekë Dukagjinit

Para zbulimit të Statuteve të Shkodrës, shkencat juridike e historike shqiptare dhe shumë studiues të huaj janë përqendruar kryesisht në studimin e së drejtës zakonore të shqiptarëve, posaçërisht në Kanunin e Lekë Dukagjinit, duke e konsideruar si një nga burimet primare dhe kryesore për organizimin dhe institucionalizimin e marrëdhënieve juridike në arealin mesjetar të Shqipërisë së Veriut.⁷⁰

E drejta zakonore shqiptare është një e drejtë popullore e pashkruar, e transmetuar brez pas brezi nga tradita gojore që ka shërbyer për rregullimin e marrëdhënieve juridike gjatë shekujve në viset shqiptare. Ajo nuk është krijuar nga ndonjë person i vetëm e as nga ndonjë organ i vetëm legjislativ. E drejta zakonore shqiptare e ka origjinën e saj të lashtë nga shoqëria fisnore, parashtetërore, ku në të vërtetë forma dhe përmbajtja e saj janë karakteristike për një shoqëri pa shtet.⁷¹ Pas lindjes së shtetit ajo bashkëjetoj me të drejtën shtetërore: në shoqërinë skllavopronare dhe në atë feudale një pjesë e së drejtës zakonore u sanksionua nga shteti, pjesa tjetër vazhdoi të vepronte pavarësisht prej tij.⁷² Pranë “nomokanonit” feudal bizantin, në Shqipëri është një e drejtë zakonore, një e drejtë popullore me tipare arkaike interesante, që s’i njihete e drejta bizantine ose që ishte në kundërshtim me të, ka vënë në dukje studiuesi shqiptar Aleks Buda për këtë çështje.⁷³

Termi “kanun”, ka prejardhje greko – bizantine. “Nomokanon” quheshin normat juridike – fetare që nxirrnin perandorët e Bizantit.⁷⁴ Ky term hyri në gjuhën shqipe nëpërmjet fjalës turke “*Kanunname*”,⁷⁵ që ishte dekret i sulltanit për një rajon të veçantë ose për një grup shoqëror të veçantë ku tregohen rregullat e përgjithshme për vjeljen e detyrimeve, zgjidhjen e

⁶⁸ Schmitt, *Arbëria Venedike*, 114.

⁶⁹ Ibid.

⁷⁰ Elezi, “Kanunet dhe qytetet mesjetare,” në: *Statutet e Shkodrës*, 1.

⁷¹ Elezi, *E Drejta Zakonore Penale e Shqiptarëve* (Tiranë: 8 Nëntori, 1983) 15 – 16.

⁷² *Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri*, botim i tretë, (University Press Luarasi, 2005), 231.

⁷³ Aleks Buda, “Vendi i Shqiptarëve në Historinë Evropiane të shek. VIII – XVIII,” *Studime Historike* 1 (1967): 7.

⁷⁴ *Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri*, 232.

⁷⁵ Ibid.

grindjeve lokale, mënyrën e zotërimit të tokës dhe përjashtimet nga disa detyrime.⁷⁶

Një ndër burimet kryesore të së drejtës zakonore shqiptare është Kanuni i Lekë Dukagjinit, i hartuar me emrin e Lekës III Dukagjin (1459 – 1479).⁷⁷ Kanuni zbatohet në Malësinë e Mbishkodrës dhe në Dukagjin, i cili në atë periudhë përfshinte Shalën e Shoshin, Pukën, Iballën, Mirditën dhe Malësinë e Lezhës.⁷⁸ Kjo është një krahinë e ashpër, e ftohtë, alpine, disi larg rrugëve të zakonshme të komunikacionit, ku kushtet gjeografike kanë ndikuar për ruajtjen dhe konservimin e këtij thesari kulturor.⁷⁹

Kanuni i Lekë Dukagjinit është burimi kryesor i së drejtës zakonore, sepse përbën korpusin më të plotë e të ruajtur mirë dhe është i ndarë në 12 libra, në 24 krerë, në 159 nyje e 1263 paragrafë.⁸⁰ Për sa i përket ndarjes së lëndës sipas degëve të së drejtës mund të bëhet ndonjë vërejtje, sepse kjo ndarje nuk është gjithmonë e saktë.⁸¹ Përveç kësaj ka përzierje normash juridike dhe morale, si dhe norma të së drejtës kanonike me ato të së drejtës zakonore.

Libri i parë i Kanunit të Lekë Dukagjinit i kushtohet pozitës juridike të kishës,⁸² një pozitë krejt e veçantë dhe e privilegjuar, ashtu sikurse ishte Kisha Katolike në Malësitë e Veriut, e cila ka luajtur një rol civilizues për zhdukjen e disa institucioneve të vjetra e të dëmshme në fushën e së drejtës familjare, të gjakmarrjes, etj., në këto vise. Gjithashtu, në nyjet dhe paragrafët e këtij kanuni, pasqyrohen edhe dy nga vlerat e virtytet më të çmuara të popullit shqiptar ndër shekuj, që janë besa⁸³ dhe mikpritja.⁸⁴

3. Sprovë për një qasje krahasuese midis këtyre dokumenteve juridike

Megjithë diversitetin e dukshëm në kohë, në hapësirë e në përmbajtje, që shfaqin Statutet e Shkodrës në krahasim me Kanunin e Lekë Dukagjinit, për hir të së vërtetës, duhet përmendur se ato karakterizohen edhe nga disa ngjashmëri midis tyre. Këto ngjashmëri lidhen, së pari, me lindjen dhe zhvillimin e këtyre dy legjislacioneve në mjedisin dhe truallin historik shqiptar, ku pavarësisht ndikimeve të ndryshme, ato shprehin autenticitetin dhe origjinalitetin shqiptar të tyre.

⁷⁶ Petrika Thëngjilli, *Historia e Perandorisë Osmane* (Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 1997), 262.

⁷⁷ *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, 25. Milan Šufflay, *Serbët dhe Shqiptarët*, përkthyer në shqip Ilir Ibrahim, Zef Fekeçi, Karl Gurakuqi, Zekeria Cana (Tiranë: Bargjini, 2001), 60.

⁷⁸ *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, f. 26.

⁷⁹ *Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri*, 233.

⁸⁰ *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, 1 – 109.

⁸¹ *Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri*, 233.

⁸² *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, libri i parë, 1 – 6.

⁸³ *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, nyja 122.

⁸⁴ *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, nyja 96.

Së dyti, lidhet me pozitën gjeografike dhe administrative të qytetit të Shkodrës si kryeqendra e Shqipërisë Veriore⁸⁵ jo vetëm në kohët më të hershme, por edhe në ditët e sotme. Si pasojë e kësaj, elemente të së drejtës zakonore të veriut shqiptar, kanë ushtruar ndikimin e tyre dhe kanë krijuar një farë simbioze me të drejtën qytetare shkodrane qysh para daljes së Kanunit të Lekë Dukagjinit. Thuhet se ky kanun e ka prejardhjen nga lashtësia dhe se është më i vjetri në Evropë. S'është çudi që kjo të jetë e vërtetë, sepse zor të gjendet një kanun më i ashpër. Ligjet dhe kanunet që i atribuohen Lekës, duket qartë se janë më të hershme se sa shekulli XV, pra, se koha kur thuhet se ai ka jetuar. Ndoshta atyre ligjeve u janë bindur luftëtarët e panjohur me armë bronzi që dalin nga varrezat parahistorike.⁸⁶

Së treti, ka të bëjë me marrëdhëniet dhe bashkëpunimin reciprok ekonomik, politik, social e kulturor të qytetit me botën rurale përreth tij. Një nga komponentët e rëndësishëm për formimin e njësuar dhe konsolidimin e popullit e të kombësisë si unitet social – historik i ri, janë lidhjet ekonomike midis krahinave të ndryshme – natyrisht brenda kuadrit e mundësive të shoqërisë dhe të ekonomisë feudale. Në realizimin e këtyre lidhjeve një rol aktiv luanin qytetet.⁸⁷ Në këtë kuadër, përveç lidhjeve dhe bashkëpunimit ekonomik, ka ndodhur edhe shkëmbimi dhe adaptimi i dokeve, i zakoneve dhe i kulturës midis qytetit dhe krahinave që ndodheshin nën influencën dhe juridiksionin e tij social – ekonomik.

Së fundi, ka të bëjë edhe me zhvendosjet demografike të popullsisë nga zonat e thella e të ashpra rurale e me vështirësi serioze ekonomike drejt qyteteve për një jetë më të sigurtë e më të mirë. Ky është një fenomen historik që ndodh rëndom në historinë evropiane në fillim të mesjetës së vonë, i cili është në antitezë të plotë me shekujt e mesjetës së hershme, kur ndodhi braktisja dhe ruralizimi në masë i qyteteve.⁸⁸ Të njëjtën gjë mund të aludojmë edhe për banorët e malësive të thella përreth Shkodrës, të cilët duke u nisur nga kushtet e vështira ekonomike apo nga motivi i gjakmarrjes migruan drejt qytetit, duke mbartur me vete zakonet dhe normat kanunore të zonës nga ku ata vinin.

Në këtë mënyrë, mund të shpjegohet deri diku influenca e së drejtës zakonore shqiptare në disa dispozita të Statuteve të Shkodrës dhe ngjashmëria e këtyre të fundit me disa nga normat e Kanunit të Lekë Dukagjinit. Në mënyrë të përafërt, ngjashmëritë midis këtyre dy

⁸⁵ Edith Durham, *Brenga e Ballkanit dhe Vepra të tjera për Shqipërinë dhe Shqiptarët*, ribotim, përktheu në shqip Kudret Isai (Tiranë: Naum Veqilharxhi, 1998), 539.

⁸⁶ Durham, *Brenga e Ballkanit*, 17. *Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri*, f. 230.

⁸⁷ Malltezi, "Qytetet dhe roli i tyre në lidhjet ekonomike midis krahinave shqiptare në shek. XIII – XV," 73.

⁸⁸ George Duby, *Rural Economy and Country Life in the Medieval West* (South Carolina: Muller, 1968), 187. Henri Pirenne, *Economic and Social History of Medieval Europe* (New York: Harcourt Brace, 1956), 53.

legjislacioneve mesjetare shqiptare konsistojnë në paragrafët që kanë të bëjnë kryesisht me çështje agrare, si ruajtja dhe respektimi i kufijve të tokës,⁸⁹ mbi vijat e ujit⁹⁰ e mbi praktikën e gjysmatarisë;⁹¹ me çështje blegtorale, si mbi barinjët që ruajnë bagëtinë,⁹² mbi dëmet që shkakton bagëtia⁹³ dhe derrat në arë.⁹⁴ Për këtë të fundit, kreu 252 i Statuteve të Shkodrës parashikon: “*Kur derrat e dikujt futen në arat, vreshtat ose kopshtet e dikujt tjetër kur ato kanë ende prodhim dhe pasi pronarit të derrave i është bërë paralajmërim tri herë me radhë, pas paralajmërimit të tretë pronari i tokës ka të drejtë ta vrasë derrin*”, kurse në Kanunin e Lekë Dukagjinit, nyja 110, paragrafi 748, 749 thuhet shprehimisht: “*Thiu në dam ka pushkë. Po e gjete thinë në dam, bjeri pushkë*”. “*Po u gjet thiu në dam pa verza (kular – krrabza) në qafë vritet*”.

Gjithashtu, një ngjashmëri tjetër shfaqet te dispozita për gjakmarrjen dhe larjen e gjakut (urazbës),⁹⁵ ku kreu 224 i Statuteve të Shkodrës bën fjalë se: “*Nëse provohet se një person ka vvarë një burrë ose një grua, të dënohet me pesë hyperperë sklavonie, që duhet të ndahen midis mbretit dhe njeriut më të afërt të të vvarit. Pasi të ketë paguar, të mbyllet në shtëpi dhe të shlyejë urazbën (taksën e gjakut)*”, kurse në Kanunin e Lekë Dukagjinit, nyja 124, paragrafi 892 përmendet: “*Kush të vrasë njërin, kje burrë, a grue, djalë a*

⁸⁹Statuti di Scutari, kreu 14, 17, 22, 37: (Janë cituar edhe herë tjetër në punim). ~ Kanuni i Lekë Dukagjinit, nyja 57, paragrafi 241: “*Kufijtë e tokës nuk luhen*”. “*Se e cila tokë, po kje arë a livadh, kopshtë a vreshtë, prozhem a zabel, xanë a orgajë, a rrethi i shpis, katundi me katund a flamuri me flamur e shpija me shpi, kan të damet me kufi*”.

⁹⁰Statuti di Scutari, kreu 47: “*Në rast se dikush dëshiron të hapë një vijë uji për arat e veta, duhet ta bëjë këtë si është zakoni i vjetër. Në rast të kundërt do të gjobitet me 12 hyperperë ku gjysma i kalon kontit dhe gjysma tjetër fqinjët që pësoi dëmin. Përveç kësaj të paguajë edhe dëmin*”. ~ Kanuni i Lekë Dukagjinit, nyja 67, paragrafi 299: “*Me da e me hapë ujë e vis, e me ja u vu menden dasave, detyra e bulgut asht*”. Paragrafi 300: “*Po theu ujët e vis në rend të huej e në mende të vet bulgu, damin e lan bulgu*”.

⁹¹Statuti di Scutari, kreu 34, 45, 46: (Janë cituar edhe herë tjetër në punim). ~ Kanuni i Lekë Dukagjinit, nyja 67, paragrafi 304: “*Gjithshka të mbjellë bulgu në tokë të zotnis (çdo bimë) do ta ndajë me zotnin mbas vendimit, qi të kenë ba*”. Paragrafi 305: “*Pemë (fiq, arra, shega, molla, dardha e këso tjerash) bulgu i shkundë e i mbledhë e i dan përgjysmë me zotnin*”.

⁹²Statuti di Scutari, kreu 72: “*Barinjët që çojnë gjedhin në kullota duhet ta bëjnë mirë një punë të tillë dhe ta kenë mendjen që në kthim të mos u mungojë ndonjë kokë bagëti*”. ~ Kanuni i Lekë Dukagjinit, nyja 45, paragrafi 144: “*Bariu – rrogtar asht në detyrë me ia vu menden tufës të mos t’i damtohet as mos t’i baje dam kuej*”.

⁹³Statuti di Scutari, kreu 78, 79, 250: (Janë cituar edhe herë tjetër në punim). ~ Kanuni i Lekë Dukagjinit, nyja 65, paragrafi 282: “*Po u xu një tufë e hueja në mal a në vri të flamurit tjetër, i zoti i tufës do të lajë pashtrakun*”.

⁹⁴Statuti di Scutari, kreu 252,253: (I cituar edhe herë tjetër në punim). ~ Kanuni i Lekë Dukagjinit, nyja 110, paragrafi 748. Paragrafi 749.

⁹⁵Statuti di Scutari, kreu 224; Kreu 246; Kreu 266: “*Asnjë burri nuk i lejohet të marrë diçka nga paja e së shoqes për të paguar një gjakmarrje apo urazbë*”.

cucë a edhe ferishte djepi, i mirë a shemtim me dukë, kryeplak a sterplak, i pasë a i pa – pasë, fisnik a firuk, ndëshkimi asht një doret: për vrasë të mashkullit 6 qese, 100 desh e gjysë kau giobë". Të tri këto aspekte, janë karakteristike për shoqëritë e krahinave rurale e të izoluara, por në mënyrë të veçantë, fenomeni i gjakmarrjes, dëshmon për një zakon tipik të malësive veriore shqiptare.

Fakti që edhe në krahët e Statuteve të Shkodrës flitet për gjakmarrjen, tregohet në mënyrë eksplicite për një pjesë të ndikimit dhe të simbiozës të së drejtës zakonore në jetën juridike të "kryeqytetit" të Shqipërisë së Veriut në gjysmën e parë të shekullit XIV. Kjo dispozitë që bën fjalë për pagimin e taksës së gjakut, d. m. th, të gjakmarrjes, është vënë nën ndikimin e zakonit tradicional sllav të shpërblimit të gjakut të pranuar nga malësorët dhe të sanksionuar edhe me të drejtën zakonore të shqiptarëve, që më vonë do të përmbliidhej në normat kanunore të Lekë Dukagjinit.⁹⁶ Në dispozitë nuk përmendet sasisa e taksës (urazbës) që paguhet për gjakmarrje, por kjo me sa duket i është lënë traditës së malësorëve; gjithashtu vërehet se taksa e gjakut nuk mund të merret nga burri prej pajës së gruas,⁹⁷ duke vënë në mbrojtje të posaçme të drejtat pasurore të bashkëshortes.

Një dispozitë tjetër deri diku e përafërt midis Statuteve të Shkodrës dhe Kanunit të Lekë Dukagjinit vërehet edhe te neni që ka të bëjë me vjedhjen, ku në plan të parë të dy këto legjisllacione vënë në mbrojtje pronën private dhe pasurinë e komuniteteve përkatëse të tyre. Në lidhje me këtë, kreu 203 i Statuteve të Shkodrës parashikon: "*Nëse një burrë i vjedh dikujt në qytet ose jashtë qytetit dhe nëse vjedhja provohet, dënohet me dymbëdhjetë hyperperë sklavonie gjobë, gjashtë për kontin dhe gjashtë për zotëruesin e gjësë së vjedhur. Përveç kësaj, gjëja e vjedhur i kthehet të zotit. Pas kësaj, vjedhësi as mund të gjykohej e as të shpallet në kërkim*", kurse nyja 116, paragrafi 804 i Kanunit të Lekë Dukagjinit përcakton se: "*Dypërnjahja*". "*Nder të gjitha vendet, ku mbahet kanuja, çdo gja e vjedhun ka dypërnjahren: "Dy për një, mjaft të hecin me këmbë"*". Kjo normë e statutit dallohet nga norma përkatëse e Kanunit të Lekë Dukagjinit, vetëm përse i përket kthimit të gjësë së vjedhur, e cila sipas kanunit kthehet dy për një, veç gjobës që është e përbashkët; ndërsa gjysma për kontin e gjysma për të zotin në kanun ndryshon pak, pasi ky i fundit nuk e parashikon kontin.

Megjithatë, pavarësisht disa përafrimeve midis Statuteve të Shkodrës dhe Kanunit të Lekë Dukagjinit, duhet theksuar, se e drejta zakonore përmbante norma që rregullonin marrëdhëniet juridike të njerëzve në zonat rurale e malore të qeverisjes vendore, në jug, në veri të Shqipërisë e deri në Kosovë, ndërsa në qytete nuk vepronte fare, pavarësisht reflektimit të ndonjë impakti të vogël. Me daljen në dritë të Statuteve të Shkodrës të dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit XIV, plotësohet një boshllëk i madh në lidhje me organizimin ligjor dhe vetëqeverisjen e komunës qytetare. Kaq i vërtetë

⁹⁶Sufflay, *Serbët dhe Shqiptarët*, 60.

⁹⁷*Statuti di Scutari*, kreu 266.

është për ne tani fakti se popullsia qytetare shqiptare i qe përngjitur natyrshëm, pa drojë, civilizimit bashkëkohor evropian, madje, në statet më të avancuara të tij me standarde dhe instrumente ligjore të përparuara të tipit më relevant “Statut”, i thënë ndryshe “Kod i zgjeruar ligjor” apo më saktë “Kushtetutë”. Themi “Kushtetutë”, pasi për nga fuqia legislative që mbart ky dokument, objekti që trajton dhe administron, fushat ku ai shtrin efektet e tij, kompetencat që ngarkon, etj., ai ka vlerën, natyrën dhe atributet e një ligji themeltar, pra të një kushtetute.⁹⁸

Duke parë dispozitat e Statuteve të Shkodrës dhe marrëdhëniet konkrete që ato rregullojnë, detyrimet dhe sanksionet që dalin prej tyre, normat dhe distancat urbane, që pretendojnë të mbrojnë të drejtat dhe kompetencat e institucionit të mbretit, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të gjykatave,⁹⁹ barrierat ligjore për parandalimin e krimit dhe të korrupsionit,¹⁰⁰ dëshmitari¹⁰¹ dhe të drejtat e tij, noteri,¹⁰² përmbaruesi,¹⁰³ financieri,¹⁰⁴ llojet e veprave penale,¹⁰⁵ masat administrative që parashikohen, etj., kupton fare qartë se në ç`nivele të avancuara zhvillimi juridiko - institucional gjendej qyteti i Shkodrës në krahasim me krahinat malore përreth tij.

Duke e parë me kujdes këtë akt themeltar të rendit juridik, të përpiluar me standarde profesionale të admirueshme, me një kulturë të lartë shtetërore e qytetare, nuk ka se si të mos kthejmë vështrimin tonë te Kanuni i Lekë Dukagjinit, i cili është konsideruar gjer më tash si i vetmi dokument i rëndësishëm dhe bazal, që ka administruar dhe harmonizuar jetën e shoqërisë shqiptare të veriut në shekujt e mesjetës së vonë. Ndryshimi midis Statuteve të Shkodrës dhe Kanunit të Lekë Dukagjinit vërehet dukshëm te statusi që gëzonte gruaja në këto dy dokumente juridike. Në përgjithësi, gruaja shkodrane e gjysmës së parë të shekullit XIV ka një status që do t`ia kishin lakmuar edhe pasardhëset e saj në shekujt e mëvonshëm. Pasuria familjare është pronë në mënyrë të barabartë. “*Gjithçka që fitojnë burrë e grua së bashku konsiderohet e barabartë, d. m. th. gjysma i takon burrit dhe gjysma gruas*”.¹⁰⁶ Gruaja ka të drejtë të ndajë pjesën e saj nga vjehri e vjehrra, si dhe ka të drejtë të bëjë testament. “*Vajza dhe femra në përgjithësi ka të drejtë të lëshojë testament, duke filluar nga mosha dymbëdhjetë vjeç e lart*”.¹⁰⁷ Kujtojmë kalimthi për krahasim ndonjë nen të Kanunit të Lekë Dukagjinit: “*Grueja asht shakull për me bajtë sa të jetë në derë të burrit*”.¹⁰⁸

⁹⁸Irakli Koçollari, *Historia e filozofisë të së drejtës* (Tiranë: Dudaj, 2008), 134.

⁹⁹*Statuti di Scutari*, kreu 97, 98, 110, 111, 118, 119, 121, etj.

¹⁰⁰Ibid, kreu 156.

¹⁰¹Ibid, kreu 132, 133, 137, 139.

¹⁰²Ibid, kreu 56, 93, 94, 120.

¹⁰³Ibid, kreu 106.

¹⁰⁴Ibid, kreu 105.

¹⁰⁵Ibid, kreu 200 – 276.

¹⁰⁶Ibid, kreu 166.

¹⁰⁷*Statuti di Scutari*, kreu 186.

¹⁰⁸*Kanuni i Lekë Dukagjinit*, nyja 29.

“Me rrahë burri gruen, nuk bie në faj kah kanuja, e as prindja s`mund t`a kërkojnë të rrahmen”¹⁰⁹ ose “gruaja që lëshohet, tuj dalë shpijet të burrit, kurrnji send s`ka tager me marrë vedi posë petkash, që ka në shtar”.¹¹⁰

Por, ndërsa Kanuni i Lekë Dukagjinit, na ofron imazhet e një shoqërie shqiptare në provinca të thella, vështirë të arritshme, të administrueshme dhe të qeverisshme, larg idesë së institucioneve, rregullave dhe hierarkisë shtetërore; në të kundërt, një pamje dhe realitet krejt tjetër na ofrojnë Statutet e Shkodrës, imazhet e një bote të civilizuar, të shoqërisë shqiptare të kohës, të barazvlerëshme me qytetërimin evropian, të kontrolluar dhe administruar rreptësisht nga ligji, rregulli e drejtësia.

Duke iu referuar këtyre normave kanunore, formohen impresionet e deformatuara, se shoqëria shqiptare mesjetare, shfaqet të jetë një shoqëri thjesht rurale, që administrohej nga norma dhe doke zakonore orale të një bote të ashpër e baritore.¹¹¹ Përmes analizës së Kanunit të Lekë Dukagjinit të krijohet përshtypja se realiteti shqiptar është ende i paurbanizuar, ende pa institucione dhe struktura të mirëfillta shtetërore, i mbetur pas në kohë, në raport me shoqëritë fqinje evropiane, që shkonin në rritje drejt prosperitetit të vazhdueshëm.

Por, në kundërshtim me këtë peizazh baritor dhe klanor që ofron kanuni, Statuti i Shkodrës, ky monument i mahnitshëm juridik, afrohet të na thotë se, shoqëria shqiptare nuk është një shoqëri baritore, që rregullon lëvizjen dhe veprimtarinë e saj me kujtesën zakonore tradicionale – kanunore, nuk është një shoqëri me diferenca gjinore e mbytur nga gjaku dhe gjakmarrja, por ajo është një shoqëri qytetare me standarde civilizmi bashkëkohore, e denjë dhe e barabartë për t`u çapitur krah për krah mbretërive të tjera evropiane të kohës.¹¹² Padyshim, zonat e thella dhe të largëta rurale, ato kohë të errëta mesjetare, ruanin ende rite të traditave të lashta dhe relikte mitologjike, që pozita gjeografike ua ofron si privilegj vetëm këtyre terreneve.

Konkluzion

Në sintezë të analizës dhe krahasimit që trajtuam më lart, mund të themi se Statutet e Shkodrës dhe Kanuni i Lekë Dukagjinit janë dy monumente juridike shumë të rëndësishme dhe përbëjnë fondin themelor për studimin e shumë aspekteve të shoqërisë shqiptare në Mesjetë. Krahas problematikës kryesore të çështjeve juridike e institucionale të shoqërisë së qytetit dhe fshatit shqiptar në atë periudhë, këto dy legjislacione japin dorë edhe për të ndjekur studime në fusha të tjera, meqenëse aty mund të mblidhen të dhëna për ekonominë, për sociologjinë, për gjuhësinë, për etnografinë, për demografinë e kështu me radhë.

¹⁰⁹Ibid, nyja 28.

¹¹⁰Ibid, nyja 31.

¹¹¹Ermal Baze, *Një Qytet me Statute: Shkodra në gjysmën e parë të shekullit XIV* (Tiranë: Muzgu, 2013), 212.

¹¹²Koçollari, *Historia e filozofisë*, 135.

TERRORIZMI SI KONCEPT, SHKAQET E LINDJES, QËLLIMI, TAKTIKAT DHE STRATEGJITË E TIJ

Fatjon Malaj¹, Leonard Sala²

¹Fakulteti Ekonomik, Universiteti "Eqrem Çabej"

Email: fatjonselammalaj@gmail.com

²Bashkia Gjirokastër

Email: leonardgezimsala@gmail.com

Abstrakt

Ky artikull shqyrton nocionin e terrorizmit që nga fillimi i tij e deri më sot, së bashku me zhvillimin e tij. Po ashtu paraqiten të dhëna dhe detaje specifike në lidhje me organizatat historike dhe bashkëkohore, si ALKAIDA dhe ISIS. Veprimet e ndërmarra nga Shqipëria dhe kursi i ndjekur nga institucionet shqiptare. Bashkëpunim si brenda ashtu dhe me organizata jashtë qeverisë shqiptare.

Veprimet e ndërmarra nga agjencitë shqiptare të zbatimit të ligjit demonstuan aftësinë e tyre për të përballuar situatën, pavarësisht faktit se ato ishin filozofikisht dhe praktikisht jo të familjarizuara me të.

Shumica e individëve kanë një ide ose opinion të paqarte se çfarë është terrorizmi. Bombat, vrasja e një kreu të shtetit, masakrat e qytetarëve të pambrojtur nga forcat ushtarake të qeverisë, kontaminimi i ushqimit në supermarkete dhe incidente të tjera mund të konsiderohen të gjitha shembuj të kësaj përshtypjeje. Në fakt, terrorizmi përdoret shpesh për të përshkruar çdo akt të paimagjinueshëm të dhunës kundër shoqërisë.

Fjalë kyçe: *Fjalët Kyçe: Masa kundërterror, ISIS, radikalizëm, organizatë, influencë*

Abstract

This article examines terrorism as a concept from its birth to the present day and its evolution, presenting data and concrete facts about organizations dating back to the past and to the present day, such as ALKAIDA and ISIS. measures and path followed by Albania as acted by the Albanian institutions. Internal cooperation and cooperation with institutions outside the Albanian state.

The steps and measures taken by the Albanian law enforcement agencies, which although they did not know him ideologically and in many ways, showed that they were up to the task.

Most people have a vague idea or judgment of what terrorism is. One could look for this impression in various acts such as: placing bombs, killing a head of state, massacres of innocent civilians by military government forces,

poisoning food in supermarkets, etc. Indeed, any unimaginable act of violence committed against society is often labeled as terrorism.

Keywords: *counterterrorist measures, ISIS, radicalization, organization, influence*

Shumica e njerëzve kanë një ide apo një gjykim të turbullt se ç'është terrorizmi. Dikush mund ta kërkojë këtë impresion tek aktet e ndryshme, si: vendosja e bombave, vrasjet e një kryetari shteti, te masakrat e forcave qeveritare ushtarake ndaj civilëve të pafajshëm, te helmimet e ushqimeve në supermarkete etj. Në të vërtetë çdo akt i pakonceptueshëm i dhunës që ndërmerret ndaj shoqërisë shpesh etiketohet si terrorizëm.

Një tjetër vështirësi kur ne duam të përcaktojmë fjalën "*terrorizëm*" është qëndrimi i shteteve dhe qeverive të ndryshme të cilët pranojnë si terror "lëvizjet për liri dhe pavarësi" ose incidentet e rëndomta.

Nëse ne hetojmë për këtë fjalë, nëpër fjalorë dhe analistë të ndryshëm, gjejmë më shumë se një përcaktim dhe konkretisht:

Përcaktimi i parë Oxford English Dictionary e përcakton terrorizmin si një "Politikë e ndjekur për të goditur me terror objektivat kundër të cilëve është krijuar, shfrytëzim i metodave të frikësimit, i terrorit në fakt apo i kushtit të të qenit i terrorizuar"

Përcaktimi i dytë është koncepti "i frikësimit" dhe i krijimit të ndjenjës së frikës dhe tmerrit në një shkallë të gjërë të individëve dhe shoqërisë.

Përcaktimi i tretë është "Përdorimi i paligjshëm i dhunës ose kërcënimit për përdorim dhune kundër personave, shoqërisë dhe pasurisë me qëllim gjunjëzimin e qeverisë dhe pranimin e kushteve të vëna nga ata, për më së shumti qëllime politike". Përveç këtyre mund të themi se "Dhuna e përdorur, fare pak ose aspak për qëllime dhe efekte fizike, por vetëm për impakte dramatike në shoqëri, është terror.

Përcaktimi i katërt është "Përdorimi i llogaritur i dhunës apo kërcënimit për dhunë , për arritjen e qëllimeve me karakter ideologjik apo politik , nëpërmjet instalimit të frikës, tmerrit dhe detyrimit me terror.

Përcaktimi i pestë është "Metodë radikale përfshirë dhe dhunën, e cila përdoret për të tërhequr vëmendjen për një problem, çështje, ose konflikt politik, duke përfutur nga avantazhi i përdorimit të mjeteve të medias si përhapëse dhe përçuese në një kohë shumë të shkurtër në një hapësirë shumë të madhe.

Në zhvillimet aktuale është e pamundur të përshkruash terrorizmin brenda kontekstit të dhunës. Terrorizmi ekziston edhe në forma dhe variante të ligjëshme, siç janë në fillim *protestat*, duke u transformuar pastaj në *takime* dhe *demonstrata*, duke vazhduar me *aktivitete të lehta dhune* dhe, në fund, transformohen në *veprime intensive sabotazhi, vrasje etj.*

Përcaktimi konceptual duhet të kërkohej te kjo skemë:

Disa analistë e gjejnë përcaktimin e kësaj fjale te fjala latine "*Tremble*" që do të thotë; *drithërimë, rrëqethje, të dridhesh, të rrëqethesh.*

Sot terrorizmi konsiderohet si dhunë ndaj të drejtave të njeriut dhe, pikërisht, OKB-ja e shikon të tillë me rezolutën e saj të datës *18 dhjetor 1994*. Ajo vë në dukje që terrorizmi, si dhunë ndaj të drejtave të njeriut përfshihet në dokumente të ndryshëm ndërkombëtare dhe në rezolutat për këtë çështje të disa institucioneve ndërkombëtare në kohët e fundit. Veçanërisht, *konfliktet e brendshme bazuar mbi ndryshimet etnike* konsiderohen të jenë shumë të rëndësishme për rrezikun e sigurimit në këtë periudhë. Prandaj këto çështje luajnë një rol të rëndësishëm në dokumentet e OKB-së, OSBE-së, NATO-s etj.

Shkaqet e terrorizmit

Në një ditë të vetme aktet terroriste përhapen në botë për motive të ndryshme. Stili i akteve terroriste që duke vepruar si separatiste, anarkiste, disidente, nacionaliste është që të arrihet një objektiv më i largët, më i gjerë se sa viktimat e momentit. Pra ato mund të jenë:

a. Social- kulturore

Ndryshimet kulturore shkaktojnë disa ndryshime në jetën sociale apo, me fjalë të tjera, jeta shoqërore ndryshon në porcion me ndryshimet kulturore. Sidoqoftë, nëse ndryshimet në strukturën sociale janë shumë të shpejta dhe përfshijnë një segment të shoqërisë, dhe jo të gjithën, pjesa tjetër mbetet e pandryshuar, e pazhvilluar dhe prapa këtyre ndryshimeve. Në këtë mënyrë balanca sociale prishet dhe njerëz të ndryshëm të shtresave të ndryshme të shoqërisë mendojnë në mënyrë të ndryshme, ku vetëm një marrëveshje për të mirën e të gjithë shoqërisë mund t'i ribalancojë.

Këta persona, grupe ose anormalitete shpesh shkaktojnë dhunë, anarki dhe humbje të identitetit social dhe e vendosin shoqërinë në dilema se çfarë është e drejtë dhe çfarë është gabim, duke shkaktuar konfuzion në vlerësimin e koncepteve të kulturës, gjuhës, besimit, moralit dhe familjes. Për më tepër, ata formojnë një atmosferë për t'iu imponuar qëndrimeve dhe ideologjive të tyre.

Terroristët dhe njerëzit në favor të dhunës ushqehen me plagët e shoqërisë, si: korrupsioni, mosmarrëveshjet, problemet sociale dhe i shfrytëzojnë ato. Për aq kohë sa njeriu është i vlerësuar dhe orientuar drejt, ai e kap kohën dhe ecën në krah të zhvillimit, ndërsa ai që ndodhet bosh, i vetmuar dhe i braktisur mund ta përkrähë dhe mbështesë dhunën kundër shoqërisë, pasi fajin e të qenit të tij i pa vlerësuar ia faturon shoqërisë.

Roli i familjes në jetën e fëmijës është më i rëndësishmi në të bërit të tij njeri shoqëror. Arsyeja pse familjet nuk janë të afta ta marrin këtë rol, ndodh që ky të jetë hap në drejtimin e kundërt. Boshllëqet e lëna nga familjet në personalitetin e fëmijëve, mbushen me ideologji të mësuara në disa shkolla, konvikte, gazerma dhe fundacione politike duke krijuar kështu të

ashtuquajturit njerëz të programuar. Nga ana tjetër, për individët socialë dhe të shëndetshëm nuk është e lehtë në mendjen e tyre të zërë vend vrasja dhe dhuna.

b. Ekonomike

Problemet ekonomike shkaktojnë te njerëzit jo vetëm probleme materiale, por shpesh edhe psikologjike. Ndarja e pabarabartë e të ardhurave në shoqëri është një nga elementet më të rëndësishme që organizatat terroriste përdorin dhe shfrytëzojnë si propogandë, e cila manipulon në radhë të parë njerëzit e pashkolluar dhe injorantë.

Shumë ndryshime dhe zhvillime pozitive në jetën ekonomike dhe sociale të një vendi mund të jenë me efekte në persona dhe grupe të të rinjve, sidomos në periudhën e adoleshencës dhe në momente të ndjeshme të jetës së tyre. Mungesa e vëmendjes së shoqërisë për t'i drejtuar këta, si dhe shfrytëzimi nga ana e grupeve me qëllime terroriste është një problem për zgjidhje. Sistemi nuk mund të punojë drejt nëse rritja dhe zhvillimi ekonomik nuk mbështeten me integrim social.

c. Arsimore

Arsimi dhe arsimimi kanë fuqinë e ndryshimit të mendimeve të individëve dhe të shoqërisë në përgjithësi. Ka gjithmonë një mundësi për t'i bërë njerëzit shoqëror, nëpërmjet arsimimit të vazhdueshëm. Paqja, siguria dhe stabiliteti i shoqërisë varen plotësisht në arsimimin e individëve të saj. Sa më i mirë dhe sa më i plotë të jetë arsimimi, aq më e dobishme dhe sociale është shoqëria. Roli i familjes, shkollës, insitucioneve dhe medias është t'i edukojnë dhe t'i bëjnë njerëzit shërbëtorë të shoqërisë dhe, nga ana tjetër, roli i qeverisë është që ta bëjë arsimimin të mundur për gjithë shoqërinë si dhe në të njëjtën kohë ta monitorojë dhe kontrollojë atë.

Qëllimet dhe strategjitë e terrorizmit.

Qëllimet e organizatave terroriste janë paraqitur të ndryshme, të varura këto nga vendet ndaj të cilëve ndërmerren këto akte dhe nga grupet që i ndërmarrin. Qëllimi i terrorizmit është të ndërtojë një qeveri të re në vendin që ai godet, qeveri e cila të ketë bazë ideologjinë e tij. Ata duan të shkatërrojnë regjimin aktual me mjetet e dhunës.

Organizatrat terroriste deklarojnë se ata synojnë të kenë më shumë paqe dhe mënyrë jete të pastër në besnikëri të ideologjisë që ata mbështetin. Ata i shikojnë qeveritë dhe liderët si të padrejtë dhe mizor. Për hir të kësaj terrorristët e konsiderojnë veten e tyre si variante të panjohur shoqëror. Ata sugjerojnë idenë që publiku i pavetëdijshëm është i paaftë të kuptojë diçka të mirë dhe kjo vjen sepse nuk është e mundur për momentin që publiku të lidhë veprimet, dhe, ndërsa koha kalon, njerëzit do të bëhen të përgjegjshëm për të marrë pjesë në aktivitete të organizuara.

Qëllimi i terrorit duket se është shkatërrimi i regjimit politik si objektiv i largët dhe ky do të arrihet pasi të përmbushen fillimisht objektivat e afërta, të tillë si:

1. Parësore është shkatërrimi i regjimit si sistem politik dhe dobësimi i autoritetit shtetëror.
2. Bërja e mundur e publikut të huaj të dëgjojë kërkesat e tyre.
3. Dobësimi i rezistencës së pushtetit publik me ndihmën e kërcënimit ndaj njerëzve dhe detyrimin e publikut të pranojë idetë e tyre.
4. Sigurimi i mbështetjes së publikut dhe pjesëmarrjes në shoqëri.

Qëllimet bazë të organizatave terroriste për fazën e parë janë bërja e njerëzve të dyshojnë në sistemin politik dhe të dobësojë autoritetin moral të shoqërisë. Pra, për fazën e parë objektiv i terrorit politik është shkatërrimi i sistemit dhe frikësimi i publikut. Terroristët përpiqen të shkaktojnë reagime të cilat përmbushin qëllimet e tyre. Për terroristët efekti i operacionit është më i madh dhe më i rëndësishëm se vetë operacioni. Terroristët sillen indiferent ndaj viktimave të tyre. Personaliteti i viktimave nuk ka rëndësi për terroristët.

Për të lejuar publikun të dëgjojë zërin e tyre terroristëve iu duhet *propaganda*, qëllimi i së cilës është të shpalosë e të deklarojë dobësinë dhe pamundësinë e qeverive, sistemeve dhe grupeve kundërshtarë të tyre. Çdo operacion terrorist kërkon të bëjë një shou publik dhe të përhapë panik në shoqëri. Ata e dinë mirë se kjo arrihet, pikësepari, duke zgjedhur objektiva të rëndësishëm, kyç dhe këto objektiva ata i zgjedhin duke u mbështetur në qëllimin e operacionit.

Terrorizmi, në kontekst, është konsiderimi me impaktet fizike dhe konsekuencat politike, më i madh se numri i vdekjeve dhe dëmeve materiale që mund të shkaktojë.

Objektivat e të gjitha llojeve të terrorizmit janë:

- a. Të bëjë që emri dhe zëri i organizatës të dëgjohej.
- b. Të lëkundë autoritetin e shtetit.
- c. Ta tregojë veten të fuqishëm.
- d. Të neutralizojë reagimin e publikut.
- e. Të ngrejë moralin e anëtarëve të organizatës.
- f. Të njihet dhe pranohet në fushën politike.
- g. Të ushtrojë presion në forcat e sigurisë, për përdorim të dhunës.

Ajo çka mund të themi për strategjitë e terroristeve është si më poshtë:

1. Terroristët përpiqen të arrijnë objektivat e tyre nëpërmjet formimit të një *atmosfera dëshpërimi dhe frike* në radhët e grupeve të përcaktuar si objektiva për t'u goditur.

2. Nëse *pasojat psikologjike* të një operacioni janë më të mëdha se pasojat fizike, ky konsiderohet si akt terrorist.

3. Terroristët nuk njohin dhe zbatojnë ndonjë rregull apo moral të luftës. Në gjykimin e tyre nuk ka neutralitet, ose je me ta, ose armik i tyre.

4. Terroristët përdorin armë, metoda, dhe mjete brutale e barbare.

Strategjia e përbashkët e terroristëve është të kryejnë akte dhune të cilat të tërheqin vëmendjen e publikut, qeverive dhe botës për objektivat e tyre. Media luan një rol kritik në këtë strategji. Përshkrimi i akteve terroriste dhe zënia e titujve, kronikave dhe faqeve të para në mediat masive me këtë akt do të thotë se terroristët e kanë arritur qëllimin e tyre. Viktima e terrorit nuk është apo është rrallë objektivi i aktit, viktima e vërtetë është publiku i cili duke parë njerëzit e terrorizuar, të masakruar, ankthin dhe frikën në sytë e tyre, bëhet viktimë njëjloj si dhe ato.

Taktikat terroriste

a. Vendosja e bombave është taktika e përbashkët e cila në njëzet vjetët e fundit është përdorur në pothuaj dy të tretat e akteve terroriste. Kjo metodë është e përhapur për faktin se është e lehtë për t'u përdorur, prodhuar, transportuar dhe vështirë për t'u zbuluar. Deri tani janë përdorur që nga bombat postare deri te makinat bombë. Terroristët e përdorin këtë metodë për të krijuar kredibilitetin e tyre dhe për të treguar forcën dhe aftësinë se çfarë janë në gjendje të bëjnë.

b. Zjarrvënia. Nuk është aq e përhapur sa bombat, por është përdorur për të përçarë dhe shkatërruar besimin e njerëzve tek organet e sigurisë dhe kryesisht është përdorur kundër mjeteve të përdorimit publik, qendrave ekonomike dhe politike, dyqaneve, fabrikave, hoteleve etj. Ashtu si dhe bomba një mjet zjarrvënës është shumë i lehtë për t'u prodhuar dhe përdorur dhe shumë i vështirë për t'u parandaluar dhe zbuluar.

c. Rrëmbimet e mjeteve të transportit tokësor dhe ajror.

Rrëmbimet e kamionëve si metodë ka qenë shumë e përhapur në vitet 60-70 të shek.XX, sidomos në Irlandën e Veriut dhe në Spanjë. Kjo metodë arrin shpejt objektivin për të qenë në qendër të vëmendjes, pasi media mund ta ndjekë dhe shfaq hap pas hapi këtë operacion, por, gjithashtu, është edhe shumë i rrezikshëm, pasi, p.sh., po të rrëmbehet një kamion me 30000 litra karburant dhe ky të përplasat me një objekt strategjik, kjo do të thotë se një bombë gjigande ka goditur këtë objekt.

Rrëmbimet e avionëve kanë qenë një praktikë e përhapur derisa nuk bëhej kontroll i imët për armë zjarri, bomba etj. në aeroporte. Më vonë terroristët kanë përdorur edhe personelin e aeroporteve për të futur armë në avionë, të cilët lejoheshin të kalonin jashtë portave të detektorëve metalikë. Duke

përmirësuar masat e sigurisë në aeroporte terroristët kërkonin të tjera mënyra duke arritur në faktin e ditur të 11 shtatorit 2001 kur vetë avionët përdoren si bomba.

d. Pritat. Rrallë kanë dështuar pritrat e planifikuara me kujdes. Terroristët kanë kohë të përgatiten, ata shpenzojnë javë dhe muaj për të përgatitur të tilla operacione. Terroristët kanë gjithashtu avantazhin mbi policinë, ushtrinë dhe strukturat e sigurisë, të zgjedhin objektivat, kohën, vendin e operacionit me qëllim të maksimizojnë mundësitë e suksesit.

e. Rrëmbimet. Jo të gjitha pritrat ngrihen për të vrarë. Në disa raste qëllim i pritës është kapja dhe rrëmbimi i dikujt për arsye shkëmbimi me diçka tjetër. Duke rrëmbyer një qeveritar apo person të rëndësishëm, terroristët tregojnë "supermacinë" mbi strukturat e sigurisë, nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, duke kaluar koha dhe problemi i të rrëmbyerit nuk zgjidhet, bën që terroristët të jenë në qendër të vëmendjes, të kenë pushtuar faqet e para të gazetave, të jenë lajmi i parë i TV-ve dhe radiove, dhe objekt i bisedës, shprehjes së shqetësimit, frikës dhe pasigurisë së opinionit publik, çka është dhe qëllimi strategjik i terroristëve.

P.sh rrëmbimi i gjeneralit amerikan, Dozier, nga terroristët italiane u bë një problem sinjifikativ kombëtar dhe ndërkombëtar. Rrëmbimi i pengjeve (1200) izraelitë nga HAMAS-i u bë shkak i luftës midis Izraelit dhe HAMAS-it si organizatë terroriste.

Ndërsa ditët ktheheshin në javë dhe javët në muaj media italiane dhe ndërkombetare ishte e fokusuar në aftësinë e policisë italiane për të zgjidhur situatën.

f. Mbajtja peng. Ndryshimi midis rrëmbimit dhe mbajtjes peng është pak e ngatërruar dhe nganjëherë e ngjashme, por gjithsesi varet nga qëllimi.

Kështu, rrëmbimi kryhet për arsye shpërblimi në të holla kryesisht apo favore të tjera në shkëmbim të lirit të të rrëmbyerit, ndërsa mbajtja peng i kalon këto kërkesa dhe përfshin ato politike, në shkëmbim të jetës së pengut. Tipike rrëmbimi i pengjeve izraelite nga HAMAS-i në 7 tetor 2023.

h. Vrasjet. Janë ndoshta forma më e vjetër e terroristëve, që është përdorur. Grupet terroriste që kanë përdorur këtë metodë janë Seperatistët Baskë (ETA) në Spanjë, Brigadat e Kuqe në Itali, 17 Nëntori në Greqi, IRA në Irlandën e Veriut etj, ku objektivat e këtyre sulmeve shpesh janë qeveritarë, gjykatat, policë dhe zyrtarë të sigurimit.

Koncepte bazë të luftës kundër terrorizmit. Komponentët e përgatitjes së çdo qeverie kundër terrorizmit dhe masat parandaluese kundër tij.

Lufta kundër terrorizmit përfshin të gjithë veprimet që janë kundër terrorizmit duke u shtrirë nga veprimet e policisë, të forcave ushtarake dhe shërbimeve informative.

Jane dy dimensionet e luftës kundër terrorizmit:

1. Masat mbrojtëse dhe të sigurimit fizik që kanë qëllim të pengojnë terroristët të depërtojnë në ambientet shtetërore, ushtarake apo private dhe t'i mbajnë ato jashtë këtyre ambienteve.
2. Masat kundërvepruese të cilat kanë të bëjnë me parandalimin, zbrapsjen dhe kundërveprimin e veprimeve terroriste.

Komponentët e programit të çdo qeverie kundër terrorizmit:

Në programin e çdo qeverie parashikohen masat e luftës së gjithanshme kundër terrorizmit. Sipas *Dr Joseph Luns, ish- ministër i Jashtëm nga 1956 deri 1971 dhe sekretar i përgjithshëm i NATO-s nga 1971 deri 1983*, një program efektiv i luftës kundër terrorizmit është i bazuar, *veçanërisht*, në qëndrimin e patjetërsueshëm të politikës qeveritare e cila duhet të përfshijë :

- Shteti të deklarohet totalisht kundër terrorizmit
- Forcat qeveritare duhet t'i përgjigjen menjëherë dhe me ashpërsi çdo kërcënimi apo sulmi terrorist.
- Shteti nuk duhet t'u bëjë negociata, pazar apo lëshime terroristëve.
- Veprimet e forcave qeveritare në këtë luftë duhet të jenë të ligjshme dhe të respektojnë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut.

Për të arritur suksesin mbi këtë sfidë duhet:

Së pari, bashkëpunim ndërkombëtar mes vendeve

Së dyti, kontroll të plotë mbi tregtinë dhe destinacionin e armëve që shiten.

Së treti, dënimet e terroristëve duhet të bëhen në përputhje me rregulla të njëjta në të gjithë vendet.

Së katërti, krijimi i një bordi ndërkombëtar i cili të mblidhet dhe shkëmbejë eksperiencë dhe ide disa herë në vit, për luftën kundër terrorizmit.

Së pesti, shtetet që sponsorizojnë terrorizmin duhet të jenë objekt i sanksioneve të gjithanshme ndërkombëtare.

Masat Parandaluese dhe Mbrojtëse

Masat parandaluese dhe mbrojtëse përfshijnë:

- Aftësinë informative, zbuluese dhe raportuese për aktivitetet dhe qëllimet e grupeve terroriste.
- Planifikim dhe procedura të shpjeguara me detaje për masa dhe periudha të caktuara.

- Personel të trajnuar për të kryer këto detyra.
- Ndërgjegjësim të qytetarëve për masat që po merr shteti.
- Masa sigurie procedurale dhe strukturore për ta mbajtur kërcënimin terrorist larg.

Rëndësia e ligjit

Pa një bazë dhe mbështetje ligjore është i pamundur suksesi kundër grupeve terroriste. Shumë inisiativa në luftën kundër terrorizmit, të tilla si: përzgjedhja e forcave të kualifikuara antiterror, mjetet, financimi etj, që kërkojnë proceduara; trajnim dhe eksperiencë operationale, janë të rëndësishme; por më kryesore është mbështetja e tyre ligjore.

Masat e kundërpërgjigjes ndaj kërcënimeve terroriste dhe shfrytëzimi i të gjithë faktorëve në luftë kundër tij.

Masat antiterroriste nuk mund të mbahen në nivelin maksimal gjithë kohën dhe masat e sigurisë duhet të jenë mjaft fleksible kur ka një kërcënim për sulm terrorist. Tashmë, njihen pesë nivele të kërcënimit që përdoren dhe që duhet të adaptohen në sistemin e gatishmërisë së trupave:

1. Kërcënimi ***normal***. Nuk ka të dhëna për një kërcënim të besueshëm dhe kryhen procedurat rutinë të sigurisë.
2. Kërcënimi ***alfa***. Ka të dhëna të përgjithëshme për një aktivitet të mundshëm terrorist. Në këtë nivel personeli është instruktuar për një vëmendje më të lartë, kontrollohet identiteti i personave që hyjnë në bazë, si dhe mjetet janë në gadishmëri.
3. Kërcënimi ***bravo***. Ka të dhëna në rritje për një sulm të mundshëm terrorist. Në këtë nivel janë rishikuar planet operationale dhe masat mbrojtëse shtesë.
4. Kërcënimi ***charlie***. Është kryer një incident terrorist apo informacionet tregojnë se ai është i mundur edhe për ne. Në këtë nivel merren masa ekstra duke shtuar patrullimet e rojeve, kontrollet e hyrje-daljeve, ngritjen e pengesave dhe kontrolli i imët i automjeteve.
5. Kërcënimi ***delta***. Është niveli më i lartë i sigurisë, i cili zbatohet vetëm në zona ku sulmi terrorist është kryer ose informacionet tregojnë se ai do të kryhet. Në këtë nivel i gjithë aktiviteti rutinë ndalon dhe fokusimi operational varet nga asgjësimi i kërcënimit.

Faktorët e kërcënimit

Për të përcaktuar realisht nivelin e kërcënimit duhet të merren parasysh dhe vlerësohen 6 (gjashtë) faktorë të kërcënimit terrorist;

Ekzistenca. Një grup është prezent, vlerësohet të jetë prezent ose në gjendje për të rritur aksesin në një rajon të dhënë.

Mundësia. Grupi paraqet nivelin e kërkuar dhe të vlerësuar për të drejtuar sulme terroriste.

Qëllimi. Qëllimi përcaktohet nga informacioni i grumbulluar nga shërbimet inteligjente brenda grupit terrorist.

Historia. Aktivitetet e kryera dhe të regjistruara nga grupi terrorist në kohë të ndryshme.

Objektivi. Objektivi përfshin informacion të besueshëm për aktivitete që tregojnë përgatitje për një veprim të veçantë terrorist.

Mjedisi i sigurisë. Përfshin politikat dhe aftesitë të cilat paraqesin operacionet antiterroriste në një zonë të caktuar të rajonit.

Të gjithë këta faktorë duhet të merren parasysh nga planifikuesit antiterror në sektorin operativ me qëllim për të llogaritur në mënyrë analitike se në cilin nivel është shkalla e kërcënimit apo objektit për të cilin planifikohet ruajtja.

Terrori dhe Media

Ata, të cilët drejtojnë akte terroriste, duan që këto akte të jenë efektive, zëri i tyre të dëgjohet më shumë, si dhe të shkaktojnë dhe të japin një shok në tërë shoqërinë. Aktet terroriste kryhen me këtë qëllim, si dhe objektivat zgjidhen të përshtashëm për të përmbushur këtë qëllim.

Në kohën kur lajmi që ka lidhje me këto akte është në faqe të parë dhe me gërma të mëdha, si dhe ka pushtuar televizionet dhe fjalimet; kjo do të thotë se terroristët e kanë arritur qëllimin e tyre. Terroristët nuk duan që shumë njerëz të vdesin, por shumë njerëz t'i shikojnë, ata kënaqen kur emrat e tyre shfaqen në gazeta dhe televizione. Qëllimi i tyre është audienca, jo viktimat. Në rast se opinioni publik bëhet indiferent atëherë terroristët rrisin dozën e dhunës dhe akteve të tjera për të rifituar qendrën e vëmendjes.

Të transmetosh një lajm lidhur me terrorizmin si një "*lajm*" është një e drejtë universale për informim. Megjithatë masmedia ka përgjegjësitë shoqërore në gjithë mjedisin e sigurisë përballë publikut, për të transmetuar me paanëshmëri, pa ekzagjerim dhe ndershmërisht. Pasojat e shkaktuara nga një transmetim lajmi, lidhur me një akt terrorist, në masmedia mund të klasifikohen si "*pozitive*" dhe si "*negative*".

Lajmi për terror mund të ketë shumë pasoja negative, pasi, siç thamë më lart, vetë përhapja e gjerë dhe në kohë të shkurtër, mundësuar nga masmedia, është qëllim i terroristëve. Është fakt se disa herë shtypi jep qëllimet, organizimin, mënyrat dhe emrat e organizatorëve të akteve terroriste duke bërë kështu të mundur një lloj propagande si dhe duke krijuar në disa raste negociime të fshehta me liderët e këtyre organizatave.

Ekzagjerimi i numrit të vdekjeve dhe plagosjeve në lajme, zmadhimi i turmave demonstruese kundër forcave të rendit, çon në transmetimin sipas linjës së dëshiruar nga terroristët. Përshkrimi i incidenteve me hollësi, shfaqja e masakrave pas akteve terroriste shkakton trauma në individë dhe

grupe individësh, si dhe ndjenjë "inferioriteti" dhe "rivaliteti" midis organizatave që mund të jenë rivale ose kundërshtarë në mes tyre.

Kur aktet terroriste bëhen të shpeshta në media, terroristët bëhen "të njohur" para opinionit publik dhe dhuna që ata shkaktojnë deri diku pranohet si "e ligjshme", dhe vetë terroristët të kthehen në heronj. Dhuna duke pasur një efekt të lartë ndjeshmërie ndikon në temperamentin e njerëzve dhe veçanërisht të fëmijëve.

Disavantazhet e transmetimit të lajmeve për aktet terroriste mund t'i përmbledhim:

- a. Në shkaktimin e frikës dhe shqetësimit në audiencë.
- b. Shumë grupe njerëzish njihen me teknikat dhe taktikat e akteve të dhunës si rezultat i përshkrimit dhe shpjegimit të detajuar

Kur ne krahasojmë vlerat dhe veçoritë e Forcave të Armatosura me vlerat dhe veçoritë e medias vëmë re se FA-ja karakterizohet nga; autoriteti, rregulli, hierarkia, bashkëpunimi, puna në grup, tradita, reparti dhe insitucioni. Nga ana tjetër, media e urren autoritetin; kaosi është lajmi më i mirë për të, në media ka rivalitet dhe individualizëm.

Anormaliteti është lajm për median, jo rregullsia, prandaj asaj i duhet kërkuar partneritet dhe përgjegjëshmëri, pushteti i saj duhet të shfrytëzohet për të mirën e shoqërisë.

Objekt i medias janë dhe forcat e sigurisë, çdo defekt apo gabim në një operacion mund të bëhet objekt i medias pa u shqetësuar për pasojat. Media ka mundësinë të intervistojë, të grumbullojë informacion herë-herë i pamundur nga forcat e sigurisë çka e bën atë në këtë rast partnere në luftën kundër terrorizmit.

Referenca

- Çështje të Sigurisë Kombëtare, Rasti i Shqipërisë, Tiranë, 2004.
- Politika e Sigurisë Kombëtare në shoqërinë Demokratike, Tiranë, 1996.
- NATO përballë sfidave të reja ndaj Paqes dhe Sigurisë Ndërkombëtare, Shoqata Shqiptare e Atlantikut, Tiranë, 2003.
- Strategjia e Sigurisë Kombëtare e RSH, Tiranë, 2005.
- Karlo JEAN, "Gjeopolitika", Tiranë, 1998.
- GMC, Moduli 3, 3816-E Gordon Brown kryeministri i UK
- GMC, Moduli 3, 3203-E, George Bush.
- Gazeta Koha Jone 20 qershor 2007 Xhavit Shala.
- GMC, PTSS, Moduli 1, 2737-E
- Miller, T. (2022). "Preventing Radicalization: State Strategies and Challenges." Global Security Insights.
- Miller, T. (2023). "Assessing the Threat of Returning Foreign Fighters." Journal of Peace Studies.

Miller, T. (2023). "Returning Fighters and National Security in the Balkans." *European Security Review*.

Rizvi, N. (2023). "ISIS's Continuing Threat: A Global Perspective." *Journal of International Affairs*.

Smith, J. (2019). "ISIS and Al-Qaeda: Diverging Paths." *Journal of Terrorism Studies*.

Smith, J. (2019). "Socio-Political Challenges of ISIS Influence in the Balkans." *International Journal of Conflict Studies*.

Smith, J. (2020). "Negotiating Return: The Dynamics of ISIS Fighters from the Balkans." *Journal of Terrorism Studies*.

Smith, J.(2020). "The Phenomenon of ISIS: A Global Threat." *Journal of Global Terrorism Studies*.

Williams, L. (2019). *Methods of Terror: The Techniques of ISIS.* *International Journal of Counterterrorism*.

Williams, P. (2018). "The Arsenal of ISIS: A Comprehensive Overview." *International Security Journal*.

“KOMPLOTI” I BEN BLUSHIT, NJË ROMAN NDRYSHE, LARG TRADITËS QË JEMI MËSUAR TË LEXOJMË

Merita Gjokutaj-Shehu

Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë

e-mail: merigjokutaj@yahoo.com

Abstrakt

"Komploti" i autorit Ben Blushi është një roman ndryshe, shumë larg traditës që ne jemi mësuar të lexojmë, aq sa ka ngjallur interes, por edhe debate nga publiku, për shkak të temës që trajton, mënyrës se si e trajton atë dhe personazheve që ka ndërtuar. Mënyra e konceptimit dhe organizimit të narrativës i ka dhënë tregimtarit jo vetëm misionin e tregimtarit për atë që di, sheh dhe mendon, por edhe synimin për të depërtuar hapur në thelbin e ngjarjeve, të personazheve, me qëllim zbërthimin e tyre, krijimin e portretëve, përshkrimin e mjediseve, rrethanave, por edhe njohjen nga brenda, thellimin e karakterit të veprës, duke tërhequr vëmendjen dhe shikimin e lexuesit. Formulimi i tij është larg shabloneve të gjuhës libreske, është i rafinuar në teknikë dhe stil, çka e bën veprën tërheqëse.

Fjalët kyç: krijues, novel, karakter, strukturë, fenomeni.

Abstract

"Conspiracy" by the writer Ben Blushi is a different novel, far from the tradition that we are used to reading, so much so that it has aroused interest, but also debates from the public, because of the topic it deals with, the way it deals with it and the characters it has built. The way of conceiving and organizing the narrative has given the storyteller not just the mission of the storyteller for what he knows, sees and thinks, but the aim to penetrate openly into the essence of the events, of the characters, aiming at their discovery, the creation of portraits, description of environments, circumstances, but also recognition from the inside, deepening the character of the work, attracting the reader's attention and gaze. His phrasing is far from the templates of the librarian language, it is fine in technique and style, which makes the work attractive.

Key words: creator, novel, characters, structure, phenomena.

Ben Blushi është autor i një sërë veprash si: vëllimi “100 ushtarë”, romanet “Të jetosh në ishull”, “Otello, Arapi i Vlorës”, “Shqipëria”, “Kandidati”, “Kryeministri”; esetë politike “Hëna e Shqipërisë” dhe “Letër një Socialisti”; libri me portrete “41 sekrete”, dhe i fundit prezantuar në panairin e librit në nëntor, 2023, romani “Komploti”. Krimtaria e tij për vlerat që mbart e transmeton është nderuar me çmime të ndryshme letrare, si çmimi “European për Letërsinë” (2014) për romanin “Otello, Arapi i Vlorës”, çmimi “Kult” (2015) si eseist i vitit për “Hëna e Shqipërisë”, çmimi “Lumo Skëndo” (2022) për “41 sekrete”etj..

Ben Blushi ka arritur të krijojë profilin e tij, duke shfaqur talentin dhe pasionin, elegancën e të rrëfyerit, forcën e fenomeneve që zgjedh dhe vë në qendër të krijimeve të tij, tërheqjen e lexuesit drejt librit dhe mënjorës së fjalës, duke fiksuar e përpunuar vazhdimisht ngjarje, përshtypje, kujtime, episode e përjetime, me një tematikë të larmishme e të pasur.

“Komploti” i shkrimtarit Ben Blushi është një roman ndryshe, larg traditës që ne jemi mësuar të lexojmë, aq sa ka ngjallur interes, por dhe debate nga publiku, për shkak të temës që trajton, mënyrës si e trajton dhe personazheve që ka ndërtuar. Romani ka një strukturë narrative tërheqëse, që sjell zhdërvjelltas personazhe që shfaqen si përvoja specifike të jetës njerëzore. Shfaqen karaktere, fati i të cilëve duket si projektion i jetës së kujdo, me vese dhe virtyte, me dëshira të jetuara dhe të pajetuara, me ëndrra të bukura, por dhe të frikshme. Shfaqen situata të çuditshme, por që në të gjitha gjejmë botë, shpirt dhe kohë të mbrapshta.

Pothuajse, në të gjitha veprat që kemi lexuar, subjektet bazohen në ngjarje, fenomene dhe dukuri që i përkasin së kaluarës ose së tashmes, ndërkohë që te “Komploti”, vërejmë se subjekti i shtrin ngjarjet në një të ardhme hipotetike, konkretisht në vitet 2043-2044 kur në Shqipëri është krijuar një komunitet i madh afgan, ndërkohë që popullsia shqiptare është pakësuar ndjeshëm. Meqë popullsia e tyre, pra, e emigrantëve shtohet me ritme të larta, ndërkohë që shqiptarët lindin më pak dhe emigrojnë më shumë, në këto vite, të huajt bëhen shumicë dhe fitojnë bashkinë e Shëngjinit, duke zgjedhur Kryetar Bashkie një afgan. Për shkak të rrethanave dhe ndryshimit të shpeshtë të Qeverive, ky afgan, i cili martohet me një shqiptare Agetina Pagjinin, zgjidhet Ministër i Mbrojtjes së Shqipërisë. E pra, këtu dhe kështu fillon “Komploti”.

Megjithatë, pa filluar ende leximin e romanit të intrigon thënia: “Atyre që mund t’i pengojnë ngjarjet e këtij romani të ndodhin vërtet”. Në fakt, ky roman, i cili nuk ka lidhje me konspiracionet çmendurake që mbushin rrjetet e ekranet, duket se përveçse një metaforë therëse, ka brenda edhe një dozë të rëndësishme analize politike që i ofrohet lexuesit në një formë tjetër, në një formë stilistike letrare.

Romani “Komploti” e tërheq lexuesin në një botë të komplikuar, që shihet dhe përjetohet emocionalisht, ku shfaqen karaktere të veçanta, marrëdhënie të ndryshme në hapësirë dhe kohë, rrjedhë ngjarjesh në përmasa dhe mjedise të caktuara, procese individuale e kolektive, të cilat janë të lidhura me ata të

tre: Simon Shuter, Leonid Trocki dhe Lavi Elton, të cilët nuk binin asnjëherë dakort si për të shkuarën, dhe për të ardhmen, dhe prandaj nuk kishin asnjë projekt të përbashkët...¹. Tre hebrenjtë do të luajnë deri në fund gjithë fijet e një konspiracioni, fundi i të cilit është befasues dhe i paimagjinueshëm për të gjithë.

Sa nis leximin e romanit përshtypje të bën fillimi interesant “*Në vjeshtën e vitit 2043, tre çifutë u takuan në plazhin e Durrësit. Ky takim do të ishte i parëndësishëm për kujtimet e secilit prej tyre dhe as do të gjente vend në ndonjë nga arkivat që regjistrojnë komplotet e shumta të çifutëve nëpër botë, sikur atë ditë të mos ndodhte një ngjarje që do t'i detyronte tre çifutët të organizonin një plan për të devijuar rrjedhën e historisë së një shteti të vogël si Shqipëria*”.²

Gjatë leximit kupton se autori me art ka mbledhur arsye, pikënisje, copëza gjurmësh, rrebeshe urrejtjesh, pjesëza kundërshtish, mëri e inate të vjetra për të krijuar një subjekt interesant. Blushi në vepër ka shndërruar Shqipërinë në një nga qendrat e botës në mesin e shekullit të XXI, kohë kur mbarë globi është përfshirë nga lëvizje dhe transformime të mëdha.

Personazhet që jetëzojnë fabulën e këtij romani janë: Mohamed Durrani, Agetina Pagjini, e bija e Serafin Pagjinit, Raul Fico, Lavi Elton, Hasan Dosti e më pas me emrin Leonid Trocki, doktor Muradi, Zina, Simon Shuter, Vaso Taso, Hamzai, padrona, Lana Sator e më pas Frida Trocki, Murad Dosti, Marenglenian Babarameto etj, etj.

Mënyra e konceptimit dhe e organizimit të rrëfimit i ka dhënë rrëfimitarit jo thjesht misionin e tregimtarit për atë që di, sheh e mendon, por synimin të depërtojë haptazi në thelbin e ngjarjeve, të karaktereve, duke synuar zbulimin e tyre, krijimin e portreteve, përshkrimin e mjediseve, rrethanave, por dhe njohjen nga brenda, duke thelluar karakterin e veprës, duke tërhequr vëmendjen dhe vështrimin e lexuesit. Fraza e tij është larg shablloneve e gjuhës libeske, është fine në teknikë e stil, çka e bën veprën tërheqëse.

Gjatë leximit të romanit “Komplotit” vërejmë:

- **Portrete interesante të personazheve...** **Simon Shuter**, i cili ishte mësuar të mos ndiqte planet e të tjerëve, por të detyronte të tjerët të ndiqnin planin e tij.³ **Leonid Trocki**,.....në vjeshtën e vitit 2043, ishte 73 vjec, por ndihej jo më shumë se 23 vjeç. Ishte i freskët, i gjallë, nuk kishte asnjë sëmundje, trupi i tij ishte pa mish të tepërt, muskujt të fortë, truri i punonte me shpejtësi dhe kujtesa nxirrte nga arkivat e saj cdo detaj.....⁴ Ishte po ai burrë i imët, që kishte ardhur me varkë nga liqeni, me një ecje të shpejtë, me mjekër të hollë, me syze të rrumbullakëta dhe me një kasketë pa ngjyrë....⁵ **Raul Fico** nuk ishte as nacionalist, as patriot, as komunist, as fashist dhe shpesh mendonte

¹ Blushi. B, Komploti, BOTIME PEGI, 2023, fq. 46.

² Blushi. B, Komploti, BOTIME PEGI, 2023, fq. 7.

³ Blushi. B, Komploti, BOTIME PEGI, 2023, fq. 191.

⁴ Blushi. B, Komploti, BOTIME PEGI, 2023, fq. 143-144.

⁵ Po aty, fq. 99-100.

se fati i tij më i madh ishte që nuk kishte ëndrra. Nuk kishte as fantazi, as imagjinatë. Sipas tij imagjinata, fantazia është një instrument në duart e atyre që duan të kthejnë dështimin në sukses.⁶ Ai kishte arritur të mbetej njeri i mirë, kundër dëshirës së vet. Ai e kishte kthyer martesën në diplomaci pasive, por asnjëherë në lumturi aktive.

- **Përshkrime pikante për natyra karakteresh të deformatuara:** *Sipas tij, provinciali është burimi i të gjitha të këqijave të kësaj bote dhe, në përgjithësi, provinca me kufizimet dhe kompleksitetet e saj, ishte lavatricja më e madhe e karaktereve njerëzore, të cilat i shtrydhte, i dridhte, i përdridhte dhe i thante deri në poshtërim. Një provincial nuk ishte asnjëherë ai që ishte ose ai që mendonte se ishte, ose ai që do të donte të ishte. Kjo ishte teoria e tij për provincialin. Provinciali ishte gjithmonë mashtrues, dinak dhe përherë i shëmtuar.*⁷
- **Përshkrime të bukura** “ *Në sipërfaqen e pasqyrës... ndërroheshin ditët dhe netët, verat dhe vjeshtat dhe dimrat me pranverat, aty shëtiste hëna çdo natë dhe shfaqej dielli çdo mëngjes, aty parakalonin retët, shkrepnin vetëtimat dhe ndizeshin qiejt, aty çelnin trëndafilat dhe lulet e bardha të kumbullës...*”⁸
- **Bukurinë e këtij vendi të bekuar, bukurinë e Shqipërisë parë nga këndvështrimi i një të huaji:** “*Shqipëria ishte vendi ideal, në të cilin çdo çifut do të donte të kishte lindur, duke parë diellin që çdo mëngjes nxirrte kokën nga majat e maleve në lindje dhe pastaj zbriste ngadalë, për t’u zhytur në det në perëndim. Pozicioni gjeografik i Shqipërisë ishte pothuajse identik me atë të Pelestinës, të dyja vendet lageshin nga ujërat e Mesdheut, por ndryshimi që shkonte në favour të Shqipërisë, ishte se këtu nuk kishte shkretëtirë, kishte ujë sa të duash, male të freskëta, plot minerale...*”⁹

Po ashtu, shfaqet rrëfimi përmes këndvështrimeve të shumëfishta, intertekstualiteti, simbolizmi, ironia, vetmia shpirtërore, frustrimi, zhgënjimi, sfida e historisë dhe e miteve, sfida e moralit tradicional, zëvendësimi i besimit në të vërtetën absolute me ndjenjën për të vërtetën të relativizuar, vetëdijesimi për realitetin si konstrukt fiktiv.

Gjithashtu, rrëfimi njëjtësohet me jetën, për shembull merr dhe rikthen disa emra nga historia si: Rauf Fico dhe Trocki të ndërlidhur me pasardhësit e tyre në fikson, sigurisht në një kontekst tjetër, duke i dhënë një drejtim të caktuar “Komplotit”, por dhe elemente realiste në përshkrime të ndryshme, p.sh: “*Kur Shqipëria u hap në vitin 1990, nga një tregtar i fshehur që ndihmonte komunistët, ai u kthye shumë shpejt në një biznesmen që ndikonte qeveritë, përzgjidhte investitorët e huaj, ndërmjetësonte koncensionet dhe garantonte negociatat mes palëve politike sa herë kishte kriza...*”¹⁰

⁶ Po aty, fq. 22-23.

⁷ Po aty, fq. 27.

⁸ Po aty, fq. 74-75.

⁹ Po aty, fq. 58.

¹⁰ Blushi. B, Komploti, BOTIME PEGI, 2023, fq. 70.

- **Të pranishme në roman kemi edhe thëniet koncentrat, shprehje të mentalitetit shqiptar:**
- *Njerëzit pa karakter vuajnë më pak nga stresi.*¹¹
- *Peshku që kërkon ushqim në tokë, nuk kthehet më në det.*¹²
- *Shqiptarët kishin stomakët më të vegjël në Ballkan dhe zemrat më të mëdha...*¹³
- *Sikur Shqipëria të mos kishte qenë një vend kaotik, që i lejonte të gjithë të flisnin kundër të gjithëve...*¹⁴
- *Nuk donin të përcillnin propozime kaq serioze me njerëz, që në përgjithësi kanë raport të vështirë me seriozitetin....*¹⁵
- *Fjala realist është çadra e vetme e fatalistëve, disfatistëve, pesimistëve zhurnalistëve dhe analistëve...*¹⁶

Gjithsesi, fjala është sa e drejtpërdrejtë dhe e figurshme, përshkrimi lakonik, pamjet janë të kapshme dhe konkrete, kurdoherë me një ndjenjë kërsërie. Stili i tij në dukje shfaqet i lehtë, por ndërsa e lexon, të siguron për forcën shprehëse, për energjinë, ku fillojnë të evidentohen personazhet, ngjarjet, detajet duke shkaktuar një joshje të sigurtë për të ndjekur rrjedhën e rrëfimit.

Ben Blushi te romani “Komploti” është treguar i kujdesshëm dhe falë mjeshtërisë së artit të shkrimit, arrin të shpalos një skenar hipotetik, që për hir të së vërtetës më futi shumë në mendime, më tërhoqi gjatë leximit, duke humbur kështu konceptin e kohës e të vendit.

Duke përfunduar, mendoj se krijimtaria e tij, krahasuar me autorë të tjetër të letërsisë shqipe, ka një origjinalitet që të tërheq. Romani “Komploti” bën bashkë në një: shkrimtarin, publicistin, analistin, politikanin dhe eseistin. Rrëfimi i tij, përkon me prirjen e audiencave të sotme që nuk presin nga letërsia të jetë glorfikim i së vërtetës, por që ajo të shndërrohet në energji të menduarit. Si i tillë romani “Komploti” është shkruar bukur e me stil.

Literatura:

B. Blushi, KOMPLOTI, Botime PEGI, 2023.

Floresha Dado. Teoria e veprës letrare. Poetika. Tiranë, 2003.

¹¹ Po aty, fq. 18.

¹² Po aty, fq. 35.

¹³ Po aty, fq. 73.

¹⁴ Po aty, fq. 97.

¹⁵ Po aty, fq. 43.

¹⁶ Po aty, fq. 30.

GJUHA DHE LETËRSIA PËR FËMIJË

Merita Gjokutaj-Shehu¹, Anastasia Kuro²

¹Departamenti i Gjuhës shqipe dhe Letërsisë

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër

e-mail: merigjokutaj@yahoo.com

²Shkolla e mesme e bashkuar “Muhamet Gjollesha”, Lazarat

Abstrakt

Në trupin e letërsisë shqipe, një vend të veçantë zë letërsia shqipe për fëmijë. Breza të tërë janë rritur me këtë letërsi, dhe edhe fëmijët e sotëm vazhdojnë të kërkojnë kontributin e saj në arsimimin dhe kënaqësinë e tyre. Vështirësia e të shkruarit të një letërsie të tillë është e njohur gjerësisht. Është një fushë që kërkon pjekuri të madhe, qofshin ata shkrimtarë, prindër, fëmijë, mësues apo psikologë. Ka shumë aspekte që mund të eksplorojnë në letërsinë për fëmijë, por, duke u përqendruar në objektiv, do të trajtojmë veçanërisht gjuhën si mjetin kryesor për arritjen e krijimtarisë cilësore, si artistikisht ashtu edhe arsimore, si dhe elementet e tjera që janë të lidhura pazgjidhshmërisht me gjuhën, pa të cilën një letërsi e tillë nuk mund të ekzistojë. Letërsia nuk është vetëm e organizuar si gjuhë, por është krijuar nga gjuha.

Fjalët kyç: letërsi shqipe, fëmijë, mësues, psikolog, prindër

Abstract

In the trunk of Albanian literature, a special place is occupied by Albanian literature for children. Generations have grown up with this literature, and even today's children continue to seek its contribution to their education and enjoyment. The difficulty of writing such literature is widely acknowledged. It is a field that requires the utmost maturity, whether as a writer, a parent, a child, a teacher, or a psychologist. There are many aspects that can be explored in children's literature, but focusing on the objective, we will specifically address language as the basic tool for achieving high-quality creativity, both artistically and educationally, as well as other elements that are inevitably linked to language, without which such literature cannot exist. Literature is not only organized as language, but is made from language.

Key words: Albanian literature, children, teacher, psychologist, parent.

Në trungun e letërsisë shqipe një vend të veçantë zë dhe letërsia shqipe për fëmijë. Me këtë letërsi janë rritur breza të tërë, madje, vazhdojnë të kërkojnë plotësimin e edukimit dhe kënaqësisë edhe fëmijët e sotëm. Pranohet vështirësia për të shkruar një letërsi të tillë. Është fusha që do pjekurinë më maksimale, si shkrimtar, si prind, si fëmijë, si mësues e si psikolog. Letërsia për fëmijë është mision. Jo kushdo mund “të trokasë” në këtë portë të shenjtë.

Të shumta janë aspektet mbi të cilat mund të ndalesh për trajtim nëletërsinë për fëmijë, por duke u përmbajtur objektit, do tëspecifikohemi te gjuha si mjeti bazë për realizimin e një krijimtarie sa më cilësore, si në drejtimin artistikdhe në atë edukativ, por edhe tek elemente të tjera që lidhen në mënyrë të pashmangshme me gjuhën, pa të cilat nuk mund të kemi një letërsi tëtillë. Letërsia nuk organizohet vetëm si gjuhë, por bëhet prej gjuhës. Gjuha është shpata e shkrimtarit, ndaj ai duhet ta zotërojë këtë lloj arme, po deshi që të fitojë në betejën e tij.

Gjuha në letërsinë për fëmijë është një gjuhë specifike, është jo vetëm mjeti kryesor i komunikimit, por dhe mjeti shprehës i lidhur me moshën e fëmijës, stadin e zhvillimit, prandaj themi se duhet talent, kulturë në të shkruar, aftësi për të hyrë në botën e fëmijës, pasi një fëmijë nuk flet e nuk mendon si një i rritur. Ja, pse duhet ruajtur një lloj naiviteti që është i natyrshëm sipas moshave.

Elementet te të cilat do të ndalem janë:

1. Në fondin e artë të shkrimtarëve për fëmijë kemi autorë,si: **Spiro Çomora, Mitrush Kuteli, Petro Marko, Naum Prifti, Bedri Dedja, Odhise Grillo, Adelina Mamaqi, Xhevat Beqaraj, Tasim Gjokutaj, Shpresa Vreto, Ivoni Reso, Bekim Harxhi, Ramadan Pasmaci, Ferat Cakërri, Hamdi Meca, Skënder Hasko, Janaq Pani** etj.. Atame gjuhën e tyre kanë arritur të ndërthurin disa prej receptorëve të domosdoshëm social-psikologjikë e pedagogjikë për të pasur një letërsi të bukur. Kanë shfrytëzuar mjeshtërisht folklorin tonë, kanë respektuar psikologjinë e grupmoshës së cilës i kanë kushtuar veprën e tyre, kanë përdorur një gjuhë mjeshtërore dhe të kulluar, kanë ditur që t’i ndërtojnë librat e tyre jo vetëm si prezantues të ngjarjes, por duke shmangur moralizimet kanë përcjellë mesazhe të bukura.

Krijimtarinë e tyre e kanë të gjallë. Shumë prej veprave të tyre i kanë qëndruar kohës. Disa prej tyre janë pjesë e programeve të leximeve në shkolla. Ata e kanë lexuesin e tyre besnik dhe sot. Vargu i autorëve është shtuar pas viteve 2000 me emra të rinj, si: **Shkëlzen Zalli, Viktor Canosinaj, Natasha Shuteriqi–Poroçani, Rudina Çupi, Rovenia Rrozhani, Edi Gogu, Persida Asllani, Rudina Xhunga, Anila Kruti** etj.

2. **Letërsia për fëmijë është mision dheka specifika të veçanta.** Mençuria dhe largpamësia e shkrimtarit për fëmijë është që të punojë shumë, në shumë drejtime dhe të shkelë në të gjitha fushat ku shkel mosha e fëmijës, për të

ndërtuar artin e tij të besueshëm e të suksesshëm. Të shkruajë edhe për fëmijën që do të lindë vite më pas, sepse letërsia për fëmijë ka ligje më të sofistikuar që kërkojnë jo vetëm fantazi dhe afësi krijuese, jo vetëm dëshirë dhe përkushtimin për të botuar.

Mirëfilli dihet se, veç arritjeve, ajo mbart edhe një sërë problemesh që lidhen me mjeshtërinë, përvojën, horizontin kulturor e mosthëllimin në specifikën e saj. Të gjitha këto pasqyrohen në brendi e në formë dhe shprehen në dobësi të njohura, si skematizmi, uniformiteti, gjuha, varfëria e mjeteve shprehëse etj..

Kërkesat që shtrohen para shkrimtarëve që shkruajnë për fëmijë, nuk kanë të bëjnë vetëm me zbatimin e normës letrare. Ato janë më të tjera: gjuhësore, gjuhësore – stilistike, logjike e psikologjike. Veprat letrare për fëmijë, me gjuhën e pastër dhe të thjeshtë artistike, kanë një mision të rëndësishëm arsimor. Kur flitet për veçantitë apo karakterin specifik të letërsisë për fëmijë, gjithnjë duhet të kemi parasysh fëmijët gjër më 14-15 vjec, të cilët sipas grupmoshave, kanë ndryshime nga të rriturit në pikëpamje të zhvillimit psikik, aftësive perceptuese të folurit dhe të menduarit, të sasisë dhe të cilësisë së përvojës jetike etj. Letërsia për fëmijë luan një rol shumë të madh edhe për mësimin e gjuhës amtare shpejt e drejtë. Mësimi i gjuhës, veçanërisht, në institucionet parashkollore, gjen një mbështetje të fuqishme në materialin letrar të krijuar për të vegjlit, ndihmon për zhvillimin e të folurit etj. Prandaj gjuha e veprës duhet të jetë në përputhje me moshën e fëmijëve, duke u dhënë mundësi atyre të luajnë me fjalën, pasi vetëm kështu ata mund të mësojnë nuancat e gjuhës amtare, mund të përvetësojnë muzikalitetin e pasurisë që ka gjuha. Nga vetë natyra fëmija do vargje që këndohen e kërcehen. Vargjet të mos kenë shumë bashkëtingëllore, pasi fjalë të tilla janë vështirë të shqiptohen nga fëmijët. Kujdes të veçantë –përdorimit të saktë të fjalëve. Në rast se në letërsinë e të rriturve gabimet e përdorimit të fjalëve janë gjë e keqe, në letërsinë për fëmijë shndërrohen në të dëmshme. Prandaj, themi se gjuha e letërsisë për fëmijë duhet të jetë sa më e përpiktë, e krehur, e bukur, e fuqishme, lodruedhe në përshtatje me moshën e fëmijës.

3. Në ç’ nivel dhe në ç’ pozita e kemi sot letërsinë për fëmijë? Shkrimtarë të vërtetë të Letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj, aktualisht, kemi pak. Ne kemi shkrimtarë, si Xhavit Bushati, Adelina Mamaqi, Gaqo Bushaka, Bardhyl Xhama, Viktor Cenosinaj e të tjerë, që jetojnë, shkruajnë dhe botojnë. Një boshllëk ka krijuar dhe ikja nga kjo jetë e një sërë autorëve kontribues në këtë fushë, si: Bedri Dede, Odise Grillo, Shpresa Vreto, Tasim Gjokutaj, Bekim Harxhi, Skender Hasko etj. Megjithatë, ata kanë lënë si testament krijimtarinë e tyre me mesazhet që i përkasin së sotmes dhe së ardhmes.

Në qarkullim ka dhe libra për fëmijë, veçanërisht, ata që i përkasin letërsisë parashkollore, dhe “shëtutin” me shumicë mes pedagogjisë, skolastikës e biznesit. Ndërsa për letërsinë që i përgjigjet moshës shkollore, pak vlera të

vërteta gjen, sepse mungojnë disa çelësa, si: talenti, gjuha, njohja e psikologjisë dhe botës së fëmijëve, origjinaliteti, autoktonia, guximi krijues dhe besimi në të, kulturologjia, temat aktuale dhe perspektive.

4. Pak a shumë gjen diçka nga letërsia për fëmijë në tekstet e leximit të shkollës. Megjithatë, duke menduar shumë shqiptarë që janë jashtë Shqipërisë e që në kthimet e tyre të herëpashershme, kërkojnë me ngulm sa më shumë libra për fëmijët e tyre, që të ruajnë gjuhën shqipe, të ruajnë fijet që i mbajnë lidhur me atdheun, jam e bindur se nuk do të duan të blejnë letërsinë e huaj për fëmijë, të cilën kollaj e gjejnë në vendin ku jetojnë. Kontakti i parë i fëmijëve të diasporës sonë me gjuhën letrare janë pikërisht librat apo rrëfimet elektronike të shkrimtarëve tanë për fëmijë. Teknologjia ka zhvillimin e saj të përhershëm. Po të funksionojë ka dobi të madhe. Mendojmë se njohjet janë të rastësishme dhe kush është dashamirës dhe prind i interesuar për fëmijët e tij, ia del disi. Këtu lind nevoja për klasifikimin e kësaj letërsie me më shumë korrektësi duke i kaluar projektet e librave në sitë të imët redaktorësh para se të publikohen.

5. A e shohim si problem faktin që fëmijët tanë, sot, më shumë njohin shkrimtarët e huaj sesa shkrimtarët shqiptarë për fëmijë. Pse ndodh kjo dhe si mund të arrihet e kundërta? Shtëpitë botuese e kanë një prirje të tillë drejt autorëve të huaj. Nuk ka gjë të keqe t'i sjellësh, është kulturë e kultura duhet njohur. Por librat duhen zgjedhur. Ka përkthime shkel e shko. Ka përkthime me gabime ortografike, që jo vetëm nuk njohin gjuhën e huaj, por as shqipen me strukturat sintaksore të saj.

6. Sa ka evoluar krijimtaria për fëmijë në kohën kur fëmijët po sfidohen me një “modernitet”, i cili nuk po kuptohet aq shumë nga të rriturit? Është një trinitet ekzistues që jeton dhe përherë bëhet agresiv: celulari, fëmija, libri. I ndodhur mes këtyre problemeve, fëmija në të shumtën e herës bëhet rob i celularit. Libri “harrohet”. Është detyrë e prindërve, mësuesve, punonjësve të bibliotekave, shkrimtarëve, institucioneve etj., të mos çuditen një ditë nga fjalët: Ky nxënës nuk di të lexojë, ky nxënës është analfabet.

7. Një rol të veçantë në LF luan edhe elementi i ilustrimit. Veç gjuhës edhe figura që shoqëron krijimin, nxit fantazinë dhe fëmijën e tërheq shumë. Një vlerësim të veçantë meritojnë ilustrimet e dikurshme të Dollit Gjinalit dhe Safo Markos e që për hir të së vërtetës janë të paarrtshme krahasuar me ilustrimet e sotme.

8. Letërsia për fëmijë ka zhvillim, por nuk ka njohje. Duhet përkthyer që të njihet. Mendojmë se dinjitet e vlerë mund t'i japin kësaj letërsie shtëpitë botuese të vërteta. Shoqëria dhe shkollat pak i njohin krijuesit e letërsisë për fëmijë se pak kanë mbetur. Shpesh për të kujtuar një shkrimtar, prindërit apo të rriturit i bëjnë zë fëmijërisë së tyre. **Por botuesit çfarë mendojnë, përse shpeshherë ata zgjedhin që të përkthejnë libra për fëmijë nga gjuhët e huaja, edhe jo të botojnë autorë shqiptarë?**

“Libra të huaj për fëmijë që janë botuar në shqip në fakt ka shumë. Problemi është si janë botuar, cila është cilësia e përkthimeve? Ka shumë prindër që ankohen për këtë. Sipas botueses Irena Toçi duhet kuptuar diçka; tjetër gjë janë politikat e librit, mbështetja që mund t’i japë vetë shteti shqiptar nëpërmjet librit edhe tjetër gjë është ajo që bëjnë botuesit. “Pavarësisht qëllimeve të mira apo pasionit tonë, ne jemi edhe biznesmenë, që japim kontributin në këtë fushë, por edhe për të marrë falë kontributit që japim feedback-un e duhur. Libri për fëmijë në Shqipëri gjatë viteve të fundit nuk ka lulëzuar në kuptimin e autorëve shqiptarë. Interesi i tyre, i vetë shkrimtarëve është më i vogël për të shkruar për këtë moshë. Është faji ynë apo është faji i tyre, ndoshta nuk është faji i askujt, por i një tregu të vogël, që nuk nxjerr gjithmonë shkrimtarë për fëmijë. Kemi pasur ndërkohë shkrimtarë të mëdhenj për fëmijë, që ne vazhdojmë t’i botojmë, ku do të përmendja me shumë kënaqësi edhe krenari, si Tasim Gjokutajn, Bardhyl Xhamën, Odhise Grillon, Skënder Haskon etj., që ne mundohemi t’i sjellim çdo vit. Ka edhe autorë të rinj, të cilët përpigën të shkruajnë për fëmijë. Për shembull, Anila Kruti, Viktor Cenosinaj, i cili ka qenë shumë i ndjekur për fëmijët. Për arsye se botimet që vijnë nga gjuha e huaj janë në përgjithësi botime enciklopedike, didaktike edhe në grup, nga ku janë edhe më të sofistikuar edhe të studiuara për psikologjinë e fëmijëve, mendoj se nuk ka asgjë të keqe që ne të përkthejmë nga një gjuhë e huaj. Edhe libra të tillë ka shumë në tregun tonë, falë punës vetëmohuese të botuesve, që arrijnë të kombinojnë interesat e punës së tyre me ato të zhvillimit kulturor edhe qytetar”.¹

9. Libri për fëmijë, i pambështetur nga strukturat shtetërore, por edhe nga mediat, është një letërsi që ka mbijetuar vetëm nga idealizmi i autorëve. Pasioni i tyre duhet vlerësuar. Duhet hapur sektorë të posaçëm për të promovuar përafrimin autor-lexues, përderisa edhe mënyrat e komunikimit në ditët e sotme ofrojnë mundësi të pafundme, për t’i shërbyer lexuesit të sotëm e të nesërm. Interesimi në drejtim të kësaj letërsie të shtrihet edhe në universitete, ku të studiohet e të mësohet shkrimi krijues në përshtatje me moshën, për të përgatitur shkrimtarë të rinj, të profilizuar, por edhe ilustrues të posaçëm e bashkëkohorë për këtë zhanër. Por, mbi të gjitha, urojmë të bëhet diçka që mësuesit e letërsisë të lexojnë libra për fëmijë (shumica, sidomos, ata që nuk i kanë të vegjël fëmijët e tyre, librin e fundit për fëmijë e kanë lexuar qysh se kanë qenë vetë fëmijë – bëni një anketë dhe do të shihni sa alarmante është gjendja).

Mbështetja institucionale e Ministrisë së Arsimit apo edhe e Ministrisë së Kulturës ka qenë herë e pranishme, herë jo. Nuk ka ditur që të bëjë më shumë apo pamundësi për të bërë më shumë. Fëmijët edhe të rinjtë po i largohen gjithnjë edhe më shumë librit në format letre. Nuk mund të them se ata lexojnë online në kompjuter. Mendoj se harxhojnë kohë duke lexuar para kompjuterit, por jo për të lexuar letërsi, por për të luajtur dhe për të lexuar

¹Letërsia shqipe për fëmijë: Në zgrip, Koha jonë, 15 prill 2019

kuriozitete. U menduan si një formë disi interesante dhe nxitëse leximet publike, pora mjafton që lexuesit e së ardhmes të formohen në këtë mënyrë, apo shteti duhet që të të zbatojë politika më afatgjata dhe konkrete? Fëmijët edhe të rinjtë po i largohen gjithnjë edhe më shumë librit në format letre.

Në mbyllje do të theksoja se, pavarësisht arritjeve dhe problemeve që përmendëm, veprat më të mira të kësaj letërsie, të së djeshmes dhe të së sotmes, falë gjuhës dhe një sërë elementesh të tjera të domosdoshme për një krijim, do të presin e do të përcjellin brezat e fëmijëve, madje, do të lexohen me endje edhe nga të rriturit, sigurisht, shoqëruar me statusin e prindit, gjyshit apo mësuesit dhe edukatorit. Me këtë letërsi jemi rritur ne, kemi rritur fëmijët tanë dhe shpresojmë të rrisim dhe nipërit e mbesat, për t'i bërë qytetarë të denjë të këtij vendi, si dhe për të mos shkëputur fijet lidhëse me atdheun e tyre mëmë.

Literatura:

Astrit Bishqemi, Letërsia për fëmijë, 1997.

Tasim Gjokutaj, Letërsia për fëmijë, Toena, 1997.

T. Gjokutaj, Letërsia shqipe ka nevojë për vlerësim, për qëndrime shkencore ndaj saj, Letërsia si e tillë, Tiranë, 1996.

TRADITA DHE MODERNITETI NË ROMANIN “AGONIA”

Mirela Saraçi

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër

e-mail: mirelagjirokaster@yahoo.com

Abstrakt

Shkrimtari Odise Kote prezanton së fundmi romanin e tij të titulluar “Agonia”, një vepër që shqyrton me thellësi tensionin midis traditës dhe modernitetit në shoqërinë shqiptare. Në këtë roman, shkrimtari paraqet një realitet kompleks ku vlerat tradicionale, si familja dhe nderi, zënë një vend qendror në ndërgjegjen kolektive, por njëkohësisht gjenden nën presionin e ndryshimeve që sjell moderniteti. Familja, si një institucion kyç i strukturës shoqërore tradicionale, perceptohet jo vetëm si një burim stabiliteti dhe mbështetjeje, por edhe si një hapësirë ku ndihen më së shumti tensionet e tranzicionit shoqëror. Përballë normave dhe ritmeve të shpejta të një bote që ndryshon vazhdimisht, marrëdhëniet familjare shpesh sfidohen nga dilemat morale, ndasitë gjeneracionale dhe humbja e referencave të përbashkëta. Tradita shfaqet si një forcë e fuqishme që mban gjallë një lidhje të thellë me të kaluarën, duke ngjallur një ndjenjë nostalgjie për vlerat dhe praktikën që kanë udhëhequr shoqërinë për breza të tërë. Në këtë kuadër, norma të tilla si respekti për familjen, besnikëria ndaj rregullave të shoqërisë dhe ruajtja e dinjitetit personal janë shtyllat kryesore, të cilat mbështesin një rend të paracaktuar dhe të stabilizuar. Ndryshimet që moderniteti sjell janë shpesh të papritura dhe shkatërruese për individët dhe shoqërinë, duke krijuar konfuzion dhe pasiguri për ata që janë të lidhur me normat e së kaluarës. Në këtë përplasje, individët përballen me sfida të mëdha për të përshtatur veten dhe për të gjetur një balancë midis vlerave të së kaluarës dhe kërkesave të së tashmes.

Fjalë kyçe: tension, traditë, norma, nostalgji, modernitet, pasiguri.

Abstract

The writer Odise Kote recently presented his novel Agonia, a work that deeply examines the tension between tradition and modernity in Albanian society. In this novel, the author portrays a complex reality where traditional values, such as family and honor, hold a central place in the collective consciousness, but are simultaneously under pressure from the changes brought about by modernity. The family, as a key institution of the traditional social structure, is seen not only as a source of stability and support but also as a space where the tensions of social transition are most strongly felt. Confronted with the fast-paced norms and rhythms of an ever-changing world, family relationships are often challenged by moral dilemmas, generational divides, and the loss of shared references. Tradition appears as a powerful force that sustains a deep connection to the past, evoking a sense of nostalgia for the values and practices that have guided society for generations. Within this framework, norms such as respect for the family, loyalty to societal rules and the preservation of personal dignity are the main pillars supporting a predetermined and stabilized order. The changes brought by modernity are often unexpected and disruptive for individuals and society, creating confusion and insecurity for those tied to the norms of the past. In this clash, individuals face significant challenges in adapting themselves and finding a balance between past values and the demands of the present.

Keywords: *tension, tradition, norms, nostalgia, modernity, insecurity.*

Shkrimtari Odise Kote prezanton së fundmi romanin e tij të titulluar "Agonia", një vepër që shqyrton me thellësi tensionin midis traditës dhe modernitetit në shoqërinë shqiptare. Në këtë roman, shkrimtari paraqet një realitet kompleks ku vlerat tradicionale, si familja dhe nderi, zënë një vend qendror në ndërgjegjen kolektive, por njëkohësisht gjenden nën presionin e ndryshimeve që sjell moderniteti. Familja, si një institucion kyç i strukturës shoqërore tradicionale, perceptohet jo vetëm si një burim stabiliteti dhe mbështetjeje, por edhe si një hapësirë ku ndihen më së shumti tensionet e tranzicionit shoqëror. Përballë normave dhe ritmeve të shpejta të një bote që ndryshon vazhdimisht, marrëdhëniet familjare shpesh sfidohen nga dilemat morale dhe humbja e referencave të përbashkëta. Tradita shfaqet si një forcë e fuqishme që mban gjallë një lidhje të thellë me të kaluarën, duke ngjallur një ndjenjë nostalgjie për vlerat dhe praktikën që kanë udhëhequr shoqërinë për breza të tërë. Në këtë kuadër, norma të tilla si respekti për familjen, besnikëria ndaj rregullave të shoqërisë dhe ruajtja e dinjitetit personal janë shtyllat kryesore, të cilat mbështetin një rend të paracaktuar dhe të stabilizuar. Ndryshimet që moderniteti sjell janë shpesh të papritura dhe shkatërruese për individët dhe shoqërinë, duke krijuar konfuzion dhe pasiguri për ata që janë të lidhur me normat e së kaluarës. Në këtë përplasje, individët përballen me sfida të mëdha për të përshtatur veten dhe për të gjetur një balancë midis vlerave të së kaluarës dhe kërkesave të së tashmes.

Vetë termi “Agoni” në literaturë dhe filozofi lidhet me çaste të vështira që nxitin refleksionin mbi jetën, vdekjen dhe kuptimin e ekzistencës. Me një stil të veçantë dhe një thellësi të jashtëzakonshme emocionale, Kote ka arritur të kapë shqetësimet dhe përvojat e shoqërisë moderne.

Rrëfimi është i mbushur me një atmosferë të rëndë dhe reflektive, duke na bërë Ne, lexuesin e tij, të mendojmë për thellësinë e ekzistencës njerëzore. Odise Kote është një autor që shpesh eksploron realitetin përmes një analize subjektive dhe filozofike. Pavarësisht se vepra e tij përmban elemente të imagjinatës, ajo pasqyron gjithashtu, sfida dhe dilema të jetës reale. Kjo qasje e bën të mundur që lexuesi të lidhet me përvojat e personazheve, duke i dhënë një dimension të thellë realitetit që ai paraqet.

Personazhet e romanit, Bojken Kostani dhe Keti Braumfisher shpesh përballen me dilema të cilat pasqyrojnë konfliktin midis traditës dhe modernitetit i cili luan një rol të rëndësishëm në formësimin e besimeve dhe veprimeve të tyre.

Ata nisin aventurën për kërkimin e legjendës më 25 dhjetor 1996. Një aventurë kjo, e kërkuar prej kohësh.

“Jemi shumë të rinj dhe në kujtesën tonë do të regjistrohen shumë gjëra, ndodhi, ngjarje, takime, thyerje shpirti, flirte e dashuri të pakryera. Janë ca ndërhyrje, ca ligje të fshehta, ca vibrime të holla që, kur kapërcejnë zonën e ndaluar, të shpienë kalime të kundërnatyrshme. Dhe ndodh ftohja e tmerrshme, gjer në tharje. Po kjo s’mund të ndodhte me Bojken Kostanin. S’mund’!’¹

Legjendat shqiptare janë një pasuri kulturore që përmes simbolikës së tyre, ofrojnë një pasqyrë të thellë të shpirtit njerëzor dhe vlerave shoqërore. Ato na mësojnë se si të kuptojmë dhe vlerësojmë trashëgiminë tonë kulturore duke na lidhur me historinë dhe identitetin tonë.²

Simbolika e tyre në këtë roman shërben si një mjet për të reflektuar mbi ngjarjet historike dhe shoqërore duke theksuar tensionin mes individit dhe kolektivit. Diku thotë autori dëgjoheshin vargje që drithëronin:

*“Çupëz e Përmetit sytë ç’ti vërvita,
I ziu çmë gjeti, se në Vjosë u mbyta...”³*

Legjendat “ Shkëmbi i nuses” dhe “ Gjarpri i zi” në romanin “ Agonia” shërbejnë si simbole të thella që lidhen ngushtë me realitetin shqiptar, duke reflektuar elemente të natyrës, traditës dhe psikologjisë kolektive. “ Shkëmbi i nuses” përfaqëson forcën e traditës dhe qëndrësën. Ai ilustron sakrificat dhe vuajtjet që gratë shqiptare kanë përballuar në emër të

¹ Odise Kote, Agonia, Tiranë, 2024, fq.32.

² Alfred Uçi, Mitologjia, folklori, letërsia, Tiranë, 2000, fq. 158-165.

³ Odise Kote, Agonia, Tiranë, 2024, fq.21.

familjes dhe komunitetit. Nga ana tjetër, “Gjarpri i zi” simbolizon kërcënimet dhe rrezikun që i kanoset shoqërisë shqiptare. Ai përfaqëson frikën nga e panjohura dhe ndjenjat e pasigurisë që shpesh shoqërojnë individët.

Gjarpri mund të interpretohet si metaforë për armiqësitë dhe sfidat e brendshme që e ndjekin shoqërinë shqiptare si dhe për rolin e forcave që minojnë unitetin dhe paqen.

Të dy këto simbole janë të lidhura ngushtë me realitetin shqiptar duke shprehur tensionin mes traditës dhe modernitetit.

Ato na bëjnë të reflektojmë mbi rolin e historisë dhe legjendave, në formësimin e identitetit kombëtar duke theksuar se edhe pse e kaluara mbart ngarkesa, ajo është gjithashtu një burim forcash mbi të ardhmen.

Në këtë mënyrë legjendat nëprozën e Kotes shërbejnë jo vetëm si tregime, por edhe si mjete që ndihmojnë në kuptimin e realiteteve komplekse dhe shpesh tragjike të jetës shqiptare.

Midis legjendave ka një lidhje të fortë. Kjo lidhje kuptohet qartazi nëse i japim përgjigje pyetjes se cila është marrëdhënia midis Pemës së Jetës, Mirëqenies së Parajsës dhe Kryqit të Krishtit?

“Kompleksi i këtyre ndjesive iu përforcua edhe më , kur i pa këmishën e zbërthyer dhe një medaljon të madh, krejtësisht të veçantë mes gjoksit. Mbi petën e florinjte dallonte kryqi, me një bordurë paksa të trashë , pasuruar anash me motive floreale që krijonin konfiguracion të jashtëm tetëkëndor. Florealja që simbolizon Pemën e Jetës, vinte si imazh i përsëritur luleje që nuk mbyllet kurrë . Marrëdhënie e fortë midis Pemës së Jetës, Mirëqenies së Parajsës dhe Kryqit të Krishtit. “ E çuditshme!”, vetëtiu si flakë një ide që i kishte gërryer mendimet”.⁴

Pema e Jetës përfaqëson jetën, shpëtimin dhe lidhjen me Zotin. Në traditat biblike ajo është burim i pavdekësisëdhe harmonisë. Parajsa, si vend i paqes dhe lumturisë, është gjendja e përkryer ku njeriu jeton në harmoni me Zotin dhe natyrën. Pema e Jetës dhe Mirëqenia e Parajsës lidhen me ideale të jetës së përrjetshme ndërsa Kryqi është rruga për të arritur atje. Ai përfaqëson sakrificën, shpëtimin dhe mundësinë e shpengimit. Në krishterim kryqi është simboli i dashurisë së Zotit për njerëzimin dhe shenjë e shpëtimit përmes sakrificës së Krishtit. Këto simbole gjithashtu përfaqësojnë ciklin e jetës, vdekjes dhe ringjalljes. Të tria simbolizojnë kërkimin për shpëtim dhe ringjallje. Marrëdhënia midis këtyre simboleve krijon një narrativë të pasur mbi shpirtin, shpëtimin dhe përkushtimin duke ofruar një vizion të thellë për jetën dhe qëllimin e saj. Pyetja që ngrihet në roman; *Kush jam unë?!*⁵ shpreh marrëdhëniet mes personazheve të ndikuar nga humbja,

⁴ Odise Kote, Agonia, Tiranë, 2024, fq.178.

⁵ Odise Kote, Agonia, Tiranë, 2024, fq.155.

tensionet dhe keqkuptimet. Këto elemente në roman shfaqen në shumë forma, si: fizike, emocionale dhe psikologjike të pranishme në çdo faqe të romanit. Personazhet përballen me konflikte të thella që i detyrojnë të bëjnë zgjedhje të vështira. Këto dilema shpesh reflektojnë tensionet mes detyrimeve familjare dhe aspiratave personale, duke krijuar një atmosferë ngarkuese emocionale. Karakteret shpesh kalojnë nëpër një proces transformimi duke u përballur me pasojat e veprimeve të tyre dhe duke u përpjekur të gjejnë një ekuilibër. Vetë autori shprehet: “Gjë e zgjatur, gjatë e gjatë bëhet gjarpër”.⁶

Megjithatë nëpërmjet vështirësive, shpesh shfaqet një ndjenjë shprese dhe aspiratash për një të ardhme më të mirë.

Kjo përpjekje për të gjetur një rrugë përpara është një element thelbësor që ndihmon në balancimin e tragjedisë me një ndjenjë të mundësisë. Disa përpiqen të mbështeten te të tjerët duke krijuar lidhje të reja, ndërsa të tjerë tërhiqen dhe izolojnë veten nga dhimbja e së kaluarës. Kjo përcjell dhe mesazhin e romanit; se pranimi i së kaluarës është çelësi për shërimin emocional. Ndërsa ata përballen me kujtimet, lexuesi sheh një evolucion të karaktereve që kalojnë nga mohimi në pranimin e së kaluarës. Në karakterin e personazheve marrin pjesë elemente natyrore si moti apo peizazhi. Ritmi i romanit është i ngadaltë dhe reflektues duke u fokusuar në brendësinë e përjetimeve të personazheve. Ky fluks lejon lexuesin të përjetojë ndjenjat dhe mendimet në një mënyrë të thellë. Romanin “Agonia” i autorit Odise Kote e cilësojmë si vepër moderne për disa arsye:

1. Romani trajton tema të thella dhe universale si humbja, identiteti dhe përballja me të kaluarën.
2. Kote krijon personazhe me shumë nuanca të cilat përballen me dilema të vështira emocionale.
3. Si shkëmbi ashtu dhe gjarpri përfaqësojnë aspekte të humbjes- një humbje identiteti, sigurie dhe lidhjeje.
4. Pavarësisht sfidave personazhet kërkojnë shpresë dhe mundësi për ndryshim dhe transformim.

Të gjitha këto elemente ofrojnë një kuptim më të thellë të përvojave jetësore njerëzore dhe kontribuojnë në klasifikimin e veprës si një roman modern, duke e bërë atë një reflektim të pasur mbi jetën, identitetin dhe sfidat që përjetojmë.

Si përfundim, mund të themi se autori Odise Kote me krijimtarinë e tij ndihmon në pasurimin e traditës letrare shqiptare me temat që trajton duke eksploruar ekzistencën njerëzore, ndjenjat e humbjes dhe pasigurisë. Stili i

⁶ Odise Kote, Agonia, Tiranë, 2024, fq. 40.

tij poetik dhe simbolik ofron një pamje të re mbi realitetin shqiptar dhe sfidat e tij. Kote është një nga zërat që e bën letërsinë moderne shqiptare më të pasur dhe më të ndjeshme, duke ofruar reflektime të thella mbi identitetin dhe përvojat njerëzore.

Burime bibliografike

Sabri Hamiti, Letërsia moderne shqipe, 2009.

Odise Kote, Agonia, Tiranë, 2024.

Umberto Eko, Teori dhe kritikë moderne, Rozafa , Prishtinë, 1996.

Agron Tufa, Letërsia dhe procesi letrar në shekullin XX, Tiranë, 2018.

SabriHamiti, Letërsia bashkëkohore, “Vepra letrare”, nr. 10.

Roland Zisi, Letërsi bashkëkohore shqipe, Tiranë, 2008.

Alfred Uçi, Mitologjia, folklori, letërsia, Tiranë, 2000.

KULTURA GJUHËSORE DHE ROLI I MEDIES NË EDUKIMIN GJUHËSOR TË SHOQËRISË

Spiridhulla Poçi

Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore

Universiteti "Eqrem Çabej"

e-mail: spiridhulla_poci@yahoo.com

Abstrakt

Krijimi e një gjuhe kombëtare të përbashkët ka qenë qëllimi i përpjekjeve të atdhetarëve shqiptarë që në periudhën e Rilindjes. Këto përpjekje morën një hov të ri pas Luftës Nacionalçlirimtare, përpjekje që u kurorëzuan me mbajtjen e Kongresit të Drejtshkrimit më 1972, në të cilin gjuha shqipe u kodifikua si një gjuhë standarde. Si një nga gjuhët më të vjetra të Ballkanit, por e dokumentuar vonë me shkrim, është zhvilluar si gjuhë letrare në një periudhë të shkurtër, por kjo nuk e ka penguar të formësohet si një gjuhë standarde mjaft e pasur, e përpunua, e njësuar dhe e kristalizuar. Ajo i ka zgjeruar dhe po i zgjeron gjithnjë e më shumë të gjitha funksionet e saj, si në formën e shkruar, ashtu dhe në atë të folur. Ajo është gjuha e shtetit, e ekonomisë dhe e politikës, e arsimit, e kulturës, shkencës dhe e shumë fushave të tjera. Si një nga arritjet më të mëdha të popullit shqiptar, ajo sot përdoret në të gjithë praktikën shkrimore, botuese nga e gjithë media.

Fjalët kyç: *gjuha kombëtare, kultura gjuhësore, standart*

Abstract

The creation of a common national language has been the goal of the efforts of Albanian patriots since the period of the Renaissance. These efforts gained new momentum after the National Liberation War, culminating in the convening of the Spelling Congress in 1972, where the Albanian language was codified as a standard language. As an ancient Indo-European language, though documented in writing relatively late, it developed as a literary language in a short period. However, this did not prevent it from forming into a rich, refined, unified, and crystallized standard language. It has expanded and continues to expand all its functions, both in written and spoken form. The Albanian language is the language of the state, economy, politics, education, culture, science, and many other fields. As one of the greatest achievements of the Albanian people, it is now used in all written and publishing practices, by all media, which play an important role in educating the Albanian-speaking society with a linguistic culture according to the standard of the Albanian language.

Key words: *National language, linguistic culture, standard*

Cilat janë tiparet kryesore të gjuhës letrare¹

1. Një nga tiparet e gjuhës letrare është *përbashkësia* dhe *përgjithshmëria*, çka do të thotë se ajo është një gjuhë letrare e përbashkët dhe e përgjithshme, domosdoshmërisht për të gjithë kombasit dhe shtetasit. Ajo është shtetërore a zyrtare, e ligjruar edhe nga shteti, pasi është një faktor dhe element i domosdoshëm për komunikimin ndërshtetëror dhe organizimin shoqëror. Ajo ruan *identitetin* dhe *integritetin*, i cili shprehet:

- së pari, në specifikën kombëtare të sistemit dhe të strukturës së saj. Madje, gjuha standarde fillon e ndihet si gjuhë kombëtare dhe prej brezave të rinj, prindërit ose stërgjyshërit e të cilëve e kanë përvetësuar si të tillë pa e pasur si gjuhë amtare.

- së dyti, ky identitet i gjuhës letrare shprehet në origjinalitetin dhe amtarësinë e saj, domethënë, në veçoritë specifike të sistemit fonetik, gramatikor, fjalëformues e leksikor, të cilat e dallojnë atë nga gjuhët e tjera.

2. Tipari thelbësor që karakterizon gjuhën letrare kombëtare ose gjuhën standarde është kristalizimi dhe njësimi i normës. Ky është një tipar që dallon gjuhën letrare të njësuar nga gjuha e përgjithshme, e cila mund të quhet dhe kombëtare, edhe e përbashkët, por nuk mund të quhet kurrësi standarde pa kristalizuar normën e saj në të gjitha strukturat. Pra, gjuha **standarde**, krahas shumë tipareve, sidomos gjuhësore, të përbashkëta me format e tjera të gjuhës, **karakterizohet nga disa tipare**, të cilat e bëjnë të funksionojë si një sistem më vete dhe si një formë e veçantë e gjuhës.

Tiparet karakteristike të standardit janë:

1. Gjuha standarde **formohet në mënyrë të ndërgjegjshme**, që të shërbejë për komunikimin në rrafshin kombëtar ose në një rrafsh tjetër çfarëdo, të një komuniteti, në të cilin nuk mund t'i përmbushte kërkesat asnjë nga format e tjera dialektore.

2. *Është gjithnjë rezultat, përfundim i marrëveshjeve, i bashkimit të pikëpamjeve dhe i vendimeve* që merren për elemente leksikore e fjalëformuese, për dukuri fonetike e morfologjike, për dukuri sintaksore, drejtshkrimore e drejtshqiptimore. Mbi këto pikëpamje e marrëveshje hartohen parimet themelore, shkruhen rregulla të veçanta, të cilat do të bëhen të detyrueshme për të gjithë, sidomos në ligjërime të veçanta dhe në institucione të rëndësishme arsimore, kulturore, shkencore, në administratë dhe në krijimtarinë letrare e në media të ndryshme.

3. *Standardi është një shkallë shumë e lartë e përpunimit në të gjitha nënsistemet* dhe që këtë formë të gjuhës e bën shumë më të zhdërvjellët dhe më të hapur për një pasurim të vazhdueshëm të saj, qoftë me fjalë e me njësi të tjera gjuhësore, marrë nga dialektet a të folmet e gjuhës ose edhe nga gjuha e shkrimtarëve a autorëve të tjerë.

¹Shih Miço Samara, "Histori e gjuhës letrare shqipe", Tiranë, 2000, fq. 17-28.

4. Standardi përfaqëson *një shkallë të lartë të njësisë* në të gjitha nënsistemet dhe kjo vlen sidomos për drejtshkrimin dhe për rregulla të veçanta gramatikore. Këto rregulla përcaktohen në një mënyrë shumë të qartë në botime të veçanta, siç janë fjalorët drejtshkrimorë e normativë të gjuhës ose dygjuhësh, libra drejtshkrimi, gramatika të ndryshme normative, tekste shkollore e shkencore, revista me qëllime të veçanta e të tjera botime ku bëhet fjalë për standardin ose ku zbatohet në një shkallë të lartë standardi.

5. Një tjetër tipar i standardit është pasuria e gjuhës standarde dhe **pasurimi i vazhdueshëm**, sidomos për funksione të veçanta në jetën publicistike, letrare e shkencore. Këtu një segment të veçantë e shumë të rëndësishëm përbën terminologjia e shumëllojshme dhe shumë e pasur që përdoret në të gjitha fushat e dijes. Pasurimi i standardit në këtë sferë është i nevojshëm, sidomos, për gjuhët standarde të ndodhura në një situatë kulturore dhe politike, siç është shqipja e sotme.

Kështu, duhet dalluar mirë standardi nga jonorma. Standardi ose norma ka të bëjë me proninë e trajtave të njësuara. Por edhe nënstandardi mund të ekzistojë objektivisht, sepse ka të bëjë me praninë e llojeve e varianteve të ndryshme të normës për qëllime të caktuara, për shkak të ekzistencës për një kohë të gjatë të dialekteve të gjuhës letrare.

Ndërsa jonorma ka të bëjë me praninë e shmangieve ose të formave gjuhësore të panormativizuara, të cilat nuk mund të kodifikohen. Gjuha letrare standardizohet më shpejt në aspektin e të shkruarit sesa në aspektin e të folurit, sepse në aspektin e të folurit gjuha është më shumë në lëvizje, pëson zhvillime të vazhdueshme, madje, dhe ndryshime, veçanërisht, nga pikëpamja fonetike e leksikore, sepse folësi është më i shkujdesur kur flet. Në aspektin e të shkruarit, gjuha lidhet më shumë me shtresat e arsimuara, që e përvetësojnë normën në shkollë dhe prandaj e zbatojnë më lehtë atë, ndërsa në aspektin e të folurit, sidomos pjesa e popullsisë që nuk e shkruan çdo ditë atë ose që nuk e ka ndjekur shkollën rregullisht, mund të mbetet më mbrapa nga ana e kulturës së gjuhës.

Çfarë është kultura e gjuhës?

Zbatimi i normës drejtshkrimore është vetëm hapi i parë cilësor drejt kulturës së gjuhës². Gjovalin Shkurtaç thekson se drejtshkrimi është një kod i caktuar, që i përket kulturës së të shkruarit, por që, veçanërisht për natyrën e gjuhës sonë, ndihmon e udhëheq edhe punën në lëmin e kulturës së të folurit³. Kultura e gjuhës formësohet e zhvillohet në mënyrë të ndërgjegjshme, me punë këmbëngulëse e të vijueshme. Zotërimi i normave të standardit në të gjitha sistemet dhe nënsistemet e gjuhës është një bazë e sigurt në përvetësimin dhe zhvillimin e kulturës gjuhësore të çdo individi. Por kultura gjuhësore, e cila s'mund të kuptohet pa zotërimin e normës, nuk është e barasvlefshme me normën. Kultura gjuhësore nuk parakupton vetëm

²Shih Gjovalin Shkurtaç, Kultura e gjuhës, Tiranë, 2006, fq. 26.

³Po aty, fq. 26.

zbatimin e normës gramatikore, drejtshkrimore e drejtshqiptimore. Ajo është diçka më e gjerë. Për të shprehur sa më saktë e bukur ndjenjat dhe mendimet e tyre duhet që njerëzit të njohin sa më mirë thesarin leksikor-frazeologjik, si dhe sistemin stilistikor të gjuhës, të zotërojnë mjeshtërinë për t'i gjetur, zgjedhur e përdorur me efekt të gjitha mjetet shprehëse emocionale e vlerësuese të gjuhës. Pra, kultura e gjuhës vijon si ndërthurje organike e kërkesave të normës gjuhësore me ato të normës stilistikore⁴.

Kultura e gjuhës dhe gjuha e medias në mjetet e informimit masiv (televizor, gazeta)

Gjuha është mjeti kryesor i kumtimit dhe si e tillë ajo pasqyron pashmangshëm çdo përparim të shoqërisë njerëzore, zhvillohet pa pushim duke u pasuruar e përpunuar me fjalë e kuptime të reja. Ndryshimi dhe zhvillimi i gjuhës ndodh në përshtatje dhe në përputhje me nevojat e shoqërisë në periudha të ndryshme të zhvillimit të saj. Ajo nuk është asnjëherë në qetësi, është gjithnjë në lëvizje, në ripërtëritje dhe në gadishmëri për t'iu përgjigjur të gjitha nevojave të reja që i dalin bashkësisë shoqërore përkatëse për të kumtuar e përcjellë zhvillimet e përparimet e reja⁵. Pasqyrimi i ndryshimeve të mëdha politiko-shoqërore që përjetoi Shqipëria pas viteve '90, zhvillimi i proceseve të thella demokratike kërkonte edhe në fushën e gjuhës mjete të reja të informimit publik, gjë që solli një zhvillim të ndjeshëm të medias autovizive, të mjeteve të informimit me shkrim, në gjuhën e të cilave vërehet një ndryshim i madh.

Gazetat, televizioni, radioja, për pjesën dërrmuese të popullsisë, kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë një lloj 'ushqimi' i vazhdueshëm përgjatë gjithë ditës. Këto janë mjete të medias që ndikojnë pashmangshmërisht te njerëzit. Veç funksionit informues, ato përcjellin te lexuesit shumë elemente që kanë të bëjnë me gjuhën, si formë bazë e komunikimit. Shumica e njerëzve përdorin në jetën e përditshme shumë fraza dhe shprehje që i lexojnë nëpër gazeta, në titrat me shkrim në televizion ose i dëgjojnë në emisione të ndryshme televizive. Këto mjete të medias, të cilat ndjekin dhe pasqyrojnë gjerësisht veprimtarinë shoqërore, politike e ekonomike të mbarë vendit tonë, kanë ndihmuar gjallërisht për përhapjen dhe ngulitjen e normës letrare kombëtare dhe për ngritjen e kulturës gjuhësore të shoqërisë. Gjuha e tyre nga viti në vit është bërë më e larmishme dhe më e përpiktë, më e pasur e më e zhdërvjellë, duke zbatuar gjithnjë e më drejt normat e gjuhës letrare në të gjitha nënsistemet e saj: në drejtshkrim, në morfologji e sintaksë, në leksik e fjalëformim.

⁴Po aty, fq. 27.

⁵Po aty, fq. 29.

Si ka ndryshuar gjuha në mjetet e informimit masiv?

Krijimi i institucioneve të reja solli gjallërimin dhe përdorimin e fjalëve që nuk përdoshin për arsye të mungesës së tyre, *bashki, kryebashkiak, kryekomunar, kryeplak, kryepleqësi, parlament, parlamentar, grup parlamentar, komunë, administrator, kryeadministrator, kryeklerik, kryepeshkop etj.*

Gjithashtu, si rezultat i ndryshimit të marrëdhënieve politiko- shoqërore në Shqipëri në gjuhën e mjeteve të informimit u krijuan shumë fjalë të reja, që pasqyrojnë institucionet e reja demokratike dhe marrëdhëniet e reja shoqërore që lindën, si: *kreu i ekzekutivit, uniformat blu, selia rozë, selia blu, numuri dy i qeverisë, njëshi i prokurorisë, periudhë e trazicionit, strategjia e privatizimit, koalicion qeveritar ose përformancë e qeverisë, interferencat politike, vende partnere etj, të cilat mbështeten në fjalë të burimit shqip apo edhe në fjalë të gjuhëve të huaja⁶.*

Prurjet më të mëdha në gjuhën e mjeteve të informimit autoviziv dhe me shkrim janë ato nga fusha të ndryshme të dijes të mendimit njerëzor. Pasurimi e përfitimin prej tyre është më i madh nga fusha e drejtësisë e ekonomisë, filozofisë, nga shkencat shoqërore e natyrore, nga fusha e teknologjisë, nga ato fusha ku dhe ndryshimi është më i madh, të tilla si: *shteti i së drejtës, ekonomia e tregut, ekonomi informale, drejtësi ligjore, institucion demokratik, hark kohor, aks rrugor, ridimensionim, sherrndjellës, luftëndjellës, mezipritje, burrështetas etj.*

Sot, në gjuhën e shkruar, në publicistikë, kanë marrë zhvillim formimi⁷ i fjalëve të përbëra me element të parë fjalët *ish-, bashkë-, krye-, vetë-, para-, si: ish-pronar, ish-zyrtar, ish-kryebashkiaku, ish-supervizori, bashkëkryetar, bashkëjetesë, bashkëfinancues, kryetituj, kryeartikull etj.*

Gjejmë, gjithashtu, shumë fjalë të tjera të përbëra⁸: të formuar në përputhje me ligjet e brendshme të gjuhës shqipe, emër +emër, si: *pikëndalesë, trupprojë, fundjavë, lokal-hotel, grupkërkuës, gjobëvënës, fillimmuaji;* të formuara me strukturë emër+emër i huaj ose anasjelltas, si: *eurodeputet, mininëndetëse, video-lojëra* ose të formuara emër i huaj+emër i huaj, si: *miniintervistë, minimarket, master-plan, top-listë multimiliarder etj.*

Shkelje të standardit të gjuhës shqipe në media (televizor, gazeta)

Pa mohuar arritjet dhe ndihmën e madhe që kanë dhënë mjetet e medias në pasurimin dhe përpunimin e gjuhës letrare shqipe, nga vëzhgimi që kemi bërë në gjuhën e tyre vërejmë se gjuha standarde nuk respektohet:

⁶ Shih Thoma Dhima, Aspekte të përdorimit të gjuhës standarde në mjetet e informimit me shkrim, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 20/1 fq. 325-326.

⁷ Shih Tomor Osmani-Mimoza Priku, Rreth disa tipave të fjalëformimit në publicistikën e sotme në sistemin emëror, botuar në "Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare", Prishtinë, 2007, fq.419-420.

⁸ Po aty, fq. 421.

Së pari, duke mosrespektuar normën leksikore, sidomos duke përdorur fjalë prej burimit të huaj, veçanërisht nga anglishtja, te të cilat mund të dallojmë: Fjalë të zëvendësuara hershëm me fjalë përgjegjëse të shqipes, por që përdorimi i tyre është rigjallëruar, të tilla si: *eksperiencë, kontestoj, inspiroj, provizor, moment, posedim, survejoj, destinacion, publicitet, ambient etj.* Të gjitha këto fjalë kanë përgjegjëset e tyre në gjuhën shqipe dhe duhet të zëvendësohen prej tyre; Fjalë të huaja që po përdoren në gjuhën e mjeteve të informimit, të cilat nuk kanë ekzistuar më parë, si një mënyrë për t'iu përgjigjur gjithë atij ndryshimi të madh që ndodhi në vendin tonë pas viteve 1990, të tilla si: *destruktiv, konsensus, permanent, implementoj, spunto, unison, mediatekë, sekser, fans, akses, donator, lidership, editor, bodigard, xhentil, inaguroj, spektakël, influencë, fokusoj, mazhorancë, asamble, p.sh.:* Duke filluar nga nesër me konstituimin e Këshillit Bashkiak... . Vakancat në Gjykatën e Lartë... Spak sekuestron serverin e kamerave... .

Së dyti, duke mosrespektuar në gjuhën e tyre të folur dhe të shkruar normën gramatikore (morfologjike e sintaksore) dhe drejtshkrimore.

Më poshtë po paraqitim disa shmangie nga norma e gjuhës shqipe standarde. (Shembujt janë forografuar në kanale të ndryshme televizive. Po sjellim vetëm shembuj të ligjërimit të shkruar).

1. Mungesa e zanores *ë* në shkrimin e titrave. Në shumë pamje zanorja *ë* mungon. Më shpesh mungon kur titrat shkruhen me shkronjë të madhe. Zëvendësimi i saj nga zanorja *e* është i gabuar. Një i huaj do ta kishte shumë të vështirë të lexonte e kuptonte drejt këto shkrime.





2. Mungesa e pjesëzës *të* në formimin e kohës së ardhme të mënyrës dëftore, mungesa e nyjës te shkurtesat.

Forma e kohës së ardhme të dëftores ndërtohet me pjesëzën do +kohën e tashme të mënyrës lidhore, prandaj pjesëza të s'mund të hiqet. Forma pa pjesëzën *të* është dialektore. Edhe te shkurtesat është e domosdoshme shkrimi i nyjës rasore.



3. Përdorimi i gabuar i përemrave, veçanërisht i përemrave pronorë.



4. Shkrimi i emrave të përveçëm, të huaj, në gjuhën shqipe. Mungesa e përshtatjes rasore në fjali.



5. Shkrimi i gabuar i fjalëve të ndryshme si; të shoqëruar-it-duhet të shoqëruarit



për-shkallëzimi duhet përshkallëzimi



ndër-kombëtarisht duhet ndërkombëtarisht

Si ndikon gjuha e medias në edukimin gjuhësor të shoqërisë?

Shkelja e normave drejshkrimore, gramatikore e leksikore në gjuhën e mjeteve të informimit masiv është mosrespektim i kulturës gjuhësore. Mjetet e informimit masiv (televizioni, radioja, gazeta) janë mjete shumë të fuqishme të rrezatimit të kulturës gjuhësore. Si të tilla, ato duhet të jenë pararojë të përdorimit të një gjuhe të pastër e të rregullt. Për shumë njerëz, sidomos ata që lexojnë vetëm gazetën dhe dëgjojnë radion e televizionin, gjuha në media shërben si model për normën e gjuhës. Harald Uajnrh⁹shprehet “Duket se shumë qytetarë në vetëdijen e tyre normative gjuhësore orientohen nga gazetatat për sa u përket shprehjeve gjuhësore të shkruara dhe nga radioja e televizioni për dyshimet e mundshme rreth gjuhës së folur”.

Nëse para viteve '90 duhej shumë mund për të gjetur ndonjë shkelje gjuhësore në televizion a gazetë, sot ato i gjejmë rëndom. Gazetarët, punonjësit në media të shumta e të ndryshme duhet të bëjnë përpjekje maksimale për të ngritur nivelin e kulturës gjuhësore te vetë ata, me qëllim që media të mos shërbejë vetëm për përcjelljen e informacionit, por të ruajë, zhvillojë e pasurojë çdo ditë gjuhën shqipe, të përcjellë te shoqëria modelin gjuhësor më të mirë. Gjovalin Shkurtaç thekson: “..po të mos shtojmë kujdesin për gjuhën e medias, po të mos i përgatisim dhe t'i zgjedhim si duhet folësit e drejtuesit e emisioneve të radio-televizioneve publike e private, atëherë më kot investojmë e shqetësohemi për mësimin e gjuhës në shkolla dhe për zgjedhjen dhe kualifikimin e vazhdueshëm të mësuesve të gjuhës shqipe”¹⁰.

Literatura

- Miço Samara, Histori e gjuhës letrare shqipe, Tiranë, 2000.
Gjovalin Shkurtaç, Kultura e gjuhës, Tiranë, 2006.

⁹ Cituar nga Gjovalin Shkurtaç në Kultura e Gjuhës, Tiranë, 2006, fq. 53.

¹⁰ Gjovalin Shkurtaç, Kultura e gjuhës, Tiranë, 2006, fq.52.

Thoma Dhima, Aspekte të përdorimit të gjuhës standarde në mjetet i informimit me shkrim, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 20/1.

Tomor Osmani-Mimoza Priku, Rreth disa tipave të fjalëformimit në publicistikën e sotme në sistemin emëror, botuar në “Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare”, Prishtinë, 2007.

Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Tiranë, 1974.

Rami Memushaj, Shqipja standarde, Toena, 2004.

KONTRIBUTE DHE PËRPPJEKJE NË RRUGËTIMIN PËR ZHVILLIMIN DHE KONSOLIDIMIN E GJUHËS LETRARE SHQIPE

Spiridhulla Poçi¹, Anastasia Kuro²

¹Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Universiteti "E. Çabej"

e-mail: spiridhulla_poci@yahoo.com

²Shkolla e mesme e bashkuar "Muhamet Gjollësia", Lazarat

Abstrakt

Historia e gjuhës shqipe është historia e vetë popullit shqiptar. Ngjarje historike, gjuhësore dhe letrare kanë lënë gjurmët e veta edhe në historinë e zhvillimit të gjuhës shqipe. Përppjekjet e shqiptarëve për të shkruar e zhvilluar gjuhën shqipe, të dokumentuara me veprat e autorëve të shek.15-të, 16-të,17-të, u pasuan në periudhat e mëvonshme nga ngjarje me rëndësi të madhe historike, gjuhësore dhe letrare, si: përhapja e iluminizmit dhe e lëvizjes së popujve për liri, me lindjen e kërkesa të reja, shumë të përparuara për kohën, që lidheshin me shkrimin e shqipes dhe me zhvillimin e arsimit; periudha e Rilindjes Kombëtare, me ngjarje të rëndësishme për gjuhën shqipe, si: krijimi i Shoqërisë së Stambollit, e emërtuar "Shoqëria e të shtypurit shkronja shqip"; hapja e shkollave në gjuhën shqipe; krijimi i një numëri të konsiderueshëm klubesh; unifikimi i alfabetit të shkrimit të gjuhës shqipe, i cili në histori njihet si "Alfabeti i Stambollit"; konferenca e ipeshkvinjve në Shkodër 1902; Kongresi I dhe II i Manastirit 1908,1910; Kongresi i Elbasanit 1909; Shpallja e Pavarësisë 1912; Komisia Letrare e Shkodrës 1916-1918; Kongresi i Lushnjës 1920; Kongresi i Drejtshkrimit 1972; një numër i madh kongresesh e mbledhjesh, vendimet e të cilave qenë me rëndësi mbarëkombëtare, sepse hodhën bazat e formimit dhe zhvillimit të gjuhës shqipe, norma letrare e së cilës në të gjitha nënsistemet e saj, fonetik, leksikor e gramatikor u kristalizua në periudhën e mëvonshme, duke u paraqitur sot si një gjuhë letrare gjithëkombëtare e aftë të përballet denjësisht me gjuhë të tjera me histori shkrimi e zhvillimi shumë më të hershëm.

Key words: Albanian language, writing, development, literary norms.

Abstract

The history of the Albanian language is the history of the Albanian people themselves. Historical, linguistic, and literary events have left their marks on the history of the development of the Albanian language. The efforts of Albanians to write and develop the Albanian language, documented through the works of authors from the 15th, 16th, and 17th centuries, were followed in later periods by significant historical, linguistic, and literary events, such

as: the spread of Enlightenment ideas and the movement of peoples for freedom, with the emergence of new, advanced demands for the time, related to the writing of Albanian and the development of education; the period of the National Renaissance, with important events for the Albanian language, such as: the founding of the Society of Istanbul, known as the “Society for the Printing of Albanian Letters”; the opening of schools in the Albanian language; the creation of a significant number of cultural clubs; the unification of the Albanian alphabet, which in history is known as the “Istanbul Alphabet”; the conference of bishops in Shkodër in 1902; the First and Second Congresses of Manastir in 1908 and 1910; the Congress of Elbasan in 1909; the Declaration of Independence in 1912; the Literary Commission of Shkodër from 1916 to 1918; the Congress of Lushnjë in 1920; the Congress of Orthography in 1972; and a large number of other congresses and meetings, the decisions of which were of nationwide importance, as they laid the foundations for the formation and development of the Albanian language. Its literary norms in all of its subsystems—phonetic, lexical, and grammatical—crystallized in the later period, presenting Albanian today as a national literary language capable of competing with other languages that have a much older history of writing and development.

Key words: *Albanian language, writing, development, literary norms.*

Shqiptarët, si një nga popujt më të vjetër e të lashtë të Ballkanit, shekuj me radhë, janë gjendur nën tryshninë e pushtuesve të huaj, trysni që ka lënë gjurmët e veta edhe në historinë e gjuhës shqipe, sepse, siç thekson prof Çabej, “.. historia e gjuhëve është historia e popujve që i flasin e i kanë folur”¹. Nuk mund të flasësh për zhvillimet dhe sfidat gjuhësore në Periudhën e Pavarësisë Kombëtare pa pasur parasysh lëvizjen kombëtare shqiptare për liri dhe arsim në Periudhën e Rilindje, sidomos në dhjetëvjeçarët e fundit të shek. XIX. Rrethanat historike dhe politike, pushtimet bizantine, ai sllave e osman, presioni i dy gjuhëve liturgjike, latine në veri dhe greke në jug i penguan të parët tanë të lëvronin gjuhën shqipe. Megjithatë, ngjarjet kulturore, gjuhësore dhe letrare, gjatë Periudhës së Rilindjes Kombëtare në fundshekullin XIX dhe në fillimshekullin XX nuk u zhvilluan në mënyrë të rastësishme dhe në një truall bosh. Dokumentet dhe dëshmit e para të shkrimit të shqipes, që prej shek. të 15-të, të 16-të, të 17-të, kryesisht me karakter fetar dhe didaktik, të autorëve Veriorë e Jugorë, veprat e Buzukut, Budit, Bardhit, Bogdanit e Matrëngës dëshmojnë përpjekjet e shqiptarëve për të shkruar gjuhën shqipe. Në shekullin e 18 -të, me përhapjen e iluminizmit dhe të lëvizjes së popujve për liri, lindën kërkesa të reja, shumë të përparuara për kohën, që lidheshin me shkrimin e shqipes dhe me zhvillimin e arsimit. U vunë re përpjekjet për arsimim të disa elementëve atdhetarë me prirje iluministe. Kjo dukej sidomos në qendrat e

¹ E. Çabej, Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, pjesa I, Botime “Çabej”, 2008, fq. 9

Shqipërisë së Mesme e Jugore, qendra që patën një zhvillim të mirë ekonomik dhe kulturor, sidomos në Voskopojë, Elbasan, Berat etj, në veprimtarinë e pedagogëve si Grigor Voskopojari, Teodor Kavalioti, Kostë Beratasi, Teodor Haxhifilipi etj.

Në periudhën e Rilindja Kombëtare, e cila karakterizohet jo vetëm si një nga lëvizjet më të organizuara politike që shqiptarët kishin njohur deri atëherë, u shënua një zhvillim i gjithanshëm i mendimit politik dhe kulturor kombëtar, i gjuhës dhe letërsisë shqipe². Kjo lëvizje përfshiu të gjitha sferat e jetës shpirtërore, morale, ushtarake, materiale të popullit dhe gjeti një pasqyrim të fuqishëm në fushën e arsimit kombëtar dhe të mësimin të gjuhës shqipe. Duke qenë në peshën e sundimit osman, rilindësit kuptuan se aspirat e tyre për një Shqipëri të lirë e të pavarur, mund të bëheshin realitet nëpërmjet dy rrugëve, të cilat ishin në funksion të njëra-tjetrës. Së pari, nëpërmjet luftës së armatosur dhe, së dyti, nëpërmjet lëvrimin të gjuhës shqipe në shkollë. Gjuha shqipe shihej si dëshmi e bashkësisë së shqiptarëve; tipar themelor i kombit; njeje qendrore që bashkonte gjithë shqiptarët, pa dallim krahine dhe feje. Por shqiptarëve u mohojë të shkruanin e të lexonin në gjuhën e nënës. Siç thekson Sami Frashëri më 1899, shqiptarëve nuk u lejohej "... të shkruhej asnjë copë kartë në gjuhën tënë" dhe "...ndalohej të hapurit e shkollave shqipe"³.

Por si paraqitej gjendja e shkollave dhe e gjuhës shqipe në kapërcyell të shekujve?

Në fundshekullin e 19-të në Shqipëri sistemi arsimor ishte i prapambetur, i kufizuar me një numër shkollash të pakta dhe jo në gjuhën amtare. Ai ishte shndërruar në një mjet të fuqishëm ndikimi politik e kulturor të sundimit osman dhe të shteteve të tjera. Kjo diktonte nevojën e ngutshme të përhapjes së arsimit në gjuhën shqipe. Kristoforidhi shkruan: "Ndë mos u shkroftë gjuha e shqipes edhe sot mbë këtë ditë nuk do të shkojnë shumë vjet dhe nuk do të ketë më Shqipëri ndë faqe të dheut dhe as nuk do të shënohet më emri i Shqipërisë ndë hartë të botës as nuk do të përmendet më bir shqiptari e bijë shqiptare pas kësaj jete."⁴. Në trojet shqiptare, përveç shkollave turke dhe greke, ishin çelur dhe shkolla serbe, bullgare, të cilat i përçanin gjithnjë e më shumë shqiptarët. Në të tilla kushte patriotët shqiptarë i vunë vetes detyrë të përhapnin në Shqipëri dritën e diturisë me anë librash në gjuhën shqipe. Me krijimin e Shoqërisë së të Shtypuri Shkronja Shqip lëvrimi i gjuhës shqipe hyri në një fazë të re dhe pak nga pak lëvizja për përhapjen kulturore do të merrte një hov të ri. Kishte ardhur koha që ëndrra e Rilindësve për shkolla në gjuhën shqipe të bëhej realitet. U hapën shkollat e para në gjuhën amtare, si: Mësonjtorja e Korçës 1887, e cila u pasua nga shkolla të tjera, si ato në krahinën e Pogradecit, Rekës, Ohrit, Prizrenit, Kolonjës⁵ etj. Në fillim të

² Sh. Demiraj-K. Prifti, Kongresi i Manastirit, Tiranë, 2008, fq. 14.

³ S. Frashëri, Shqipëria ç'ka qënë, ç'është dhe ç'do të bëhet? Bukuresht, 1899; Tiranë 1962, fq. 65. Cituar në "Sh. Demiraj-K. Prifti, Kongresi I Manastirit, fq.16

⁴ Shih Sh. Demiraj-K. Prifti, Kongresi I Manastirit, Tiranë, 2008, fq. 30.

⁵ Demiraj-K. Prifti, Kongresi i Manastirit, Tiranë, 2008, fq.35-40.

shek. XX hapen shkollat fillore në Elbasan, Tiranë, Berat, shkolla “Liria” në Gjirokastrë etj. Në këtë periudhë krijohen një numër i konsiderueshëm klubesh, si: klubi “Bashkimi” i Manastirit, klubi i Korçës, Elbasanit, Shkodrës, Shkupit dhe më vonë klubi i Tiranës, Durrësit, Gramshit, Gjirokastrës, Delvinës, Përmetit etj., të cilët u shndërruan në organizata të gjera me karakter kombëtar në veprimtarinë e tyre për arsim në gjuhën amtare dhe në luftën kundër reaksionit xhonturk. Ajo çka duhet të theksojmë është fakti që shumë të përkohshme revista e gazeta, klube e shoqëri të ndryshme e shkruanin gjuhën shqipe me alfabetë të ndryshme.

Në këto rrethana përhapja e shkrimit shqip dhe njësimi i alfabetit u trajtuan nga rilindësit jo vetëm si çështje në rrafshin kulturor, por dhe si çështje në rrafshin politik. Që gjuha të shndërrohej në mjet bashkimi duhej të shkruhej e të këndohej me një alfabet të vetëm. Samiu shkruan “.. një gjuhë që s’shkruhet e s’këndohet, nuk zihet gjuhë”. Por si do të shkruhej dhe këndohej? Deri në botimin e Alfabetares së Stambollit shqipja shkruhej me alfabetë të ndryshme: në Shqipërinë e Veriut përdorej alfabeti tradicional i autorëve të vjetër, bejtexhinjtë e shek. XVIII përdornin alfabetin arab, disa të tjerë, si Kristoforidhi përdori në dialektin tosk alfabetin grek të plotësuar, në dialektin geg alfabetin latin të plotësuar etj. Përveç këtyre nuk mungojnë përpjekjet për krijimin e disa alfabeteve origjinale, si: alfabeti i Theodhor Haxhifilipit⁶, Naum Veqilharxhi⁷, Hasan Tahsinit⁸ etj. Pra, çështja e shkrimit të gjuhës shqipe me alfabetë të ndryshme në gjysmën e dytë të shek XIX tërhoqi vëmendjen e rilindësve, të cilët filluan përpjekjet për vendosjen në shkrimin e shqipes të një alfabeti të përbashkët. Menjëherë pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, një nga kërkesat e së cilës ishte përhapja e arsimit në Shqipëri dhe mësimi i gjuhës shqipe në shkolla, patriotët shqiptarë, të mbledhur në Stamboll, të organizuar në klubin “Shoqëria e të shtypurit shkronja shqip”, 1879, arritën të kapërcenin mosmarrëveshjet dhe me një ndjenjë të lartë përgjegjësie mundën të zgjidhnin një nga çështjet më të ngutshme dhe më të domosdoshme për përhapjen e dijes dhe diturisë, atë të unifikimit të alfabetit të shkrimit të gjuhës shqipe, i cili në histori njihet si “Alfabeti i Stambollit” dhe që, me 36 shkronjat e tij i përgjigjej plotësisht kërkesave fonologjike të shkrimit të shqipes.

Mësimdhënia në shkolla, botimet e gazetave dhe revistave të ndryshme, botimi i të përkohshmeve, si: “Dituria” e Stambollit, “Drita” në Sofje, “Kalendari Kombiar” në Sofje, botimet e librave të Samiut, Naimit etj., ndihmuan në përhapjen e alfabetit të Stambollit, i cili filloi të konsiderohej si alfabet kombëtar⁹, sidomos, në Shqipërinë Jugore e të Mesme. Me këtë alfabet u botua “Alfabetarja e gjuhës shqipe”, e cila qe një gur themeli në rrugën e gjatë e të pasur të teksteve shkollore shqipe, model dhe pikë

⁶ T. Osmani, Historia e alfabetit të gjuhës shqipe, Tiranë, 1987, fq 56-58.

⁷ Universiteti i Tiranës, Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit, 1972, fq. 14-16.

⁸ T. Osmani, Historia e alfabetit të gjuhës shqipe, Tiranë, 1987, fq. 132.

⁹ Sh. Demiraj-K. Prifti, Kongresi i Manastirit, Tiranë, 2008, fq. 40.

referimi për autorët e mëvonshëm. Por edhe ky alfabet nuk e zgjidhi përfundimisht çështjen e shkrimit të gjuhës shqipe. Në Shqipërinë e Veriut, me qendër kulturore Shkodrën, ky alfabet nuk u përhap¹⁰. Në Shkodër, siç thekson Shaban Sinani, ishin në rivalitet tre alfabete, jo dy, siç përmenden zakonisht: i shoqërisë “Bashkimi”, themeluar nga Preng Doçi; i shoqërisë “Agimi”, i themeluar nga Ndre Mjeda; dhe alfabeti i propozuar nga Gasper Jakova-Merturi, që zakonisht harrohet.¹¹Për t’i dhënë zgjidhje problemit të njësimin grafemor të alfabetit të gjuhës shqipe u mbledh në Shkodër, më 1-10 maj 1902, konferenca e ipeshkvinjve me përfaqësimin e shtatë dioqezave kishtarë katolike të Shqipërisë (dioqeza e Shkodrës, Shkupit, Durrësit, Lezhës, Pultit, Sapës dhe Mirëditës)¹². Edhe kjo konferencë nuk arriti në një vendim përfundimtar, por ajo është një hap përgatitor për njësimin e alfabetit të shqipes. Këmbëngulja e abatit Preng Doçit u përlligj me faktin që alfabeti i vetëm mbijetues në kohë prej fillimit të shekullit XX e këndej është ai i Preng Doçit, pra, alfabeti i shoqërisë “Bashkimi”.¹³

Edhe shumë revista të tjera si: “Shqipëria” e Bukureshtit, “Albania” e Faik Konicës (Bruksel-Londër); “Kombi” e Bostonit; “Besa”, “Pellazgu” të Kajros etj, botoheshin po me alfabetin latin, por me ndryshime midis tyre¹⁴. Kjo gjendje shqetësonte patriotët, si Faik Konica, Çajupin, Hil Mosin, Asdrenin, Mithat Frashërin, Aleksandër Xhuvanin, Loni Llogori, Ndre Mjeda, Fan Nolin etj., që në artikujt e botuar në disa revista e gazeta kritikonin përdorimin e alfabeve të ndryshme nga shoqëritë kulturore dhe organet e shtypit. Shumëllojshmëria e alfabeve ishin dukuri divergjente dhe shumë të dëmshme për unitetin e kombit shqiptarë. Për këtë arsye organet e shtypit shqiptar hapën faqet e tyre për të diskutuar çështjet e njësimin të gjuhës shqipe. Ato u bënë thirrje gjithë shoqërive gjuhësore që të arrinin një marrëveshje dhe të pranonin një alfabet të njëjtë. Por përpjekjet e tyre për të kurorëzuar me sukses çështjen e njësimin të alfabetit të gjuhës shqipe nuk u realizuan para vitit 1908, gjë që u bë e mundur në rrethanat e reja dhe të favorshme politike që u krijuan pas fitores së revolucionit xhonturk¹⁵.

Nismën për thirrjen e Kongresit të Manastirit e mori klubi shqiptar “Bashkimi” i Manastirit. Ai u thirr 14-22 nëntor. Merrnin pjesë 32 delegatë me të drejtë vote, të cilët përfaqësonin qytete dhe shoqëri të ndryshme. Në Kongres pati shumë diskutime nga anëtarë të ndryshëm, por ajo që duhet theksuar është fakti që të gjithë anëtarët, pavarësisht se në disa çështje të tjera nuk pajtoheshin, ishin dakord që alfabeti të ishte me bazë latine. Çështjet kryesore për njësimin e alfabetit, mbi të cilat diskutoi komisioni i

¹⁰ Shih Sh. Demiraj-K. Prifti, Kongresi i Manastirit, Tiranë, 2008, fq.40-41.

¹¹ Shih Sh. Sinani, Konferenca e ipeshkvinjve (1902) për njësimin e grafematizimit të shqipes, botuar në përmbledhjen e materialeve të konferencës “Zhvillime gjuhësore dhe letrare në Periudhën e Pavarësisë”, Gjirokastër 2018, fq. 18-19.

¹²Po aty, fq. 20.

¹³Po aty, fq. 24

¹⁴ Po aty, fq. 41.

¹⁵ Po aty fq. 48-50.

përbërë prej 11 anëtarësh ishin: 1. A do të adaptohet një nga tri alfabetet kryesore, d.m.th., alfabeti i Stambollit, i shoqërisë “Bashkimi” apo i shoqërisë “Agimi”? 2. A do të bëhej një kombinim midis këtyre tri alfabeteve? 3. A do të liheshin mënjatë të tria këto alfabete dhe do të krijohesh një alfabet krejt i ri? Pas shumë diskutimesh anëtarët e komisionit vendosën të pranonin alfabetin e Stambollit “e bashkë me të një abece thjesht latine që të mësohen e të përdoren bashkërisht në mest të shqyptarëve”¹⁶. Arsyeja e pranimiit dhe të një alfabeti latin krahas atij të Stambollit u paraqit nga komisioni thjesht si një çështje teknike, sepse me alfabetin latin mund të shtypeshin libra jashtë Shqipërisë, por mësimi në shkolla do të qe i detyrueshëm për të dy alfabetet.

Pavarësisht se Kongresi i Manastirit nuk e zgjidhi përfundimisht çështjen e alfabetit, ai pati një rëndësi të madhe në historinë e shkrimit të gjuhës shqipe. Numri i alfabeteve që do të përdornin shqiptarët pas Kongresit u reduktua në dy dhe, për më tepër, të dy alfabetet ngjanin sepse ishin krijuar mbi bazën e alfabetit latin. Ngjarjet e mëvonshme, orvajtjet e xhonturqve për t’u imponuar shqiptarëve alfabetin arabo-turk, masat shtypëse të qeverisë osmane për të penguar lëvizjen kombëtare shqiptare nuk lejuan një rishikim të çështjes së njësimiit të alfabetit. Vetë koha tregoi se alfabeti i Stambollit mbeti në një përdorim gjithnjë e më të kufizuar dhe alfabeti thjesht latin i Kongresit të Manastirit ishte bërë alfabeti i përbashkët i gjithë shqiptarëve. Pas Kongresit të Manastirit, në luftë kundër reaksionit xhonturk, për të shprehur gadishmërinë në mbrojtje të lëvizjes kombëtare për liri, kulturë e arsimim në gjuhën shqipe u mbajtën kongrese të tjera, si: Kongresi i Elbasanit (shtator 1909), Kongresi i dytë i Manastirit (prill 1910) etj. Vendimet e Kongresit të Elbasanit, që në histori ka hyrë me emrin “Kongresi për shkollat” patën një rëndësi të madhe historike në luftën e popullit shqiptar për arsim, kulturë e progres shoqëror në kushtet e rënda të robërisë otomane. Ndër vendimet kryesore mund të përmendim: çeljen e një shkolle normale që të shërbente për përgatitjen e kuadrove mësimdhënës; çeljen e një shkolle bujqësore; u kërkua vendosja e elbasanishtes në bazë të një gjuhë letrare dhe normalizimin e ortografisë¹⁷; themelimin e Shoqërisë së Mësonjtoreve shqiptare “Përparimi” dhe njohjen e saj nga të gjitha klubet e tjera. Kjo shoqëri ndihmonte shkollat në gjuhën amtare që ishin çelur dhe po çelehin në Pogradec, në krahinën e Devollit, në Gjirokastër, Labovë, Leskovik¹⁸ etj. Një rëndësi të veçantë kjo shoqëri u kushtonte programeve në shkolla, p.sh: programi që u caktua për Shkollën Normale përfshinte gramatikë, sintaksë, letërsi, retorikë, poezi, gjuhët e huaja, histori, gjeografi, filozofi etj, një program bashkëkohor për kohën, gjë që shënoi një arritje të madhe të lëvizjes arsimore shqiptare, sepse prej saj dolën brezat e parë të mësuesve që morën në dorë arsimin shqiptar në vitet e Pavarësisë e në

¹⁶ Po aty, fq. 97.

¹⁷ Universiteti i Tiranës, Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit, 1972, fq. 103.

¹⁸ Po aty, fq. 108.

vazhdim. Pak muaj më vonë u çel Kongresi i Dytë i Manastirit, i cili u mbajt në një situatë shumë të rëndë për arsimin shqiptar. Regjimi xhonturk i shikonte përpjekjet e shqiptarëve për arsim dhe gjuhë amtare si rrezikun kryesor të Perandorisë Turke, prandaj, për ta, hovi i shqiptarëve për çeljen e shkollave, ngritjen e shtypshkronjave, mbajtjen e Kongreseve duhej të ndërpritej¹⁹. Shumë nga detyrat dhe vendimet e Kongresit II të Manastirit nuk mundën të realizohen dhe as të botohen në ndonjë fletore në gjuhën shqipe²⁰.

Me ngritjen e flamurit në Vlorë, më 28 nëntor 1912, u krijua shteti i pavarur shqiptar, i cili që në fillimet e tij ndjeu nevojën e një gjuhe të përbashkët kombëtare. Në vazhdim të traditave të Rilindjes Kombëtare atdhetarët e konsideruan arsimin dhe kulturën si faktorë të rëndësishëm për përparimin e kombit, mjet për bashkimin e tij e ruajtjen e unitetit kombëtar në luftë me përpjekjet e vazhdueshme të shovinistëve fqinjë për ta copëtuar atë. Në këtë periudhë puna për lëvrimin e gjuhës shqipe u përqendrua brenda trojeve shqiptare. Qeveria e Vlorës, përveç problemeve të mëdha politike, kishte shumë probleme pedagogjike dhe didaktike për të zgjidhur: duheshin hapur shkolla, duheshin hartuar dokumentet e para shkollore, si: plane, programe, tekste, të cilat shiheshin si gurët e themelit për të ngritur godinën e shkollës shtetërore shqiptare. Vend të rëndësishëm në gjithë programin e saj Qeveria i kishte dhënë mësimin të gjuhës shqipe dhe përdorimit të saj në administratat dhe në të gjitha sferat e jetës. Këto masa ndikuan në forcimin e arsimit kombëtar dhe tashmë shkolla shtetërore shqiptare, e lidhur me kushtet e reja politike të kohës, në fillimet e Pavarësisë, ishte një realitet i lindur. Shumë patriotë, pedagogë e arsimtarë, si: Luigj Gurakuqi, Mithat Frashëri, Lef Nosi, Aleksandër Xhuvani, Sotir Peçi, Baba Dudë Karbunara, Mati Logoreci, Kolë Kamsi etj., hodhën themelet e një shkolle të re, që ishte vazhdim i shkollës kombëtare të Rilindjes me frymë atdhetare, demokratike, iluministe dhe që nga pikëpamja organizative ishte shtetërore dhe e detyrueshme, gjë që hapi një faqe të re në arsimin shqiptar. Filloi puna për botimin e teksteve mësimore sidomos të abetareve, që shiheshin si teksti i parë për mësimin e gjuhës së shkruar shqipe. Në vitet në vazhdim numri i abetareve, i teksteve ndihmëse për mësuesit të botuara në trojet shqiptare dhe jashtë tyre u rrit ndjeshëm. Mund të përmendim: “Abetari i vogël shqyp”, Nikaj, Shkodër, “Abeceja shqype e Kumanovës”, botua nga klubi i Kumanovës, “Këndim për radhën e parë”, botua nga Niko Lako, Milano; “Abetarja shqipe”, botuar nga Jashar Agjahu, teksti anonim, botuar nga shtypshkronja “Zojës së papërllyeme” “Abetare për shkollat fillestare të Shqypnisë”. Mati Logoreci boton “Librin e mësuesit për përdorim të abetarit” etj.

Pas vitit 1912, zgjerimi i vëllimit të botimeve shkollore, shkencore e të letërsisë artistike e bënte përditë e më të ngutshme çështjen e një gjuhe letrare të përbashkët, për të cilën kishin filluar përpjekjet e para që në vitet 60 të shek. 19, ku për herë të parë, me veprat e Kostandin Kristoforidhit të

¹⁹ Po aty fq. 114.

²⁰ Po aty. fq.116-117.

shkruara ndërgjegjshëm në të dy dialektet, gjejmë të mishëruar si qëllim të vetëdijshëm afrimin e të dy varianteve letrare dialektore në shkrim, gjë që shënonte një hap historik real për njësimin e gjuhës së shkruar. Me vullnetin e intelektualëve patriotë shqiptarë, me nxitjen dhe mbështetjen e Komandës ushtarake austriake u organizua në Shkodër Komisia Letrare²¹ 1916-1918. Ndër çështjet kryesore që u trajtuan mund të përmendim:

Së pari, krijimin e një gjuhe letrare të përbashkët dhe të bazës së saj dialektore, për të cilën u zhvilluan diskutimet të mëdha e të forta. Për anëtarët e Komisisë ishte e qartë, se cilat qenë rrugët e përfitimit të saj: 1. Marrja për bazë e një dialekti të vetëm; 2. Përzierja e elementeve të të dy dialekteve; 3. Rruajtja e të dy dialekteve në shkrim e shoqëruar nga një punë e vetëdijshme për njohjen e ndërsjelltë dhe afrimin e tyre²². Dëshira e anëtarëve të Komisisë dhe e Ministrisë së Jashtme austriake për një gjuhë shkrimi të njësuar për përdorim zyrtar e shkollor në territoret shqiptare të pushtuara prej saj gjatë Luftës I Botërore ishte imediate.²³ Prandaj, për të sheshuar mosmarrëveshjet e ndryshme dhe për të kënaqur dhe dëshirën e Komandës austriake u propozua që në bazë të gjuhës së përbashkët letrare të vihej një dialekt natyror, i kuptueshëm nga të gjithë shqipfolësit, dialekti i Elbasanit, i cili konsiderohej si “urë në mes të toskërishtes e të gegërishtes”.

Pas “përzgjedhjes” së bazës dialektore të gjuhës së përbashkët, përpara Komisisë shtrohej çështja e rregullimit të “orthografiës për sa të mundet për të dyë gojet shqiptare”²⁴. Kjo shihej si detyra kryesore në funksion të lëvrimit të gjuhës shqipe dhe kërkohesh të përcaktohej kodi drejtshkrimor i gjuhës zyrtare shqipe, duke kaluar kështu në atë fazë të planifikimit gjuhësor që quhet faza e kodifikimit. Por varianti dialektor i Elbasanishtes në bazë të gjuhës letrare të përbashkët, edhe pse u dekretua nga shteti në janar 1923 si gjuhë zyrtare shtetërore mbeti i kufizuar. Vendimet e Komisisë u miratuan nga Kongresi i Lushnjes 1920, i cili u quajt Kongresi I Kombëtar i Arsimit. Ndër çështjet kryesore që u paraqitën në programin e Kongresit mund të përmendim: unifikimi i shkollës; hartimi i programit sintetik dhe analitik për shkolla fillore e qytetëse; botimin e teksteve shkollore, gramatikave etj; caktimi i një gjuhe të përbashkët sipas së cilës do të shkruheshin këtej e tutje të gjithë librat shkollorë; botimi i një të përkohshme

²¹ A. Omari, Sfondi historiko-gjuhësor i zgjedhjes së elbasanishtes si gjuhë e përbashkët shkrimi në Komisinë Letrare të Shkodrës, botuar në “Lufta e Parë Botërore, Shqiptarët, Ballkani, Europa”, Tiranë, 2016, fq. 169-170.

²² Gjergj Pekmezi, Gjergj Fishta (Regjistër protokolli i Komisisë Letrare Shqipe në Shkodër 1916-1918 9, sipas riprodhimit anastatik në Tomor Osmani, Komisia Letrare shqipe në Shkodër, vep.cit. fq. 175-176.

²³ A. Omari, Sfondi historiko-gjuhësor i zgjedhjes së elbasanishtes si gjuhë e përbashkët shkrimi në Komisinë Letrare të Shkodrës, botuar në “Lufta e Parë Botërore, Shqiptarët, Ballkani, Europa”, Tiranë, 2016, fq. 170, vepër e cituar.

²⁴ K. Jorgaqi, Komisia Letrare Shqipe (1916-1918), një ndërmarrje e pastër planifikimi gjuhësor, botuar në “Lufta e Parë Botërore, Shqiptarët, Ballkani, Europa”, Tiranë, 2016, fq 218.

pedagogjike; përgatitja e kuadrove etj. Që në janar 1921 filloi të botohet në Shkodër e përkohshmeja “Shkolla e re”, në mars po të atij viti Këshilli i Epërm Arsimit me në krye Aleksandër Xhuvani filloi të botojë të përkohshmen “Kumtari arsimor”, në të cilën gjetën pasqyrim materialet e Kongresit si dhe shumë çështje e probleme të shkollës sonë në ngritje e sipër. Në këtë Kongres u hodhën bazat e terminologjisë gramatikore shkollë të sotme ku A. Xhuvani, si kryetar i komisionit u ngarkua me detyrën e përpunimit të saj. Ai botoi më 1919 “Libri i gjuhës e gramatika” pjesa I; 1920, “Libri i gjuhës shqipe” Pjesa e dytë ; 1922, librat “Njohuritë e para të sintaksës shqipe” pjesa e parë; më 1934, “Sintaksa shqipe” pjesa e dytë. Një mungesë të ndjeshme në shkollat tona plotësoi botimi më 1927 i librit të Ilia Dilo Sheperit “Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe”. Në vitet në vijim, në kushtet e vështira të viteve 30, pavarësisht punës këmbëngulëse të forcave demokratike për një riorganizimi dhe demokratizim të shkollës, për një gjuhë të përbashkët letrare, nuk munguan edhe pikëpamjet divergjente, lokaliste, për zgjidhjen e problemit gjuhësor mbi baza dialektore e nëndialektore, pikëpamje të cilat penguan dhe ngadalësuan zgjidhjen e problemit të gjuhës sonë letrare në shkallë kombëtare.

Pas Luftës Nacionalçlirimtare procesi i zhvillimit të gjuhës letrare hyri në një fazë të re. Botohet “Fjalori i gjuhës shqipe” 1954; “Rregullat ortografike” 1956; Në vazhdim, më 1956-1972, prirjet e zhvillimit të gjuhës letrare u bënë më të qarta dhe kristalizimi i normës së saj u bë me ritme më të shpejta. Ngjarja më e rëndësishme ishte mbajtja e Kongresit të Drejtshkrimit, më 1972, në të cilin u sanksionua norma standarde e gjuhës shqipe. Pas Kongresit të Drejtshkrimit vazhdoi puna për përsosjen strukturore dhe funksionale të gjuhës letrare, ngulitjen e normës letrare të njësuar etj. . U botuan dy vepra të rëndësishme si “Fjalori i gjuhës shqipe”, 1980 dhe “Fjalori i shqipes së sotme”, 1984. Në këtë periudhë u botuan dhe shumë tekste të tjera mësimore të gjuhës shqipe.

Pas viteve 1990, si pasojë e vendosjes së pluralizmit, ndryshimit të marrëdhënieve ekonomike dhe shoqërore, hapjes së kufijve tokësorë dhe kulturorë, ndodhën ndryshime të shumta edhe në gjuhën shqipe, herë-herë të dëmshme. Edhe sot ajo përballlet me probleme të shumta, së pari, me probleme gjuhësore, në çdo sistem e nënsistem të saj, më shumë në sistemin leksikor, por dhe morfologjik e sintaksor. Së dyti, duhet të jemi të kujdesshëm në përballje me diskutimet që janë bërë kohët e fundit në media, por dhe në auditorë, nga njerëz që nuk kanë formimin e duhur në lidhje me tezat e origjinës së gjuhës shqipe, marrëdhënieve të saj me gjuhët e tjera etj. .

Si përfundim, mund të themi se vendimet e marra në ngjarjet kryesore me karakter historik, kulturor e gjuhësor, si: Kongresi i Manastirit, Shpallja e Pavarësisë, Komisia Letrare e Shkodrës, Kongresi i Lushnjës, Kongresi i Drejtshkrimit, një numër i madh kongresesh e mbledhjesh të tjera, qenë vendime historike, me rëndësi mbarëkombëtare, sepse hodhën bazat e formimit dhe zhvillimit të gjuhës shqipe, norma letrare e së cilës në të gjitha nënsistemet e saj, fonetik, leksikor e gramatikor u kristalizua në periudhën e

mëvonshme, duke u paraqitur sot si një gjuhë letrare gjithëkombëtare e aftë të përballet denjësisht me gjuhë të tjera me histori shkrimi e zhvillimi shumë më të hershëm. Detyra e përditshme e gjithsecilit mbetet ta mbrojmë, zhvillojmë dhe ta pasurojmë atë.

Literatura

E. Çabej, Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, pjesa I, Botime “Çabej”, 2008.

Sh. Demiraj-K. Prifti, Kongresi i Manastirit, Tiranë, 2008.

Sh. Sinani, Konferenca e ipeshkvijve (1902) për njësimin e grafematizimit të shqipes, botuar në përmbledhjen e materialeve të konferencës “Zhvillime gjuhësore dhe letrare në Periudhën e Pavarësisë”, Gjirokastër 2018.

T. Osmani, Historia e alfabetit të gjuhës shqipe, Tiranë, 1987.

Universiteti i Tiranës, Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit, 1972.

A. Omari, Sfondi historiko-gjuhësor i zgjedhjes së elbasanishtes si gjuhë e përbashkët shkrimi në Komisinë Letrare të Shkodrës, botuar në “Lufta e Parë Botërore, Shqiptarët, Ballkani, Europa”, Tiranë, 2016.

KRIZAT SOCIALE DHE MORALE TË NJË SHOQËRIE NË TRANZICION

Laureta Konomi

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër

email:laureta.dhoska@hotmail.com

Abstrakti

Romani "Agonia," i shkrimtarit Odise Kote përmes strukturës së tij komplekse, stilit të veçantë dhe një lenteje të fortë kritike ofron mundësi për interpretime të shumta. Pasuria e përshkrimeve dhe fuqia emocionale e dialogëve krijojnë një ritëm që përçon energjinë e një periudhe të mbushur me pasiguri dhe sfida. Përmes gjuhës, si element estetik dhe që spikat pë pasurinë e saj, autori shpreh jo vetëm dhimbjen dhe pështjellimin e krizave sociale, por edhe luftën e brendshme të individit për të ruajtur identitetin dhe integritetin e tij moral, reflekton tensionin midis së vjetrës dhe së resë, një tension që përshkon thellësisht strukturën e shoqërisë dhe të vetë individit. Shumëllojshmëria stilistike e romanit, ku gërshetohen toni reflektiv, sarkazma e hollë dhe analiza kritike, i jep veprës një shtresëzim kuptimor që shkon përtej thjesht rrëfimit të ngjarjeve. Fokusi im mbi "Krizat sociale dhe morale të një shoqërie në tranzicion" është një reflektim i dhimbshëm mbi humbjen e shpresës dhe rrënimit të vlerave në një periudhë të rëndësishme historike. Një periudhë e shoqëruar me transformime radikale dhe ngjarje të paparashikueshme të cilat sjellin një ndikim të thellë në të gjitha aspektet e jetës së individit dhe të shoqërisë në tërësi. Në këtë kontekst, individit jo vetëm që tronditet psikologjikisht nga pasiguria dhe ndryshimet e papritura, por gjithashtu përballë me sfida të cilat kërkojnë përshtatje të shpejtë dhe kreative. Në kushtet kur strukturat dhe vlerat tradicionale janë në pikëpyetje, individit mund të ndodhet përballë një boshllëku ekzistencial, duke u përfshirë nga nevoja për të rianalizuar parimet themelore mbi të cilat bazohet identiteti personal, marrëdhëniet shoqërore dhe roli i tij brenda këtij realiteti.

Fjalë kyçe: strukturë, shoqëri, periudhë, tranzicion, tradicionale.

Abstract

The novel "Agonia" by the writer Odise Kote, through its complex structure, unique style, and a sharp critical lens, offers opportunities for multiple interpretations. The richness of descriptions and the emotional power of the dialogues create a rhythm that conveys the energy of a period filled with uncertainty and challenges. Through language, as an esthetic element that stands out for its richness, the author expresses not only the pain and confusion of social crises, but also the internal struggle of the individual to

preserve his identity and moral integrity. It reflects the tension between the old and the new, a tension that deeply permeates both the structure of society and the individual. The stylistic diversity of the novel, where the reflective tone, subtle sarcasm, and critical analysis intertwine, gives the work a layered meaning that goes beyond merely narrating events. My focus on "Social and Moral Crises in a Society in Transition" is a painful reflection on the loss of hope and the collapse of values during an important historical period. A period marked by radical transformations and unpredictable events that have a profound impact on all aspects of an individual's life and society as a whole. In this context, the individual is not only psychologically shaken by uncertainty and sudden changes, but also faces challenges that require quick and creative adaptation. In conditions where traditional structures and values are questioned, the individual may find himself facing an existential void, caught up in the need to reanalyze the fundamental principles upon which personal identity, social relations, and his role within this reality are based.

Keywords: *structure, society, period, transition, traditional.*

Romani më i ri i shkrimtarit Odise Kote, "Agonia", përmes njëstili të fuqishëm dhe të kujdesshëm narrative, i cili pasqyron thellësisht shoqërinë shqiptare në kohë tranzicioni nuk lë indiferent asnjë lexues. Romanin e karakterizon një strukturë komplekse dhe një qasje kritike ndaj krizës së identitetit, moralit dhe ekzistencës në një periudhë të pastrukturuar. Duke ndërthurur ndjesitë e frikës, tjetërsimit dhe pasigurisë, çdo ngjarje transformohet në një përvojë të gjallë në mendjet e atyre që i rikthehen asaj kohe përmes leximit, por edhe për ata që e zbulojnë për herë të parë këtë realitet, sa të largët, aq edhe tronditës.

Titulli i romanit "Agonia" më shumë se thjesht një koncept "gjendje e rëndë dhe e pashpresë e diçkaje që është në mbarim, në shuarje, çastet e fundit të një sistemi shoqëror të një sundimi, dukurie etj"¹ dhe emër, simbolizon thelbin e tij duke i dhënë një kuptim më të thellë dhe universal. Mesazhi që ai përcjell është i qartë dhe i fuqishëm: historia ka një prirje të frikshme për t'u përsëritur. Duke u kthyer pas në ngjarjet e së kaluarës, ndonjëherë ne zbulojmë se krizat e mëdha shpesh ndodhin kur kombet zgjedhin të injorojnë mësimet e dhimbshme të historisë së tyre. Koha si koncept narrativ vepron si një mekanizëm artistik në këtë roman. Ajo që fillimisht shihet si një histori lineare transformohet në një strukturë më komplekse dhe e mbingarkuar, e ngjashme me një mozaik të mbushur me përvoja dhe tensione. Në këtë mozaik, ato nuk janë të ndara nga individi, por ndërthuren me të, duke krijuar një marrëdhënie të ndërlikuar dhe dinamizmi i tyre nxjerr në pah forca të fshehura, shkaqe dhe ndikime që, në mënyrë të ndjeshme, formësojnë përvojën dhe ndërgjegjen e tij për të perceptuar realitetin dhe veten.

¹Fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë, 1987, fq.25.

Në këtë kontekst, Agonia shfaqet e shkrirë në të gjithë narrativën e romanit duke fituar një intesitet gjithnjë e më të madh, duke u shndërruar në një energji që nxit zhvillimin e ngjarjeve duke konsoliduar edhe më shumë idenë e veprës: të paraqitjes së një agonie të pafund në një kohë absurde, të një kohe, e cila parë nga këndvështrimi i sotëm, do të ishte akoma më absurde, të quhej thjesht një kohë e kaluar!

Udhëtimi i Bojken Kostanit, personazhi kryesor i romanit, është një rrugëtim i ndërthurur dhe i ndërlikuar, sa fizik aq dhe shpirtëror. Ai përpiqet të kuptojë rrënjët e kaosit që po përjeton vendi, por përballet, gjithashtu, me dilemën e vendit që ai vetë ka në këtë botë të fragmentuar.

Ai sfidohet nga ndjenja e pafuqisë përballë një realiteti të ashpër dhe shpesh absurd, ku mbijetesa e tij personale dhe profesionale për të ruajtur objektivitetin në një mjedis ku e vërteta manipulohet, varet nga aftësia për t'i rezistuar rrymës së dehumanizimit që po kaplon shoqërinë shqiptare. “I lejohet gazetarit të këndojë një psalm? Unë jam gazetar, bëj një punë të mbushur me armiqësi e kundërshti. Dëshmoj të padëmtueshme. Si ta braktis, tëiki e të vij atje te ti, moj Keti Braumfisher? Njerëzit këtu në vendin tim, sapo kanë filluar të dallojnë lajmin e vërtetë nga dokrrat”.²

Teksa lexuesi zhytet në faqet e romanit, përballet me një panoramë tronditëse dhe ndien peshën e një bote që po shpërbëhet. Një botëku përmbyesja e vlerave tradicionale dhe etike bëhet normë dhe ato që dikur ishin bazat e moralit dhe ndershmërisë nuk janë më referenca të qëndrueshme.

“Reforma, reforma”!, i thanë kudo që shkoi. Etja për lavdi, smira, egoizmi i papërmbyesja e tretën ngadalë, e vunë poshtë. Iu dorëzua pijes”.³

Një realitetku fajdet dhe abuzimet ekonomike janë të përhapura, ku ndjenjat e solidaritetit dhe besnikërisë janë zëvendësuar me egoizmin e shfrenuar, ku dhimbja dhe konfuzioni përjetohej si ndjesi të përditshme, ku çmenduria e mendjes dhe fuqia e parasë shkatërrojnë çdo kufi të racionalitetit dhe humanizmit, ku dhuna, nuk është më një anomali, por bëhet pjesë integrale e jetës. Një realitet i cili e rrëzon njeriun në një humnerë ekzistenciale duke e vendosur në një përplasje të dhimbshme me vetveten dhe duke e kthyer çdo marrëdhënie njerëzore në një luftë të ashpër për mbijetesë.

Ky rend destruktiv, të cilin autori e paraqet me një thellësi analize të hollësishme, ngrihet përballë individit dhe përfshin një shoqëri të tërë, duke e mbushur me kontradikta të thella dhe dramatike.

Objektet dhe njerëzit që dikur kishin lidhje me të, tani shfaqen si simbole të një rënieje sociale dhe shpirtërore. Këto elemente krijojnë hapësira ku ndjenjat e humbjes dhe papërshtatshmërisë thellohen, duke e lënë atë në labirintin e mendimeve dëshpëruese dhe emocioneve zhgënjyese. Çdo hap është një përballje me fantazmat e së kaluarës, të cilat e bëjnë jetën e tyre të

² Kote, Odise: Agonia, Tiranë, 2024, f.42-43.

³ Kote, Odise: Agonia, Tiranë, 2024, fq. 37.

përditshme një akt pa fund përpjekjesh për të mbijetuar në një sistem të prishur duke u ndier më i izoluar se kurrë, në një botë që duket se ka harruar se kush është.

Nën këtë presion, njeriu humbet kuptimin e ndjesisë së përkatësisë dhe përqafon një lloj pragmatizmi të ftohtë, duke u udhëhequr nga instiktet e tij më të ulëta, nëpërballje me sfida që s'kanë vetëm ndikim mbi identitetin e tij, por edhe mbi fatin i cili duket se është përcaktuar.

“Mendja njerëzore duket e paaftë të kapërcejë murin e kufizimit që e pengon të kuptojë si ndodh e gjitha kjo. Edhe midis përgjumjesh, ndodhin çudi të pashpjegueshme. Si kjo flamë e paparë, por e dëgjuar, e frikshme dhe çorientuese. Mendja është magnet. Po mendove pozitivisht ajo tërheq pozitivitetin, po mendove negativisht ajo tërheq negativitetin”.⁴

Me një stil të ngjeshur dhe dramatik autori pikturon një panoramë të frikshme të kaosit duke nxjerrë në pah se si njeriu, i zhytur në mjerim dhe degradim moral, i kalbur nga anarkia e brendshme dhe i mbushur me djallëzi e mashtrime, mund të rrëshqasë në një spirale dhune që e shpie drejt akteve më makabre. Kjo krijesë e përçudnuar, “një bandit i mjerë rruge, që qelbej mjerim, vjetërsirë, anicirë shpifësire, gojështurur e dimërak si mynxyrë”⁵ është mishërimi i një shoqërie që ka humbur çdo lidhje me njerëzoren, duke përfunduar në një univers të mbushur me urrejtje, vrasje dhe një shkatërrim të papërfytyrueshëm.

Skenat e frikës dhe lutjeve për shpëtim: “të paktën vajzën mos e prekni, mos e qëlloni. Është e huajshqiptoi me zë që nuk besoi se ishte i tij. Në atë zë ishte gjithë mërzia, urrejtja, shpagimi hakmarrës. Nuk e dinte si do të ishte vdekja e tij pas përleshjes. Imazhi i fytyrës së copëtuar, një sy i prishur, tjetri që shikonte gjithë urrejtje e hakërrim.”⁶ “krijojnë një atmosferë të ngjeshur emocionale që e bën lexuesin të tërhiqet në këtë narrativë tragjike dhe të pyesë mbi natyrën dhe moralin e vrasësit: a është vrasës në kuptimin e mirëfilltë apo ekzistenca e tij në një situatë kaotike e shtyn të veprojë ashtu?!

Përdorimi i ironisë nga autori shërben për të zbuluar situatat kontradiktore, duke krijuar një ndjesi të thellë të dhimbjes dhe absurdes. Autori mjeshtërisht e përdor këtë teknikë për të nxjerrë në pah konfliktin e pashmangshëm ku realiteti përballlet me parodinë e tij. Kjo ironi nënvizon kontrastin e mprehtë midis pritshmërisë së pakuptimtë dhe paarsyeshmërisë së asaj që ndodh. Poshtë një sipërfaqeje festash, brohoritjesh dhe skenash euforike, një torte gjigande presidenciale që krijon një iluzion sa të gëzueshëm aq edhe grotesk, ndodhet një tension dhe frikë e thellë, duke i dhënë narrativës një thellësi të veçantë. “Që torta do të ishte e pazakontë kjo nuk kishte diskutim, por askush nuk i dinte përmasat e sakta. Entuziastët përfytyronin si tortë

⁴ Kote, Odise: Agonia, Tiranë, 2024, fq. 50.

⁵ Kote, Odise: Agonia, Tiranë, 2024, fq. 346.

⁶ Kote, Odise: Agonia, Tiranë, 2024, fq. 344.

presidenciale krejt fasadën e katit të parë të Pallatit të Kulturës, të tjerë, racionalistët, besonin në përmasa disi më tokësore”,⁷

Simboli luan gjithashtu një rol kyç në roman, duke ofruar një dimension shtesë për interpretimin e tij. Ajo çfarë duket si liri e fituar, është në të vërtetë një formë e fshehtë e skllavërisë, ku njeriu është i lidhur fort me frikat dhe pasionet që e kanë ngërthyer. Në këtë kontekst ato nuk janë thjesht mjete letrare, por janë një thirrje për reflektim dhe një paralajmërim për tragjeditë e pashmangshme që do të pasojnë.

“Paratë e fajdeve konvertoheshin në dollarë. Thasët me lekëi çonin natën në bankë dhe merrnin thasë me dollarë. Me pak fjalë,-dhe ashtu si mjeshtrit e shahut që me pak lëvizje tregojnë fundin e pashmangshëm të lojës.”⁸

Edhe në marrëdhëniet shpirtërore, Bojken përballet me dilema të thella që e sfidojnë kuptimin e tij për dashurinë dhe jetën. “Bojken Kostanit lëndimthi i doli padashur një “ah”, psherëtimë hollake, disi cinike, që sikur mori formën e një gremçi të padukshëm ku do të vareshin kujtimet e një kohe joshumë të largët. “Eh, kush na qenka? Aurora Lila. Me Aurora Lilën ishin mbyllur të gjitha rrugët e kthimit. Në drurët e kujtesës vareshin vetëm tekste të trishtuara këngësh të vjetra, dhimbje e pabesueshme, trazuar nga mëria e Zotit. Bisedat e tyre përfundonin duke lënë shumë gjëra pa thënë. Një relief me gropa të fshehura. Përse i dërgonte befaz sinjale turbulluese?”⁹

Lidhja e fortë me të kaluarën nuk është thjesht një kujtesë, është një burim pasigurie, shkak tensionesh të vazhdueshme që e bën atë të dyshojë për të ardhmen që dëshiron të ndjekë. Kjo e kaluar shndërrohet në simbol të brishtësisë së tij dhe ide e qartë, se pavarësisht përpjekjeve për t’u çliruar, ajo do të mbetet gjithmonë një pjesë e pandashme e ekzistencës së tij, një grackë mes hijeve të nostalgjisë dhe realitetit të tashëm. Lidhja e tij më e plotë, por dhe e trazuar me Ketu Braumfisher fillimisht ilustron tensionin psikologjik, sfidat që sjellin botëkuptimet dhe kulturat e ndryshme në lidhjet personale.

“Bojkeni, herë me të qeshur e herë seriozisht, e pickonte:vetëm në fillim të rrugës jemi bashkë. Gjatë ecjes pastaj ndahemi. “Dhe nuk ishte fjala vetëm për gazetari apo punë redaksish. Qe diçka më e thellë, konceptuale, shpirtërore, mënyrë e përveçme e të parit të botës. E menduar kështu edhe vetë u habit përse u tremb. Syri dhe veshi i mendjes së saj, si pjesa më e rrezikshme e njeriut, u frikësua nga ato që s’mund t’i perceptonte e kuptonte si duhej, tregimet, besimet, rrëfenjat, zakonet. Dhe kishte të drejtë. Ato i përkitnin një jete e njëkulture tjetër”.¹⁰

Më pas kjo marrëdhënie paraqitet si një përvojë gjithëpërfshirëse, duke u shndërruar në një lidhje unike dhe të fuqishme. Një marrëdhënie e cila reflekton, gjithashtu, potencialin për të adoptuar, por edhe për të gjetur

⁷ Kote, Odise: Agonia, Tiranë, 2024, fq. 120-121.

⁸ Kote, Odise: Agonia, Tiranë, 2024, fq. 257-256.

⁹ Kote, Odise: Agonia, Tiranë, 2024, fq. 249.

¹⁰ Kote, Odise: Agonia, Tiranë, 2024, fq. 28-29.

balancën në kulturat e secilit përtej dallimeve. Në romanin “Agonia”, marrëdhënia mes dy personazheve, Bojken dhe Ketit Braumfisher, është një shembull i një lidhjeje të fuqishme dhe gjithëpërfshirëse që tejkalon dallimet kulturore, sociale dhe psikologjike. Kjo lloj lidhjeje reflekton mundësinë e krijimit të një marrëdhënieje të thellë, edhe kur dy individë vijnë nga kontekste me vlera, besime dhe identitete të ndryshme. Bojken, si një djalë shqiptar, është i mbushur me vlera tradicionale, të cilat pasqyrojnë pasigurinë dhe tensionet e një shoqërie që është në tranzicion dhe është ende duke u përpjekur të gjejë ekuilibrin mes së kaluarës dhe së ardhmes. Nga ana tjetër, Ketit Braumfisher, një vajzë e ardhur nga një kulturë perëndimore, është më shumë e orientuar drejt individualizmit dhe një lirie që mund të duket e largët për Bojkenin. Ajo ka një ndjenjë të fortë të pavarësisë për të ruajtur autonominë e saj, e cila mund të përbëjë një sfidë për të kuptuar dhe përshtatur me qëndrimet e Bojkenit. Në këtë marrëdhënie, përvoja gjithëpërfshirëse që përshkruhet është procesi i përballjes me këto dallime dhe në të njëjtën kohë mundësia për të ndërtuar një lidhje më të fuqishme dhe më të qëndrueshme. Kjo marrëdhënie është një lloj "agonie", në kuptimin që kërkon përpjekje të vazhdueshme dhe mund të shkaktojë tensione, por gjithashtu mund të çojë në një rritje dhe zhvillim të përbashkët. Por ajo që e bën marrëdhënien mes tyre unike dhe fuqishme, është përpjekja për të adoptuar dhe gjetur balancën midis këtyre dy botëve të ndryshme. Ky proces i balancimit është gjithashtu një mundësi për të mësuar nga njëri-tjetri dhe për të përjetuar ndryshimin në mënyra që nuk ishin të mundshme për secilin prej tyre individualisht. Bojkeni mund të fillojë të kuptojë vlerën e pavarësisë dhe autonomisë që Ketit i sjell në marrëdhënie, ndërsa Ketit mund të vlerësojë më shumë rëndësinë e ruajtjes së lidhjes me identitetin dhe trashëgiminë kulturore, diçka që ndoshta nuk e kishte kuptuar plotësisht më parë.

Në këtë mënyrë, lidhja mes Bojkenit dhe Ketit është një proces transformues, ku secili person ndihmon tjetrin të evoluojë dhe të rritet përtej kufijve të secilit. Ky balancim i kulturave dhe i mundësisë për të kuptuar dhe përqaftuar dallimet kulturore, është një hap i rëndësishëm drejt krijimit të një lidhjeje të fuqishme që tejkalon muret e ndarjes dhe tensioneve të natyrshme që lindin nga dallimet kulturore.

“Ferri” që i propozon Ketit e cila e sfidon duke e pranuar pasigurinë dhe frikën që sjell ky realitet, është një zgjedhje e mbushur me dilema.

Është përballja, përpjekja, dhe në fund dështimi për të kuptuar një botë që është në kundërshtim me botën e tij, shuarja e iluzionit për të jetuar në kuptimësidhe fundi i trishtë zbulon çmimin e lartë që individët paguajnë, ndërsa përballen me traumat që ndikojnë jo vetëm fizikun, por edhe psikikën e tyre të brishtë.

“Je gati të vish me mua në ferr?”

Ia tha ato fjalë dhe nuk u duk i zhbartur prej “fajit”, ngaqë nuk kishte mundur t’i rrëfente çudi të padëgjuesha shqiptare. Si t’ia thoshte asaj se në një qytet të Jugut ishte vjedhur me tank kasaforta e blinduar e bankës? Si t’ia

thoshte se rebelët kishin kapur një punonjës të shërbimit informativ dhe e kishin djegur të gjallë me benzinë?”¹¹

“S’ka tingull më të keq se e qara me ofshamë e nënës kur sheh djalin shtrirë në divan, as të gjallë, as të vdekur.Por ka dhe një tingullmë të keq se ai.

Heshtja!

Heshtja e ndërgjegjes.

Bojken Kostani, lodhur nga shpërthimet e befta , trazimet, humbi sërish ndjenjat...”¹²

Të përshkruash një tragjedi kombëtare,një botë amoraliteti, paturpësie, pabesie, tradhtie, dinakërie, të dokumentosh absurdin e instiktit vrasës, të sjellësh në projektion letrar një histori me kaq kompleksitete situatash dhe karakteresh, në një limit romanesk të hapësirës letrare, paraqet një sprovë sa të ndërgjegjes intelektuale, aq dhe të vokacionit dhe horizontit krijues të autorit.

Romani “Agonia” ka një qasje të jashtëzakonshme për të sjellë në jetë momente kyçe të historisë së një kombi dhe,ndërsa ngre ura lidhëse mes së kaluarës dhe së tashmes, krijon një ndërthurje të kohëve që u jep ngjarjeve historike një përmasë njerëzore dhe emocionale që shkon përtej fakteve historike. Në këtë kuadër, romani ngre pyetje të rëndësishme dhe të përrjetshme mbi identitetin, moralin dhe ekzistencën. Ato pyetje janë një pasqyrim i luftës së vazhdueshme të njerëzimit për të gjetur kuptim në një botë të pasigurt dhe shpesh të pakuptueshme. Duke sfiduar lexuesin të meditojë mbi këto çështje, romani ndërthur historinë individuale me atë kolektive, duke ofruar një tablo të gjerë kuptimore të natyrës njerëzore që rezonon pavarësisht epokës apo rrethanave specifike. Thelbi i romanit shërben si një kujtesë për mënyrën se si përvojat e së shkuarës ndikojnë në të tashmen dhe të ardhmen, duke formësuar mënyrën se si individët dhe shoqëritë përballen me krizat, ndërtimin e identitetit dhe kërkimin e qëndrueshmërisë morale. Ai është një reflektim mbi vulnerabilitetin dhe forcën e njerëzimit, një histori e përhershme që na fton të rivlerësojmë thelbin tonë dhe lidhjet tona me të tjerët.

Burime bibliografike

Sabri Hamiti, Letërsia moderne shqipe, 2009.

Odise Kote, Agonia”, Tiranë, 2024.

Umberto Eko, Teori dhe kritikë moderne, Rozafa , Prishtinë, 1996.

Agron Tufa, Letërsia dhe procesi letrar në shekullin XX, Tiranë, 2018.

Sabri Hamiti, Letërsia bashkëkohore, në “Vepra letrare” nr. 10.

Roland Zisi, Letërsi bashkëkohore shqipe, Tiranë, 2008.

¹¹ Kote, Odise, “Agonia”,Tiranë 2024,fq. 314-315.

¹² Kote, Odise, “Agonia”,Tiranë 2024,fq. 366.

GJUHA GREKE NË ZONËN E MINORITETIT ETNIK GREK NË SHQIPËRI-STATUSI REAL I GJUHËS GREKE DHE SHQIPE NË KËTË ZONË

Donika Boboli – Koçi¹, Aleksandër Boboli²

¹Universiteti “Eqrem Çabej”

e-mail: donika.boboli@yahoo.com

²Universiteti “Eqrem Çabej”

e-mail: aleksanderboboli@yahoo.com

Abstrakt

Arsimi kombëtar dhe identiteti i pakicave kombëtare ka qenë nga problemet më të rëndësishme në Ballkan dhe Evropën Lindore gjatë shekullit të kaluar. Qeveritë e ndryshme, të detyruara nga Traktatet e Lidhjes së Kombeve për t'i respektuar ato, kanë pasur prirjen për të asimiluar këto pakica brenda kufijve të tyre me mjete dhe mënyra të ndryshme. Shteti shqiptar u përpoq të ndërtonte që në fillim një sistem arsimor që do t'u përgjigjej idealeve kombëtare, për të kultivuar te brezi i ri idenë e bashkimit kombëtar dhe për të nxitur asimilimin e Minoritetit Etnik Grek. Ky artikull trajton vendimet e qeverive shqiptare që nga krijimi i shtetit shqiptar në lidhje me arsimin në gjuhën greke, raportet e saj me gjuhën shqipe dhe vendosjen eventuale të dygjuhësisë në pakicën etnike greke.

Fjalë kyç: *Minoritetit Etnik Grek, Ballkan, Evropën Lindore*

Abstract

National education and the identity of national minorities has been one of the most important problems in the Balkans and Eastern Europe during the last century. The various governments, bound by the Treaties of the League of Nations to respect them, have tended to assimilate these minorities within their borders by various means and ways. The Albanian state tried to build from the beginning an educational system that would respond to national ideals, to cultivate in the new generation the idea of national unity and to promote the assimilation of the Greek Ethnic Minority. This article deals with the decisions of the Albanian governments since the establishment of the Albanian state regarding education in the greek language, its relationship with the Albanian language and the late establishment of bilingualism in the Greek Ethnic Minority

Keywords: *Greek Ethnic Minority, Balkans, Eastern Europe*

1. Statusi i gjuhës greke dhe shqipe në zonën e Minoritetit Etnik Grek

Çështja e statusit të gjuhës greke dhe asaj shqipe në zonat e Jugut ku me shumicë banon Minoriteti Etnik Grek është një problem sa gjuhësor, aq edhe politik. Është një çështje që në fakt doli pas formimit të shtetit shqiptar, nevojave të tij për shtetbërje, synimeve për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare shqiptare dhe ngritjen e arsimit kombëtar.

Dhe për arsye jo thjesht metodologjike, por edhe për dallime thelbësore midis tyre, statusin real të gjuhës greke në zonën e Minoritetit duhet ta trajtojmë në tri periudha:

- periudha e parë 1921-1939,
- periudha e dytë 1945-1990,
- periudha e tretë 1990- në vazhdim.

1.1 Periudha e parë

Menjëherë pas Luftës së Parë Botërore, me shembjen e perandorive dhe krijimin e shteteve të reja, doli në sipërfaqe problemi i mbrojtjes së pakicave kombëtare në këto shtete. *Konferenca e Paqes në Paris* përgatiti një varg traktatesh për mbrojtjen e të drejtave të pakicave. Një deklaratë të tillë nënshkroi dhe Shqipëria me futjen e saj në Lidhjen e Kombeve më 2 tetor 1921, brenda së cilës përfshihej edhe çështja e mësimit të gjuhës së pakicave. Me këtë deklaratë minoriteti kishte të drejtë të hapte shkollat e veta në gjuhën amtare dhe të përdorte lirisht gjuhën greke në institucionet e tij fetare si edhe në jetën e përditshme. Shteti paralelisht detyrohej që mësimi në shkollat fillore të bëhej në gjuhën e pakicës. Në qershor të vitit 1927, Ministria Shqiptare e Arsimit vendosi që të gjithë mësuesit e shkollave private t'i nënshtroheshin testeve të njohjes së gjuhës shqipe dhe vetëm ata që kalonin do të mbeteshin në sistemin arsimor, pjesa tjetër do të pushohej menjëherë.¹

Në vitin 1928 *Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare, neni 207*, mbyll në njëfarë mënyre shkollat e deriatëhershme që funksiononin si private (në zonën e minoritetit grek atë periudhë funksiononin shkolla private, të quajtura komunitare) dhe paralelisht zëvendëson mësuesit minoritarë ose grekë (nga Greqia) me mësues shqiptarë).

Siç del dhe nga shënimet informuese që u dërgonin institucioneve të ndryshme në Tiranë autoritetet arsimore lokale, p.sh., prefektura e Gjirokastrës, kishin rezerva ndaj shkollave minoritare dhe lëndëve që

¹Dajo S., Janinë 2022, Dimensioni i vërtetë i abstenimit arsimor të bardhë, beteja ligjore e B/H-ve dhe shfarosja e protagonistëve(1925-1945), faqe 284-285.

zhvilloheshin aty.² Gjithashtu, autoritet arsimore mendojnë, siç referohet në një raport-rezervat të përgatitur pas inspektimit të shkollave grekofone, se mësuesit minoritarë paguhën nga shteti grek, se mundësitë e të ardhurave të komuniteteve nuk mund t'u plotësojnë atyre rrogën³, si edhe propozojnë masa drastike për të evituar, siç shkruhet “përhapjen e grekomonizmës në popullin e katundevet”.⁴

Në vitet e mëvonshme mbyllën njëra pas tjetrës të gjitha shkollat private komunitare në pamundësi për të përmbushur parashikimet e nenit 207 të Statutit Themeltar. Më 1933 me amendimet që iu bënë neneve 206-207 të Statutit Themeltar, arsimimin dhe edukimin e shtetasve shqiptarë e merr përsipër shteti. Si pasojë të gjitha llojet e shkollave private pushojnë së funksionuari. Për pasojë shkollat komunitare minoritare mbyllën edhe me ligj. Paralelisht qeveria këto shkolla i shtetëzoi duke ruajtur mësimin e gjuhës amtare në shkollat e fshatrave grekofone.⁵

²Në një informacion që inspektori i Arsimit të Prefekturës së Gjirokastrës i dërgon Ministrisë së Arsimit më 13 nëntor 1924 thuhet: “...Sadoqë në shkollat e katundevet grekofone përdoren vetëm libra që kanë shkuar nga kontrolli i Inspektorit dhe siellin për këtë qëllim vulën e saj, sado që mësuesit të këtyre shkollave janë detyruar të zhvillojnë vetëm lëndën e historisë dhe gjeografisë, që është dhënë në Kursin e Gushtit 1923, sado që u është dhënë programa sintetikoanalitike e përkthyer në gjuhë greqishte dhe janë porositur të mos lozin nga lënda e saj, me gjithë këto na duket e pamundur të bëhet një kontrollim i shpeshtë dhe i nevojshëm sa duhet në këto shkolla po të marrim parasysh numrin e madh-numër që bashkë me shkollat kombëtare bëhet 92 e ca- te mbetat e komunikacionit të sotëm dhe shumë pengime të tjera. Kemi propozuar disa herë dhe jemi lutur që për këto shkolla është i doemosmë emërimi i një inspektori të veçantë me ndjenja patriotike të kulluara, i zoti i gjuhës greqishte e i zot i punës. Vetëm me emërimin e një inspektori të këtillë, i cili t'a ketë qëndrën në Bularat, ku janë dhe Zyrat e Krahinaris së Dropullit, do të jetë i mundur kontrollimi dhe inspektimi shpeshte dhe i vërtetë i këtyre 92 e ca shkollave. Për këtë qëllim nuk duhet bëhet kursim. Na duket një nevojë shumë e madhe... AQSH F. 195 V. 1924

³....Në Prefekturën e Gjirokastrës ma se 62 shkolla grekofone, prej të cilave 24 janë si zyrtare t'emnuem siç dihet prej asj P.T. Ministrie për të dhanë mësim në gjuhën shqipe ndër lëndet e caktueme. Përveç këtyre 24 vet janë dhe 38 krejt privatë që ndër të cilat mbassi nuk ka mësues t'emnuem për gjuhën kombëtare, kuptohet prej vetiut se në gjuhën shqipe nuk bahet aspak ndo-nji mësim por fill e krejt çdo lëndë bahet greqisht.... Sjelljet pra të këtyre mësuesve këso-doret dhe veprimet e tyre në këtë mnyrë tregojnë sheshazi se me titullin që janë tue mbajtur si mësues zyrtarë përpiqen me paramendime të dominojnë mbi arësimin komëtarë... punë kjo që nuk durohet, prandaj sa të jet e mundun e ma parë të meren masat e duhura për me u pre hapin sistematik qi pa banet në dëm t'arsimit të kombit dhe të gjuhës së tija zyrtare. AQSH, F. 195 V. 1928

⁴Ibid.

⁵Vërejtjet e Qeverisë Shqiptare dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve pas ankesave zyrtare që iu drejtuan këtij të fundit nga Minoriteti Etnik Grek, në Papadopoulos G. Minoriteti Etnik Grek në Shqipëri dhe çështja e tij arsimore, f. 88, Botimi IBE, Janinë 1981.

Aktet e qeverisë shkaktuan reagimin e minoritetit duke shpallur grevë arsimore gjatë vitit shkollor 1934. Paralelisht u mblodhën me mijëra firma dhe iu dërgua peticion Lidhjes së Kombeve. Kjo e fundit dërgoi çështjen për shqyrtim në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës, vendimi i së cilës detyroi qeverinë shqiptare të kthente statusin e shkollave të minoritetit në gjendjen e mëparshme. Në zbatim të vendimit të Hagës qeveria nxjerr një rregullore të veçantë ku rregullon statusin e shkollave private dhe atyre shtetërore të minoriteteve. Rregullorja u botua në Fletoren Zyrtare më 12 Nëntor 1935. Sipas kësaj rregulloreje, në shkollat private programi shkollor është ai zyrtar, ndërsa gjuha për të gjitha lëndët do jetë gjuha e minoritetit⁶. Edhe për shkollat shtetërore, për ato komunitete që nuk kanë mundësi për të mbajtur shkolla private, zbatohet i njëjti program dhe të gjitha lëndët do zhvillohen në gjuhën e minoritetit.

Rregullorja ka parashikuar gjithashtu se mësimi i gjuhës shqipe në këto shkolla, private ose shtetërore, është i detyrueshëm⁷. Për sa i përket teksteve, në shkollat private minoritare “do të përdoren librat dhe veglat e tjera shkollore, të hartueme në gjuhën minoritare mbas programës zyrtare vetëm me pëlqim të Ministrisë së Arsimit”⁸, ndërsa mësuesit kandidatë për shkollat private, duhet të plotësojnë disa kushte, ndërmjet të tjerave të dinë gjuhën shqipe.⁹

Gjatë kësaj periudhe në zonat e quajtura minoritare funksiononin një numër i konsiderueshëm shkollash private (komunitare) dhe shtetërore. Në përgjigjen e ministrit të Punëve të Jashtme të atëhershëm të Mbretërisë Shqiptare, që i dërgohet sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, në lidhje me pretendimet e Minoritetit Etnik Grek, për sa u përket numrit të shkollave, në këtë zonë bëhet fjalë për një numër shkollash që i kalon të 50-at nga vitet 1925 deri në vitin 1933, ndërsa mësuesit e kalojnë numrin 70-të¹⁰. Këto

⁶Rregullore mbi shkollat private të Minoriteteve, Neni 8 “Për sa i përket vjetit shkollor, dëftesave, klasifikimit, kalimit të provimeve të nxansvet si dhe moshës së detyrueshme, sistemit e programës, zbatohen pikrisht dispozitat e ligjës organike të Arsimit. Programi shkollor është ajo zyrtarë e shkollave të Shtetit, por në të gjitha lëndët e për të gjitha klasët do të zhvillohet në gjuhën e minoritetit. Msimi i fesë që nuk përfshihet në programin zyrtar mund të mësohet në gjuhën e minoritetit.

⁷Ibid. Neni 11 “ Në shkolla minoritare Ministrija e Arsimit ka të drejtë me shti si të detyrshëm msimin e gjuhës shqipe”.

⁸Ibid. Neni 9

⁹Ibid. Neni 3, pika c “me ditë, për sa është e mundur, gjuhën shqipe, kjo konditë hyn në fuqi mbas tri vjet.”

¹⁰Tabela nr. 1 bashkëlidhur me vërejtjet e Qeverisë Shqiptare: viti shkollor 1925-1926, shkolla private dhe shtetërore 51, mësues 72, viti shkollor 1926-1927, shkolla private dhe shtetërore 53, mësues 73, viti shkollor 1930-1931, shkolla private dhe shtetërore 57, mësues 94, viti shkollor 1932-1933, shkolla private dhe shtetërore 50, mësues 64 etj në Papadopoulos G. Minoriteti Etnik Grek në Shqipëri dhe çështja e saj arsimore, Janinë 1981.

numra, pothuaj, me pak ndryshime, referohen edhe nga autoritetet greke të asaj kohe.¹¹

Në këtë periudhë gjuha mbizotëruese ishte gjuha greke. Shumica dërmuese e mësuesve ishin shkolluar në shkollat e Janinës, Korfuzit apo Athinës, me njohuri minimale për gjuhën zyrtare shqipe. Për më tepër, shumica e shkollave ishin komunitare, megjithëse edhe këto sipas ligjit zbatonin programin zyrtar. Por edhe në shkollat e ashtuquajtura shtetërore, mësimi sipas ligjit zhvillohej tërësisht në gjuhën e minoritetit, përveç orës së mësimt të gjuhës shqipe. Edhe mësuesit e emëruar nga shteti shumica ishin minoritarë, mësuesit shqiptarë ishin të paktë.

Për rrjedhojë niveli i njohjes së gjuhës zyrtare ishte i ulët. Këtë gjë e përforconte izolimi gjeografik, mungesa e rrugëve dhe e komunikimit me komunitete të tjera që flisnin shqip. Të shtojmë këtu se gjatë kësaj periudhe qytetarët ishin të lirë të udhëtonin jashtë shtetit duke ruajtur kështu kontaktet gjuhësore me standardin zyrtar të gjuhës greke. Për më tepër, edhe një pjesë e librave që përdorshin në shkolla, kryesisht gramatikat, ishin botime origjinale që përdorshin edhe në shtetin grek.

Pra, si përfundim, për sa i përket kësaj periudhe, në zonat e minoritetit etnik grek, s'mund të flasim për dygjuhësi.

1.2 Periudha e dytë (1945-1990)

Kjo periudhë stigmatizohet nga dy ngjarje dhe realitete të ndryshme politike, që mund të karakterizohen edhe si ngjarje kozmogonike. Shqipëria pas Luftës së Dytë Botërore përshihet në kampin socialist (1944), ndërsa më 1990 shënohet rënia e regjimit socialist-komunist dhe fillimi i rrugëtimit drejt një bote demokratike. Shteti shqiptar u izolua, pothuaj, tërësisht nga bota e jashtme. Pjesëtarëve të Minoritetit Etnik Grek si edhe gjithë popullit shqiptar iu mohuan të drejtat dhe liritë themelore bazë.

Për sa i përket arsimit, në përgjithësi, në Shqipëri dhe, në veçanti, në zonat e minoritetit etnik grek, pak muaj pas çlirimit të vendit, Ministria e Arsimit dërgon një qarkore¹²për rregullimin e disa çështjeve emergjente për arsimin fillor, sidomos për përmbajtjen e disa lëndëve që do luanin rolin më të rëndësishëm në edukimin e brezit të ri me idealet dhe vlerat e regjimit të sapolindur komunist.

Shkollat fillore deri në atë kohë funksiononin në bazë të programit të vitit 1938 me disa ndryshime që u bënë në vitin 1944. Kështu, pothuaj menjëherë pas çlirimit të vendit, në shkurt të vitit 1945, Ministria e Arsimit dërgon

¹¹Inspektori për shkollat e minoritetit grek, caktuar nga ana e qeverisë greke me qendër në Janinë, për vitin shkollor 1929-1930 bën fjalë për 62 shkolla, 65 mësues komunitarë, 19 qeveritarë dhe 2 mësues që japin vetëm gjuhën shqipe.

¹²Ministria e Arsimit, Qarkore nr. 280, Tiranë, më 21 shkurt 1945.

Qarkoren e parë me nr. 280. Kjo Qarkore 280 përbën në fakt dokumentin e parë zyrtar ku pasqyrohej realiteti i ri politik¹³.

Si edhe gjatë periudhës së parë, gjuha amtare e minoritetit ishte edhe gjuha e shkollës si edhe e botimeve të ndryshme shkollore apo jashtëshkollore. Përgjatë kësaj periudhe, pavarësisht problemeve gjuhësore në zhvillimin e së folmes së gjuhës greke në zonat e minoritetit për shkak të izolimit total nga trangu amë dhe mungesës së plotë të kontakteve gjuhësore, u përgatitën dhe u botuan librat shkollore në gjuhën greke dhe u arsimua (pavarësisht cilësisë dhe njohurive shkencore e gjuhësore) gjithë kuadri i domosdoshëm për arsimin minoritar të detyrueshëm.

Statusi i gjuhës greke në zonat minoritare ishte shprehje, nga njëra anë, e parimeve leniniste për të drejtat dhe kulturën e minoriteteve dhe, nga ana tjetër, rrjedhojë e synimeve ideologjike, propagandistike të sistemit që pretendonte të ndërtonte një shoqëri socialiste-komuniste.

Megjithë nivelin e kënaqshëm të analfabetizmit (në krahasim me zonat e tjera rurale të Shqipërisë), gjatë viteve të para të sistemit socialist u ngritën edhe në zonat e minoritetit kurse analfabetizmi për mësimin e gjuhës amtare, çka përbënte fillimisht instrumentin e nevojshëm për të përçuar te njerëzit ideologjinë komuniste, për të edukuar brezin e ri me parimet e njeriut të ri socialist. Në vazhdim, për arsye edhe të distancimit gradual të së folmes së minoritetit nga standardi zyrtar në Greqi, kjo gjuhë u përdor edhe për të formuar një lloj ndërgjegjeje të pakicat kombëtare që s'kishte lidhje me prejardhjen apo identifikimin etnik të tyre. Argument për këtë përbën vetë termi "minoritar" që për shumë dekada ka zëvendësuar ose ka venitur identifikimin etnik. Ky term, edhe për shkak të numrave të minoriteteve, ku minoriteti më i madh ishte minoriteti grek, u identifikua në njëfarë mënyre me këtë minoritet.

Gjuha greke gjatë kësaj periudhe ishte gjuha e shkollës. Lëndët për katër klasat e shkollës fillore zhvilloheshin në gjuhën amtare, vitet e para pas Çlirimit greqisht bëheshin edhe lëndët e shkollave shtatëvjeçare, por që gradualisht u zëvendësuan me lëndë në gjuhën shqipe. Nga vitet 50-të deri në vitin 1992, në arsimin e detyrueshëm (8-vjeçar) gjuha shqipe zinte përqindjen më të madhe të lëndëve. Por duhet theksuar që gjuha e komunikimit të përditshëm ishte gjuha amtare, që "pengonte" kështu mësimin e gjuhës shqipe. Gjithashtu, në zonat e thella rurale problemet e

¹³Ibid. "Nuk ka shumë ditë që shkollat fillore çelën dyert e tyre për vitin shkollor 1944-1945. Pas kaqë vjet robërie dhe lufte, populli shqiptar i këputi vargojt e fashizmit gjakatar, çporri pushtonjësit e urryer, spastroi vëndin nga armiqtë dhe tradhëtorët dhe filloi veprimtarinë e vet në të gjitha degët e aparatit shtetnor nën udhëheqjen e qeverisë demokratike. Gjithë aparati shtetnor po i përvishet punës së rindërtimit dhe të mëkëmbjes së vëndit me vullnetin dhe besimin e patundur se Atdheu i ynë, Shqipërija, do të shkojë përpara pa u ndalur, ashtu si ka qënë dhe Ideali i Heronjve të Luftës NacionalÇlirimtare...Kuptohet vetiu se në regjimin tonë demokratik s'do të ketë më vënd shkolla e vjetër, por një shkollë e re me parime të reja..."

mësimit të gjuhës shqipe ishin edhe më të dukshme, si pasojë edhe e mungesës së komunikimit me zonat urbane shqipfolëse.

Ekzistencën e problemeve, për sa i përket mësimit të gjuhës shqipe në shkollat minoritare, e dëshmon edhe një raport i seksionit të arsimit e kulturës të qarkut të Gjirokastrës i vitit 1954¹⁴. Ky raport u përpilua pas një kontrolli të organizuar nga autoritetet e Ministrisë së Arsimit në pesë shkolla shtatëvjeçare dhe pesë filllore. Në raport identifikohet gjithë problematika e mësimit të gjuhës shqipe, si edhe propozohen masa për përmirësimin e punës. Problemet fokusohen në klasat e treta dhe të katërta si edhe në vetë përgatitjen e mësuesve¹⁵. Por edhe në klasat më të larta ku lëndët bëhen të gjitha në shqip, konstatohen probleme dhe shumë gabime në të folur dhe të shkruar dhe jo në të kuptuarit e lëndës.¹⁶ Gjithashtu, raporti propozon marrjen e një sërë masash pedagogjike dhe metodike, pa harruar të nënvizojë që diçka e tillë duhet bërë problem edhe i familjes dhe organizatave të Partisë.¹⁷

¹⁴Seksioni i Arsim Kulturës Qarku Gjirokastrë, Konkluzione për gjendjen e mësimit të gjuhës shqipe në shkollat minoritare dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e punës, Gjirokastrë më 23. 3. 1954.

¹⁵“Në klasat e treta dhe të katërta nxënësit nuk kanë mësuar as minimumin e fjalëve që parashikon programa. Kjo ndodh për këto arsye: a) Mësuesit nuk e kanë parasysh programën ose nuk e studiojnë atë me kujdes dhe shpesh herë nuk e kanë fare në shkollën e tyre siç p.sh në shkollën 7-vjeçare të Cercovicës...c) nuk bëjnë përpjekje për të mësuar ata vetë gjuhën shqipe mirë për ta folur drejt dhe pa gabime të paktën në orën e mësimit. Me lehtësi më të madhe ata flasin greqisht në pjesën më të madhe të orës së mësimit të gjuhës shqipe dhe nuk dallohet mirë nëse është orë e mësimit të gjuhës shqipe apo greqisht...”

¹⁶Ibid. “d) nxënësit e të gjitha klasave të 7-vjeçares bëjnë shumë gabime në të folur dhe në të shkruar në mësimin e gjuhës dhe në hartimet dhe aq më tepër në mësimit e tjera. Bile për shkak të dobësive të gjuhës ata, me gjithë mund të dinë përmbytjen e mësimeve të lëndëve të ndryshme (e studiojnë dhe e kuptojnë me sa konstatohet) nuk janë në gjendje që ta tregojnë këtë shqip, veçse me disa fraza të thjeshta, të varfra e me mjaft gabime... Edhe në ndonjë shkollë ku kërkesat e mësuesit të gjuhës mund të jenë më të mira e më me këmbëngulje, kjo punë nuk pasohet ose të ndikohet edhe nga mësuesit e lëndëve të tjera...”

¹⁷ Ibid. “ 1. Çdo shkollë të sigurojë dhe të ruajë me kujdes programet përkatëse...zbatimi i programës në shkollë është i detyrueshëm për të gjithë, por jo vetëm si sasi, por edhe si cilësi...3. Të organizohet mirë ora e mësimit të gjuhës shqipe. Të shfrytëzohet kjo në maksimum, të jepen detyra shtëpiaje me shkrim, të cilat të kondrollohen rregullisht dhe sistematikisht. 4. Mësuesit të vejnë të gjitha përpjekjet që të flasin dhe të shkruajnë drejt e pa gabime të paktën ato gjëra që duhet t’u mësojnë nxënësve për çdo orë mësimi... 6. Të ngrihet niveli i kërkesave të mësuesvet të të gjitha lëndëve dha klasave...8. Drejtoritë e shkollave 7-vjeçare dhe arsimtarët e shkollave filllore duhet të luftojnë me çdo kush për problemin e mësimit të gjuhës shqipe, ta bëjnë problem të familjes, të organizatave bazë të Partisë, të Pushtetit dhe të organizatave të masave, duke kërkuar nga organizatat bazë të Partisë që ta marrin herë pas here në shqyrtim.”

Pas viteve 1960, me shtrirjen në vazhdim të arsimit 8-vjeçar dhe përgatitjen e mësuesve në institucionet arsimore shqiptare, zvogëlohen një pjesë e problemeve në mësimin e gjuhës shqipe, ndërsa dalin në sipërfaqe probleme serioze në mësimin e gjuhës amtare. Gjuha greke, larg zhvillimeve gjuhësore për shkak të izolimit total, por edhe në mungesë të një arsimit adekuat të mësuesve ose të faktorëve demografikë, të punësimit etj., ndjek një rrugë tkurrije. Si rrjedhojë, ekuilibri gjuhësor, sidomos në fshatrat afër zonave urbane, anon në anën e gjuhës shqipe. Gjuha greke zhvishet, pothuaj, nga funksionet e tjera duke u rrudhur e plotësuar thjesht nevojat e komunikimit të përditshëm.

1.3 Periudha e tretë (1990- në vazhdim)

Ndryshimet politike që ndodhën në Shqipëri në vitet 1990-1991, ndikuan edhe në ekuilibrat gjuhësorë në zonat minoritare greke. Në qoftë se për periudhën e dytë mund të bëjmë fjalë për një ekuilibër dygjuhësor (duke pasur parasysh të gjitha rrafshet dhe funksionet e gjuhës) që anonte nga gjuha e shumicës që ishte dhe gjuha e vetme zyrtare, gjatë kësaj periudhe dhe vit pas viti, vërehet e kundërta. Dallohen prirje ku ekuilibri gjuhësor anon nga ana e gjuhës së pakicës. Arsyet janë më tepër se gjuhësore.

Me ndryshimet politike, me hapjen e Shqipërisë drejt botës së jashtme, me prioritetet për punësim dhe jetë më të mirë të të gjithë shtetasve shqiptarë, pavarësisht prejardhjes etnike, u krijuan realitete të reja që nuk i lanë jashtë as ekuilibrat gjuhësore në zonat e kontaktit midis gjuhës greke dhe asaj shqipe. Në këtë rast kur them për zona kontakti, nuk i kufizojmë këto në zonat kompakte ku tradicionalisht banon minoriteti etnik grek.

Gjithashtu, ndryshimi i ekuilibrit dygjuhësor erdhi dhe si pasojë e zhvillimeve të reja demokratike dhe e kërkesave të vazhdueshme të minoritetit etnik grek për zgjerimin e përdorimit të gjuhës dhe hapjen e shkollave të reja. Paralelisht, shteti shqiptar, duke u bërë pjesë e institucioneve europiane dhe ndërkombëtare, filloi të aplikonte një politikë tjetër për sa u përket të drejtave gjuhësore dhe arsimore të pakicave kombëtare.

Kështu e drejta e gjuhës dhe e arsimit u mishërua edhe në Dispozitat Kushtetuese të prillit 1991¹⁸, por edhe më vonë në Kushtetutë.¹⁹ Paralelisht u

¹⁸Ligji Nr. 7491, datë 29.4.1991, Për dispozitat Kryesore Kushtetuese, Neni 4: Republika e Shqipërisë njeh dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të pakicave kombëtare, të pranuar në dokumentat ndërkombëtare.

¹⁹Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 20: 1. Personat që u përkasin pakicave kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë para ligjit të drejtat dhe liritë e tyre. 2. Ata kanë të drejtë të shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore. Ata kanë të drejtë t'i ruajnë e zhvillojnë ato, të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare, si dhe të bashkohen në organizata e shoqata për mbrojtjen e interesave dhe të identitetit të tyre.

njohën ose u ratifikuan, duke u bërë në këtë mënyrë pjesë e legjislacionit të brendshëm, shumë konventa ndërkombëtare në lidhje me standardet e respektimit të të drejtave të pakicave.²⁰

Kështu, ndërsa para viteve 90-të raporti gjuhë greke –gjuhë shqipe ishte në favor të gjuhës shqipe, pas viteve 90-të përftohet një raport tjetër. Këto raporte përcaktohen nga Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit²¹, raporte që janë në fuqi akoma dhe sot. Në ciklin e lartë të shkollës 8-vjeçare (vitet e fundit 9-vjeçare) lëndët zhvillohen në raportin 58% për gjuhën amtare dhe 42% për gjuhën shqipe, ndërsa në ciklin e parë fillor (njëlloj si në periudhën e dytë 1945-1990) të gjitha lëndët zhvillohen në gjuhën greke, përveç 30 orëve “Lexim e gjuhë shqipe”.

2. Planifikimi gjuhësor dhe “standardizimi i gjuhës minoritare greke”

Pas Luftës së Dytë Botërore, komuniteti greqishtfolës në jug të vendit u shkëput si me thikë nga kontaktet shoqërore, kulturore, arsimore dhe njerëzore që kishte zhvilluar me bashkëkombësit në shtetin grek. Kjo shkëputje, ky izolim total, pashmangshmërisht do çonte në zhvillime specifike gjuhësore dhe në thellësi kohe në kahun negativ. Sistemi i ri politiko-shoqëror pas viteve 1945, në zbatim rigoroz të doktrinës marksiste-leniniste-staliniste për sa u përket çështjeve gjuhësore, por edhe trajtimit të çështjeve që kishin lidhje me gjuhët e kombeve të tjera, në rastin e Shqipërisë, të minoriteteve të njohura prej saj, ndoqi një politikë gjuhësore në përshtatje me synimet konkrete politike dhe ideologjike të sistemit komunist. Për të folmen e minoritetit grek konstatojmë një përkrahje, një politikë, pra, që e kishte zanafillën në parimet ideologjike komuniste, por edhe në nevojat konkrete të elitës sunduese për transmetimin e mesazheve ideologjike dhe formimin e “njeriut të ri socialist”. Për më tepër, zonat e banuara nga minoritarë “rrezikonin” më shumë nga ideologjia borgjeze-kapitaliste për shkak të lidhjeve me Greqinë fqinje.

Shkollat minoritare gjatë viteve të para pas çlirimit, punonin ende me libra shkollorë të paraluftës, të botuara në Greqi. Gjuha e këtyre librave (bëhet fjalë për shkollat fillore) ishte gjuha “Dhimotiki”, e njëjta formë gjuhësore që mbizotëronte në sistemin arsimor grek të paraluftës.²² Kjo formë e

²⁰Ligji Nr. 8496 datë 03.06.1999, Për ratifikimin e “Konventës kuadër të Këshillit të Europës për mbrojtjen e minoriteteve”.

²¹Udhëzimi nr. 14 i Ministrisë së Arsimit, datë 3.9.1994.

²²Duhet nënvizuar se pas vendosjes së komunizmit në Shqipëri dhe sidomos pas viteve 50, një burim tjetër literature në gjuhën greke ishin edhe librat me karakter letrar ose politik ideologjik që vinin të përkthyer në gjuhën greke nga Bashkimi Sovjetik. Në atë kohë një pjesë e madhe e intelektualëve të majtë grekë, pas përfundimit të luftës civile greke u vendosën në vendet e ish-demokracive popullore të Lindjes, dhe kryesisht në B.S. Kështu një pjesë e literaturës marksiste, por edhe e

fosilizuar do mbizotëronte në vazhdim, pothuaj, deri në fillim të viteve 90. Nevoja për libra për gjuhën amtare dolën në sipërfaqe që gjatë vitit shkollor 1945-1946, megjithëse në krahasim me pjesën tjetër të Shqipërisë situata në zonat jugore ku përmbledheshin dha ato minoritare, ishte më e mirë si nga tekstet apo ndërtesat shkollore. Në fund të vitit shkollor 1945-1946, në një raport që seksioni i arsimit të prefekturës së Gjirokastrës i dërgonte Ministrisë së Arsimit, për herë të parë bëhet fjalë për nevojën e përgatitjes së librave dhe mësuesve²³.

Bibliografi:

Dajo S., Janinë 2022, Dimensioni i vërtetë i abstenimit arsimor të bardhë, beteja ligjore e B/H-ve dhe shfarosja e protagonistëve(1925-1945), titulli i origjinalit, Βορειοηπειρωτικά, Ηαληθινήδιάστασητηςγλεγκικήςεκπαιδευτικήςαποχής,οδικαστικόςαγώναςτωνΒ/Ητωνκ αιεξολόθρευσητωνπρωταγωνιστών(1925-1945).

Papadopoulos G. Minoriteti Etnik Grek në Shqipëri dhe çështja e tij arsimore, Botimi IBE, Janinë 1981.

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH).

veprave letrare bolshevike u përkthyen në gjuhën greke, literaturë me të cilën u furnizuan edhe intelektualët minoritarë grekë në Shqipëri.

²³“Për një organizim më të mirë të shkollave Minoritare çfaqim mendimin: a) Pranë seksionit t’ Arsimit të Prefekturës t emërohet një sekretar daktilografist që të dijë ty gjuhët për përkthime mësimesh, broshurash, rivistash, si është Bujku i Ri, Pionieri, që kështu t’ u jipet mësuesve lënda e nevojshme, b) Të formohet pranë seksionit t’ Arsimit të Prefekturës një komision mësuesish minoritarë për përpilim librash këndimi si dhe për shqyrtimin e lëndës së Historisë që do mësohet nëpër shkolla të Minoritetit, c) të hapet një kurs pedagogjik për gjithë ata mësues që nuk janë të karrierës... ASHV. V. 1945, Dosja 180, fl.3.

EDUKIMI NË MINORITETIN ETNIK GREK NË DITËT E SOTME, STRUKTURA DHE KARAKTERISTIKAT E TIJ

Evanthia Baruta¹, Sofia Delijorgji², Edlira Çimi³

¹Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek, Universiteti “Eqrem Çabej”

e-mail: evanthiabaruta@gmail.com

²Departamenti i Gjuhës Greke, Universiteti i Tiranës

³Mësuese, Shkolla “Pandeli Sotiri”

e-mail: edliracimi2020@gmail.com

Abstrakt

Edukimi në Minoritetin Etnik Grek në ditët e sotme përbën një sfidë të rëndësishme, që kërkon politika të gjithanshme dhe të adresuara në mënyrë të mirëfilltë drejt nevojave të këtij komuniteti. Përmes këtij artikulli do të bëhet një prezantim i përgjithshëm i gjendjes aktuale të arsimit në gjuhën greke të Minoritetit Etnik Grek në Shqipëri. Në vijimësi do të përqendrohemi në shkollat që funksionojnë në Minoritet dhe, kryesisht, te veçoritë e tyre dhe mënyrën e funksionimit. Gjithashtu, do t'u referohemi programeve analitike të detajuara e të ndërhuara për të arritur qëllimet e mësimdhënies dhe të mësimnxënies në të gjitha lëndët që zhvillohen në këto shkolla, si edhe zbatimin e tyre duke iu përshtatur kurrikulave të reja. Pjesë e këtij artikulli do të jetë përshkrimi në mënyrë të detajuar i stafit arsimor të këtyre shkollave, si dhe do të përmenden seminarët trajnuese që janë bërë dhe vazhdojnë të zhvillohen për formimin dhe ngritjen e mësuesve nga ana profesionale, për të qenë të përgatitur në lidhje me zbatimin e kurrikulave të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Çështja e fundit që do të trajtojmë, është gjendja aktuale e potencialit të nxënësve nëpër shkolla dhe diversiteti i tyre.

***Fjalë kyçe:** arsimi, minoriteti, shkollë, nxënës, stafit arsimor*

Abstract

Nowadays, the Education in the Greek Minority of Albania constitutes an important challenge, requiring comprehensive and well-addressed policies towards the needs of this community. Through this article, a general presentation of the current state of education in the Greek language of the Greek Minority in Albania will be made. Subsequently, we will focus on the schools that operate within the Minority, primarily on their characteristics and the way they function. Additionally, we will refer to the detailed analytical programs designed to achieve the teaching and learning goals in all subjects developed in these schools, as well as their implementation in accordance with the new curricula. Part of this article will include a detailed description of the educational staff of these schools, as well as mention the training seminars that have been and continue to be conducted for the professional development and improvement of teachers to be prepared concerning the implementation of the curricula of the Ministry of

Education and Sports. The final issue we will address is the current state of student potential in schools and their diversity.

Key words: *education, minority, school, student, educational staff*

1. Hyrje

Arsimi në gjuhën greke në Shqipëri është i lidhur drejtpërdrejt me praninë historike të Minoritetit Etnik Grek. Që nga krijimi i shtetit shqiptar (1912) e deri më sot, njihet me ligj ekzistenca e **Minoritetit Etnik Grek (MEG)**, i cili jeton në jug të vendit, duke iu njohur të gjitha të drejtat që i takojnë si pakicë kombëtare. Nga ana tjetër, ky komunitet është në përpjekje të vazhdueshme për mbijetesë të qetë, duke kërkuar politika të përshtashme, funksionale dhe frytdhënëse për ruajtjen e identitetit kombëtar dhe kulturor si dhe të drejtën e arsimimit në gjuhën amtare.

Pak vite pas Luftës së Parë Botërore, Shqipëria mori përsipër njohjen dhe respektimin e të drejtave të minoritetit grek (Protokolli i Kapesticës-1920), të cilin e njohu zyrtarisht me hyrjen e saj në Lidhjen e Kombeve (1920) si pakicë kombëtare, duke iu njohur e drejta e besimit fetar dhe e përdorimit të gjuhës amtare greke.

Në lidhje me edukimin në gjuhën amtare në MEG, deri në Luftën e Dytë Botërore ekzistonte një gjendje paqëndrueshmërie, parë kjo në lidhje me zbatimin e ligjit për minoritetin, pasi shpeshherë bëheshin shkelje të marrëveshjeve të bëra për të drejtat e anëtarëve të këtij komuniteti. Konflikti më i madh ndodhi në vitin 1934, i cili çoi në mbylljen e të gjitha shkollave greke në Shqipëri, (Υφαντής, 2006). Anëtarët e MEG-ut reagueshan me mënyra të ndryshme dhe Këshilli i Kombeve të Bashkuara e dërgoi çështjen në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë, ku iu dha e drejta Minoritetit Grek, (Μιχαλόπουλος, 1992) kështu që qeveria shqiptare u detyrua (1935-1936) të rihapte shkollat greke në zonën e Minoritetit (Υφαντής, 2006).

Me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore, qeverisja e Shqipërisë i kaloi regjimit komunist të Enver Hoxhës. Ky fakt pati pasoja negative në jetën e minoritetit grek. Menaxhimi dhe trajtimi i pakicës greke nga regjimi komunist synonte në shumicën e rasteve tjetërsimin e ndërgjegjes së tyre kombëtare, me qëllimin përfundimtar përforsimin e vendit.

Konkretisht, regjimi komunist ndoqi një politikë agresive në kurriz të popullatës greke, me arrestime në grup, internime dhe burgosje. Detyroheshin familje të tëra të shkuleshin nga vendlindja dhe të zhvendoseshin në veri të Shqipërisë dhe anasjelltas për të ndryshuar demografikisht dhe etnikisht teritorin ku jetonte komuniteti grek. (Πόλιου, 2021)

Gjithashtu, duke u përpjekur të imponojë ideologjinë e shtetit, u bënë përpjekje për kufizimin e diversitetit fetar, që mbizotëronte në Shqipëri,

duke promovuar tipin e "njeriut të ri socialist".¹ Për sa i përket mënyrës së trajtimit të minoritetit grek, regjimi komunist, edhe pse e njihte me kushtetutë praninë e tij, vazhdoi të shkelte të drejtat e këtij komuniteti (Μάρκας, 2003). Gjatë kësaj periudhe, arsimi u orientua drejt ndërtimit të një shoqërie socialiste (Γεωργούλης, 1995; Μαλκίδης, 2011). Ky fenomen vazhdoi deri në rënien e regjimit diktatorial në vitin 1990.

Ndryshimi i pushtetit në Shqipëri u shoqërua me rënien e komunizmit dhe vendosjen e demokracisë (1990-1991). Tranzicioni politik dhe shoqëror i vendit ndikoi si në jetën e minoritetit grek, ashtu edhe në arsimimin në gjuhën amtare greke.

Tsitselikis (2003) thekson se në periudhën pas vitit 1990, sistemi arsimor i pushtetit totalitar të Hoxhës u vu në pikëpyetje, kështu që u kërkua një model i ri arsimimi i minoriteteve bazuar në standardet evropiane, ndërkohë që kadri ligjor i arsimimit të pakicave kombëtare u ndikua nga faktorë të ndryshëm.

Nga viti 1990 e deri më sot, arsimi i minoritetit ka kaluar nëpër reforma të vazhdueshme dhe kufizime nga pala shqiptare. Nga ana tjetër, përfaqësuesit dhe organizatat politike të MEG-ut kanë ushtruar trysni kundrejt organeve përkatëse për zbatimin me rigorozitet të së drejtës së tyre për arsimim. Presioni i ushtruar ndaj Shqipërisë nga vetë minoriteti, por kryesisht nga organizatat ndërkombëtare, çoi në përmirësimin e kadrut ligjor (Τσιτσελίκης, 2003). Rol të rëndësishëm luajti greva e përgjithshme e shtatorit 1991 me kërkesat themelore:

- zhvillimi i të gjitha mësimëve në këto shkolla vetëm në gjuhën amtare,
- hapja e shkollave greke në fshatrat me popullsi të përzier që ishin krijuar gjatë regjimit komunist brenda këtyre zonave,
- hapja e shkollave të ngjashme kudo në vend ku jetonin grekë dhe plotësohen kushtet e parashikuara,
- përfshirja e lëndëve të Historisë dhe Gjeografisë së Greqisë në programet mësimore si lëndë më vete.²

Si rrjedhojë e këtyre presioneve, greqishtja u rikthye si gjuhë bazë e mësimdhënies edhe në ciklin e dytë të arsimit të detyrueshëm (klasat 5-8), me përjashtim të lëndëve shkencore (1994), ndërsa në shkollat e mesme minoritare (klasat 9-10), orët e mësimit të gjuhës greke u rritën nga dy në katër orë (1996). Gjeografia dhe Historia e Greqisë u prezantuan si lëndë të veçanta. U hapën shkolla greke në të gjitha fshatrat me popullsi të përzier që janë krijuar në zonën minoritare. Pas vitit 1996 u krijuan zyrtarisht klasat në gjuhën amtare në qytetet Gjirokastër, Delvinë dhe Sarandë.

Faktor frenues në arsimin e MEG-ut ishte emigrimi masiv i popullsisë pas vitit 1991, i cili çoi në kufizimin e popullsisë së pakicës, reduktimin e madh të numrit të nxënësve duke çuar në mbylljen e mëvonshme të shkollave të

¹ Barkas, P. (2003), «Η Ελληνική Μειονότητα επί καθεστώτος Χότζα» në Τσιτσελίκης, Κ. & Χριστόπουλος, Δ.(επιμ.), *Η Ελληνική Μειονότητα της Αλβανίας*, (Αθήνα: Εκδόσεις Κριτική & ΚΕΜΟ), f.. 226.

² Studimi për arsimin në MEG.

minoritetit. Nga ana tjetër, nxënësit me origjinë greke, që jetonin jashtë zonave të caktuara minoritare, ndiqnin shkollat shqipe për shkak të mos ekzistencës së shkollave në gjuhën amtare. (Σαράβανης, 2017)

Arsimi në gjuhën greke i MEG-ut përballet edhe sot me shumë probleme, nisur fillimisht me tkurrjen e popullsisë që ka sjellë, nga njëra anë, reduktimin e theksuar të numrit të nxënësve duke u bërë shkak për mbylljen e disa shkollave fillore dhe nëntëvjeçare dhe, nga ana tjetër, mungesën e stafit didaktik të specializuar, si rrjedhojë, disa mësues mbulojnë lëndë për të cilat nuk kanë studime analoge, por të përafërta.

Në Arsimin Parauniversitar në gjuhën greke, sot funksionojnë 18 shkolla publike në të gjithë rajonin e MEG-ut në tri bashki:

5 shkolla të arsimit fillor, klasa I – V, në qytetin e Delvinës, Dërmish, Çukë, Karahaxhi, Dhrovian;

9 shkolla nëntëvjeçare, klasa I – IX, në qytetin e Gjirokastrës, në Dervician, në Bularat, në qytetin e Sarandës, në Aliko, Livadhja, Finiq, Mesopotam, Navaricë;

4 shkolla të arsimit të mesëm të lartë, klasa X – XII, që funksionojnë si shkolla të bashkuara, nga klasa I – XII, në qytetin e Gjirokastrës, Dervician, Bularat dhe Livadhja.

2. Karakteristikat e planprogrameve

Arsimi në minoritetin grek ndjek kornizën kurrikulare të sistemit arsimor shqiptar. Programi i mësimdhënies në shkollat e pakicave kombëtare greke dhe raporti i lëndëve midis gjuhës greke dhe shqipe në tri ciklet e arsimit janë të strukturuar si më poshtë:

a) Cikli i parë, AF klasa I – V, të gjitha lëndët zhvillohen në gjuhën greke, kurse gjuha shqipe mësohet si gjuhë e dytë me 5 orë në javë.

b) Cikli i dytë, AMU klasa VI – IX, mësimi në gjuhën greke zhvillohet në 58% të lëndëve, ndërsa pjesa tjetër 42% zhvillohet në gjuhën shqipe.

c) Cikli i tretë, AML klasa X – XII, mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, ndërsa greqishtja si gjuhë e dytë në të tri klasat me dy ose katër orë në javë.

Programet analitike janë hartuar nga ekspertë të secilës fushë nën mbikqyrjen e Ministrisë së Arsimit. Ato janë hartuar në vitin 2015, një vit pas zbatimit të Reformës në Arsimin kombëtar. Hartohen në gjuhën shqipe, por janë përshtatur me interesat dhe nevojat akademike dhe sociale të nxënësve minoritarë.

Mbështetur në kurrikulat e reja dhe duke ndjekur udhëzimet e duhura, mësuesit mund të ndryshojnë klimën e shkollës, të përdorin mënyra dhe mjete të reja në mënyrë që klasa të zhvillohet në një laborator kërkimi, komunikimi, veprimi dhe shprehjeje, i cili i shtyn nxënësit të punojnë për të realizuar: bashkëpunimin, vetëdijen, ndërgjegjësimin gjuhësor, aftësitë e komunikimit, përgjegjësinë, tolerancën, disiplinën, ndjenjën e drejtësisë, ndjeshmërinë demokratike, rivalitetin, solidaritetin, kultivimin estetik, zgjidhjen e problemeve, mësimin eksplorues dhe kompetencën dixhitale.

Planprogramet ose programet e studimit përcaktojnë qëllimet dhe objektivat e lëndëve, përmbajtjen e mësimnxënies, metodologjinë e mësimdhënies dhe

format dhe llojet e vlerësimit. Bazuar në këto, hartohen tekstet mësimore dhe formulohen udhëzimet e mësimdhënies. Plani mësimor është një dokument i rëndësishëm, i cili orienton shkollën për organizimin e procesit mësimor, në nivel shkolle, shkalle dhe klase (Baruta, 2023). Në vitin 2014, Shqipëria iu nënshtua një reforme arsimore dhe ajo përparoi gradualisht nga viti në vit derisa u përfundua në vitin 2019 ku u hoqën planprogramet e veçanta për secilën lëndë dhe u vendos Kurrikula me bazë kompetencat dhe ndërveprim të fushave.

Planprogrami bashkëkohor, (Kurrikula) konsiderohet si një udhëzues i plotë mësimor (Γεωργογιάννης, Μπούρας, 2007). Ajo përfshin, përveç materialit mësimor edhe qëllimet e përgjithshme të arsimit, si dhe një sasi elementesh të tjera të dobishme për mësuesit dhe nxënësit, të tilla si objektivat e përgjithshme dhe specifike të çdo lënde, sugjerimet metodologjike dhe mundësitë e përdorimit të mjeteve mësimore etj. Të gjitha këto elemente i lejojnë mësuesit të kenë fleksibilitet si në arritjen e qëllimeve dhe objektiveve të synuara të mësimdhënies së njëzive të veçanta mësimore, ashtu edhe në vlerësimin e nxënësve.

Sipas studimit për arsimin në MEG, nga departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Greke, të realizuar në vitin 2015, ka pasur probleme të shumta lidhur me planprogramet, si:

- mungesa e planprogrameve për çdo lëndë,
- përmbajtja e planprogrameve nuk ishte në përputhje me përmbajtjen e librave,
- metodologjia e planprogrameve nuk ishte e mjaftueshme etj.

Pas reformës së 2014-ës, të dhënat ndryshuan si për programet mësimore ashtu edhe për tekstet shkollore. Fillimisht, le të theksojmë këtu se tani ekziston program analitik për çdo lëndë kryesore, si dhe për lëndët “Gjuha amtare”, “Historia” dhe “Gjeografia e Greqisë”.

Pjesë e grupit të hartimit të programeve ishin edhe anëtarë të departamentit të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek të Universitetit të Gjirokastrës. Planprogramet e reja për çdo lëndë u përgjigjen kërkesave të kohës dhe pasqyrojnë të gjitha ndryshimet, si në rrafshin social, ashtu edhe në atë pedagogjik.

Planprogramet e reja kanë si pikënisje rezultatet e të nxënit, pra, gjithçka që nxënësi duhet të dijë, të kuptojë dhe të jetë në gjendje të aplikojë pas përfundimit të çdo procesi mësimor. Theksi kalon nga lënda, mësuesi dhe procesi i mësimdhënies, te nxënësi dhe te rezultatet e pritura të të nxënit. Prandaj kërkohet si thelb në këtë drejtim projektimi, ku baza e projektimit, të jenë rezultatet e të nxënit dhe të gjithë parametrat e tjerë të mësimnxënies.

Mësimdhënia e lëndëve në gjuhën amtare tashmë siguron dhe forcon identitetin kombëtar të nxënësve, pasi me ligj mësohet jo vetëm Historia dhe Gjeografia e Shqipërisë, por edhe Historia dhe Gjeografia e Greqisë.

3. Tekstet shkollore

Interes paraqet edhe çështja e teksteve shkollore përmes të cilave realizohet programi analitik i lëndëve. Teksti shkollor është një mjet mësimor në formë

të shtypur, i projektuar për nxënësit e shkollës, që përfshin kurrikulën e një lënde, të një klase dhe të një niveli arsimor të caktuar dhe u shërben nevojave të procesit arsimor. Ky mjet përdoret nga nxënësi, mësuesi dhe prindi. Ministria e Arsimit është përgjegjëse për miratimin e tij, për aq kohë sa ai përmbush kërkesat dhe pritshmëritë e programit analitik. (Βουγιούκας 1985, Καψάλης & Χαραλάμπους 1995, Ξωχέλλης 2005).

Elementet kryesore të strukturës së teksteve shkollore janë paraqitja e materialit mësimor nëpërmjet tekstit, ilustrimeve, tabelave etj, që është pjesa më themelore dhe më e madhe. Gjithashtu, parë nga ana ndërtimore, përzgjedhja e temave, gjuha e përshtatshme për grupmoshat, përkufizimet, konceptet, formulat dhe rregullat, duhet të bëhen të kuptueshme përmes mësimdhënies, detyrave dhe shpjegimeve të dobishme në strukturën e tekstit shkollor (Καψάλης & Χαραλάμπους, 1995).

Që nga viti 2014, pas hartimit dhe publikimit të programeve analitike të reja, filloi procesi i hartimit të teksteve të reja shkollore për arsimin e detyruar. Instituti i zhvillimit të arsimit me partner kryesor departamentin e Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek të UGJ-së merr përsipër realizimin e të gjitha procedurave për hartimin dhe vlerësimin e teksteve shkollore. Përmbajtja e tyre është përshtatur me objektivat e programeve analitike, që nxjerrin në pah vlerat universale dhe ndërkulturore, përmes të cilave do të kultivohet identiteti etnik dhe ndërgjegjja e qytetarit të botës.

3.1 Veçoritë e teksteve shkollore të shkollave të MEG-ut

Nisur nga ndryshimet e bëra në kurrikulën e re për programet mësimore, u bënë ndryshimet e duhura për të gjetur zbatim edhe në tekstet e reja shkollore. Për herë të parë dhe pas shumë përpjekjesh, procesi i hartimit të teksteve iu besua stafit akademik të departamentit të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek të universitetit të Gjirokastrës, si institucioni më i përshtatshëm në vend, për realizimin e këtij projekti. Ky departament përgatit mësues të cilët më pas bëhen personeli didaktik i shkollave në MEG, si në ato publike, edhe private. (Ξέρρα & Μπαρούτα, 2022)

Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve, personeli akademik i Departamentit, në bashkëpunim me specialistë të fushave përkatëse, morën përsipër hartimin e librave "Gjuhë amtare" për klasat 1-9, si dhe Historinë e Greqisë për klasën e 9-të dhe Gjeografinë e Greqisë për klasën e 8-të. Pjesë e veçantë ishin edhe përkthimet e teksteve me përmbajtje shkencore, si: Matematikë, Dituri natyre dhe Biologji. Vëmendje iu kushtua mësimëve me përmbajtje sociale (Qytetari, Edukim figurativ, Edukim muzikor), të cilat u përkthyen dhe u përshtatën për nxënësit e MEG-ut, duke kultivuar nëpërmjet tyre ndërgjegjen kombëtare dhe shoqërore të fëmijëve.

Me fjalë të tjera, shohim se hartimi i librave për shkollat publike në MEG tani i është caktuar një institucioni kompetent koordinues, i cili mobilizon dhe bashkërendon kontributin e individëve dhe ekspertëve kompetentë, në mënyrë që librat të jenë produkt konsultimi, diskutimi, krahasimi. Në tekstet e reja për lëndën e Gjuhës amtare, vëmë re se për herë të parë po bëhet një përpjekje e jashtëzakonshme për përmirësimin e nivelit të mësimdhënies së

gjuhës greke. Librat kanë si qëllim t'u përgjigjen kushteve të sotme shoqërore duke përfshirë tekste bashkëkohore dhe koncepte të përshtatshme për çdo grupmoshë, të cilat nxënësi i ndesh në përditshmërinë e tij. Parë në këtë drejtim gjejmë përdorim të një fjalori të pasur dhe gjithëpërfshirës, ilustrime të përshtatshme si dhe shpjegim të thelluar të dukurive gramatikore.

Konkretisht, librat përfshijnë të gjitha llojet e teksteve, si: tekste letrare (duke përfshirë autorë grekë, shqiptarë, të huaj si dhe anëtarë të MEG-ut), letra, artikuj, ese, tekste nga gazeta, nga guida turistike, nga faqe të internetit etj. .

Autorët e librave janë përpjekur që tekstet shkollore të reja të përfshijnë sa më shumë tema me përmbajtje shoqërore, kulturore dhe natyrore të mjedisit ku jetojnë nxënësit. Kujdes i veçantë u tregua nga grupi i hartimit, që librat të përfshijnë tema nga mitologjia greke, në mënyrë që fëmijët të kenë njohuri të qëndrueshme rreth saj, sepse programet mësimore nuk parashikojnë mësimin në veçanti të mitologjisë, e cila është një fushë me interes të veçantë për nxënësit. (Ξέρρα & Παρούτα, 2022)

Risi që vihet re në tekstet e reja shkollore, është mënyra e paraqitjes së fenomeneve gramatikore, të cilat prezantohen fillimisht nëpërmjet përfshirjes së tyre në pjesën e teksteve, ku në vazhdim nxënësi identifikon fenomenin gramatikor dhe më pas kalon në interpretimin e tij. Pra, çdo fenomen mësohet në mënyrë funksionale me struktura gramatikore në kontekst, me qëllim përvetësimin dhe përdorimin e saktë të gjuhës.

Së fundmi, në tekstet e reja shkollore u identifikuan përpjekjet për përmirësimin e fjalorit si nëpërmjet përzgjedhjes së teksteve, ashtu edhe përmes ushtrimeve të ndryshme gjuhësore, për ta pasuruar fjalorin aktiv dhe pasiv të nxënësve, duke qenë se në rajonin tonë përdorim idiomën e Dropullit, me devijime të vogla nga gjuha standarde greke.

Çështje e rëndësishme që mbeti jashtë vëmendjes së IZHA-s, është sigurimi i librit të mësuesit dhe i fletores së punës për nxënësit, të cilat janë elemente të domosdoshme në procesin mësimor. Shpresojmë që ato të realizohen sa më shpejt, pasi mungesa e tyre vështirëson si nxënësit, të cilët nuk kanë detyra shtesë për të konsoliduar më mirë njohuritë e marra për gjuhën, ashtu edhe mësuesit që analizojnë dhe zhvillojnë vetë çdo mësim pa udhëzime specifike.

Në një fazë të mëvonshme duhet të zgjidhet edhe çështja e hartimit të teksteve për lëndët e dyta në ciklin e parë të studimeve, për lëndën e Edukimit figurativ, Edukimit fizik, Edukimit muzikor. Problem i theksuar qëndron ende edhe sigurimi i teksteve për mësimin e gjuhës greke në shkollat e mesme, AML, që funksionojnë në zonën e minoritetit. Është e momentit të theksohet mosekzistenca e asnjë teksti në gjuhën amtare në programet mesimore që zhvillohen në të vetmen shkollë të mesme në gjuhën amtare greke, AML, që është vazhdimi i ish-shkollës Pedagogjike në Gjirokastër.

4. Staf i arsimit dhe trajnimi i mësuesve

Duke u ndalur në veçoritë e stafit pedagogjik vërejmë se pjesa më e madhe e mësuesve të shkollave në MEG, kryesisht në ciklin e parë, AF, si dhe në lëndët gjuhësore dhe përmbajtjes sociale të ciklit të dytë, AMU, janë të diplomuar në departamentin e Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek të universitetit të Gjirokastrës. Ata janë me origjinë greke, të kualifikuar nga ana didaktike, në bazë të metodave të reja dhe mësimdhënies bashkëkohore. Shumica e mësuesve kanë ndjekur të dy programet e studimit të departamentit, pra, programin “Bachelor në gjuhë, letërsi dhe qytetërim grek”, si dhe programin “Master në AMU” (Master për arsimin e mesëm të ulët në gjuhë, letërsi dhe qytetërim grek).

Lëndët e departamentit mbulojnë tri fusha: gjuhën, letërsinë dhe kulturën greke. Në këto fusha ofrohen lëndë për mësimin e gjuhës dhe didaktikën, gjuhësinë, leksikologjinë, semantikën, gramatikën historike, letërsinë dhe mësimdhënien e letërsisë, që nga letërsia antike deri në atë moderne, si dhe lëndë të kulturës antike dhe moderne. Pas përfundimit të programit “Master në AMU”, mësuesit janë të kualifikuar për mësimdhënie në lëndët gjuhësore dhe sociale.

Të paplotësuar mbeten vendet e mësuesve në ciklin e dytë të studimeve, AMU, për lëndët shkencore, problem ky i krijuar vitet e fundit, pasi mësuesit e dikurshëm tashmë janë pensionistë. Për t’i dhënë zgjidhje kësaj gjendjeje, propozojmë përthithjen e mësuesve, në specialitetet që mungojnë, nga Greqia. Vlen të përmendet se kjo mënyre përdoret në shkollat private, pas një marrëveshjeje me Ministrinë e Arsimit të Shqipërisë, duke u ofruar punë studentëve nga MEG, që kanë mbaruar studimet në Greqi në degët e kërkuara.

4.1 Trajnimi i mësuesve

Ngritja profesionale e mësuesve dhe trajnimi i tyre është prioritet për kurrikulat e reja. Mavrojorgos (1983) e përkufizon trajnimin e mësuesve si: “... tërësia e kopetencave dhe aktiviteteve që miratohen dhe zbatohen me qëllim parësor ose ekskluziv të përmirësimit dhe zhvillimit të mëtejshëm akademik dhe profesional, të njohurive praktike dhe teorike të lidhura me aftësitë dhe interesat e mësuesve gjatë periudhës së tyre si mësues”. Duke pranuar këndvështrimin se mësuesi është protagonist në procesin mësimor, për rrjedhojë, mënyra e trajnimit të tij përcakton arritjen e qëllimeve dhe objektivave të përgjithshme të vetë arsimit, çdo akt edukativ mund ta konsiderojmë si një element kyç të konsolidimit të tij profesional.³

Në kuadrin e një marrëveshjeje dypalëshe midis Greqisë dhe Shqipërisë, që nga viti 1998, Greqia mori përsipër të ndihmojë arsimin e minoritetit në fushat që lidhen me trajnimin e mësuesve dhe përmirësimin e cilësisë së teksteve shkollore (Βούρη & Καψάλης, 2003). Universiteti i Gjirokastrës dhe veçanërisht DGJLQGr-ja, në bashkëpunim me universitete të ndryshme

³ https://www.pre.aegean.gr/wp-content/uploads/2017/02/15.Fouzas_PTDE_PhD_2017.pdf

nga Greqia, ka intensifikuar seminarat trajnuese në fushën e gjuhës dhe të mësimdhënies. Seminarat e para trajnuese u zhvilluan në bashkëpunim me universitetin e Janinës dhe ndihmën e çmuar të Z. Georgios Kapsalis dhe kolegëve të tij.

Më pas u realizuan seminare kualifikimi në lidhje me programet edukative në bashkëpunim me universitetin e Maqedonisë Perëndimore përmes znj. Eleni Griva dhe kolegëve të saj. Vlen të përmendim seminarin e trajnimit online që zgjati gjashtë muaj dhe në të cilin morën pjesë të gjithë mësuesit e shkollave publike në MEG.

Duhet të theksojmë këtu se në tri vitet e fundit universiteti i Gjirokastrës ka fituar të drejtën nga Ministria e Arsimit për të kualifikuar mësuesit në module të ndryshme, si në mësimdhënien e gjuhës, ashtu edhe në modulet e çështjeve sociale. Këto module ndiqen intensivisht nga mësuesit e MEG-ut. Trajnimet i ndihmojnë mësuesit në mësimdhënien e lëndëve nga shumë këndvështrime nga ana metodologjike, pedagogjike, në pasurimin e fjalorit dhe aftësimin e tyre për të zbatuar kurrikulat e reja.

5. Kontigjenti i nxënësve në shkollat e MEG-ut

Numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollat e MEG-ut në AF, AMU dhe AML, në të tria së bashku është gjithsej 766 nxënës. Kontigjenti i nxënësve përbëhet kryesisht nga fëmijë me origjinë greke, anëtarë të MEG-ut, gjuha amtare e të cilëve është greqishtja. Pjesa tjetër e nxënësve janë me origjinë shqiptare (gjuha amtare është shqipja) dhe gjuhë e dytë greqishtja. Shumica e këtyre nxënësve kanë zgjedhur të ndjekin shkollat në gjuhën greke me synim ndjekjen e studimeve universitare në Greqi në të ardhmen.

Ky diversitet që është krijuar në shkollat e minoritetit ka arsye të shumta si: kthimi i shumë familjeve me origjinë shqiptare nga Greqia, fëmijët e të cilave njohin më mirë gjuhën greke ose në shumë raste vetëm greqishten. Pjesë e këtij grupi janë edhe nxënës të familjeve shqiptare që punojnë në fshatrat minoritare greke apo nga fshatrat fqinje shqiptare dhe zgjedhin të ndjekin shkollat e minoritetit grek.

Gjithashtu, vlen të theksohet se fëmijët që kthehen nga Greqia përballen me vështirësi për t'u përshtatur me sistemin arsimor publik shqiptar, gjë që vjen për shkak të mentalitetit të ndryshëm që ata sjellin, si dhe aftësisë së tyre të ulët në gjuhën shqipe (Καγιά, 2006).

Familjet e këtyre nxënësve përpiqen ta përballojnë këtë problem duke zgjedhur që fëmijët e tyre të studiojnë në shkolla publike në gjuhën greke ose në shkolla private ku fëmijët e kategorisë së mësipërme “ndihen mjaft të kënaqur”.

Konkretisht, shkollat që funksionojnë në rrethin e Gjirokastrës për vitin shkollor 2023-2024 janë:

Shkolla e qytetit të Gjirokastrës, nga klasa I – XII, me 130 nxënës.

Shkolla e Mesme e Bashkuar Dervician, nga klasa I – XII, me 125 nxënës.

Shkolla e Mesme e Bashkuar Bularat, nga klasa II – XII, me 77 nxënës.

Në qytetin e Sarandës, pra, në shkollën nëntëvjeçare “Adem Sheme” për vitin shkollor 2023-2024 kemi 112 fëmijë.

Në rrethin e Delvinës dhe në shkollat në Livadhja, Finiq, Çlirimi, Karahaxhi, Vrioni, Mesopotam, Dhrovian, Lefter Talo, Dërmish, Navarica kemi gjithsej 322 nxënës.

Bibliografi

Baruta, E. (2023). *Teaching Greek language in the first cycle in the schools of the Ethnic Greek Minority in Albania, didactic approach*, në konferencën ndërkombëtare “Didaktika e gjuhëve dhe kulturave të huaja: Nga politikat gjuhësore në qasjet për një kompetencë të shumëgjuhësisë”, 23-24, Tiranë.

Βουγιούκας, Α. (1985). Τα νέα Αναλυτικά Προγράμματα και βιβλία για το γλωσσικό μάθημα, Επιστημονικό Βήμα του Δασκάλου.

Βουρή, Σ. (2003). Η ελληνική μειονότητα της Αλβανίας (1914-1998), Στο Σ. Βουρή & Γ.Δ. Καψάλης, (επιμ.), *Ελληνόγλωσση εκπαίδευση στην Αλβανία*. Ρέθυμνο: Ε.ΔΙΑ.Μ.ΜΕ, Π.Τ.Δ.Ε., 17-79.

Gerojanis, K. & Buras, A. (2007). «Αναλυτικά προγράμματα – Σχολικά εγχειρίδια», Πρακτικά Συνεδρίου «Η Πρωτοβάθμια Εκπαίδευση και οι προκλήσεις της εποχής μας», Πανεπιστήμιο Ιωαννίνων.

Γεωργούλης, Σ. (1995). *Το καθεστώς των ελληνικών σχολείων από την ίδρυση του αλβανικού κράτους μέχρι σήμερα*, Στο Θ. Βερεμής, Θ. Κουλουμπής & Η. Νικολακόπουλος (επιμ.), *Ο ελληνισμός της Αλβανίας*. Αθήνα: Πανεπιστήμιο Αθηνών, ΕΛΙΑΜΕΠ.

Έκθεση που πραγματοποίησε το Τμήμα Ελληνικής Γλώσσας, Λογοτεχνίας και Ελληνικού Πολιτισμού του Πανεπιστημίου Αργυροκάστρου «Εκρέμ Τσαμπέι», Ιούνιος, 2015, ΕΚΘΕΣΗ: *Η Παιδεία στη Μητρική Γλώσσα στο Αλβανικό Δημόσιο στην Εθνική Ελληνική Μειονότητα. Κατάσταση και προτάσεις για την ποιοτική αναβάθμισή της*.

Καγιά, Ε. (2006). *Το ζήτημα της εκπαίδευσης στην ελληνική μειονότητα και οι δίγλωσσοι μετανάστες μαθητές στα ελληνικά ιδιωτικά σχολεία στην Αλβανία*, Διπλωματική εργασία

Καψάλης, Α. & Χαραλάμπους, Δ. (1995). *Σχολικά εγχειρίδια. Θεσμική εξέλιξη και σύγχρονη προβληματική*, Αθήνα: Εκδόσεις Έκφραση.

Μαλκίδης, Θ. (2011). *Η εκπαίδευση της ελληνικής μειονότητας στην Αλβανία από τη συγκρότηση του αλβανικού κράτους μέχρι σήμερα*, Αθήνα: Πανεπιστήμιο Αθηνών.

Μπάρκας, Π. (2003), «Η Ελληνική Μειονότητα επί καθεστώτος Χότζα» στο Τσιτσελίκης, Κ. & Χριστόπουλος, Δ.(επιμ.), *Η Ελληνική Μειονότητα της Αλβανίας*, (Αθήνα: Εκδόσεις Κριτική & ΚΕΜΟ).

Μαυρογιώργος, Γ. (1983). *Μορφές Επιμόρφωσης: Εννοιολογικές διευκρινήσεις - Το πολιτικοκοινωνικό τους πλαίσιο – Προϋποθέσεις, Σύγχρονη Εκπαίδευση*.

Ξωχέλλης, Π. (2005). *Κριτήρια εγκυρότητας, αξιοπιστίας και παιδαγωγικής καταλληλότητας των σχολικών βιβλίων*, Στο Χ. Βέικου, Χ. Δελή, & Α. Δημητράκου (επιμ.). Διδακτικό βιβλίο και εκπαιδευτικό υλικό στο σχολείο. Προβληματισμοί, δυνατότητες, προοπτικές. Πρακτικά Πανελληνίου Συνεδρίου του Παιδαγωγικού

Ινστιτούτου και του ΑΠΘ., Θεσσαλονίκη, 17-19 Φεβρουαρίου, 2005. Θεσσαλονίκη: Ζήτη.

Ξέρρα, Κ. & Μπαρούτα, Ε. (2022). *Τα διδακτικά εγχειρίδια για τα Δημοτικά Σχολεία της Εθνικής Ελληνικής Μειονότητας: Διαπιστώσεις και προτάσεις στο: Γλωσσική διδασκαλία και μάθηση στο σύγχρονο εκπαιδευτικό και κοινωνικό περιβάλλον*. ΤΟΜΟΣ Β', Εκδότης: Πανεπιστήμιο Δυτικής Μακεδονίας / ΠΕΚ «ΤΗΜΕΝΟΣ» ISBN 978-618-5613-08-2.

Πόλιου, Ν. (2021). *Τα έθιμα του γάμου της Δερόπολης*, Μεταπτυχιακή Διπλωματική Εργασία, Πανεπιστήμιο Ιωαννίνων.

Σαρβάννης, Γ. (2017), **«Διδασκαλία της ελληνικής γλώσσας στα ελληνικά σχολεία της Αλβανίας: Η περίπτωση του σχολείου «Όμηρος» Κορυτσάς», μεταπτυχιακή εργασία, Θεσσαλονίκη.**

Τσιτσελίκης, Κ. (2003). *Η εκπαίδευση της ελληνικής μειονότητας στην Αλβανία*, Στο Κ. Τσιτσελίκης & Δ. Χριστόπουλος (επιμ.), *Η ελληνική μειονότητα της Αλβανίας*. Αθήνα: Κριτική.

Υφαντής, Ν. Θ. (2006). *Η ελληνική Παιδεία στη Βόρειο Ήπειρο κατά την περίοδο της τουρκοκρατίας και τα νεότερα χρόνια*, Ιωάννινα: Αυτοέκδοση.

https://www.pre.aegean.gr/wp-content/uploads/2017/02/15.Fouzas_PTDE_PhD_2017.pdf

NDJESHMËRIA POETIKE E POETES GREKE MARIA POLIDHURI

Mirela Koça¹, Lorena Dedja²

¹Fakulteti i Edukimit dhe i Shkencave Shoqërore,
Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër,
e-mail: mirelakoca@yahoo.gr

²Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës.
Departamenti i Gjuhës Frënge

Abstrakt

Maria Polidhuri është një nga poetet më të shquara greke dhe, pavarësisht faktit se vdiq në moshë shumë të re, arriti të lërë pas një vepër të pasur poetike. Është përfaqësuese në Greqi e së ashtuquajturës shkollë neosymboliste të “brezit të viteve 1920”, por edhe një femër e emancipuar dhe boheme që përballoi jetën me pasion dhe dinamizëm. Ky brez poetësh ndikohet nga idetë e Dekadencës, u kundërvihet vlerave tradicionale në jetë dhe në art dhe kërkon modernizimin dhe riorganizimin e poezisë tradicionale, duke theksuar, veçanërisht, elementin lirik të vargut. Vepra e saj poetike vlerësohet kryesisht për origjinalitetin e ndjenjave që shprehen brenda saj. Dashuria dhe vdekja janë dy boshtet kryesore rreth të cilave rrotullohet poezia e saj, e mbushur me tone lirike, dhimbje, trishtim të thellë dhe natyra e saj romantike është e dukshme në çdo varg. Marrëdhënia e saj me poetin e njohur Kostas Karyotakis, veçanërisht vdekja e tij tragjike, e frymëzoi për një seri poezish ku dominojnë motivet e dashurisë dhe vdekjes.

Fjalë kyçe: Maria Polidhuri, neosymbolizëm, dashuria, vdekja, K. Karyotakis

Abstract

Maria Polidhuri is one of the most prominent Greek poets and despite the fact that she died at a very young age, she managed to leave behind a rich poetic work. She is a representative in Greece of the so-called neo-symbolist school of the generation of the 1920s, but also an emancipated and bohemian woman who faced life with passion and dynamism. This generation of poets is influenced by the ideas of Decadence, opposes traditional values in life and art, and seeks the modernization and reorganization of traditional poetry, emphasizing especially the lyrical element of verse. Her poetic work is appreciated mainly for the originality of the feelings expressed within it. Love and death are the two main axes around which her poetry revolves, filled with lyrical tones, pain, deep sadness and her romantic nature is evident in every verse. Her relationship with the renowned poet Kostas Karyotakis and especially his tragic death inspired her for a series of poems dominated by the motifs of love and death.

Keywords: Maria Polydouri, neo-symbolism, love, death, K. Karyotakis

1. Të dhëna biografike dhe veprimtaria letrare e Maria Polidhurit¹

“Vdekja e një gruaje të re, është pa diskutim tema më poetike në botë”, ka thënë **Edgar Allan Poe**. Rasti i Maria Polidhurit, tekstet e saj romantike, sëmundja e saj, lidhja me poetin e njohur Kosta Karyotakis dhe vdekja e saj në moshën 28-vjeçare, e konfirmojnë këtë thënie. Kronologjikisht, ajo i takon “brezit të viteve 1920”, por shumë kritikë e lidhin veprën e saj me brezin e viteve 1930 për shkak të ideve të saj progresive, emancipuese dhe feministe.

U lind në Kallamata më 1 prill 1902. Një epokë veçanërisht kontradiktore, me luftërat ballkanike, katastrofën e Azisë së Vogël dhe kushtet e reja sociale. Ishte vajza e tretë e mësuesit filolog Evgjenios Polidhuri dhe e Kyriaki Markatos, një grua me ide të hershme feministe. Në moshën 14 vjeçare do të botojë poezinë e saj të parë “*Dhimbja e nënës*” (“*Ο πόνος της Μάνας*”). Më 1918 mbaron shkollën e mesme dhe emërohet në Prefekturën e Mesinisë. Atje më 1922 takohet me poetin Kostas Karyotakis, dashurinë e madhe të jetës së saj. Ai magjepsset nga personaliteti, por edhe nga bukuria vajzës së re. Karyotakis e inkurajon atë të vazhdojë të shkruajë poezi, por në të njëjtën kohë i përcjell dhe pesimizmin e tij. Më 1923 Maria preket nga sëmundja e adenopatisë, sëmundje të cilën e trashëgoi nga e ëma, dhe interesi i saj për studimet fillon të zbehet.

Në vitin 1926 do të shkruajë një roman që nuk do të botohet derisa është gjallë, me titull “*Romancë*” (*Ρομάντζο*). Po atë vit shkon në Paris për të studiuar si stiliste në *École Pigier*. Vitin pasues infektohet nga tuberkulozidhe më 1928 kthehet nga Parisi dhe mëson për vetëvrasjen e Karyotakisit, lajm që e tronditi poetin dhe i shkaktoi dëshpërim të madh. Në fund të vitit 1928 boton veprën e saj të parë poetike “*Trillet që shuhen*” (*Τρίλιες που σβήνουν*), e cila pritet me ngrohtësi nga mosha e re, ndërsa trajtohet në mënyrë indiferente nga kritikët e afirmuar. Në këtë vëllim dominon lirika dhe muzikaliteti. Me termin “*trill*” në muzikë nënkuptohet përsëritja e shpejtë e dy tingujve të njëpasnjëshëm që janë një ton ose një gjysmëton larg njëri-tjetrit, ndërkohë që i referohet edhe mënyrës së cicërimës që i ngjan trillës muzikore². Titulli, pra, nga njëra anë shpreh tonet e ulëta dhe muzikalitetin e poezive të saj dhe nga ana tjetër përmbajtjen e tyre dramatike. Poezi të mbushura me ndjeshmëri femërore, plot dhimbje për jetën, për rininë e saj që vyshket, për kujtimet dhe për dashurinë e saj të madhe. Del në pah një pafajësi rinore, e cila shumë shpejt zhvillohet në një

¹Αρχείο Ελλήνων Λογοτεχνών, Ε.ΚΕ.ΒΙ; Αγρας, Τ. (1930). Μεγάλη Ελληνική Εγκυκλοπαίδεια, *Μαρία Πολυδούρη*, Αθήνα; Ζωγράφου, Λ. (1961). *Εισαγωγή στα Άπαντα της Μαρίας Πολυδούρη*. Αθήνα: Εστία; *Μαρία Πολυδούρη, Τα ποιήματα*, Φιλολογική & τυπογραφική επιμέλεια Ισίδωρος Πετρίδης, γράμματα, Αθήνα, 2001, f. 9-10.

²Λεξικό Τριανταφυλλίδη, Πύλη για την Ελληνική γλώσσα, tek https://www.greeklanguage.gr/greekLang/modern_greek/tools/lexica/search.html, 07/03/2024

pjesuri të avancuar³. Poezitë e këtij vëllimi poetik u shkruan në periudhën midis viteve 1922 dhe 1928 dhe shumica e tyre gjatë kohës kur ishte e sëmurë.

Në fund vitit 1929 botohet dhe vëllimi i saj i dytë dhe i fundit poetik me titull “*Jehonë në kaos*” (*Ηχώ στο χάος*). Përmbledhja e saj e dytë u pasua nga një kritikë e ngrohtë. Siç e shohim nga titulli, edhe kjo vepër lidhet me tingullin, por toni këtu mund të karakterizohet më i thellë, i ngjyrosur me një nuancë metafizike dhe ekzistenciale. Në të dy vëllimet dominojnë dashuria dhe vdekja, dhimbja dhe dëshpërimi. Përveç dy përmbledhjeve të saj me poezi, romanit të pabotuar dhe autobiografisë së saj, Polidhuri shkroi dhe vepra të tjera që dolën në dritë pas vdekjes së saj.

Në fillim të vitit 1930 gjendja e saj shëndetësore përkeqësohet. Vdiq në orët e para të 29 prillit 1930 dhe u varros po atë ditë në Athinë.

2. Shkrimi poetik dhe boshtet tematike të Maria Polidhurit

Polidhuri është pa dyshim një nga poetet më të mëdha të Greqisë. Personaliteti i saj luftarak, natyra e lirë dhe e pavarur e ndjeshmëria e saj e shtynë në një jetë intensive. Sipas shumicës së kritikëve letrarë, Maria Polidhuri i përket të ashtuquajturës shkollë neosimboliste dhe neoromantike të “*brezit të viteve 1920*”. Ky brez poetësh ndikohet nga idetë e Dekadencës (Decadence), u kundërvihet vlerave tradicionale në jetë dhe në art e kërkon modernizimin dhe riorganizimin e poezisë tradicionale, duke theksuar veçanërisht elementin lirik të vargut. Ndikohet nga rryma e neosimbolizmit evropian ku dominojnë dëshirat e paplotësuara, izolimi në hapësirat private, privimi i dashurisë, melankolia, dhimbja dhe kultivimi i poezive të shkurtra lirike⁴. Padyshim, Karyotakis është personaliteti kryesor i këtij brezi, nga i cili ndikohen të gjithë të tjerët dhe këtij ndikimi i atribuohet termi “karyotakizëm”. Vepra poetike e Polidhurit vlerësohet kryesisht për origjinalitetin e ndjenjave që shprehen brenda saj. “*Përshtypja e origjinalitetit është kaq shumë e theksuar, sa të bën të besosh se poezia nuk e interesonte atë si art në vetvete, por si një mënyrë për të theksuar përvojën e saj të jetës dhe kryesisht për ta pastruar atë nga ato përzierje të së përditshmes, të cilat e dobësojnë dhe e banalizojnë*”⁵. Kemi të bëjmë me një poezi erotike, ekzistenciale, të kërkimit të idealeve dhe absoluteve ndër më karakteristiket e ndjeshmërisë femërore. Dallohet për lirizmin e saj, shpërthimin emocional, sentimentalizmin, ndjenjën e melankolisë dhe muzikalitetin.

³Ελευθεριάδου, Π., *Η ποίηση του 20ου αιώνα, η περίπτωση του Κώστα Καρυωτάκη και της Μαρίας Πολυδούρη*, Πανεπιστήμιο Δυτικής Μακεδονίας, Φλώρινα, 2021, f. 91.

⁴Καράογλου, Χ., (1991), *Το περιοδικό Μούσα (1920-1923). Ζητήματα ιστορίας της νεοελληνικής λογοτεχνίας*, Νεφέλη, Αθήνα, f. 207.

⁵Αθανασόπουλος, Β., (2007), *Το ποιητικό τοπίο του Ελληνικού 19^{ου} και 20^{ου} αιώνα*, Γ', Εκδόσεις Καστανιώτη, f. 278-279.

Për Polidhurin, poezia nënkupton komunikim. Shumica e veprave të saj janë shkruar në vetën e dytë. Fjalori që përdor për të shprehur idetë, ndjenjat dhe dëshirat e saj është i thjeshtë. Po kështu, edhe për sa i përket formës së poezive, nuk përdor teknika të ndërlikuara. Shumica e veprave janë shkruar në vargun tradicional, por përdor dhe vargun e lirë. Nga figurat letrare preferon më shumë metaforat dhe krahasimet. Poezitë e saj janë të thjeshta për t'u kuptuar dhe interpretuar, të vërteta dhe të sigërtë dhe të ofrojnë kënaqësi estetike. Sipas studiueses Lili Zografou: “*Tiparet kryesore të poezisë së Polidhurit janë dy, një negativ dhe një pozitiv. Një ndjesi estetike mund të gjendet kudo. Vargu i saj është i pabarabartë dhe, pothuajse, gjithmonë i mungon përpunimi. Një pikëllim i pashuar dhe i zjarrtë, për idealet e pakapshme, për mashtrimet dhe iluzionet, e bën atë të nxituar dhe shpesh indiferente ndaj detajeve. Një varg britmash, të qarash dhe përgjërimesh të dëshpëruara shpërthejnë si zjarr, nga një grua me flokë të shprishur, të ngatërruar, me krahë të përdredhur, buzë të thata dhe gjunjë të palosur në një qëndrim braktisjeje ose lutjeje. Aq shumë, sa disa herë të krijohet përshtypja se nuk duron dot, trembet të shohë sërish dorëshkrimin e saj.*”⁶

Nevoja parësore për Polidhurin është nevoja për t'u shprehur, duke vënë kështu në plan të dytë çështjet teknike. “*Poezitë e saj nuk janë perfekte për nga ana e formës, rimës dhe harmonisë, por përmbajnë aq shumë jetë brenda tyre, sa që na bëjnë të shpërfillim papërsosmërinë e tyre të jashtme*”.⁷Për këtë arsye, kritika letrare ka dalluar dhe afirmuar vetëm disa poezi. Ndërmjet tyre mund të veçojmë poezitë, “*Pranvera*” (Ανοιξη), “*Jam e marrë për të të dashuruar*” (Είμαι τρελή να σ’ αγαπώ) dhe më shumë poezinë “*Vetëm sepse më dashurove*” (Γιατί μ’ αγάπησες).

Dashuria dhe vdekja, dhimbja, dëshpërimi, malli dhe nostalgjia mbizotërojnë në dy vëllimet poetike të Polidhurit, si edhe në veprat e tjera që u botuan pas vdekjes së saj. Sipas kritikëve, gjithë vepra e saj përkohet nga dipoli dashuri-vdekje. “*Polidhuri lëviz tërësisht në fushën e emocioneve dhe gjendjeve emocionale, zakonisht rreth dy motiveve kryesore të dashurisë dhe vdekjes, duke ruajtur një ton veçanërisht personal*”⁸.

Gjithsesi, vepra e saj nuk i referohet vetëm lidhjes me poetin Kariotakis, por bën fjalë edhe për njerëz të tjerë, për familjarët e saj, për varkëtarin biond, për Marianën, Ninën, gjahtarin e bukur të Chalandrit, për poetët Ricos dhe Raftopoulos etj.

⁶Zωγράφου, Λ., (1961), *Εισαγωγή στα Άπαντα της Μαρίας Πολυδούρη*, Αθήνα, Εστία, f. 81.

⁷Μπόμπου Βασιλική, (1954), *Μαρία Πολυδούρη, Ελληνική Δημιουργία*, Έτος Ζ, τόμος 14, Αθήνα 15 Μαΐου, f. 621.

⁸ Στεργιόπουλος,Κ.,(1980), *Η Ελληνική Ποίηση. Η Ανανεωμένη Παράδοση*. Ανθολογία-Γραμματολογία, Αθήνα: Σοκόλης, f. 422-423.

- **Elementi erotik**

Polidhuri është poetja që kompozoi disa nga poezitë më të bukura të dashurisë të shkruara ndonjëherë në gjuhën greke. Për të, dashuria përbën qëllimin e ekzistencës së saj, forcën shtytëse dhe katalitike. Elementi erotik është i theksuar në veprën e saj dhe poezia është ajo që e shpreh atë në të gjitha variacionet e tij. Karyotakis ishte dashuria e saj e madhe, prandaj dhe shumicën e poezive të saj i shkruan për të dhe i dedikohen atij. Në veprën e Polidhurit dashuria luan disa funksione:

3. Funksioni ripërtëritës i dashurisë

Në këtë kategori poezish, motivi bazë është dashuria dhe ndikimi i saj pozitiv në psikosintezën e njeriut. Këtu mund të përmendim sonetin “*Dashuria e poetit*” (*Η αγάπη του ποιητή* f. 152)⁹, që u gjend te veprat e pabotuara të poetes. Në këtë poezi theksi bie te fuqia që i ofron dashuria shpirtit të të dashuruarve. Duke përdorur vetën e dytë njëjës, poetja fillimisht i referohet takimit të parë me të dashurin e saj (“*Poet, ti rrugës më takove*”), duke e karakterizuar veten si “*lulja e parë e prillit*”, gjë që justifikohet me faktin se poetja ka lindur më 1 prill.

<i>Μ' απάντησες στο δρόμο σου, Ποιητή</i>	<i>Poet, ti rrugës më takove</i>
<i>Ήμουν το πρωτολόλουδο του Απρίλη.</i>	<i>Isha lulja e parë e prillit.</i>
<i>Η δίψα της αγάπης που ζητεί</i>	<i>Etja e dashurisë që kërkove</i>
<i>σου φλόγιζε τη σκέψη και τα χείλη.</i>	<i>Të ndriçonte buzët dhe mendimin.</i>

Në vargjet në vazhdim, ajo tregon se, sapo sytë e tyre u takuan për herë të parë, mendja e saj pushoi së menduari dhe vetëm zemra “*fliste*” dhe shpjegon se si i dashuri filloi gradualisht të shfaqte dashurinë e tij për të. Ishin që të dy të rinj të një brezi, por, në thelb, dashuria e tyre nuk mundi të kishte sukses. Në këtë poezi mungon krejtësisht motivi i vdekjes, trishtimi dhe dhimbja, ndërsa mbiztëron funksioni ripërtëritës i dashurisë. Pavarësisht se dashuria e saj nuk pati sukses, shpirti i poetes mbetet i qetë, sepse i mjafton fakti që në jetë ka pasur fatin që një njeri ta dashurojë vërtet dhe fort.

Te poezia “*Eja*” (*«Ελα γλυκέ»* f. 64), botuar në vëllimin e saj të parë poetik “*Trillet që shuhen*”, dashuria shfaqet e thellë dhe e singertë. Poetja, po në vetën e dytë njëjës, i drejtohet të dashurit të saj dhe shpreh ndjenjat e saj duke iu drejtuar me epitetin “*i ëmbël*”. Ajo shpjegon se edhe pse ai mërzitet me ardhjen e errësirës, ajo do të krijojë një “*kurorë me yje*” dhe, me fuqinë e dashurisë, drita do të shkëlqejë përsëri:

⁹Për poezitë e Polidhurit i referohemi librit ku gjendet gjithë vepra e saj poetike me titull *Μαρία Πολυδούρη, Τα ποιήματα*, Φιλολογική & τυπογραφική επιμέλεια Ισίδωρος Πετρίδης, γράμματα, Αθήνα, 2001. Atje ku nuk përmendet përkthyesi, përkthimet janë bërë nga autorja e parë e artikullit, Mirela Koça.

*Έλα γλυκέ, κι' αν φτάνει η νύχτα
και το σκοτάδι δε σ' αρέσει,
αστέρινο θαμπό στεφάνι
η αγάπη μου θα σου φορέσει.*

*Eja i ëmbli im, edhe pse nata vjen
dhe errësira nuk të pëlqen,
kurorë të zbehtë yjesh
dashuria ime do të të vesh.*

Në këtë kategori poezish mund të klasifikojmë dhe poezinë ndoshta më të bukur të poetes “*Vetëm sepse më dashurove*” (Γιατί μ’ αγάπησες, f. 60-61) nga vëllimi i saj i parë poetik “*Trillet që shuhen*”:

*Δεν τραγουδώ, παρά γιατί μ' αγάπησες
στα περασμένα χρόνια.
Και σε ήλιο, σε καλοκαιριού προμάντεμα
και σε βροχή, σε χιόνια,
δεν τραγουδώ, παρά γιατί μ' αγάπησες.*

*Thur këngë vetëm sepse më dashurove
në vitet e së shkuarës.
Dhe në diell, në profetësinë verore
dhe në shi, në dëborëra,
thur këngë vetëm sepse më dashurove.*

*Μόνο γιατί με κράτησες στα χέρια σου
μια νύχτα και με φίλησες στο στόμα,
μόνο γι' αυτό είμαι ωραία σαν κρίνο ολάνοιχτο

κι έχω ένα ρίγος στην ψυχή μου ακόμα,
μόνο γιατί με κράτησες στα χέρια σου.*

*Vetëm sepse më mbajte në krahë
një natë dhe më puthe me zjarr,
vetëm për këtë jam e bukur si
i çeluri zambak,
fërgëllon ende shpirti im,
vetëm sepse më mbajte në krahë.*

*Μόνο γιατί τα μάτια σου με κοίταζαν
με την ψυχή στο βλέμμα,
περήφανα στολίστηκα το υπέρτατο
της ύπαρξής μου στέμματα,
μόνο γιατί τα μάτια σου με κοίταζαν.*

*Vetëm sepse më vështrove me ata sy
në thellësi të shpirtit,
me madhështi vura kurorën
më të lartë të ekzistencës sime,
vetëm sepse më vështrove me ata sy.*

*Μόνο γιατί όπως πέρναα με καμάρωσες
και στη ματιά σου να περνάει
είδα τη λυγερή σκιά μου ως όνειρο
να παίζει, να πονάει,
μόνο γιατί όπως πέρναα με καμάρωσες.*

*Vetëm sepse kur ecja më shihje me
admirim
dhe në vështrimin tënd pashë të kalonte
hijësirën time të epur, si ëndërr
të luante, të ndiente dhimbje,
vetëm sepse kur ecja më shihje me
admirim*

*Γιατί δισταχτικά σα να με φώναζες
και μου άπλωσες τα χέρια
κι είχες μέσα στα μάτια σου το θάμπωμα
– μια αγάπη πλέρια,
γιατί δισταχτικά σα να με φώναζες.*

*Sepse me drojë më thirre
dhe duart drejt meje shtrive
në sy kishe turbullirën
e dashurisë së plotë,
sepse me drojë më thirre.*

Një poezi plot lirizëm që është tregues i dashurisë së përealizuar të dy poetëve, një dashuri që tronditi shëndetin dhe psikologjinë e tyre dhe i çoi në një vdekje të hershme. Bëhet fjalë për një rrëfim dashurie plot pasion të

poetes për të dashurin e saj. Në këtë poezi Polidhuri himnizon dashurinë ideale. Subjekti poetik është vetë poetja që, në vetën e dytë, i drejtohet të dashurit të saj që tashmë nuk jeton (“*i bukuri im që perëndove*”). Ajo i thotë se arsyeja që shkruan poezi është sepse e dashuroi dikur në të kaluarën. Poezia ngjan me faqet e një ditari ose me një letër dashurie, falë përdorimit të vetës së parë njëjës dhe stilit rrëfimtar. (“*Thur këngë vetëm sepse më dashurove*”, “*Vetëm sepse më mbajte në krahë*”, “*Vetëm sepse më dashurove, u linda*” etj.). Ajo që e mban akoma gjallë, edhe pse tashmë nuk ndodhet pranë saj, nuk janë stinët që ndërrohen, por sepse dikur e dashuroi, dikur e mbajti në krahë dhe e puthi. Jeta e saj ishte bosh deri sa hyri ai dhe i dha kuptim. Poetja mendon se lindi vetëm sepse ai e dashuroi. Për të bërë më të besueshme këtë dashuri ajo përdor edhe elemente të natyrës si “*agimi*”, “*trëndafila*”, “*nata*” dhe “*yje*”. Përsëritja e fjalëve “*vetëm*” (10 herë), “*jetë*” (3 herë), “*më dashurove*” (7 herë), “*bukur*” (7 herë), thekson dashurinë e Polidhurit dhe e idealizon këtë ndjenjë. Tani që i dashuri i saj nuk ekziston më jeta e poetes pushon së pasuri kuptim dhe ecën edhe ajo drejt vdekjes. Edhe pse prania e vdekjes ndihet, dashuria është ajo që mbetet dhe që meriton të vlerësohet përmes kësaj poezie. Pavarësisht strofës së fundit, motivi që dominon është ai i dashurisë. Gjendja pesimiste dhe melankolike që ekziston në shumicën e poezive të saj nuk gjendet në këtë poezi ku mbizotëron gëzimi, spontaniteti dhe shprehja e sinqertë e ndjenjave në kombinim me dashurinë e idealizuar.

4. Dashuria si shpëtim

Në këtë kategori poezish të Polidhurit dashuria funksionon si mjet për të shpëtuar nga vuajtjet dhe fatkeqësitë që rëndojnë mbi njeriun. Funkcioni i dashurisë si shpëtim vihet re në poezinë “*Kthimi*” (Γυρισμός f. 50) në vëllimin e saj të parë poetik “*Trillet që shuhen*”. Sipas L. Zografou, Polidhuri e shkruajti poezinë pas vizitës së Karyotakisit në sanatoriumin “*Sotiria*”, pak para se ai të nisej për në Prevezë. Poetja gëzohet për ardhjen e të dashurit që e priste prej shumë kohësh (“*Erdhe! Erdhe! gëzimi im vërshoi/dhe malli më shtrëngon për të më mbytur* (Ἔρθες! ἤρθες! πλημμύρισε η χαρά μου/κ’ η λαχτάρα με σφίγγει να με πνίξει)). I kërkon të pushojë së qeni i mërzitur dhe të buzëqeshë, dhe i shpjegon se ka kaluar koha që gëzohej nga lulet dhe dhuratat që ai i jepte. Ajo që dëshiron tani është që të gjendet sa më shpejt afër tij dhe ta puthë:

*Κοίτα πως αγωνίζεται η ψυχή μου
τα στέρεα της ζωής δεσμά να
λύσει.*

*ανέσπερον αστέρι να προφτάση
το αργυρό μέτωπό σου να φιλήσει.*

*Shiko si lufton shpirti im
zinxhirat e forta të jetës të
zgjidhë.*

*yll i pashuar për të arritur
të puth ballin tënd të argjendtë.*

Në poezi mungojnë plotësisht motivet e vdekjes, dominon vetëm dashuria me disa nuanca melankolie. Dashuria pushton shpirtin e poetes, duke i dhënë një ndjenjë të fortë gëzimi.

5. Funkzioni shkatërrues i dashurisë

Në këtë kategori poezish të Polidhurit dashuria paraqitet si mjet i dëmshëm dhe shkatërrues për gjendjen psikologjike të njeriut. Mund të përmendim poezinë “*Ëndërr*” (*Oveipo* f. 144) nga veprat e pabotuara të poetes, që e kishte shkruar më 1920, në vendlindjen e saj Kallamata. Bën fjalë për një vajzë që mbledh lule në mal dhe pret të kalojë i dashuri i saj që t’ia dhurojë. Por kjo nuk ndodh, gjembat i shpojnë lëkurën, por ajo i shtrëngon fort e më fort. Zhgënjimi dhe frika që burojnë nga brenda saj bëjnë që t’i vërshojnë lotët. Është një poezi ku mbizotëron melankolia, element që theksohet nga fjala “*nata*” në fund të saj. Dhurata e saj nuk arriti kurrë te marrësi dhe shpresat e saj u shkatërruan. I dashuri nuk erdhi kurrë dhe ajo mbeti vetëm me lulet që kishte mbledhur.

*Μεσ’ στον πόθο μου δεν είδα
μαύρη η Νύχτα να σιμώνει
κ’ έκλαψα χωρίς ελπίδα
που δε στα ‘χα φέρει μόνη.*

*Në epshin tim nuk pashë
që po vinte Natë e zezë
dhe unë qava pa shpresë
që nuk t’i solla vetë.*

Për të përforcuar klimën neoromantike dhe në këtë poezi Polidhuri përdor disa nga simbolet e saj të afirmuara si “*ëndrra*”, “*lulja*”, “*dhimbja*”, “*loti*”, “*shpresa*”, “*malli*”, “*nata*”.

• Elementi i vdekjes

Elementit erotik që karakterizon veprën e Maria Polidhurit shoqërohet gjithmonë me një hije vdekjeje. Kjo nuk lidhet vetëm me përjetimet e poetes, por edhe me mungesën e të dashurit të saj. Polidhuri e ka përjetuar vdekjen që në moshë të vogël me vdekjen e dy vëllezërve të saj të vegjël dhe prindërve dhe më vonë me vdekjen e të dashurit, poetit K. Karyotakisit.

Poezia e saj e parë që i referohet vdekjes është ajo me titull “*Nënës sime*” (*Της μητέρας μου* f. 49). Duke përdorur vetën e dytë njëjës, ajo i drejtohet nënës së saj: “*Nëna ime, fëmija yt jam besnik*” (*Μητέρα μου, παιδί σου εμέ πιστό*). Poetja e cilëson veten si një fëmijë besnik kundrejt kujtesës së nënës, duke theksuar kështu përjetësinë e saj. Që të dyja vuanin nga e njëjta sëmundje, kështu që Maria e ndien se do të kalojë të gjitha dhimbjet që kaloi dhe e ëma:

*Πιστό παιδί σου. Τη μαρτυρική
ζωή σου στη ζωή μου να τη νοιώσω
Μητέρα μου καλή, πονετική.*

*Fëmija jote besnik. Jetën tënde
martire, në jetën time do ta ndiejë.
Nëna ime e mirë, e dhimbshme.*

Në fund të poezisë mësojmë se nëna e saj kishtenjë brengë të fshehtë, të cilën nuk e tregoi kurrë. Kjo brengë kishte të bënte me dhimbjen që i shkaktonte sëmundja, të cilën nuk e shfaqte, me qëllim që të mos mërziste njerëzit e saj të dashur. Si përfundim, poezia himnizon figurën e nënës duke na treguar se edhe fundi i poetes do të jetë i afërt.

Në disa poezi të Polidhurit, vdekja luan rolin e strehës së dashurisë. Këtë e shikojmë në poezitë: “*Mua, këngët e mia ishin vetëm për të*” (*Εμένα τα τραγούδια μου ήταν μόνο για κείνον* f. 176), “*Fjalët e tua*” (*Τα λόγια σου* f. 149), “*Do jesh vonë*” (*Θα ‘ρθεις αργά* f. 32), “*Nuk do të vish më*” (*Δε θα ζανάρθεις πια* f. 163) etj. Te poezia e parë, “*Mua, këngët e mia ishin vetëm për të*”, nga veprat e pabotuara, Polidhuri shpreh zhgënjimin e saj me një ton melankolik dhe beson se nuk ka arsye që të përpiqet të ndiejë thirrjet e jetës:

*Ti θέλω πια να δέχομαι την προστασία της Μούσας;
Να σφίγω την καρδιά μου να δεχτεί
τις νέες αγάπες, πίστες και χαρές της,
τάχα πως είναι μοίρα μου κ' είναι και διαλεχτή!*

*Pse dua që akoma të pranoj mbrojtjen e Muzës?
Të shtrëngoj zemrën time për të pranuar
dashuritë e reja, gëzimet e saj dhe besimet,
thua se është fati im i zgjedhur!*

Më tej, poetja na shjegov se e vetmja arsye që shkruante poezi, ishte vetëm *Për të*, të dashurin e saj: “*Mua, këngët e mia ishin vetëm për të*” (*Εμένα τα τραγούδια μου ήταν μόνο για κείνον*). Edhe pse tashmë janë ndarë, ajo vazhdon ta dashurojë, madje, edhe më shumë: “*Në ndarjen tonë i sillnin si dallëndyshe vargjet*”/“*mesazh, se nga larg unë dyfish e dua* ” (*Στο χωρισμό μας του 'φερναν σα χελιδόνια οι στίχοι / μήνυμα, πώς από μακριά διπλά τον αγαπώ*). Me një notë trishtimi, ajo thekson se humbi zërin sapo mësoi për ikjen nga jeta e të dashurit të saj dhe dhimbja e rëndë që përjetoj e sillte edhe atë afër vdekjes. E përfundon poezinë me një ndjenjë të thellë dëshpërimi vdekjeprurës. Shpreh mosbesimin e saj ndaj Muzës dhe ndaj gjithçkaje, duke theksuar edhe një herë se vargjet e saj i shkruante vetëm *Për të*.

Kombinuar me motivin e dashurisë dhe atë të vdekjes, në veprën e Polidhurit gjenden edhe motive të tjera si dhimbja, nostalgjia, miqësia etj. Natyrisht, në veprën e saj duket qartë një qëndrim kritik ndaj pabarazive sociale dhe theksohet interesimi për përmirësimin e pozitës së gruas dhe emancipimin e saj. Nuk është rastësi që vepra e saj gjeti mbështetje të madhe në revistat feministe të kohës.

Maria Polidhuri është pa dyshim një nga poetet më të mëdha të Greqisë. Ndjeshmëria e saj poetike, lirizmi, muzikaliteti, tonet melankolike, natyra e saj e lirë dhe e pavarur bëjnë që vargjet e saj të ruajnë akoma edhe sot freskinë e tyre krijuese.

Bibliografia

Αγρας, Τ. (1930). Μεγάλη Ελληνική Εγκυκλοπαίδεια, *Μαρία Πολυδούρη*, Αθήνα.

Αθανασόπουλος, Β., (2007), Το ποιοτικό τοπίο του Ελληνικού 19^{ου} και 20^{ου} αιώνα, Γ', Εκδόσεις Καστανιώτη, f. 278-279.

Αρχείο Ελλήνων Λογοτεχνών, Ε.ΚΕ.ΒΙ.

Ελευθεριάδου, Π., (2021), *Η ποίηση του 20ου αιώνα, η περίπτωση του Κώστα Καρυωτάκη και της Μαρίας Πολυδούρη*, Πανεπιστήμιο Δυτικής Μακεδονίας, Φλώρινα, f. 91.

Ζήρας Αλεξ., (1988). «*Πολυδούρη Μαρία*», Παγκόσμιο Βιογραφικό Λεξικό, Αθήνα, Εκδοτική Αθηνών Ζωγράφου, Λ. (1961). *Εισαγωγή στα Άπαντα της Μαρίας Πολυδούρη*. Αθήνα: Εστία.

Καράογλου, Χ., Το περιοδικό Μούσα (1920-1923). Ζητήματα ιστορίας της νεοελληνικής λογοτεχνίας, Νεφέλη, Αθήνα, 1991, σ. 207.

Λεξικό Τριανταφυλλίδη, Πύλη για την Ελληνική γλώσσα, tek https://www.greeklanguage.gr/greekLang/modern_greek/tools/lexica/search.html?lq=%CF%84%CF%81%CE%AF%CE%BB%CE%B9%CE%B1&sin=all

Μαρία Πολυδούρη, (2001), «Νέα Εστία», τεύχος 1331, Χριστούγεννα 1982.

Μαρία Πολυδούρη, Τα ποιήματα, Φιλολογική & τυπογραφική επιμέλεια Ισίδωρος Πετρίδης, γράμματα, Αθήνα.

Μπόμπου Βασιλική, (1954), *Μαρία Πολυδούρη, Ελληνική Δημιουργία*, Έτος Ζ, τόμος 14, Αθήνα 15 Μαΐου, f. 621.

[Nika Maklena tek](https://www.facebook.com/GreekLiteratureInAlbania/?locale=zh_CN)
https://www.facebook.com/GreekLiteratureInAlbania/?locale=zh_CN

Στεργιόπουλος, Κ., 1980, *Η Ελληνική Ποίηση. Η Ανανεωμένη Παράδοση*. Ανθολογία-Γραμματολογία, Αθήνα: Σοκόλης, f. 422-423.

Τα ποιήματα. Μαρία Πολυδούρη, σε επιμέλεια της **Χριστίνα Ντουλιά**, Εκδόσεις **Εστία**, 2014, f. 300-312.

KOHA LEKSIKORE: KOHA CIKLIKE DHE CIKLI JETËSOR

Zeqir Zeqirllari
Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore,
Universiteti "Eqrem Çabej"
e-mail: zeqirzeqirllari18@gmail.com

Abstrakt

Ky punim trajton konceptin e kohës ciklike dhe ciklin jetësor nga një këndvështrim gjuhësor: si shprehen leksikalisht këto në gjuhën shqipe? Si formojnë çerdhe fjalësh? "Koha ciklike" e cila lidhet me stinët, alternimin e ditës dhe natës, si dhe me dukuri të tjera që përsëriten, është thelbësore në strukturën konceptuale të kulturës dhe gjuhës shqipe. Koha dhe hapësira janë dy dimensione që fiksojnë gjithë gjallesat dhe qeniet njerëzore. Një pjesë tjetër e studimit është analiza e ciklit jetësor të njeriut, ku përshkruhen fazat e ndryshme (biologjike dhe sociale) të jetës së tij. Gjithashtu, në këtë kuadër janë trajtuar disa prej emrave të kafshëve, të cilat janë emërtuar sipas tiparit të moshës, duke nxjerrë në pah lidhjen mes njësisve leksikore dhe perceptimit kulturor të ciklit jetësor. Njësitë leksikore, të cilat shprehin këtë "kohë", janë vjelë nga "Fjalori i Gjuhës Shqipe" 2006. Studimi synon të vë në dukje rolin dhe pasurinë e gjuhës shqipe si një mjet që jo vetëm pasqyron, por edhe ndërton realitetin konceptual të kohës ciklike dhe ciklit jetësor.

Fjalët kyç: koha ciklike, cikli jetësor, moshë, leksik

Abstract

This paper deals with the concept of cyclic time and the life cycle from a linguistic point of view: how are these lexically expressed in the Albanian language? How do they form word families? The concept of "cyclic time," which is associated with the seasons, the day-night cycle, and other recurrent occurrences, is fundamental to Albanian culture and language. Two dimensions that are fixed for all living things, including humans, are time and space. The study also includes an analysis of the human life cycle, which describes the many biological and social stages of a person's life. Additionally, several animal names that are based on age have been addressed in this paradigm, emphasizing the relationship between lexical units and how the life cycle is perceived in different cultures. The lexical units, which express this "time", are taken from the Dictionary of the Albanian language 2006. The study aims to point out the role and wealth of the Albanian language as a tool that not only reflects, but also builds the conceptual reality of cyclical time and the life cycle.

Keyword: cyclic time; life cycle; age; lexic.

I. Koha ciklike

Në gjuhë, koha mund të identifikohet në këto modele: linare dhe ciklike. Karakteri ciklik i kohës u ngulit në vetëdijen e njeriut primitiv në bazë të përsëritjes së dukurive natyrore si ndërrimi i stinëve, ditë-nata etj. Në kohët e lashta njerëzit i lidhnin ngjarjet me dukuri të tilla, si: thatësira, lufta, përmbytjet, lindja dhe vdekja, pjesët e ditës etj.

Si shembuj të natyrës ciklike në gjuhë janë: emrat e stinëve, ditët e javës, pjesët e ditës etj. Ideja e natyrës ciklike të kohës ekzistonte në shumë popuj të lashtë: për shembull, në tekstet e Vedave, tek egjiptianët e lashtë apo te fiset Maja, ku shihet se si ata përdornin ciklet për të numëruar ose për të matur kohën. Këtu mund të sjellim si shembull edhe kalendarin kinez, dymbëdhjetëvjeçar, ku çdo vit ka emrin e një kafshe.¹

Kjo është koha që përsëritet dhe ne mund ta paraqesim atë si një rrotë. Përsëritja e saj ndjek të njëjtin ritëm, pa një fillim dhe pa një fund. Këto formojnë dhe çerdhet e tyre të fjalëve, por do të përmenden dhe do të analizohen disa prej tyre, më tepër për efekt ilustrimi.

I. *Momentet e ditës*: *ag, agim (agon), agull (agullon, agullim, i agulluar), aksham, darkë, darkëherë, diellon, ditë, ditëmëdrekë, drekëherë, errur-it (të), erret, feks, gdhij-gdhirë, gjysmëmugëtirë, gjysmënatë, iqindi, lëbardhë-a, lindja (e diellit), mbrëmje, mbrëmjesor, menatë, mesditë, mesnatë, mug, mug/et, mugësirë, muzg, muzgëtirë, ndajnatë etj.*

Nga fjala *ditë* janë formuar dhe fjalët: *ditar, ditor, mb. (ditor-i: emër me kuptimin "e nesërmyja e një të kremteje të rëndësishme"), ditor, mëditës, mëditje, paradite, pasdite, përditë, përditësoj, i përditshëm, menatë, mesnatë* etj. Po ndalojmë pak te njësitë *mëditje* dhe *mëditës* të cilat sot merren si formime parashteso-prapashtesore: më+dit(ë)+je, më+dit(ë)+ës prapashtesimi i një togu parafjalor.² Osmanët gjatë sundimit të tyre shumëshekullor në Shqipëri, "duke synuar të siguronin një sundim të qendrueshëm, ata u përpoqën të ndikonin edhe në jetën shpirtërore të popullit tonë nëpërmjet përhapjes së fesë zyrtare, islamizmit."³ Nga këto huazime të sferës fetare që lidhen me kohën leksikore kemi fjalë si: *sabah, iqindi, aksham, iftar, haxh, xhuma, matem, mevlud, nevrud, ramazan* etj, të cilat shprehin veç kohës objective, edhe veprime e rituale që kryen në këto kohë *Mëngjes, drekë, darkë* tregojnë dhe vaktet ditore. Me zgjerimin dhe thellimin e dijeve tona mbi botën apo me ndryshimin e konceptimit të saj, ndryshon edhe strukturimi i fushave konceptore, shtohen në to koncepte të reja ose zhduken koncepte të mëparshme. "Kështu, fusha konceptore e

¹ Abuava, Milana, në:

https://www.researchgate.net/publication/338214929_Comparison_Of_The_Concept_Of_Time_In_English-Russian-And-Chechen-Languages

² Hysa, Enver., *Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe*, T., ASH, 2004, f. 78.

³ Demiraj, Shaban, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, T., Onufri, 2013, f. 175.

vakteve ditore dikur ndahej në pesë koncepte që mbulohehin nga pesë terma të fushës leksikore gjegjëse: *mëngjes, sillë, drekë, zemër dhe darkë*." ⁴

Sot, në kohët e reja kjo gjendje ka ndryshuar, gjë që ka sjellë ristrukturim dhe ngushtimin e fushës konceptore të vakteve, duke i reduktuar ato në tri, rrjedhimisht edhe fusha leksikore gjegjëse është rrudhur në tri fjalë: *mëngjes, drekë dhe darkë*, kurse *sillë* dhe *zemër* kanë kaluar në arkaizma. Emrat e vakteve të ushqimit shërbejnë si tema fjalëformuese për disa folje jokalimtare me prapashtesën **-o**, që ndonjëherë kanë dhe diatezën vetvetore. "Perifraza që motivon kuptimisht këto folje ka këtë përbërje: (ha)+emër në kallëzore, si: *darkoj* (ha darkë), *drekoj* (ha drekë), *silloj* (ha sillë), *zemëroj* (ha zemër). Emri në kallëzore emërton një ushqim ose vaft ushqimor që lidhet me një interval kohor të caktuar." ⁵

Turqizmat dhe orientalizmat që tregojnë kohë (*aksham, iftar, iqindi, sabah, sene (vit), syfyr* edhe vetë fjala *vakt* "kohë"), përvec *sillë*, nuk formojnë fjalë të reja në gjuhën shqipe, sikurse formohen fjalë të tjera nga temat e huazuara (turke dhe orientalizma) me prapashtesa të shqipes dhe prapashtesa të tjera të huaja si: "*argat-argatëri, beqar-beqari, boll-bollshëm (i, e), dembel-dembeli; dembelizëm; dembelos; dembelosem; dembelosje etj*"⁶

Nuk kemi folje në shqip *iftar*oj ose *syfyr*oj nga temat emërore *iftar* dhe *syfyr*, por përdoret ha+emër në kallëzore: *ha iftarin, ha syfyrin*. Sipas J. Thomait "shumë fjalë me burim nga turqishtja nuk janë tema prodhuese për formimin e fjalëve të reja. Kjo karakteristikë është një shenjë që tregon se ato nuk kanë hyrë thellë në strukturën leksikore të shqipes." ⁷

II. Ditët e javës: Java është një interval kohor 7 ditësh. Kjo mund të lidhet me fazat e hënës. Nga një fazë e hënës në fazën pasardhëse kalojnë rreth 7 ditë. Ka më shumë të ngjarë që ajo ta ketë orgjinën në paragjykimet e lashta për rolin e veçantë të numrit 7 dhe vetitë "magjike" të tij. Emrat e ditëve kanë ardhur nga 7 planetët që njiheshin në kohë të lashta. Atëherë planetët ose siç quheshin në lashtësi yj endacakë, quheshin Dielli, Hëna, Marsi, Merkuri, Afërdita (Venera), Jupiteri dhe Saturni. Secili nga këta kishte "nën mbrojtje" një ditë të caktuar, së cilës i jepte edhe emrin. "Këto emra me pak ndryshime përdoren edhe sot në shumë gjuhë." ⁸Ditët e javës në gjuhën shqipe janë huazime prej latinishtes ose janë kalke gjuhësore të krijuara sipas modelit të asaj gjuhe. Me vendosjen e krishtërit si fe zyrtare në Perandorinë Romake, prej Konstandinit, dita e diel "*solis dies-dita e diellit*" u zëvendësua me "*dominica-(vdes) dita e Zotit*". Kjo ishte përdorur nga

⁴Memushaj, Rami, *Hyrje në gjuhësi*, T., Dituria, 2002, f. 167.

⁵Buxheli, Ludmilla, *Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe*, T., ASH, 2008, f. 194.

⁶Latifi, Lindita, *Mbi huazimet turke në gjuhën shqipe krahasuar me gjuhët e tjera të Ballkanit*, T., Dudaj, 2006, f. 531.

⁷Thomai, Jani, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, T., Toena, 2011, f. 260.

⁸Kuri, Vilson., *Mitologjia, besimi dhe filozofia në vendet e Lindjes së Lashtë*, T., Reklama, 2017, f. 144.

Tertuliani si kalk nga greqishtja "κυριακή".⁹ Nyja e përparme e dëshmon se ka dalë nga një sintagmë me dy emra nga të cilit i dyti në rasën gjinore: *dita e hënë*, *dita e martë* etj. "Gjinia e nyjës përkon me atë të emrit ditë."¹⁰

Dita e enjte dhe e premte mbeten të errëta për nga burimi. "Për ditën e enjte, -K. Topalli supozon se mund të ketë kuptim fakti se në traditën e kishës romane njihen disa emërtime të veçanta të kësaj dite, si: *e Enjtja e Madhe*, *e Enjtja e flive*, *e Enjtja e petullave*, *e Enjtja e Majme* (khs.it. *Giovedì Grasso*), duke shprehur të gjitha të njëjtën gjë: ditën e fundit para se të fillojnë kreshmët, gjatë të cilave nuk hahet mishi e bulmeti. Në këtë ditë besimtarët janë të lejuar të hanë gjithçka dhe derisa të ngopen, sepse të nesërmen fillojnë kreshmët. Prandaj edhe emri i kësaj dite mund të lidhet me foljen *anjem/ënjtem* (khs. shprehjen *u aja tue ngranë*).." ¹¹

Ndërsa dita e premte mund të lidhet brenda gjuhës me *pramë* "mbrëmë" (Meyer), domethënë një ditë para së shtunës, meqënëse e *premtja* ka qenë dita e fundit te latinët, që e nisnin numërimin e ditëve nga dita e shtunë. Pjesa fundore *-te* është prapashtesë sikurse te *e enjte*.¹² Dita e shtunë ka shërbyer si temë fjalëformuese për emrin *shtunak*, me kuptimin: ai që shkon diku për të kaluar natën si mysafir kur kthehet nga dita e pazarit (zakonisht të shtunave).

Ndërsa ditët e tjera të javës nuk kanë shërbyer si tema fjalëformuese për njësi të reja, përjashto disa antroponime dhe patronime, si: Prend, Prendë, Premto-Prendi, Prendushi, Premtja etj, që etimologjikisht motivohen nga dita e *premtë*.

III. Muajt e vitit. Emërtimi i muajve të vitit paraqitet mjaft interesant në gjuhën shqipe, sepse përveç emrave të sistemit letrar, të cilat janë ose huazime nga gjuhët e tjera (përkatesisht nga latinishtja, ndonjë edhe nëpërmjet greqishtes-*janar* dhe sllavishtes- *kollozheg*), ose kalke gjuhësore *shtator*, *tetor*, *nëntor*, *dhjetor*, por kemi dhe emra muajsh të cilët janë formime të brendshme të vetë shqipes. Muajtë në gjuhën letrare shqipe janë: *janar* (*djegqerrës*, *kallnor*, *kollozhek*), *shkurt* (*frori*), *mars*, *prill*, *maj*, *qershor*, *korrik* (*djegagur*), *gusht*, *shtator* (*vjeshtë e parë*), *tetor* (*vjeshtë e dytë*), *nëntor* (*brymor*, *vjeshtë e tretë*, *shëmëhill*, *shëmitër*), *dhjetor* (*digjepiq*, *shënëndre*).

Emërtimet e muajve të cilët i kemi vendosur mes kllapave janë fjalë të vjetruara që i përkasin ligjërimin bisedor ose përdoren si variante stilistike.

⁹ La Cultura Italiana – Enciclopedia – Treccani: <https://www.treccani.it/enciclopedia/>

¹⁰ Topalli, Kolec., *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Durrës, Bot. Jozef, 2017, f. 942.

¹¹ Topalli, Kolec., *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Durrës, Bot. Jozef, 2017, f. 448.

¹² Topalli, Kolec., *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Durrës, Bot. Jozef, 2017, f. 1182.

Sipas Oda Buhholc dhe Vilfrid Fidler, ndarja e vitit, në gjuhët e njohura prej tyre, bëhet sipas dy pikëpamjesh të ndryshme:

1) sipas dy periudhash të rregullta, pothuaj, barabar të gjata të dymbëdhjetë muajve-kjo ndarje është bërë, siç dihet, në antikitetin e vonë;

2) sipas periudhave që nuk janë detyrimisht të rregullta e barabar të gjata-këto lidhen me punimet bujqësore, me dukuri meteorologjike, me ditët e festave etj.¹³ Këto dy sisteme emërtimi ndikojnë në mënyrë të ndërsjellë mbi njeri-tjetrin. Kështu, veçanërisht, në emërtimet popullore të muajve kanë hyrë shumë emra që orgjinarisht i përkisnin sistemit të dytë.

Duke u nisur nga ndarja e njohur e *Miklošič*-it, autorët e lartpërmendur, emrat shqiptarë të muajve pasqyrohen sipas parimeve të mëposhtme. Po përmendim nga artikulli vetëm emrat e muajve të pasqyruarar në Fjalorin e gjuhës shqipe, 2006.

i. Emra muajsh nga bota bimore të cilët lidhen me rritjen, pjekjen e bimëve të ndryshme: *qershor* "muaji që piqen qershitë".

ii. Emra muajsh që lidhen me botën shtazore nuk kemi gjetur, ndësa në gjuhët sllave ka për shembull emra muajsh që lidhen me emërtime për "krimbat", "karkalecat", "dhi" etj.

iii. Emra sipas dukurive natyrore në tërësi: *brymor*, *djegagur*;

iv. Emra muajsh që lidhen me punë që përsëriten periodikisht: korrik (nga *korr*-koha e të korrave), *vjeshtë* lidhet me vjeljen e rrushit, pastaj ka marrë kuptimin e gjithë stinës (Çabej).

v. Emra muajsh sipas zakoneve e festave: para së gjithash këtu duhet përmendur *kollozhek*. Këtu hyjnë edhe emërtimet sipas emrave të shenjtoreve, të cilët janë të lidhur me festa të caktuara-pikërisht në Shqipëri shpesh me orgjinë para krishtërim-it-që janë shkrirë me ritet e fesë së krishterë. Është fjala për *shëmitër*, *shëmëhill*, *shëndre*.

vi. Emra muajsh sipas radhës së muajve për periudhën nga shtatori në dhjetor, të cilët janë të shpeshta në gjuhët evropiane.¹⁴

Gjatë periudhës së gjithë vitit, ne shohim mjaft dukuri si shtegtimi i shpendëve, të vjelat e bujqësisë etj, por nuk kemi emërtim muaji nga emrat e tyre, emra shpendësh a kulturash bujqësore. Vetëm *qershori* emërtohej si i tillë për shkak se në këtë periudhë piqet qershia, ndërsa për fruta dhe bimë të tjera nuk kemi ndonjë muaj tjetër të emërtuar prej tyre. E kundërta ndodh, prodhimet e stinës emërtohen ose cilësohen nga muaji, si *misër* ose *duhan gushtak*, *zog gushtarak*, *dardhë gushtje*, *dardhë (mollë) korrikje*, *dimarak-pjepër* i verdhë që rron edhe për dimër, *dimërake*; që piqet vonë ose që mund të ruhet për dimër, *dimëror*: mollë dimërake. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për prodhimet, për mbledhjen apo vjeljen e tyre: ato nuk

¹³ Buhholc, O., Fidler, V.: "Emrat e muajve në gjuhën shqipe" në *Studime filologjike dhe pedagogjike për nder të Prof. dr. Aleksandër Xhuvanit*, T., ASH, 1986, f. 589.

¹⁴ Buhholc, O., Fidler, V.: "Emrat e muajve në gjuhën shqipe" në *Studime filologjike dhe pedagogjike për nder të Prof. dr. Aleksandër Xhuvanit*, T., ASH, 1986, f. 590.

mblidhen njëherësh të gjitha dhe nga kjo kemi emërtimet e muajve të vjeshtës: *vjeshtë e parë, vjeshtë e dytë, vjeshtë e tretë*, përkatësisht, për *shtator, tetor, nëntor*.

Nga dukuritë atmosferike, si "brymë" kemi emërtimin *brymor*. Shtojmë këtu *djegagur*-koha më e nxehtë e vitit-, kur piqet edhe guri. *Digjepiq* me rrugë metaforike emërton *dhjetorin*, sepse është periudha e dimrit nga fillimi deri në fund të dhjetorit kur nuk punohet e rrihet pranë vatrës.

IV. Shenjat e horoskopit. Horoskopi është parashikimi i fatit të njerëzve sipas astrologjisë-shenjave të zodiakut-, duke u mbështetur në datën e lindjes. Astrologjia është një nga mjeshtritë më të lashta. Që në epokën primitive njerëzit filluan të shfaqin interes të veçantë për dukuritë qiellore, vetë trupat qiellorë u personifikuan si perëndi. Që këtej lindi dhe ideja për aftësinë e jashtëzakonshme të trupave qiellorë për të ndikuar në jetën e njeriut.¹⁵ Këto *shenja* të horoskopit janë kalke gjuhësore dhe mendoj se termat e horoskopit janë një huazim kulturor i kohëve relativisht të fundit.

V. Stinët në gjuhën shqipe janë: *pranvera, vera (behari), vjeshta, dimri*. Si sinonime të saj, të fjalës *stinë*, janë përdorur edhe fjalët *herë, radhë*. Emrat e stinëve duke shërbyer si tema fjalëformuese kanë krijuar çerdhet e tyre të fjalëve, si: *pranveror, veror, verigë-mollë kokërvogël* që piqet në verë, *veroj, verim, verëz-dita e parë e pranverës-, verojkë, vjeshtarak, vjeshtor, vjeshtuk, dimërak, dimëroj, dimëror, dimërishtë* etj.. Edhe këtu vihet re se veprime, sende, gjallesa apo dhe vende, si p.sh. *dimërishtë-kullotë dimërore-*, lidhen me emrat e stinëve.

U përmend dhe më sipër se *vjeshtë* lidhet me *vjel*, ajo ka pasur në fillim kuptimin *vjelje e rrushit*, pastaj kuptimin e gjithë *stinës së vjeshtës* dhe mandej me ndërrim të gjinisë *vjeshti* mori kuptimin e muajit.”¹⁶

Njësitë *stinë* (sinon. *herë*) *ditë, natë, muaj, vit* shërbejnë si tema fjalëformuese për: **1. ndajfolje**-sipas tipit: **për-** +emër që tregon fragment kohe si: *përditë, përnatë, përvit*, ku këto shërbejnë si tema për mbiemrat *i përditshëm, i përnatshëm, i përmuajshëm* (em. *të përmuajshmet*) etj.. Prej emrave të stinëve si dhe prej njësive që matim kohën, si: sekondë, minutë, orë etj., nuk kemi mbiemra të këtij lloji, si: *i përsekondshëm, i përورشëm, i përshkullshëm* etj.

Kjo ndodh për shkak të kufizimit që ka tipi parashteso-prapashtesor në formimin me ndajshtesa, konversioni në formimin pa ndajshtesa dhe përngjitja në formimin me bashkim fjalësh. Kufizimi në këto tipe rrjedh nga veçoritë e mënyrave dhe të mjeteve që përdoren për formimin e fjalëve. Kështu, për formimet parashteso-prapashtesore, qoftë lidhja e

¹⁵Kuri, V., *Mitologjia, besimi dhe filozofia në vendet e Lindjes së Lashtë*, T., Reklama, 2017, f. 33.

¹⁶Buhholc, O., Fidler, V.: "Emrat e muajve në gjuhën shqipe" në *Studime filologjike dhe pedagogjike për nder të Prof. dr. Aleksandër Xhuvanit*, T., ASH, 1986, f. 584.

drejtëpërdrejtë e ndajshesave me rrënjën, qoftë përngjitja e sintagmave nuk janë të pakufizuara.¹⁷

2.prej emrave të stinëve si dhe prej emrave *ditë, muaj, javë* (përveç natë) formohen **mbiemra** me: **-or**, si: *dimëror, veror, mujor, pranveror* etj; me **-ak**: *verak, vjeshtak, vjeshtarak, (vjeshtuk) dimërak*. Formohen mbiemra të tipit: numëror (a për. i packt + mbiemër i prejardhur si: *njëvjeçar, dyvjeçar, pesëditor, disaditor, disavjeçar* etj; ose mbiemra të tipit: numëror (a për. i pacakt)+një emër, që tregon kohë+sh, si: *disaditësh, pesëminutësh, trejavësh etj.*¹⁸

3.folje-prej emrave të stinëve si dhe prej "mot" formohen folje me temë në **-o**, si: *beharoj, veroj, dimëroj, vjeshtoj, motoj*, me kuptimin "kaloj një interval të caktuar kohe", sipas asaj që emërtohet nga tema fjalëformuese, veprim që kryhet në një ndërkohë të caktuar."¹⁹ *Ditë* dhe *vit* shërbejnë si tema fjalëformuese për formimin e foljeve me parashtesën **stër-**, si *stërditem, stërvit*. Me këtë parashtesë formohen prej temave emërore a foljore folje me funksion faktitiv- kauzativ.²⁰

II. Cikli jetësor.

Cikli jetësor i njeriut. Fjala "cikël" i referohet një lëvizjeje rrethore, e projektuar në kohë, por *cikli jetësor* është një kohë lineare, sepse qenia njerëzore kalon vetëm njëherë në fazat e saj: *lindja, rritja, pjekuria dhe vdekja*. Ky proces nuk përsëritet më tek i njëjti individ. Sintagma *cikël jetësor* nënkupton vazhdimësinë e brezave (riprodhimin, kulturën etj). Brenda cilit jetësor të njerëzve, si edhe kafshëve, ka procese fiziologjike dhe biologjike që përsëriten në mënyrë ciklike, si: cikli menstrual, rrahjet e zemrës, frymëmarrja, gjumi-zgjimi; ose te kafshët: migrimi, gjumi dimëror, cikli i ovulacionit, rënia e qimeve etj.. Këto janë kohë ciklike.

Jeta për qenien njerëzore fillon që me stadin embrional. Kësaj periudhe i përgjigjen njësitë: *nënëri (nënësi), paralindje, shtatzanësi, shtazëni*. Periudhën e parë shqipja e shpreh me njësitë *bebe, foshnjë, kërthi, njome/ja, njomëz*, etj.. Jeta, si kohë, paraqitet si një segment me dy skaje: *ditëlindja* dhe *ditëvdekja (fundit, sosja, shkurtja)*. Fazat apo stadet e moshës përfaqësohen në gjuhë nga emra përmbledhës (përfashtoj *adoleshencë*, e cila nuk është si zë më vete në Fjalor), të cilët kanë edhe kuptim kohor, të formuar sipas modelit: temë emërore (a një mbiemër)+-(ë)ri: *foshnjëri, djalëri, vashëri, burrëri, pleqëri*.²¹

Në kategorinë e këtyre emrave që nga ana semantike emërtojnë një fazë të caktuar kohore në moshë e tij, një gjendje një, veprimtari apo status civil,

¹⁷Thomai, Jani., *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, T., Toena, 2011, f. 193.

¹⁸Dhrimo, Ali.: "Formimi i mbiemrave në gjuhën shqipe", në *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme*, Vëll. 2, T., ASH, 1975, f. 185-186.

¹⁹Buxheli, Ludmilla., *Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe*, T., ASH, 2008, f. 195.

²⁰Xhuvani, Aleksandër., *Vepra*, Vëll. 1, T., ASH, 1980, f. 405.

²¹*Gramatika e gjuhës shqipe*, Vëll. 1, T., ASH, 2002, f. 86-87.

janë edhe emrat e tipit temë emërore (një mbiemër a pjesore)+ **-ni/-i** si: *brezni, rini, shtalbnî beqari, mituri, vogëli* apo *leni*- që mendohet si krijim i ndonjë intelektual. ²²

Në kontekste të caktuara historiko-shoqërore, si periudha komuniste (shih Fjalorin e 1980-ës), për fëmijët janë përdorur edhe njësitë me ngarkesë ideologjike, si: *fatos* - nxënës i ciklit të ulët të shkollës tetëvjeçare deri në moshën nëntë vjeç, para se të hyjë në organizatën e pionierit, *pionier* - anëtar i organizatës për fëmijë të moshë 10 deri 15 vjeç, *yllkë* - fëmijë në moshën parashkollore.

Mosha, veç matjes kalendarike, e cila lidhet me datën e lindjes, identifikohet dhe merr referencë edhe në raport me moshën e dikujt tjetër ose të një grupi të tërë njerëzish, si: *brez, ortë, teste, vërsë*; mbiemrat që cilësojnë njerëzit në një moshë ose e përafërt, si: *moshatar* (përdoret edhe me kupt. *i vjetër*), *bashkëmoshatar, njëmoshës, kohanik, vërsnik* etj. Shtojmë këtu *kohanik, vërsnik*, që formohen sipas modelit: temë emërore+ **-nik/-anik**. Me këtë të fundit prej temave numërore formohen *shtatanik, tetanik*.²³ Mosha e vjetër: kjo fazë cilësohet prej një sërë mbiemrash, si: *plak (plakarec, plakaruq), i moshuar, moshëthyer, i kahmotshëm, i qëmotshëm* (dy të fundit formohen sipas modelit: nyjëzim+temë emërore (jo e parme)+ **-shëm**.

Vdekja, ky moment i befasishëm në jetën e njeriut, i cili është pjesë përbërëse e ekzistencës sonë (*Heidegger*)²⁴, ndodh që nuk respekton një kohë kronometrike të caktuar, një ditë të caktuar. Këtë moment shqipja e cilëson me një sërë kompozitash mbiemërore ekzocentrike ²⁵ (edhe si emra), si: *ditëfarosur, ditëprerë, ditësosur, ditëshkurtër*.

Krahas këtyre kompozitave, janë formuar edhe kompozitat në raporte sinonimike me to, me gjymtyrë me fjalët *jetë, ymër*, si: *jetëshkurtër, jetëgjatë, ymërshkurtër* etj.. Sipas botëkuptimit fetar, pas vdekjes fillon një jetë tjetër dhe njësitë për këtë janë: *përtejbotë, përtejavarr*, të cilat janë, më tepër, formime me përngjitje se sa formime me siparashtesën **përtej**-. Si zakon, për përkujtimin dhe respektin ndaj të ndjerit kemi njësitë: të tretat, të shtatat, të dyzetat, të cilat kanë vlerë deiktike, sepse marrin referencë nga momenti i vdekjes së individit. Këta emra, sikurse edhe emrat e disa festave të caktuara përdoren në shumës (*pluraliantum*)²⁶

Cikli jetësor, i cili përcakton vazhdimësinë e **gjallesave**, nuk është një veçanti vetëm e njeriut, por dhe e bimëve e kafshëve. Një flutur do të kalojë në fazat: *vezë-larvë (vemje)-pupë-flutur* (faza e rritur). Edhe bimët duke

²²Topalli, Kolec, *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Durrës, Bot. Jozef, 2017, f. 873.

²³Xhuvani, Aleksandër, *Vepra*, Vëll. 1, T., ASH, 1980, f. 518.

²⁴Hersch, Jeanne, *Habia filozofike*, T. Dituria, 1993, f. 287.

²⁵ Kostallari, Androkli, "Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese", në *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, T., USHT, 1972.

²⁶ Agalliu, Fatmir, "Emrat që përdoren vetëm në shumës në gjuhën shqipe", në *Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme*, T., USHT, 1972, f. 99.

kaluar në ciklin e tyre (*farë-mbirje-filiz-fidan-rritje-lulëzim-pjekje* dhe sërisht *farë*; ose pemët (jo në kuptimin e jetëgjatësisë së tyre, por në ciklin njëvjeçar) *syth-burbuqe (gonxhe)-filiz-lulëzim-frut*. Këtyre ndryshimeve gjatë ciklit të një bime u përgjigjen foljet përkatëse jokalimtare që motivohen kuptimisht: (*lëshon, çel*)+*emër në kallëzore* me kuptimin: *lëshon a nxjerr atë që emërton tema fjalëformuese*.²⁷

Një shumësi kafshësh emërtohen sipas tiparit të moshës së tyre. Ndryshe emërtohet kafsha kur është e vogël dhe ndryshe në fazat e mëtejshme të jetës së saj. Këtu mund të përmendim emërtimet: *kec-karçine-ftujë-dhi*; *kec*-i vogli i dhisë, *karçin*- keci në moshën kur shkeputet nga e ëma, *ftujë*-kec femër një deri në dy vjeç, ndërsa *dhi*-ka arritur moshën për të pjellë, megjithëse në raste të tilla ndiqet nga mbiemri *pëlle*, ndërsa kur kafshët pjellin para kësaj moshe, kemi emërtimet: *llashkë*-dele, *dhi* a *lopë* që ka pjellë një vit para kohës së zakonshme-, *paligjë (paligaçe, paliqe* etj.).

Ky punim dëshmon se gjithmonë ka vend për thellim dhe zgjerim, sepse këtu përfshihet një kombinim i leksikologjisë, semantikës, gramatikës, filozofisë, etnografisë dhe ndërveprimet kulturor, duke nxjerrë në pah jo vetëm veçoritë e shqipes si gjuhë, por dhe botëkuptimin tonë si komb për konceptin e kohës dhe ciklet jetësore.

Bibliografia

- Buxheli, Ludmilla, *Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe*, T., ASH, 2008.
Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme, T., USHT, 1972.
Çështje të gramatikës së shqipes së sotme, Vëll. 2, T., ASH, 1975.
Demiraj, Shaban., *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, T., Onufri, 2013.
Dibra, K., Varfi, N., *Gjuhësi teksti*, T., SHBLU, 1999.
Fjalori i gjuhës shqipe, (Thomai, J. etj., (red. shkencor), T., ASH, 2006.
Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, (Kostallari, A. etj., (red. shkencor), T., ASH, 1980.
Gramatika e gjuhës shqipe, Vëll. 1, T., ASH, 2002.
Hersch, Jeanne., *Habia filozofike*, T. Dituria, 1993.
Hysa, Enver, *Formimi i emrave me ndajshesa në gjuhën shqipe*, T., ASH, 2004.
Kuri, Vilson, *Mitologjia, besimi dhe filozofia në vendet e Lindjes së Lashtë*, T., Reklama, 2017.
Latifi, Lindita, *Mbi huazimet turke në gjuhën shqipe krahasuar me gjuhët e tjera të Ballkanit*, T., Dudaj, 2006.
Memushaj, Rami, *Hyrje në gjuhësi*, T., Dituria, 2002.
Ricoeur, Paul., *Time and narrative*, 3 v., Chicago, Univ. of Chicago Press, 1984.
Rrokaj, Shezai., *Filozofi e gjuhës*, T., Arbëria, 2010.

²⁷Buxheli, Ludmilla, *Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe*, T., ASH, 2008, f. 195.

Studime filologjike dhe pedagogjike për nder të Prof. Dr. Aleksandër Xhuvanit, T., ASH, 1986.

Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, T., USHT, 1972.

Topalli, Kolec, *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Durrës, Bot. Jozef, 2017.

Thomai, Jani, *Leksikologja e gjuhës shqipe*, T., Toena, 2011.

Xhuvani, Aleksandër, *Vepra*, Vëll. 1, T., ASH, 1980.

Studime filologjike, (revistë), Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë të ASHSH-së, Tiranë, 1964.

Burime elektronike:

Abuava, Milana, në:

https://www.researchgate.net/publication/338214929_Comparison_Of_The_Concept_Of_Time_In_English_Russian_And_Chechen_Languages

La Cultura Italiana – Enciclopedia – Treccani:
<https://www.treccani.it/enciclopedia/>

INTELIGJENCA EMOCIONALE DHE ROLI I SAJ NE EDUKIM

Valbona Caushi¹, Eralda Zhilla²

¹Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale
e-mail: valbona.caushi@gmail.com

²Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale
e-mail: eraldazhilla@yahoo.com

Abstrakt

Inteligjenca emocionale (IE) luan një rol të pazëvendësueshëm në përmirësimin e jetës personale dhe profesionale të individëve, veçanërisht, në fushën e edukimit. Ky artikull hulumton thellësisht konceptin e inteligjencës emocionale, që nga origjina e tij dhe zhvillimi teorik deri te ndikimi praktik në arsim. Pasi analizon teoritë kryesore dhe modelet e inteligjencës emocionale, artikulli shqyrton studime empirike që demonstrojnë lidhjen midis IE-së dhe performancës akademike, marrëdhëniet ndërpersonale dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve. Po ashtu, trajtohen strategji dhe praktika për integrimin e trajnimit të IE-së në kurrikulat shkollore, duke ofruar rekomandime për përmirësimin e sistemit arsimor. Rezultatet e studimeve tregojnë se inteligjenca emocionale ndihmon mësuesit të menaxhojnë stresin, të ndërtojnë marrëdhënie efektive me nxënësit dhe të krijojnë një mjedis mësimor më pozitiv. Për më tepër, nxënësit me nivel të lartë të IE-së tregojnë përmirësime të konsiderueshme në arritjet akademike dhe aftësitë sociale, duke nënvizuar rëndësinë e zhvillimit të kësaj kompetence në shkolla.

Fjalët kyçe: *Inteligjenca emocionale (IE), arsim, performanca akademike, aftësi sociale, mjedis mësimor pozitiv.*

Abstract

Emotional intelligence (EI) is irreplaceable in enhancing individuals' personal and professional lives, particularly in education. This article delves deeply into emotional intelligence, tracing its origins and theoretical development, and examining its practical impact on education. After analyzing the main theories and models of emotional intelligence, the article reviews empirical studies that demonstrate the connection between EI and academic performance, interpersonal relationships, and problem-solving skills. Additionally, strategies and practices for integrating EI training into school curricula are addressed, providing recommendations for improving the educational system. The findings indicate that emotional intelligence helps teachers manage stress, build effective relationships with students, and

foster a more positive learning environment. Furthermore, students with high levels of EI show significant improvements in academic achievement and social skills, underscoring the importance of developing this competence in schools.

Keywords: *Emotional Intelligence (EI), education, academic performance, social skills, positive learning environment.*

1. Hyrje

Në një botë gjithnjë e më të ndërlikuar dhe të ndikuar nga zhvillimet teknologjike, ekonomike dhe sociale, inteligjenca emocionale është bërë një kompetencë thelbësore për individët në çdo fushë të jetës. Shoqëria moderne kërkon aftësi jo vetëm për të përballuar sfidat e reja, por edhe për të ndërtuar marrëdhënie të shëndetshme dhe për të zgjidhur problemet me efikasitet. Në këtë kontekst, inteligjenca emocionale luan një rol kyç duke integruar ndjenjat, mendimet dhe veprimet në një mënyrë harmonike dhe të balancuar. Koncepti i inteligjencës emocionale, siç theksojnë Gardner (1983, 1993) dhe Goleman (1995), përfshin aftësi si vetëdija emocionale, menaxhimi i emocioneve dhe empatia. Këto aftësi janë të domosdoshme për individët që të arrijnë sukses personal dhe profesional, veçanërisht në profesione të ndërlidhura me ndërveprime sociale, siç është mësimdhënia. Në mjediset shkollore mësuesit nuk janë thjesht mbartës të njohurive akademike, por edhe modelues të sjelljes sociale dhe emocionale për nxënësit e tyre.

Sfidat e mësuesve në shkolla përfshijnë menaxhimin e një klase me nxënës nga prejardhje të ndryshme kulturore dhe sociale, trajtimin e situatave stresuese dhe ndërtimin e marrëdhënieve pozitive. Për të përballuar këto sfida, mësuesit kanë nevojë për një nivel të lartë të inteligjencës emocionale, që u mundëson atyre të qëndrojnë të ekuilibruar emocionalisht, të komunikojnë në mënyrë efektive dhe të frymëzojnë nxënësit për të arritur potencialin e tyre maksimal.

Përveç kësaj, zhvillimi i inteligjencës emocionale është i rëndësishëm edhe për nxënësit. Një shkollë që mbështet zhvillimin e IE-së promovon një mjedis ku nxënësit mund të ndihen të sigurt, të respektojnë njëri-tjetrin dhe të zhvillojnë aftësi për të menaxhuar emocionet e tyre. Këto aftësi janë të rëndësishme jo vetëm për suksesin akademik, por edhe për jetën e tyre personale dhe profesionale.

Ky artikull shqyrton në mënyrë të detajuar rëndësinë e inteligjencës emocionale në edukim, duke përfshirë teoritë kryesore, studimet empirike dhe mënyrat për të integruar IE-në në kurrikulat shkollore. Qëllimi është të ofrohen rekomandime konkrete për mësuesit dhe drejtuesit arsimorë për të nxitur zhvillimin e një mjedisi arsimor të ekuilibruar dhe të ndjeshëm ndaj nevojave emocionale të të gjithë pjesëmarrësve.

2. Teoritë kryesore

Zhvillimi i Konceptit të Inteligjencës Emocionale

Koncepti i inteligjencës emocionale ka evoluar ndjeshëm që nga origjina e tij. Edward Thorndike, në vitet 1930, e përshkroi si “inteligjencë sociale”, aftësinë për të kuptuar dhe menaxhuar marrëdhëniet me të tjerët. David Wechsler, në vitet 1940, theksoi se aspektet emocionale të inteligjencës luajnë një rol të rëndësishëm në suksesin e përgjithshëm të individit. Në vitin 1985, Wayne Payne përdori termin “inteligjencë emocionale” në disertacionin e tij, duke i dhënë rëndësi ndikimit të emocioneve në proceset mendore.

Më pas, Peter Salovey dhe John Mayer (1990) e formalizuan konceptin duke e përkufizuar si aftësinë për të perceptuar, kuptuar dhe menaxhuar emocionet e vetes dhe të të tjerëve. Ata ndanë IE-në në katër përbërës kryesorë: perceptimi i emocioneve, përdorimi i emocioneve për të lehtësuar mendimin, kuptimi i emocioneve dhe menaxhimi i tyre. Kjo qasje u bë bazë për kërkimet e mëtejshme në këtë fushë.

Termi inteligjencë emocionale u bë më i njohur përmes Goleman (1997, 2005), i cili e përshkroi inteligjencën emocionale si aftësinë për të njohur ndjenjat dhe emocionet e veta, aftësinë për të motivuar dhe kontrolluar ndjenjat në vetvete dhe në marrëdhëniet e dikujt me të tjerët. Goleman theksoi se IE-ja e lartë nuk është një garanci suksesi. Ai ka treguar se inteligjenca emocionale është faktori më i rëndësishëm që ne kemi për t’u përshtatur me të tjerët, si dhe për të rritur aftësinë për performancë në marrëdhëniet ndërpersonale në fusha të ndryshme të punës sonë. Inteligjenca emocionale është një komponentë i suksesit në jetë. Ai përfshin aftësi që janë të dallueshme, por plotësohen me aftësi njohëse të inteligjencës akademike të matëshme nëpërmjet, Koeficientit të Inteligjencës (IQ), (Goleman, 1997, 2005; Simmons & Simons, 2000). Goleman, gjithashtu, zhvilloi modelin e fushave bazë të inteligjencës emocionale. Modeli përfshin aftësi themelore emocionale dhe sociale: (1) *Të qenit i vetëdijshëm ose njohja e emocioneve të dikujt*: ne duhet të jemi në gjendje të njohim dhe perceptojmë jo vetëm emocionet tona po edhe të të tjerëve rrotull nesh dhe kështu mund të jemi më tolerantë ndaj vendimmarrjeve tona. (2) *Vetëkontrolli ose menaxhimi i emocioneve të dikujt*: Për të shmangur një stres emocional, zotërimi i emocioneve është elementi parësor që këto të fundit të mos ndërhyjnë në jetën tonë, por të kemi mundësi t’i përballojmë ato. (3) *Vetëpromovimi ose vetë-motivimi*: përdorimi i të gjithë aftësive personale për të ndjekur qëllimet dhe për të kapërcyer pengesat dhe zhgënjimet. (4) *Empatia ose njohja e ndjenjave të të tjerëve*: njohja e ndjenjave na lejon ta vendosim veten në vendin e tjetrit për të kuptuar emocionet e tij. Një mënyrë kjo për të mbajtur marrëdhënie dhe për t’u lidhur me njerëzit pavarësisht personalitetit të tyre. Të kuptuarit e përjetimeve emocionale të të tjerëve na ndihmon të udhëheqim më mirë veten tonë në ndërveprim me të tjerët dhe të jemi në gjendje të punojmë në ekipe të suksesshme pune. (5) *kopetenca sociale*: menaxhimi i emocioneve në marrëdhënie me të tjerët dhe njohja e saktë e rrethanave dhe marrëdhënieve shoqërore, ndërveprimi i vazhdueshëm me të tjerët, njohja e

saktë e rrethanave dhe marrëdhënieve shoqërore, aftësia për të bindur, udhëhequr, negociuar dhe zbutur konfliktet dhe bashkëpunimin në ekip.

Studiuesit modernë ndajnë inteligjencën emocionale në dy modele kryesore: modelet e bazuara në aftësi dhe modelet e bazuara në tipare. Modelet e bazuara në aftësi, si ai i Salovey dhe Mayer, e përkufizojnë IE-në si një grup aftësish që mund të mësohen dhe zhvillohen. Ndërsa modelet e bazuara në tipare, si ai i Petrides dhe Furnham (2001), e shohin IE-në si një tipar personaliteti të ndikuar nga gjenetika dhe mjedisi. Këto qasje ofrojnë këndvështrime të ndryshme për studimin dhe aplikimin e IE-së në fusha si arsimi, biznesi dhe shëndeti mendor.

Në përgjithësi, këto teori dhe modele theksojnë rëndësinë e zhvillimit të inteligjencës emocionale si një faktor kyç për suksesin individual dhe shoqëror.

3. Studimet kryesore

Lidhja e IE-së me Performancën e Mësuesve dhe Nxënësve

Studimi i Goleman-it (1995) ka argumentuar se zhvillimi i IE-së është i domosdoshëm për suksesin në shkollë dhe në jetë. Ai identifikoi pesë komponente kryesore të IE-së: vetëdija emocionale, menaxhimi i emocioneve, motivimi, empatia dhe aftësitë sociale. Studimet që pasuan, bazuar në teorinë e Goleman-it, sugjerojnë se nxënësit që zhvillojnë këto aftësi kanë mundësi më të mëdha për të pasur sukses akademik dhe për të krijuar marrëdhënie të shëndetshme në klasë dhe jashtë saj.

Studimi i Elias et al. (1997) dhe kolegët e tij ka zbuluar se programet e edukatës emocionale që fokusohen në zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale kanë ndikim të drejtpërdrejtë në suksesin akademik të nxënësve. Programet që përfshijnë mësimet mbi empatinë, vetëkontrollin dhe menaxhimin e emocioneve ndihmojnë në uljen e dhunës në shkolla dhe përmirësojnë rezultatet e nxënësve në lëndët shkollore.

Studimi i Todd (2006) analizoi ndikimin e inteligjencës emocionale në performancën e mësuesve duke përfshirë një kampion të gjerë mësuesish në shkolla publike. Rezultatet treguan se mësuesit me një nivel të lartë të IE-së kishin aftësi të përmirësuara për të zgjidhur konfliktet në klasë dhe për të ruajtur një mjedis pozitiv të të nxënësve. Studimi sugjeroi që trajnimet për IE-në duhet të jenë pjesë integrale e zhvillimit profesional të mësuesve.

Roli i IE-së në Edukimin Kundër Bullizmit

Elias (2003) hulumtoi rolin e inteligjencës emocionale në parandalimin dhe menaxhimin e bullizmit në shkolla. Ai analizoi të dhënat nga shkollat fillore dhe të mesme dhe tregoi se programet që përfshijnë trajnim në IE ndihmuan në uljen e incidenteve të bullizmit. Nxënësit që morën pjesë në këto programe kishin një nivel më të lartë të vetëdijes emocionale dhe aftësi më të mira për të menaxhuar emocionet negative si zemërimi dhe zhgënjimi.

Studimi i Mayer, Salovey dhe Caruso (2004) zhvilluan një model tjetër të IE-së, të cilin e quajtën "The Ability Model of Emotional Intelligence". Ky model përqendrohet në aftësinë për të identifikuar, përdorur, kuptuar dhe menaxhuar emocionet. Studimet e këtij grupi sugjerojnë se nxënësit me nivele të larta të IE-së janë më të aftë në të mësuarit, sepse ata mund të menaxhojnë emocionet që lidhen me stresin dhe të ndërveprojnë më mirë me bashkëmoshatarët dhe mësuesit.

Studimi i Durlak et al. (2011) dhe kolegët ka vlerësuar efektet e programeve të edukatës emocionale në performancën e nxënësve. Rezultatet kanë treguar se nxënësit që ishin pjesë e këtyre programeve kishin përmirësime në aftësitë e tyre sociale, si dhe në rezultatet akademike. Për më tepër, studimi ka sugjeruar se zhvillimi i inteligjencës emocionale ka një ndikim të qëndrueshëm në jetën e nxënësve, duke i ndihmuar ata të përballen më mirë me stresin dhe të përmirësojnë marrëdhëniet ndërpersonale

Ndikimi i IE-së në Suksesin Akademik

Studimi i Zinsser et al. (2015) dhe kolegët e tij ka hetuar ndikimin e trajnimit të inteligjencës emocionale te mësuesit dhe nxënësit. Ata kanë zbuluar se mësuesit që ishin të trajnuar për të zhvilluar IE-në e tyre ishin më të aftë për të krijuar një mjedis klasor që nxit zhvillimin emocional të nxënësve. Kjo gjithashtu ka pasur ndikim pozitiv në nivelin e performancës akademike dhe në aftësitë e nxënësve për të menaxhuar konfliktet dhe emocionet e tyre.

Rosario et al. (2018) realizuan një studim longitudinal me nxënës të arsimit të mesëm, duke ndjekur zhvillimin e tyre akademik dhe social për tri vite. Rezultatet treguan se nxënësit me IE të lartë jo vetëm që performuan më mirë akademikisht, por gjithashtu shfaqën aftësi të përmirësuara për të bashkëpunuar në projekte grupore dhe për të ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme me bashkëmoshatarët e tyre.

Trajnimi i IE-së për Mësuesit

Studimi i Hwang (2007) eksploro efektet e programeve të trajnimit të IE-së për mësuesit në Azinë Juglindore. Ai gjeti se mësuesit që morën pjesë në trajnimet e fokusuara të IE-së raportuan një ulje të ndjeshme të stresit dhe një përmirësim të dukshëm në menaxhimin e klasave. Studimi sugjeroi që trajnimi i vazhdueshëm për IE-në duhet të përfshihet në politikën arsimore për të mbështetur mirëqenien e mësuesve.

IE-ja si Faktor në Marrëdhëniet Shoqërore

Beckett (2012) analizoi ndikimin e IE-së në zhvillimin e aftësive sociale te nxënësit. Ai zbuloi se programet e trajnimit që fokusohen në ndërgjegjësimin emocional dhe empatinë kontribuan në krijimin e një atmosfere të bashkëpunimit në klasa dhe ulën nivelin e konflikteve midis nxënësve.

Studime të Tjera mbi IE-në dhe Edukimin

Bar-On et al. (2000): Theksuan rëndësinë e IE-së për liderët arsimorë, duke sugjeruar se drejtuesit me IE të lartë janë më të aftë për të marrë vendime strategjike dhe për të krijuar një kulturë pozitive në institucione.

Stone et al. (2005): Analizuan lidhjen midis IE-së dhe aftësive drejtuese të administratorëve shkollorë, duke zbuluar se IE-ja ishte një parashikues kryesor i suksesit në menaxhimin e burimeve njerëzore.

Williams (2008): Fokusoi studimin e tij në proceset e të nxënësve dhe zbuloi se kur mësuesit përdorin strategji të bazuara në IE, nxënësistregojnë një angazhim më të madh dhe rezultate më të mira akademike.

4. Diskutim

Inteligjenca emocionale ka treguar një ndikim të rëndësishëm në aspekte të ndryshme të edukimit. Diskutimi i literaturës dhe studimeve të kryera tregon se aftësitë emocionale dhe sociale të mësuesve dhe nxënësve janë thelbësore për përmirësimin e procesit mësimor. Për mësuesit, IE-ja ka rezultuar të jetë një mjet i fuqishëm për menaxhimin e stresit dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për mësimdhënie dhe të nxënësve. Studimet kanë theksuar gjithashtu se mësuesit me nivele të larta të IE-së janë më të aftë për të ndërhuar marrëdhënie pozitive me nxënësist dhe për të trajtuar situata konfliktuale në mënyrë efektive.

Në anën tjetër, për nxënësist, IE-ja ka ndihmuar në zhvillimin e aftësive të zgjidhjes së problemeve, të menduarit kritik dhe bashkëpunimit në grup. Studimet si ai i Rosario et al. (2018) kanë treguar se nxënësist me IE më të lartë kanë përparësi në arritjet akademike dhe në zhvillimin e marrëdhënieve ndërpersonale. Për më tepër, përfshirja e programeve të IE-së në kurrikul ka rezultuar në uljen e nivelit të bullizmit dhe në rritjen e një kulture pozitive dhe të sigurt në shkolla.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është ndikimi i IE-së në lidhshimin arsimor. Studime si ai i Stone et al. (2005) kanë treguar se drejtuesist shkollorë me nivel të lartë të IE-së kanë arritur të krijojnë një ambient pozitiv dhe të menaxhojnë me sukses burimet njerëzore dhe të tjera. Këto gjetje sugjerojnë se zhvillimi i aftësive të IE-së duhet të jetë prioritet në politikat arsimore dhe trajnimin profesional.

5. Përfundime

Inteligjenca emocionale luan një rol kritik në edukim, duke ndikuar në zhvillimin personal dhe profesional të mësuesve dhe nxënësve. Ajo ka treguar efektivitet të jashtëzakonshëm si një mjet për përmirësimin e ndërveprimeve sociale, menaxhimin e konflikteve dhe ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme brenda mjedisit shkollor.

Për mësuesist, IE-ja shërben si një faktor mbështetës për menaxhimin e stresit dhe përmirësimin e aftësive të mësimdhënies. Ata me një nivel të lartë të inteligjencës emocionale janë më të aftë për të krijuar një mjedis mësimor pozitiv dhe për të ndihmuar nxënësist të përballojnë sfidat emocionale dhe akademike. Përfshirja e programeve të trajnimit të IE-së në zhvillimin profesional të mësuesve është e nevojshme për të përmirësuar efikasitetin e tyre dhe për të reduktuar stresin në punë.

Për nxënësit, IE-ja është po aq e rëndësishme, pasi ndikon pozitivisht në aftësitë e tyre për të zgjidhur problemet, për të punuar në grup dhe për të ndërtuar marrëdhënie të shëndetshme me bashkëmoshatarët. Studimet kanë treguar se nxënësit me nivele të larta të IE-së tregojnë përmirësime të dukshme në arritjet akademike, duke demonstruar një angazhim më të madh dhe një sjellje më bashkëpunuese në mjedisin shkollor.

Gjithashtu, IE-ja ka një ndikim të madh në lidhësinë arsimor. Drejtuesit me një nivel të lartë të inteligjencës emocionale janë më të aftë për të menaxhuar burimet njerëzore dhe për të krijuar një kulturë të mbështetjes dhe inovacionit brenda institucioneve të tyre. Kjo thekson rëndësinë e zhvillimit të aftësive të IE-së jo vetëm për mësuesit dhe nxënësit, por edhe për drejtuesit arsimorë.

Në përfundim, përfshirja e inteligjencës emocionale në kurrikulat shkollore dhe programet e trajnimit profesional është një hap i domosdoshëm për të përmirësuar cilësinë e edukimit. Shkollat dhe institucionet arsimore duhet të ndjekin një qasje gjithëpërfshirëse që mbështet zhvillimin e aftësive të IE-së të gjithë pjesëmarrësit e sistemit arsimor, duke siguruar kështu një edukim të ekuilibruar, gjithëpërfshirës dhe efektiv.

Inteligjenca emocionale luan një rol kritik në edukim, duke ndikuar në zhvillimin personal dhe profesional të mësuesve dhe nxënësve. Përfshirja e trajnimeve për IE-në në sistemin arsimor ndihmon mësuesit të përballojnë stresin, të ndërtojnë marrëdhënie të qëndrueshme dhe të nxisin një mjedis mësuesor pozitiv.

Gjithashtu, përfshirja e inteligjencës emocionale në kurrikula ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësi për zgjidhjen e problemeve, të krijojnë marrëdhënie të shëndetshme dhe të bëjnë zgjedhje të suksesshme në jetë. Prandaj, shkollat dhe institucionet arsimore duhet të përqendrohen në zhvillimin e programeve të inteligjencës emocionale për të siguruar një edukim të ekuilibruar dhe gjithëpërfshirës.

Referencat

Bar-On, R., Maree, J. G., & Elias, M. J. (2000). *Emotional intelligence: Theory, development, assessment, and application at home, school, and workplace*. Psychology Press.

Beckett, C. (2012). The impact of emotional intelligence on social skills development in students. *Journal of Educational Psychology, 104*(3), 237-245.

Durlak, J. A., Weissberg, R. P., Dymnicki, A. B., Taylor, R. D., & Schellinger, K. B. (2011). The impact of enhancing students' social and emotional learning: A meta-analysis of school-based universal interventions. *Child Development, 82*(1), 405-432.

Elias, M. J., Gara, M., & Ubriaco, M. (1997). Improving social relationships and student learning: The impact of emotional intelligence programs in schools. *American Journal of Education, 104*(2), 234-252.

Elias, M. J. (2003). Prevention and intervention in the classroom: Building emotional and social skills to reduce bullying. *Journal of School Psychology, 41*(3), 235-249.

Goleman, D. (1995). *Emotional intelligence: Why it can matter more than IQ*. Bantam Books.

Goleman, D. (1997). *Working with emotional intelligence*. Bantam Books.

Hwang, F. (2007). Teacher stress management through emotional intelligence training: A study in Southeast Asia. *Asian Journal of Education, 12*(4), 54-71.

Mayer, J. D., Salovey, P., & Caruso, D. R. (2004). Emotional intelligence: Theory, findings, and implications. *Psychological Inquiry, 15*(3), 197-215.

Payne, W. L. (1985). *A study of emotion: Developing emotional intelligence*. (Doctoral dissertation, University of South Carolina).

Petrides, K. V., & Furnham, A. (2001). Trait emotional intelligence: Psychometric investigation with adolescents and adults. *Journal of Personality Assessment, 76*(1), 137-151.

Simmons, B., & Simons, G. (2000). Emotional intelligence: A guide for the modern workplace. *Management Quarterly, 13*(2), 45-56.

Stone, G., Parker, J. D. A., & Wood, L. M. (2005). Emotional intelligence and leadership effectiveness in schools. *Educational Leadership Quarterly, 41*(5), 237-258.

Todd, R. (2006). The role of emotional intelligence in teacher effectiveness. *Education Review, 18*(3), 45-63.

Zinsser, K., Denham, S. A., & Curby, T. W. (2015). The role of teachers in developing students' emotional intelligence. *Early Childhood Education Journal, 43*(6), 485-494.

Rosario, P., Núñez, J. C., Vallejo, G., Cunha, J., Nunes, T., Mourão, R., & Pinto, R. (2018). Longitudinal effects of emotional intelligence on academic performance and social skills. *Educational Psychology, 38*(3), 391-408.

Thorndike, E. L. (1936). The concept of social intelligence. *American Journal of Sociology, 41*(5), 853-864.

NDIKIMI I AKTIVITETIT FIZIK NË PERFORMANCËN E PUNËS SË PUNONJËSVE – RISHIKIM LITERATURE

Julinda Dika/Manja¹, Eralda Zhilla²

¹University of Tirana, Faculty of Social Science, AL.
e-mail: julinda.dika@gmail.com

²University of Tirana, Faculty of Social Science, AL.
e-mail: adazhilla@gmail.com

Abstrakt

Ndikimi i aktivitetit fizik në mirëqenien e punonjësve dhe kostove organizative të kujdesit shëndetësor është i njohur mirë; megjithatë, literatura e menaxhimit nuk ka trajtuar ende se si, kur ose pse duhet aktiviteti fizik i kujdesit në performancën e punës. Sugjerimi i rishikimit është një fizik sintezë ndërdisiplinore e provave në lidhje me implikimet e aktiviteteve në performancën e punës. Ndikimi i ushtrimeve fizike në performancën e punës në role të ndryshëm është studiuar gjerësisht në literaturë. Një rishikim sistematik përgjatë viteve deri në vitin 2021 është bërë nga kërkimet e ScienceDirect dhe Google Scholar Platform. Rishikimi i literaturës tregoi se aktiviteti fizik ndikon ndjeshëm në performancën e punës së punonjësve. Sidoqoftë, gjetjet ishin të diskutueshme pasi aktiviteti fizik jo gjithmonë lidhet me performancën e punonjësve, në pozicione pune zyre. Ofron një pasqyrë të të dhënave të disponueshme, vlerëson kalibrin e kërkimit të kryer në këtë fushë dhe vë në dukje probleme dhe sugjerime për më shumë studime.

Fjalët kyçe: Ushtrime fizike, performanca në punë e punonjësve, produktiviteti i punonjësve, mjedisi i vendit të punës, rishikim i literaturës.

Abstract

The impact of physical exercise on employee well-being and health care organizational costs is well known; however, the management literature has not yet addressed how, when, or why physical activity should be of concern in job performance. The review proposal is a physical interdisciplinary synthesis of the evidence regarding the implications of activities on work performance. The impact of physical exercise on job performance in different roles has been widely studied in the literature. A systematic review through the years to 2021 was done by ScienceDirect and Google Scholar Platform searches. The literature review showed that physical activity significantly affects the work performance of employees. However, the findings were controversial as physical activity is not always related to the performance of employees in office work positions. It provides an overview of available data, assesses the caliber of research conducted in this area, and points out problems and suggestions for further research.

Keywords: *Physical exercise, employee job performance, employee productivity, workplace environment, literature review.*

1. Hyrje

Performanca e punës është një aspekt thelbësor i psikologjisë industriale-organizative dhe përfshin strategji të ndryshme si rekrutimi, trajnimi dhe motivimi, të cilat kanë për qëllim përmirësimin e performancës njerëzore në organizatat e punës. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të merren parasysh ndryshimet në tiparet e matshme në programet e përzgjedhjes, pjesëmarrjen në programet e trajnimit, ekspozimin ndaj ndërhyrjeve motivuese, si dhe kufizimet dhe mundësitë e situatës. Performanca e punës përcaktohet si vlera totale e pritshme për organizimin e aktiviteteve të ndara dhe të matshme gjatë një periudhe të caktuar kohore. Ajo e ndan diferencën midis grupeve të sjelljeve të kryera nga individë të ndryshëm ose nga i njëjti individ në kohë të ndryshme, duke u bazuar në vlerën e tyre të pritur për organizatën (Motowidlo et al., 1997).

Është e rëndësishme të ndahen konceptet e sjelljes, performancës dhe rezultateve. Sjellja i referohet asaj që bëjnë individët, ndërsa performanca është vlera e pritur organizative e asaj që ata bëjnë. Rezultatet, nga ana tjetër, janë gjendje ose kushte që ndryshojnë në lidhje me sjelljen e individëve dhe kontribuojnë në efektivitetin organizativ. Lidhja midis performancës dhe sjelljes së individëve ka dy përparësi kryesore. Së pari, kufizimet dhe mundësitë e situatës mund të ndikojnë në probabilitetin që individët të kryejnë sjellje që kontribuojnë në ose e ulën efektivitetin organizativ. Së dyti, mundësitë dhe kufizimet e situatës mund të ndikojnë në rezultatet e vlerësuar organizative pa ndikuar domosdoshmërisht në sjelljet individuale të performancës. Në fund, duke marrë parasysh që psikologjia është një shkencë e sjelljes, përcaktimi i performancës si një fenomen i sjelljes ndihmon në kuptimin më të mirë të proceseve psikologjike që rregullojnë përzgjedhjen, trajnimin, motivimin dhe proceset e situatës.

Sjellja e punës është një rrjedhë e vazhdueshme veprimesh që kontribuon në arritjen e qëllimeve organizative, duke e bërë atë një fushë të rëndësishme për menaxhimin e performancës së punës. Studimi i Newton et al. (1977) sugjeron se individët natyrshëm segmentojnë sjelljen në njësi diskrete për të përpunuar informacionin social. Ata e perceptojnë sjelljen si një seri njësisht veprimi koherente të ndara nga pikat e ndërprerjes, me njëfarë fleksibiliteti në vendndodhjen e tyre në varësi të qëllimeve të perceptuesve dhe faktorëve të situatës.

2. Shqyrtimi i literaturës

Produktiviteti në vendin e punës është një faktor kyç për suksesin e një organizate. Është e rëndësishme të kuptohet dallimi midis produktivitetit të punës dhe performancës së punës. Performanca përfshin procesin e realizimit të një veprimi ose detyre, ndërsa produktiviteti fokusohet në

rezultatit final të këtij procesi. Studimi i mëposhtëm shqyrton lidhjen midis performancës së punës dhe ushtrimeve fizike.

Një nga studimet më të hershme, realizuar nga Marriott et al. (1993), i kryer mbi futbollistë meshkuj analizoi ndikimin e stërvitjes me vrap rutinë në përmirësimin e vendimmarrjes gjatë lojës. Rezultatet treguan se futbollistët përmirësonin vendimmarrjen gjatë aktivitetit fizik, duke nxjerrë përfundimin se ushtrimi i rregullt ndihmon në rritjen e aftësive për zgjidhjen e problemeve në situata komplekse. Kjo tregon rëndësinë e përmirësimit të aftësive mendore përmes ushtrimeve fizike, të cilat ndikojnë në performancën e punës.

Po ashtu, Zapata (1993) analizoi ndikimin e fitnesit në përballimin e stresit nga oficerët e policisë. Studimi zbuloi se ruajtja e shëndetit fizik është thelbësorë për menaxhimin e detyrave stresuese, pavarësisht përvojës. Megjithëse shumica e oficerëve kërkojnë programe fitnesi, vetëm një pjesë e vogël përjeton teste të rregullta, duke nxjerrë në pah nevojën për trajnime të vazhdueshme.

Në një studim mbi zjarrfikësit, Rhea et al. (2004) zbuluan se përmirësimi i komponentëve të veçantë të fitnesit, si forca muskulore dhe qëndrueshmëria, ndikon ndjeshëm në performancën gjatë detyrave të punës. Kjo nënkupton se ushtrimi i qëllimshëm për të përmirësuar këta komponentë mund të çojë në efikasitet më të madh në përmbushjen e detyrave fizike të lodhshme.

Pronk et al. (2004), në një studim mbi ndikimin e rreziqeve shëndetësore të lidhura me stilin e jetesës në performancën në punë, theksoi rëndësinë e aktivitetit fizik në përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të punës. Ai vuri në dukje se obeziteti ndikon negativisht në marrëdhëniet ndërpersonale dhe rezultoi në mungesa në punë. Aktiviteti fizik kontribuon në përmirësimin e performancës së përgjithshme dhe në reduktimin e këtyre rreziqeve.

Një tjetër studim nga Mills et al. (2007) ka hulumtuar ndikimin e një programi fitnesi të zbatuar në ambientin e punës mbi mirëqenien subjektive dhe produktivitetin e punonjësve. Ky studim kuazi-eksperimental përfshinte mbledhjen e të dhënave në dy intervale kohore: përpara fillimit të programit dhe pas përfundimit të tij. Analiza e rezultateve tregoi se grupi i ndërhyrjes, i cili mori pjesë në programin e fitnesit, shënoi përmirësime të konsiderueshme në produktivitetin e punës krahasuar me grupin e kontrollit. Këto gjetje ofrojnë dëshmi të rëndësishme empirike se programet e strukturuar dhe të mirëplanifikuara për promovimin e shëndetit dhe fitnesit në vendin e punës mund të ndikojnë pozitivisht në performancën dhe efikasitetin e përgjithshëm të punonjësve, duke përmirësuar njëkohësisht mirëqenien e tyre fizike dhe mendore.

Në një kontekst të ngjashëm, studimi i Lockie et al. (2008) identifikoi një lidhje të qartë midis aftësive fizike, të matur përmes testit PT500, dhe performancës në detyra specifike, të vlerësuar përmes testit WSTB. Rezultatet treguan se qëndrueshmëria muskulare dhe kapaciteti aerobik janë faktorë kryesorë në detyra që përfshijnë vrapimin, siç janë testet 990C dhe

500R, ndërsa forca e pjesës së sipërme të trupit, veçanërisht ajo e muskujve të tërheqjes dhe barkut, luan një rol thelbësor në detyrat e ngjitjes, si SW dhe CLF. Në bazë të këtyre gjetjeve, sugjerohet që programet trajnuese të fokusohen në zhvillimin e këtyre komponentëve fizikë për të optimizuar performancën në detyrat e zbatimit të ligjit. Veçanërisht, forca maksimale e pjesës së poshtme të trupit tregohet të jetë kyçe për detyra që përfshijnë zvarritjen e një personi.

Në studimin e tij, Siriprasert (2008), në studimin e tij mbi punonjësit e Universitetit Publik të Oregonit, shqyrtoi ndikimin e programeve të fitnesit në performancën e punës. Kampioni, i përbërë nga 344 punonjës, plotësoi një anketë që vlerësonte kënaqësinë në punë, produktivitetin, qëndrimin ndaj shëndetit, përkushtimin ndaj institucionit dhe mungesat për shkak të sëmundjeve. Rezultatet treguan se shumica e punonjësve preferonin të stërviteshin individualisht dhe të angazhoheshin rregullisht në aktivitete fizike, edhe pse një pjesë e konsiderueshme nuk ushtroheshin rregullisht. Burrat priren të marrin pjesë më shumë në programe aktive sesa gratë, ndërsa grupmosha 34-54 vjeç ishte më aktive se të tjerat. Ndërsa aktiviteti fizik ndihmon në përmirësimin e qëndrimit shëndetësor, efektet e tij mbi kënaqësinë në punë, produktivitetin, përkushtimin dhe mungesat mbeten ende të paqarta.

Studimi i McKenna (2008) ka treguar një përmirësim prej 15% në performancën individuale të punonjësve pas zbatimit të një regjimi të strukturuar ushtrimesh fizike. Hulumtimi i Drannan në Bangkok ka trajtuar lidhjen ndërmjet performancës në punë dhe angazhimit në stërvitje, duke shqyrtuar efektet ndërmjetësuese të ushtrimeve mbi gjendjen emocionale dhe mirëqenien subjektive. Ky studim ka evidentuar një korrelacion të rëndësishëm midis aktivitetit fizik dhe performancës në punë. Megjithatë, është theksuar se shkalla e perceptimit të produktivitetit, e përdorur si variabël matëse në këtë studim, nuk është një tregues i drejtpërdrejtë dhe absolut i performancës efektive në punë.

Një tjetër studim, Thorp (2012) theksoi rëndësinë inaktiviteti fizik përbën një faktor rreziku të rëndësishëm për vdekshmërinë globale, duke u renditur si shkaku i katërt më i zakonshëm i vdekjeve. Hulumtimet e fundit kanë treguar se pjesëmarrja e rregullt në aktivitete fizike, si vizitat në palestër, mund të përmirësojë efikasitetin, produktivitetin dhe etikën e punës, veçanërisht në ambientet ku kërkohet angazhim i madh fizik. Megjithatë, në pozitrat drejtuese ku shpesh kalohen periudha të gjata ulur, është e vështirë të përcaktohet nëse aftësia fizike apo niveli i stërvitjes ndikon drejtpërdrejt në performancën e punës. Stërvitja kontribuon në forcimin e muskujve dhe kockave, përmirëson shëndetin mendor dhe lehtëson vendimmarrjen e saktë, duke ndihmuar në zgjidhjen efektive të problemeve. Për më tepër, programet e fitnesit në vendin e punës janë rritur në popullaritet për shkak të potencialit për të rritur produktivitetin dhe moralin, ndërsa zvogëlojnë problemet shëndetësore. Megjithatë, ende mbetet e paqartë nëse këto programe janë

domosdoshmërisht të nevojshme dhe nëse ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në performancën individuale.

Studimet e realizuara nga Universiteti i Harvardit, publikuar në Association for Applied Sport Psychology, (2012) kanë vërtetuar se përmirësimi i qarkullimit të gjakut pas aktivitetit fizik ndihmon në rritjen e aftësive për mendim të fokusuar dhe të thelluar. Ndërsa përfitimet fizike të stërvitjes janë të mirëdokumentuara, avantazhet psikologjike janë po aq të rëndësishme. Aktiviteti fizik i moderuar kontribuon në përmirësimin e gjendjes shpirtërore, promovimin e mirëqenies, reduktimin e niveleve të stresit, rritjen e vetëvlerësimit dhe forcimin e besimit në vetvete. Ushtrimi jo vetëm që rrit nivelet e energjisë, por gjithashtu përmirëson mekanizmat e përballimit të stresit dhe ul simptomat e depresionit, duke ndikuar pozitivisht në cilësinë e përgjithshme të jetës.

Studimi i Sitthipornvorakul (2014) identifikoi se orët e gjata dhe puna e zgjatur në pozita të ulura mund të çojnë në rreziqe shëndetësore, përfshirë çrregullime kronike si diabeti dhe sëmundjet kardiovaskulare. Çrregullimet muskuloskeletore janë të zakonshme në mesin e punonjësve dhe ndikojnë negativisht në performancën e tyre, duke shkaktuar pushime për shkaqe shëndetësore, ulje të orarit të punës dhe norma më të ulëta të produktivitetit.

Në literaturën shkencore të Friedman (2014) shpesh vërehet një përdorim i ndërsjellë i termave "aktivitet fizik" dhe "ushtrim fizik," megjithatë, këto koncepte dallohen në përmbajtje dhe qëllim. Aktiviteti fizik përfshin lëvizjet e zakonshme të kryera gjatë përditshmërisë, si pjesëmarrja në sporte, noti apo veprimtari të tjera trupore, të tilla si ecja apo ngjitja e shkallëve. Ndërsa ushtrimi fizik, si një nëngrup specifik i aktivitetit fizik, është i strukturuar dhe i planifikuar me qëllim të qartë për të arritur përmirësimin e performancës fizike ose shtimin e masës muskulore.

Në studimin e tij Gummelt (2015) vë në dukje se performanca e punës e vetë-raportuar shpesh është më e saktë dhe më e paanshme në krahasim me vlerësimet zyrtare të bëra nga mbikëqyrësit. Një rritje e kënaqësisë në punë është gjithashtu e lidhur ngushtë me rritjen e produktivitetit të punonjësve, pasi individët janë më të prirur të jenë të kënaqur me punën e tyre kur ndihen mirë në ambientin e punës.

Drannan (2016) realizoi një studim që shqyrtoi ndikimin e mungesës së aktivitetit fizik në rritjen e kostove të kujdesit shëndetësor për kompanitë, duke identifikuar obezitetin si një faktor kyç në shkaktimin e vdekjeve. Studimi sugjeron se për të reduktuar këto kosto, kompanitë mund të promovojnë aktivitetin fizik si një strategji për të përmirësuar performancën, humorin dhe shëndetin e përgjithshëm të punonjësve. Analiza e të dhënave zbuloi se individët që angazhoheshin në aktivitet të rregullt fizik shfaqnin përmirësime të dukshme në performancën e punës, që ishin ngushtësisht të lidhura me përmirësimin e shëndetit subjektiv dhe humorit pozitiv. Si pasojë, nxitja e aktivitetit fizik në vendin e punës ka potencialin të ndikojë pozitivisht në mirëqenien dhe produktivitetin e punonjësve.

Studimi i Mashili et al. (2018) theksojnë rëndësinë e integritit të aktivitetit fizik në ambientet e punës për të përmirësuar shëndetin dhe performancën e punonjësve. Krijimi i një mjedisi të shëndetshëm mund të kontribuojë në reduktimin e kohës së kaluar në pozita të ulura, të rrisë energjinë dhe produktivitetin, dhe të zvogëlojë mungesat në punë. Implementimi i programeve për promovimin e shëndetit në politikat e menaxhimit ndihmon në mbështetje të një jetese më të shëndetshme, në krijimin e një ambienti pune më pozitiv dhe në uljen e kostove të kujdesit shëndetësor.

Në një studim të Vivencio & Calixtro Jr. (2021) në Rajonin XII, shqyrtoi ndikimin e faktorëve shëndetësorë në performancën e punës së instruktorëve të edukimit fizik në institucionet e arsimit të lartë. Me një kampion prej 100 mësuesish, hulumtimi zbuloi se performanca në punë nuk kishte një lidhje të drejtpërdrejtë me shëndetin fizik ose mendor, por ishte ngushtë e lidhur me shëndetin emocional dhe mirëqenien sociale. Mungesa e vetëdijes për shëndetin e tyre ishte e evidente tek shumë instruktorë, duke theksuar nevojën për një vëmendje të shtuar ndaj mirëqenies personale në kontekstin e mësimdhënies së edukimit fizik.

Një studim i realizuar në Lahore, Punjab, nga Iqbal et al. (2021) kishte për qëllim të analizonte lidhjen midis performancës në punë dhe aktiviteteve fizike të punonjësve të zyrës. Hulumtimi, i cili u zhvillua gjatë një periudhe gjashtëmuajshe dhe përfshiu 130 pjesëmarrës nga Universiteti i Lahore, Universiteti Imperial dhe HiMedic Pharmaceuticals, përdori GPAQ për të vlerësuar aktivitetin fizik dhe HPQ për të matur performancën në punë. Rezultatet nuk treguan një korrelacion të rëndësishëm ndërmjet ushtrimeve fizike dhe performancës së punës ($p = .299$, $r = .092$). Përkundrazi, edhe pse 36.2% e pjesëmarrësve shfaqën performancë të ulët në punë, kjo nuk ishte e lidhur me nivelet e aktiviteteve fizike të tyre. Ky hulumtim nuk identifikoi asnjë lidhje të konsiderueshme ndërmjet aktivitetit fizik dhe performancës në punë të punonjësit e zyrës.

Në një studim të fundit të realizuar nga Northeast Technical Institute (2023), është vënë në dukje rëndësia e aktivitetit fizik për përmirësimin e performancës në punë dhe mirëqenies së përgjithshme të individëve. Aktiviteti fizik kontribuon në rritjen e kënaqësisë në punë, nivelit të energjisë, përqendrimit dhe kreativitetit, si dhe në reduktimin e stresit dhe forcimin e aftësive të menaxhimit të kohës dhe elasticitetit. Motivimi për të mbajtur një rutinë të qëndrueshme të aktivitetit fizik është thelbësor për përfitime të qëndrueshme në këto aspekte. Ushtrimi ka ndikim pozitiv në funksionin njohës dhe mirëqenien mendore, duke ndihmuar në menaxhimin e stresit dhe ruajtjen e një ekuilibri të shëndetshëm midis punës dhe jetës personale.

3. Metodologjia

Është kryer një rishikim i thelluar i literaturës mbi ndikimin e ushtrimeve fizike në performancën e punonjësve, duke u mbështetur në burime akademike të aksesueshme përmes platformave Google Scholar dhe ScienceDirect. Studimi përfshinte artikuj të publikuar deri në vitin 2021 dhe kishte si qëllim eksplorimin e lidhjes ndërmjet aktiviteteve fizike dhe produktivitetit në vendin e punës. Për të siguruar një përzgjedhje të artikujve të përshtatshëm, janë përdorur fjalë kyçe si: "Ushtrimet fizike", "Performanca e punës së punonjësve", "Produktiviteti i punonjësve" dhe "Mjedisi i vendit të punës". Artikujt e analizuar mbulonin një spektër disiplinash, përfshirë teknologjinë e informacionit, biznesin, menaxhimin dhe sjelljen organizative, duke ofruar një pamje të gjerë mbi efektet e aktiviteteve fizike në kontekstin profesional.

4. Diskutimi

Plani Global i Veprimt për Aktivitetin Fizik (2018) nënvizon rëndësinë e aktivitetit fizik për ruajtjen e shëndetit dhe mirëqenies, pavarësisht statusit socio-ekonomik. Faktorë të ndryshëm, si akses i kufizuar në burime, normat kulturore dhe sfidat e përditshme, kontribuojnë në nivele të ulëta të aktivitetit fizik, duke rezultuar në një mungesë informacioni mbi përfitimet e tij (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2018).

Një numër studimesh kanë eksploruar lidhjen ndërmjet niveleve të fitnesit të punonjësve dhe produktivitetit të perceptuar, kënaqësisë dhe mungesave në punë. Rezultatet kanë treguar se punonjësit me aktivitete më të larta të fitnesit kanë shfaqur rritje të ndjeshme në produktivitet dhe kënaqësi në punë. Një studim që përfshinte 53 anestezist të certifikuar zbuloi se ushtrimi kishte një ndikim të vogël, por statistikisht të rëndësishëm në produktivitet. Një tjetër studim ka treguar se punonjësit që nuk integronin ushtrimet në stilin e tyre të jetesës kishin më shumë ditë mungesë mjekësore dhe një ulje të produktivitetit krahasuar me ata që ushtroheshin. Për më tepër, një studim i Dané Marie Standish zbuloi një lidhje midis kohës së humbur në punë dhe aktivitetit fizik të përditshëm ndërmjet punonjësve të zyrës, me 32% të tyre që nuk ishin fizikisht aktivë sipas rekomandimeve të CDC-së. Në një studim tjetër, Mansour Sharifzadeh në Universitetin Politeknik Shtetëror të Kalifornisë Pomona gjeti rezultate kontradiktore, duke sugjeruar se marrëdhënia midis ushtrimeve dhe performancës është komplekse dhe kërkon hetime të mëtejshme (Sitthipornvorakul et al., 2014).

5. Përfundime

Është e domosdoshme të realizohen kërkime të thelluara për të vlerësuar efektivitetin e iniciativave që promovojnë aktivitetin fizik në vendin e punës. Është e rëndësishme të shqyrtohen krahasimet direkte ndërmjet programeve që lejojnë punonjësit të angazhohen në aktivitete fizike gjatë orarit të punës me pagesë dhe atyre që nuk ofrojnë këtë mundësi. Gjithashtu, është e domosdoshme të bëhen krahasime të programeve që përfshijnë qendra stërvitore në vend me ato që nuk i kanë këto lehtësira, për të përcaktuar nëse

përfitimet në produktivitet dhe shëndet të punonjësve justifikojnë shpenzimet për ofrimin e këtyre lehtësirave.

Referencat:

Association for Applied Sport Psychology. (2012). "Psychological Benefits of Exercise". Retrieved from <http://appliedsportpsych.org/resource-center/healthand-fitness/articles/psych-benefits-of-exercise>

Drannan, J. (2016). "The Relationship Between Physical Exercise and Job Performance: The Mediating Effects of Subjective Health and Good Mood". *Arabian Journal of Business and Management Review*, 6(6), 6. doi: 0.4172/2223-5833.1000269

Drannan, J.D (2016). "The relationship between physical exercise and job performance: the mediating effects of subjective health and good mood". The Graduate School of Bangkok University.

Friedman, R. (2014). "Regular Exercise Is Part of Your Job. *Harvard Business Review*".

Gummelt, D. (2015). "Physical Activity vs. Exercise: What's the Difference?" *ACE. Job Performance*. doi: 0471264385.wei1203.

Iqbal, N., Ahmad, A., Gillani, S.A (2021). "Relationship between Physical Exercise and Job Performance among Office Workers". *The University of Lahore*, Vol. 2 No. 1 (2021): Published Volume 2 - Issue No. 1 August (2021)

Journal of Occupational and Environmental Medicine 46(1):p 19-25, January 2004. | DOI: 10.1097/01.jom.0000105910.69449.b7

Koinig, I., & Diehl, S. (2021). Healthy Leadership and Workplace Health Promotion as a PreRequisite for Organizational Health. *International journal of environmental research and public health*, 18(17), 9260. <https://doi.org/10.3390/ijerph18179260>

Lockie, R.G., Dawes, J.J., Balfany, K., Gonzales, C.E., Beitzel, M.M., Dulla, J.M., Orr, R.M (2018). "Physical Fitness Characteristics That Relate to Work Sample Test Battery Performance in Law Enforcement Recruits". *International Journal of Environment and Research. Public Health* 2018

Marriott T., Reilly T., Miles (1993). "The effect of physiological stress on cognitive performance in a simulation of soccer". *Centre for Sport and Exercise Sciences* 261-264.

Mashili, F. L., Kagaruki, G. B., Mbatia, J., Nanai, A., Saguti, G., Maongezi, S., Magimba, A., Mghamba, J., Kamugisha, M., Mgina, E., Mweya, C. N., Kaushik, R., & Mayige, M. T. (2018). "Physical Activity and Associated Socioeconomic Determinants in Rural and Urban Tanzania: Results from the 2012 WHO-STEPS Survey". *International Journal*

Mills, P. R., Kessler, R. C., Cooper, J., & Sullivan, S. (2007). "Impact of a Health Promotion Program on Employee Health Risks and Work Productivity". *American Journal of Health Promotion*.

Motowidlo, S. J., Borman, W. C., & Schmit, M. J. (1997). "A theory of individual differences in task and contextual performance". *Human Performance*, 10, 71-83.

Newton, D., Engquist, G., & Bois, J. (1977). The objective basis of behavior units. *Journal of Personality and Social Psychology*, 35, 847–862.

Northeast Technical Institute (2023). “The importance of exercise for improving work performance”, Copyright to Northeast Technical Institute.

Pronk, N.P., Bria, M., Kessler, R.C. Beck, A.L., Simon, G.E., Wang, P (2004). “The Association Between Work Performance and Physical Activity, Cardiorespiratory Fitness, and Obesity”.

Rhea, M.H., Alvar, B.A, Gray., R (2004). “Physical fitness and job performance of firefighters”. *Journal of Strength and Conditioning Research*, 2004, 18(2), 348–352 q 2004 National Strength & Conditioning Association

Siriprasert, J. (2008). “The effects of physical fitness programs on the job performance of full-time employees in public universities of Oregon”. The Oregon State University 2008

Sitthipornvorakul, E., Janwantanakul, P., Van der Beek, A.J. (2014). “Correlation between pedometer and the Global Physical Activity Questionnaire on physical activity measurement in office workers”, NCBI.

Thorp, A.A., Winkler, E., Clark, B.K., Gardiner, P.A., Owen, N., Dunstan D.W. (2012). “Prolonged sedentary time and physical activity in workplace and non-work contexts: a cross-sectional study of office, customer service and call centre employees”. *International Journal of Behavioral Nutrition and Physical Activity*

Vivencio L., Calixtro Jr. (2021). “Health status and job performance of physical education instructors in higher education institutions”. *Indonesian Journal of Educational Research and Technology*

WHO. (2011). *Physical Inactivity: A Global Public Health Problem*. WHO

World Health Organization (2018). “Global action plan on physical activity 2018–2030”: Geneva.: License: CC BY-NC-SA 3.0 IGO

Zapata, A.D. (1993). “An Analysis of Fitness, Stress and Job Performance: Concerns of Greensboro, North Carolina and Western New York Police Officers”. SUNY Open Access Repository (SOAR)

TIPARET E PERSONALITETIT DHE BURNOUT TEK INFERMIERËT

Kiduina Zaka¹, Artemisi Shehu²

¹Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale
Departamenti i Pedagogji-Psikologjisë
e-mail: kiduinazaka@gmail.com

²Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale
Departamenti i Pedagogji-Psikologjisë
e-mail: art_emisa@yahoo.com

Abstrakt

Koncepti i burnout-it po zë vend gjithmonë e më shumë në kontekstin e vendit të punës. Mjekët dhe infermierët cilësohen si një prej kategorive të profesioneve më të predispozuar për t'u prekur prej kësaj sindrome. Burnout përcaktohet si rraskapitje fizike e cila vjen si rezultat i tensionit dhe stresit kronik nga punët që kanë në fokus të ndihmuarit e njerëzve. Në këtë artikull, ky koncept është parë i lidhur me tiparet e personalitetit sipas modelit 5-faktorësh si edhe faktorët demografikë. Referuar studimeve të kryera në kultura dhe kohë të ndryshme, rezultoi se tipari i personalitetit neuroticizmi shoqërohej me nivele të larta të burnout. Ndërkohë vitet e eksperiencës në punëlidheshin pozitivisht me burnout, që do të thotë se infermierët me pak vite eksperiencë pune përjetonin nivele më të larta të burnout-it se ata që kishin më shumë vite eksperiencë.

Fjalët kyç: Koncepti burnout, mjekë, infermierë, personalitet

Abstract

The concept of burnout is increasingly taking place in the context of the workplace. Doctors and nurses are considered one of the categories of professions most predisposed to being affected by this syndrome. Burnout is defined as physical exhaustion that results from chronic tension and stress from jobs that focus on helping people. In this paper, this concept is seen as related to personality traits according to the 5-factor model as well as demographic factors. Referring to studies conducted in different cultures and times, it resulted that the personality trait neuroticism was associated with high levels of burnout. Meanwhile, years of work experience were positively associated with burnout, meaning that nurses with fewer years of work experience experienced higher levels of burnout than those with more years of experience.

Keywords: burnout concept, doctor, nurse, personality

1. Hyrje

Është kaq e rëndësishme të kuptojmë dinamikat në vendin e punës, sesi tipare tonat të personalitetit ndërthuren me elementet e punës dhe përkthehen në reagime dhe mënyra sesi ne i përgjigjemi situatave të ndryshme. Mjekët dhe infermierët që punojnë në spital kanë kontaktin e parë me çdo pacient. Rastet dhe patologjitë që paraqiten janë të një game të gjerë. Përveç kësaj, stafit mjekësor do t'i duhet të përballet edhe me familjarë të shqetësuar e që shpesh i shohin mjekët dhe infermierët si shpëtimin e vetëm dhe kërkojnë prej tyre edhe mrekulli. Oraret e punës, turnet, kushtet e punës dhe konflikti punë-familje janë disa faktorë që ndikojnë në nivelin e stresit të përjetuar nga ky profesion. Stresi dhe presioni që personeli mjekësor përjeton është i lartë. Prej kohësh roli i infermierëve është konsideruar shumë i ekspozuar ndaj stresit bazuar në punën fizike, vuajtjet njerëzore, orët e punës, personelin dhe marrëdhëniet ndërpersonale, që janë thelbësore për ta.¹ Lidhur me burnout-in janë bërë shumë studime duke e parë atë të lidhur me variabla të ndryshme si kënaqësia në punë, inteligjenca emocionale, stili i lidershipit, tiparet e personalitetit etj.. Pse u zgjodh pikërisht kjo temë?

E para, sepse ka një historik të mëparshëm nga studimet e kryera në vende të ndryshme, në kohë të ndryshme dhe me kultura të ndryshme. Kështu që mund të bëhet një krahasim të evoluimit të kësaj sindrome në kohë.

Së dyti, u fokusuate personeli mjekësor për shkak të zhvillimeve të kohëve të fundit. Shpërthimi i një pandemie globale, siç ishte ajo e COVID-19, na gjeti të gjithëve të papërgatitur e na ndryshoi stilin e jetesës dhe përditshmërinë tonë. Personeli mjekësor ishte ai që përballej me rrezikun më të lartë shëndetësor, emocional, fizik dhe psikologjik. Mjekët dhe infermierët ishin ata të cilët punuan me orë të zgjatura pa marrë parasysh lodhjen fizike; jetuan me rrezikun e pashmangshëm për t'u infektuar vetë e më pas për t'jua transmetuar virusin familjarëve të tyre kur shkonin në shtëpi; u përballën me një numër të lartë pacientësh që humbën jetën. Sigurisht, mënyra sesi çdo person reagon ndaj ndryshimeve dhe situatave të panjohura është tërësisht individuale sepse ndikon personaliteti i secilit, background-i socio-ekonomik dhe arsimor, mosha, gjinia etj.. Për këtë arsye, mendova se kjo kategori punonjësish meriton një vëmendje të veçantë për të thelluar studimet në fushën e sipërpërmendur.

Qëllimi kryesor i këtij artikulli është të rishikojë marrëdhënien që ekziston ndërmjet tipareve të personalitetit dhe burnout-it të mjekët dhe infermierët, bazuar në studime të shtrira në kohë dhe kultura të ndryshme.

¹Jenning, 2009.

2. SHQYRTIM LITERATURE

2.1 Tiparet e personalitetit

Çdo individ lind me një arsenal unik të karakterit, ndryshe nga të tjerët, qoftë kjo në terma të sjelljeve apo personalitetit. Referuar Allport, të cituar te Pettijohn², personaliteti është shuma totale e të gjitha gjërave që përbëjnë një person: veprimet, mendimet dhe ndjenjat. Personaliteti përkufizohet si modelet e dallueshme dhe të qëndrueshme të sjelljes dhe njohjes që karakterizojnë përshtatjen e një personi në jetë. Teoritë mbi personalitetin dhe zhvillimin e tij janë të shumta, por në këtë punim do t'i referohemi modelit pesëfaktorësh të personalitetit.

McCrae dhe Costa³ identifikuan 5 tipare të personalitetit.

Neuroticizmi lidhet me përjetimin e emocioneve negative. Personat që kanë nivel të lartë të neuroticizmit prirën të kenë ndryshime apo lëkundje të gjendjes së tyre të humorit, do të përjetojnë nivele ankth, stres apo trishtim. Ndërkohë personat që nuk janë neurotikë prirën të jenë stabilë emocionalisht dhe t'i përballojnë me sukses edhe situatat e vështira.⁴

Ekstraversioni është një tipar që përfaqëson diferencat individuale në përfshirjen sociale. Thënë ndryshe, personat që shfaqin tiparin e ekstraversionit janë ata individë që u pëlqen dhe e shijojnë të jenë sa më shumë socialë dhe pjesë e grupeve. Ndërkohë që introvertët në krahasim me ekstrovertët, prirën të jenë më të tërhequr nga jeta sociale.⁵

Pajtueshmëria lidhet me diferencat individuale në terma të dhembshurisë, pranimit dhe respektimit të të tjerëve. Personat që e kanë këtë tipar personaliteti prirën që të shqetësohen për mirëqenien e të tjerëve.⁶

Të qenurit i hapur ka të bëjë me pjesën intelektuale, krjimitarinë, kuriozitetin, të qenurit kreativ. Ndërkohë personat që janë mendjengushtë kanë pak interes për të qenë kuriozë ose kreativë.⁷

Ndërgjegjshmëria. Personat e ndërgjegjshëm prirën të jenë të rregullt, të organizuar, ambiciozë dhe punojnë fort për të arritur qëllimet e tyre. Ndërkohë që personat e pandërgjegjshëm janë kundërta e atyre të përshkruar më sipër. Ata janë të çrregullt, të papërgjegjshëm dhe jo shumë të motivuar për të përmbushur detyrat dhe qëllimet.⁸

Studime të ndryshme kanë marrë në konsideratë faktorin gjini në trajtimin e konceptit të personalitetit dhe tipareve të tij. Qëndrimet që mbajnë studiues të ndryshëm janë të dy drejtimeve. Ka studiues që pohojnë se ekzistojnë diferenca gjinore lidhur me tiparet e personalitetit dhe e lidhin këtë me

² Pettijohn, 1996, fq.390.

³ McCrae, Costa, 1999.

⁴ [John, O. P. & Srivastava, 1999.](#)

⁵ Soto, 2018.

⁶ Roccas, et al. 2002.

⁷ Alan & Baykal, 2021.

⁸ Roccas, et al. 2002.

perspektivën biologjike. Ata thonë se këto diferenca vijnë për shkak të ndryshimeve dhe volumit që kanë burrat dhe gratë në çështjet e riprodhimit dhe investimit që prindërit japin te pasardhësit e tyre. Sipas tyre, gratë janë më të shqetësuara për mirëritjen e fëmijëve, për këtë arsye duhet të jenë më të përfshira emocionalisht, më mbështetëse, më pranuese. Kurse burrat janë më të shqetësuar për të siguruar vazhdimësinë e llojit dhe për këtë arsye duhet të shfaqin veten të fortë, me vetëbesim dhe agresivë. Ndërkohë sipas teorisë tjetër, këto diferenca gjinore vijnë si pasojë e ndikimeve sociokulturore duke qenë se shoqëria pret që burrat dhe gratë të kenë role të ndryshme sociale.⁹

Sipas një studimi të kryer nga Nighute dhe Sahebrao¹⁰ me 150 studentë të mjekësisë për të parë diferencat gjinore lidhur me tiparet e personalitetit, rezultoi se gratë kishin nivele më të larta të neuroticizimit krahasuar me burrat ($p < .001$, $d_s = 0.54$). Sa i përket tipareve të tjera të personalitetit si: ekstraversioni, pajtueshmëria, të qenurit i hapur dhe ndërgjegjshmëria, nuk kishin diferenca gjinore

Ndërkohë një studim i kryer me 177 studentë në një kolegji në Teheran, rezultoi se vajzat kishin nivele më të larta në tiparet, si: të qenurit hapur ndaj eksperiencave dhe pajtueshmëria, krahasuar me djemtë.¹¹

2.2 Koncepti i burnout-it

Vitet e fundit i është kushtuar një rëndësi e veçantë sindromës së burnout-it tek infermieret si një nga faktorët që lidhet ngushtë me produktivitetin e punës së tyre. Burnout-i si term u prezantua fillimisht nga Freudenberg në vitin 1974. Ai vuri re shenja të mungesës së motivimit dhe ulje të produktivitetit të vullentarët në një spital të shëndetit mendor.¹²

Autorë të ndryshëm kanë kryer studime të shumta dhe janë përpjekur të japin një përkufizim të konceptit të burnout-it. Të gjitha këto përkufizime kanë emërues të përbashkët në konceptin e burnout-it rraskapitjen fizike e cila vjen si rezultat i tensionit dhe stresit koronik nga punët që kanë në fokus të ndihmuarit e njerëzve. Sipas Maslach¹³, koncepti i burnout-it përfshin 3 komponentë:

Rraskapitje emocionale. Kjo ka të bëjë me varfërimin e energjive dhe burimeve emocionale të individit. Shkaqet kryesore të kësaj rraskapitjeje janë mbingarkesa në punë dhe konfliktet personale në punë. Rrjedhimisht individit ndihet pa energji për t'u përballur me një ditë tjetër nëpunë ose me një tjetër person që kërkon ndihmë prej tij. Rraskapitja emocionale përfaqëson komponentin individual të burnout-it.

⁹Weisberg, Deyong & Hirsh, 2011.

¹⁰Nighute dhe Sahebrao, 2016.

¹¹Rahmani & Lavasani, 2012.

¹²Dall'Ora, Ball&others, 2020.

¹³ Maslach, 1982.

Depersonalizim. Kjo ka të bëjë me detashimin që përjetohet në mënyrën sesi i përgjigjemi të tjerëve dhe ky detashim mund të çojë në dehumanizëm. Depersonalizimi përfaqëson komponentin ndërpersonal të burnout-it.

Arritje personale të ulëta. Kjo lidhet me ndjenjën e kompetencës dhe produktivitetit në punë. Individu ndihet i paaftë dhe jo i përshtatshëm për t'u përgjigjur kërkesave të klientëve dhe për t'i ndihmuar ata. Arritjet personale përfaqësojnë komponentin e vetëvlerësimit të burnout-it.

Shkaqet e mundshme që çojnë në individ në burnout përfshijnë stresin e vazhdueshëm, krizat në zhvillimin profesional, mbingarkesa në punë, mungesa e suksesit.¹⁴

Sipas Tsolakidis dhe Fountouki¹⁵, ekzistojnë disa faktorë që ndikojnë në sindromën e burnout-it tek infermierët.

Stafi i spitalit. Pandemia e COVID-19 e solli në vëmendje këtë element si faktor ndikues në përjetimin e burnout-it tek infermierët. Mospërputhja e raportit staf-pacient bën që infermierët të përjetojnë ndjenja të rraskapitjes, lodhjes emocionale dhe nivele të ulëta të produktivitetit. Ndërkohë pasja e një raporti të përshtatshëm staf-pacient rezulton në nivele më të larta të përkujdesjes së pacientëve. Rrjedhimisht këta të fundit janë më të kënaqur me shërbimin e marrë nga stafi dhe kanë nivele më të ulëta të vdekshmërisë. Kështu stafi është më pak i prirur të përjetojë burnout.

Oraret e punës. Stafi mjekësor punon me orë të zgjatura dhe kryesisht të punuarit me turne shkakton një çrregullim të ciklit të tyre të jetesës. Kjo gjë prek si jetën personale, familjare ashtu edhe atë sociale. Nga studimet e kryera, ka rezultuar se personat që punojnë me turne të natës kanë tendencën të kenë një qëndrim jo pozitiv ndaj punës së tyre, të kenë më shumë konflikte në punë dhe të përjetojnë nivele më të larta të burnoutit.

Paga. Puna cilësohet si burimi kryesor i të ardhurave për të siguruar jetesën. Një pagesë e ulët është faktor risku për të rritur përjetimin e burnout-it te stafi mjekësor. Kjo lidhet me fluksin e punës që ata kanë.

Mungesa e drejtësisë. Një punonjës ndien që po trajtohet me drejtësi kur ai merr shpërblimin e duhur për punën e bërë. Pra, ai percepton që po trajtohet me besim, ndershmëri dhe respekt. Të tre këta faktorë bëjnë të mundur që të rritet interesi për punën. Në të kundërt, individ i përjeton ndjenja të zemërimit, inatit dhe armiqësisë, të cilat do të çojnë në rritje të pakënaqësisë nga puna.

Mjedisi i punës. Studimet kanë treguar se mënyra sesi menaxhohet një spital dhe sesi organizohet puna aty ka një ndikim të drejtpërdrejtë në rraskapitjen emocionale të personelit mjekësor.

Ndarja e detyrave. Mungesa e qartësisë mbi detyrat dhe punët e gjithsecilit çon në një paqartësi rolesh. Rrjedhimisht, kjo do të reflektohet në konflikte mes kolegësh. Ndërkohë, kur detyrat janë qartësisht të ndara dhe secili i di

¹⁴ Meier, Davis, 1982.

¹⁵Tsolakidis et al. 2022.

detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kjo reflektohet në marrëdhënie të mira ndërprofesionale midis stafit dhe reduktim të konflikteve.

2.2.1 Pasojat e burnout

Pasojat e burnout-it nuk ndikojnë vetëm individin, por edhe ambientin e punës ku punojnë këta persona. Ndër pasojat më të mëdha të burnout përmendim:

Pasoja psikologjike. Burnouti në punë ndodh si në nivel konjitiv ashtu edhe në atë emocional. Sipas studimeve, këto pasoja manifestohen përmes problemeve në vendimmarrje dhe përqendrim, ankth, depresion, pakënaqësi nga jeta, problem me përqendrimin dhe vëmendjen, pagjumësi, rritje të konsumimit të duhanit dhe alkoolit.¹⁶

Pasoja shëndetësore. Të qenurit i ekspozuar ndaj një stresi të vazhdueshëm rezulton të ketë pasoja në shëndet si: gastrit, dhimbje muskulore, problem kardiovaskulare, dhimbe koke, rritje e nivelit të kortisolit në gjak.¹⁷

Pasoja biheviorale. Përveç pasojave psikologjike dhe fizike të prezantuara më sipër, rezulton se sindroma e burnoutit lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me pakënaqësinë në punë, reduktimin e angazhimit në punë, uljen e produktivitetit. Si rrjedhojë, një pjesë e punonjësve e lënë punën, ndërkohë të tjerë vazhdojnë, pavarësisht pasojave që përjetojnë apo faktit që nuk i përmbushin maksimalisht përgjegjësitë e tyre. Burnout-i shoqërohet me sjellje devijante në vendin e punës dhe në përfshirje në konflikte me kolegët.¹⁸

Pasoja organizacionale. Punonjësit që përjetojnë pasojat e burnoutit sigurisht që e reflektojnë atë edhe në mjedisin dhe mbarëvajtjen në punë. Si ndodh kjo? Individët që përjetojnë sindromën e buroutit shfaqin nivele më të ulëta të motivimit në punë, mosrealizim të detyrave, konflikt me kolegët, reduktim të efikasitetit dhe produktivitetit. Të gjitha këto përkthen në kosto për punëdhënësin.¹⁹

2.3 Studime të ngjashme

Janë kryer një sërë studimesh lidhur me sindromën e burnout në të cilët janë hulumtuar marrëdhënia e burnoutit me të dhënat demografike. Më poshtë janë përmbledhur disa prej tyre që lidhen specifikisht me temën e këtij kërkimi shkencor. Është parë marrëdhënia e burnoutit me të dhënat demografike si gjina, statusi martesor dhe vitet e eksperiencës në punë. Gjithashtu është parë edhe marrëdhënia e burnoutit e tiparet e personalitetit, referur modelit 5 faktorësh të personalitetit. Këto studime janë realizuar në vende të ndryshme me kultura të ndryshme dhe në kohë të ndryshme. Kjo do

¹⁶ Yates, 2020.

¹⁷ Rudman et al. 2020.

¹⁸ Olivares-Faundez et al. 2014.

¹⁹ Edu, Laguia & Moriano, 2022.

të mundësojë krahasimin e rezultateve të këtij kërkimi shkencor me studime të tjera të mëparshme në backgrounde të ndryshme kulturore.

Burnout dhe statusi martesor. Në studimet që Khan²⁰përmbledh, rezultoi se vihet re një nivel i lartë i burnout tek ata që janë beqarë, krahasuar me individët e martuar ose të divorcuar. Ndërkohë çiftet e martuara pa fëmijë raportojnë nivele më të larta se çiftet e martuara dhe me fëmijë.

Burnout dhe gjinia. Sa i përket diferencave gjinore në përjetimin e niveleve të burnout ende nuk ka një përfundim të mirëpërcaktuar. Disa studime pohojnë se femrat përjetojnë më shpesh burnout sesa meshkujt. Ndërkohë studime të tjera pohojnë të kundërtën²¹. Megjithatë mendohet se femrat përjetojnë më shumë rraskapitje emocionale kurse meshkujt depersonalizim.²² Po ashtu një studim i realizuar nga Almulihi²³, rezultoi se niveli i përgjithshëm i burnoutit ishte më i lartë tek infermierët meshkuj sesa te femrat gjatë periudhës së COVID-19. Sa i përket rraskapitjes emocionale, nuk u vunë re diferenca gjinore ndërkohë që depersonalizimin e përjetuan më shumë meshkujt.

Burnout dhe eksperiencë në profesion. Sipas Salazar²⁴, infermierët e rinj me pak vite eksperiencë në punë raportuan nivele më të larta të sindromës së burnoutit gjatë periudhës së COVID-19. Të njëjtat rezultate pohoi edhe studimi i kryer nga Dimunova dhe Nagyova²⁵.

Në shumë studime është parë marrëdhënia e tipareve të personalitetit me sindromën e burnout. Në studimin e Angelini²⁶, rezultoi se nivelet e larta të neuroticizmit dhe nivele të ulëta të ndërgjegjshmërisë, pajtueshmërisë, ekstaversionit dhe të qenurit i hapur lidheshin me nivele të larta të burnoutit. Ndërkohë në një tjetër studim i kryer tek infermierët femra²⁷ rezultoi se tipari i personalitetit të të qenurit i hapur nuk kishte një marrëdhënie statistike të rëndësishme me burnoutin.

Bibliografia

Alan, H., & Baykal, Ü. (2021). Personality traits of nurse managers and evaluation of their traits by their subordinates. *Florence Nightingale. Journal of Nursing*, 29(3), 379-388.

Almulihi, Q. A. A., et al. (2022). "Gender-based differences in burnout during the COVID-19 pandemic: Are female nurses more prone to burnout than males? A metaanalysis", *International Journal of Health Sciences*, 6(S4), 2061–2073.

²⁰ Khan, 2013.

²¹ Zhang et al, 2022.

²² Khan, 2013.

²³ Almulihi et al. 2022.

²⁴ Salazar et a., 2023.

²⁵ Dimunova dhe Nagyova, 2012.

²⁶ Angelini, 2023.

²⁷ Divinakumar, et al. 2019.

- Angelini, G. (2023), "Big five model personality traits and job burnout: a systematic literature review", BMC Psychology 11(1).
- Dall'Ora et al., (2020), "Burnout in nursing: A theoretical review", Human Resources for Health 18(1).
- Dimunova, L. & Nagyova, I. (2012), "The Relationship between Burnout and the Length of Work Experience in Nurses and Midwives in the Slovak Republic", ISSN 1803-4330 • volume V/1.
- Divinakumar, K. J. et al. (2019), "Personality traits and its correlation to burnout in female nurses", Ind Psychiatry J. 2019 Jan-Jun; 28(1): 24–28.
- Edu, S., Laguia, A., Moriano, J. (2022), "Burnout: A Review of Theory and Measurement", International Journal of Environmental Research and Public Health 19(3):1780
- Jennings, B.M (2009), "Patient Safety and Quality: An Evidence-Based Handbook for Nurses", chapter 26: Vol. 2.
- John, O. P. & Srivastava, S. (1999), "The big five trait taxonomy: History, Measurement and Theoretical Perspective", New York: Guilford.
- Khan, sh. N. (2013), "Exploring the Causes and Consequences of Job Burnout in a Developing Country", Journal of Basic and Applied Research International 3(5):212-227.
- Maslach, C. (1998), "A Multidimensional Theory of Burnout", Oxford University Press.
- McCrae, R. & Costa, P. (1999), "A five-factor theory of personality", New York: Guilford.
- Meier, S. & Davis, S. (1982), "Burnout: A Term in Search of a Theory", APA.
- Nighute, S. & Sadawarte, S. (2016), "Big Five Personality Traits and Gender Difference", International Physiology Vol. 4 No. 2.
- Olivares-Faundez, V. et al.(2014), "Relationships between burnout and role ambiguity, role conflict and employee absenteeism among health workers", TERAPIA PSICOLÓGICA 2014, Vol. 32, Nr 2, 111-120.
- Olivares-Faundez et al. (2014), "Relationships between burnout and role ambiguity, role conflict and employee absenteeism among health workers", Terapia Psicológica 2014, Vol. 32, No 2, 111-120.
- Pettijohn, T. (1996), "Psikologjia, Një hyrje koncize", Tiranë, Lilo.
- Rahmani, S. & Lavasani, M. G. (2012), "Gender Differences in Five Factor Model of Personality and Sensation Seeking", Procedia - Social and Behavioral Sciences 46:2906-2911.
- Roccas, S. et al. (2002), "The Big Five Personality Factors and Personal Values", Personality and Social Psychology Bulletin 28(6):789-801.
- Rudman, A. et al. (2020), "Consequences of early career nurse burnout: A prospective long-term follow-up on cognitive functions, depressive symptoms, and insomnia", EClinicalMedicine 27 (2020) 100565.
- Salazar, J. M. et al. (2023), "The Age of Young Nurses Is a Predictor of Burnout Syndrome during the Care of Patients with COVID-19", Nurs. Rep. 2023, 13(2), 721-730.

Soto, C. J. (2018). "Big Five personality traits. The SAGE encyclopedia of lifespan human Development" (pp. 240-241). Thousand Oaks, CA: Sage.

Tsolakidis, et al. (2022), "Nursing Staff Burnout: A Critical Review of the Risk Factors", International Journal of Caring Sciences, Volume 15.

Weisberg, Y., Deyong, C. G. & Hirsh, J. B. (2011), "Gender Differences in Personality across the Ten Aspects of the Big Five", Frontiers in Psychology, volume 2

Yates, S. W. (2020), "Physician Stress and Burnout", The American Journal of Medicine 133:160–164.

Zhang, L. et al. (2022), "Gender differences in the experience of burnout and its correlates among Chinese psychiatric nurses during the COVID-19 pandemic: A large-sample nationwide survey", International Journal of Mental Health Nursing, volume 31.

TURIZMI I QËNDRUESHËM DHE INDIKATORËT E QËNDRUESHMËRISË

Lutfi Gaba¹, Rovena Bega²

¹“Eqrem Çabej” University, Department of Economic Policies and Tourism
e-mail: gabalutfi2018@gmail.com

²“Eqrem Çabej” University, Finance Accounting Department
e-mail: rovenabega5@gmail.com

Abstrakt: Sektori i turizmit për ekonominë e shumë vendeve është një sektor kontribues i padiskutueshëm me impaktin e tij direkt dhe indirekt në të. Natyra multidisiplinore e vet turizmit si fenomen social, ekonomik e kulturor e bën jashtëzakonisht të vështirë gjurmimin e të gjitha efekteve të tij dhe diapazonin e shtrirjes së tyre. Politikat duke e kuptuar peshën në rritje të turizmit janë të fokusuar në zhvillimin e këtij sektori për të adresuar sfidat me të cilat përballlet si dhe për të balancuar natyrën e paqëndrueshmërisë dhe fragmentare të tij. Gjithsesi, një nga sfidat më të mëdha për politikbërësit është ndërtimi i një kornize prioritare për menaxhimin dhe planifikimin e destinacioneve. Asnjë destinacion nuk mundet që të arrijë qëndrueshmërinë nëse menaxhuesit e tij nuk njohin çështjet kyçe në të dhe nuk kanë një set treguesish për të matur performancën e destinacionit. Qëllimi i këtij studimi është identifikimi i indikatorëve të qëndrueshmërisë në një destinacioni turistik, përkufizimi dhe rëndësia e tyre në zhvillimin e politikave të qëndrueshme për menaxhimin e destinacioneve. Kjo do të realizohet nëpërmjet një rishikimi literature qoftë nga institucionet më të rëndësishme ndërkombëtare si dhe agjencive që merren me standartizimin e indikatorëve, por dhe autorëve më të njohur në këtë fushë.

Fjalët kyçe: Destinacion turistik, indikatorët e qëndrueshmërisë, menaxhim, planifikim, standartizimi i indikatorëve

Abstract

The tourism sector for the economy of many countries is an indisputable contributing sector with its direct and indirect impact on it. The multidisciplinary nature of tourism as a social, economic and cultural phenomenon makes it extremely difficult to trace all its effects and the range of their extent. Realizing the growing weight of tourism, policies are focused on the development of this sector to address the challenges it faces as well as to balance its unstable and fragmented nature. However, one of the biggest challenges for policy makers is to build a priority framework for destination management and planning. No destination can achieve sustainability if its managers do not recognize the key issues in it and have a set of indicators to measure the destination's performance. The purpose of this study is the

identification of indicators of sustainability in a tourist destination, their definition and importance in the development of sustainable policies for the management of destinations. This will be done through a literature review either by the most important international institutions and agencies that deal with the standardization of indicators, but also by the best-known authors in this field.

Keywords: *Tourist destination, sustainability indicators, management, planning, standardization of indicators*

Hyrje

Rëndësia e sektorit të turizmit në ekonomitë e vendeve të ndryshme është e padiskutueshme, ndërkohë që pesha e tij specifike në këto ekonomi varion nga vendet e zhvilluara tek ato në zhvillim, megjithatë: “Të dyja vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim ndikohen pozitivisht nga turizmi, me një efekt më të fortë rritjeje në zhvillim” ashtu si citohet te: (Gaba, 2023)

Tashmë fokusi i të gjithëve është qëndrueshmëria dhe menaxhimi profesional i këtij procesi zhvillimi me synimin për të ruajtur aftësinë e destinacioneve për të qenë gjithmonë tërheqëse dhe konkurruese dhe të balancuara në shfrytëzimin e aseteve.

"Qëndrueshmëria nuk është diçka që ne e arrijmë dhe e ndalojmë, por është një qëllim që ne vazhdimisht përpiqemi ta arrijmë." (Gössling, Stefan, Daniel Scott dhe C. Michael Hall 2020).

Ndjekja e zhvillimit të qëndrueshëm është identifikuar si një objektivi themelor i politikave për institucionet më të rëndësishme në botë, si: WTO (OBT), Banka Botërore, UNESCO por dhe për organizatat qeveritare të cilat e kanë vendosur në fokusin e politikave të tyre për shkak të rritjes së këtij sektori dhe impaktit të fortë në ekonomi.

Tema e qëndrueshmërisë është temë e diskutuar gjerësisht në literaturën profesionale. Qëndrueshmëria ose interesi për qëndrueshmërinë afatgjatë ka tre dimensione kryesore si ato ekonomike, sociale dhe mjedisore. Dokumenti bazë që përcakton zhvillimin e qëndrueshëm është Axhenda 21, e miratuar në Konferencën e OKB-së për Mjedisin në 1992 (MMR CR, 2008). Në përgjithësi, turizmi i qëndrueshëm plotëson nevojat e pjesëmarrësve aktualë të turizmit së bashku me nevojat e banorëve të destinacionit në lidhje me ruajtjen e burimeve për brezat e ardhshëm. Si i tillë, turizmi i qëndrueshëm nuk duhet të prishë apo rrezikojë mjedisin natyror, kulturor dhe social të destinacioneve (Indrova et al., 2008). (Zuzana Kvítková*, Zdenka Petrů*, Petr Šauer, 2022)

Në ditët e sotme dhe në të ardhmen, dy dokumente janë më të rëndësishmet, Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs), të miratuara në vitin 2015 (UWTO, 2015). Dokumenti i fundit përfshin grupin ambicioz të 17 qëllimeve dhe 169 objektiveve lidhur me qëndrueshmërinë. (Zuzana Kvítková*, Zdenka Petrů*, Petr Šauer, 2022)

Sipas UNWTO (United Nation World Tourism Organization 2005, p. 11-12) dhe UNEP (United Nations Environment Programme) turizmi i qëndrueshëm përkufizohet, si: turizmi që merr në konsideratë të plotë impaktin aktual dhe të ardhshëm ekonomik, social dhe mjedisor duke trajtuar (adresuar) nevojat e vizitorëve, industrisë së turizmit, mjedisit dhe komuniteteve pritëse.

Vendi ynë, Shqipëria, është karakterizuar në përgjithësi nga zhvillime pozitive ekonomike, duke krijuar kështu një mjedis makroekonomik të qëndrueshëm. Kalimi i ekonomisë shqiptare nga ekonomi e centralizuar drejt asaj kapitaliste bëri që shumë sektorë të ekonomisë të mos egzistojnë më dhe sektorë të tjerë të rinj të lulëzojnë. Edhe pse me shumë vonesë për shumë shkaqe një nga sektorët më me perspektivë të ekonomisë është ai i turizmit.

Duke parë trendin rritës dhe ndikimin pozitiv të këtij sektori në zhvillimin e të gjithë ekonomisë, vendimmarrësit politikë i dhanë prioritet investimeve dhe zhvillimit të këtij sektori, duke e shndërruar atë në një sektor strategjik.

Kështu në vitin 2019, qeveria shpalli “STRATEGJINË KOMBËTARE PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË TURIZMIT 2019 - 2023” me synim promovimin e turizmit dhe zhvillimin e rajoneve me potencial turistik ndërsa këtë vit (2024) proklamoi strategjinë e re S3 2025 - 2030 që thellon dhe më tej fokusin që kanë politikët për të konsoliduar sektorin e turizmit dhe infrastrukturën e tij me të gjithë elementet e saj përbërës.

Rëndësia e turizmit bëhet edhe më përcaktuese në zonat apo rajonet e vogla që janë larg qendrave të mëdha dhe të zhvilluara të vendit, të cilat në pamundësi për të përfituar nga ky zhvillim përballen me probleme të ndryshme si mungesa e investimeve, ngurtësia e sektorëve ekonomikë, mungesë inovacioni dhe teknologjie, tkurrje demografike, mungesë perspektive.

Padyshim që procesi i rritjes dhe zhvillimit të sektorit të turizmit shoqërohet me problematika që kanë lidhje me sektorin në përgjithësi si kudo në botë por dhe me kontekstin e stadit të zhvillimit dhe ekonomik që ndodhet Shqipëria si një vend në zhvillim.

Praktikat e menaxhimit, planifikimit dhe marketingut të destinacioneve turistike ende vazhdojnë të jenë shumë larg të të qenit profesionale apo të ngjasojnë me praktikat që ndjekin vendet me një sektor turizmi të konsoliduar.

Në nivel lokal dhe rajonal, menaxhimi i destinacionit është ende i papërshtatshëm; rregulloret për turizmin e qëndrueshëm, bashkëpunimin ndëradministrativ, koordinimin dhe bashkëpunimin mes grupeve të interesit në nivele të ndryshme mbetet ende i kufizuar. Vëllimet e turizmit mund të jenë duke shënuar rritje në Shqipëri, por nga pikëpamja mjedisore, sociale dhe ekonomike, zhvillimi aktual i turizmit duket mjaft i paqëndrueshëm (Peter Nientieda, Dritan Shutina)

Disa nga problematikat kryesore të sektorit të turizmit që ndikojnë thellësisht në zhvillimin e qëndrueshëm të destinacioneve ashtu si përmenden te (Msc. Lutfi Gaba¹, Prof. asoc. Lorenc Koçiu², 2024) janë :

- Mungon baza e të dhënave për destinacionet, planifikimi afatgjatë dhe vizioni.
- Menaxhimi i destinacioneve kulturore në Shqipëri si vend në zhvillim nuk kryhet nga DMO të specializuara por nga qeveria qendrore.
- Infrastruktura turistike ende nuk është e konsoliduar me të gjithë elementët e saj përbërës
- Shumë nga vendimmarrësit nuk e kuptojnë konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm të destinacionit.
- Nuk ka plan menaxhimi për çdo destinacion më vete, por ai ndjek një strategji të përbashkët kombëtare.
- Të ardhurat e mbledhura nga atraksionet kryesore të destinacioneve shkojnë për pushtetin qendror dhe kjo i bën bashkitë të varura nga buxheti qendror dhe me pak pavarësi në vendimmarrje.
- Ekziston një mungesë e theksuar e bashkëpunimit, koordinimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet palëve të interesuara.
- Komunitetet në destinacione nuk janë pjesë aktive në planifikim dhe vendimmarrje dhe tregojnë pak interes për zhvillimin e qëndrueshëm.

Vendimmarrësit në nivel qendror dhe lokal, institucionet kërkimore, sipërmarrësit, komuniteti agjencitë zhvillimore dhe gjithë aktorët që formësojnë skenën ekonomike dhe sociale të vendit duhet të ndërgjegjësohen dhe të ndjekin dinamikat në destinacionet turistike dhe të kenë vizion të qartë e strategji afatgjatë duke u udhëhequr nga parimi i qëndrueshmërisë së destinacioneve.

Rritja e ndërgjegjësimit nga të gjithë aktorët në terren si dhe të referuarit e një baze standardesh për vlerësimin e zhvillimit të qëndrueshëm të këtij sektori do ju mundesonte stakeholders-ave të masin performancën e treguesve kryesor të këtij sektori me qëllim krijimin e të dëshirueshmes dhe shmangien e të padëshiruarës në të ardhmen. Po ashtu identifikimi i treguesve jo performues dhe orientimi i politikave drejt përmirësimit të produktit turistik në nivelin hard ose soft si dhe zhvillimi i strategjive afatgjata të mirëmenduara do ishte kontribut me vlere të jashtëzakonshme për destinacionet dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tyre.

Gjatë hartimit të politikave dhe strategjive politikbërësit duhet t'ju referohen standardeve dhe kriterëve të vendosura nga organizatat ndërkombëtare të turizmit si OBT, GSTC, ETIS, etj.

Themeli i menaxhimit profesional dhe hartimi i politikave dhe strategjive të qëndrueshme është kërkimi dhe studimi i cili mundëson një menaxhim dhe planifikim bashkëkohor dhe eficient, vizion të qartë dhe vendosje të objektivave reale, e mbi të gjitha zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë.

Përpara promovimit dhe marketingut, është studimi dhe kërkimi ai që na jep një pasqyrë të qartë të treguesve në një destinacion, tendencat e tyre, ndryshimet në faktorët e jashtëm që reflektohen edhe në dinamikën e brendshme të destinacionit. Studimi dhe prioriteti i tyre duke adresuar probleme urgjente është çelësi i përmirësimit të vazhdueshëm të turizmit në destinacion, rritjes së kënaqësisë dhe përvojave pozitive të vizitorëve si dhe përfitimeve afatgjata dhe të qëndrueshme për të gjithë aktorët.

Autoritetet shqiptare lokale dhe rajonale ende mbeten të dobëta (Shutina, et al., 2016; Mucollari, 2017), dhe ende nuk kanë kapacitete planifikimi për turizmin e qëndrueshëm. Madje, ende nuk janë krijuar as bazat për planifikimin dhe politikat e turizmit, siç janë bazat e të dhënave që regjistrojnë volumin dhe natyrën e turizmit. (Peter Nientieda, Dritan Shutina)

Qëllimi i këtij studimi është analizë dhe rishikim literature mbi koncepte dhe përkufizime mbi turizmin e qëndrueshëm dhe indikatorëve që duhet të përmbushin destinacionet turistike për të qënë të tilla. Gjithashtu, si mund të përcaktojmë se çfarë e bën një destinacion të konsiderohet i suksesshëm dhe i qëndrueshëm.

Padyshim që ky studim do ishte me vlerë për destinacionet tona turistike dhe të gjithë ata që merren me sektorin e turizmit për të përmirësuar apo modifikuar njohuritë e tyre mbi konceptin e qëndrueshmërisë në turizëm.

Rishikim literature

Turizmi i qëndrueshëm nuk është një formë specifike e turizmit, por më shumë një qasje që mund të përdoret për t'i bërë të gjitha llojet e turizmit më të dobishëm nga ana mjedisore, sociale dhe ekonomike. Në këtë mënyrë, aktivitetet turistike duhet të përqendrohen në menaxhimin e burimeve, në të cilat të gjitha kërkesat ekonomike, sociale dhe estetike të plotësohen, duke respektuar njëkohësisht kulturën, integritetin, proceset thelbësore ekologjike dhe diversitetin biologjik (World Tourism Organization, 2018) (Macarena Lozano-Oyolaa*, Francisco Javier Blancasa, Mercedes Gonzálezb, Rafael Caballerob)

Ne e përkufizojmë Turizmin e Qëndrueshëm si turizëm që fokusohet në menaxhimin e burimeve në mënyrë të tillë që të gjitha nevojat ekonomike, sociale, mjedisore ekonomike të përmbushen pa kompromentuar integritetin kulturor, ekologjik, biologjik dhe në të njëjtën kohë të mos dëmtohen nevojat e brezave të ardhshëm. (World Tourism Organization, 2018)

Ky përkufizim nuk është larg përkufizimit të formuluar nga McMinn (1997), i cili thotë se “Zhvillimet e turizmit duhet të kenë avantazhe ekonomike, të krijojnë përfitime sociale për komunitetin lokal dhe të mos dëmtojnë mjedisin natyror. Për më tepër, këto synime mund të zbatohen jo vetëm për brezin aktual, por edhe për brezat e ardhshëm.” (siç citohet në Welford & Ytterhus, 2004, f. 411) (Zuzana Kvítková*, Zdenka Petrů*, Petr Šauer, 2022)

Fleksibiliteti i lartë i përkufizimit lejon shumë qasje dhe interpretime të ndryshme të konceptit (Cernat & Gourdon, 2007).

Megjithëse, qëndrueshmëria duhet të vëzhgohet gjithmonë përmes të tre shtyllave të saj, fakti që turizmi "ka kontribuar ndjeshëm në degradimin e mjedisit, ndikimet negative sociale dhe kulturore dhe fragmentimin e habitatit" (Choi & Sirakaya, 2006, f. 1274) ka shtyrë përpara theksin në qëndrueshmërinë mjedisore dhe socio-kulturore, ndërsa qëndrueshmëria ekonomike ishte e supozuar pasi turizmi shpesh sjell ndikime pozitive ekonomike. Megjithatë, zhvillimi i mëtejshëm i metodologjisë dhe treguesve të zhvillimit të qëndrueshëm vendos theks të barabartë në të tre shtyllat.

Edhe pse qëllimi i qëndrueshmërisë është i qartë, nuk është e mundur të pretendohet nëse një destinacion është i qëndrueshëm apo jo pa të dhënat e bazuara në variablat e matur dhe tendencat e vëzhguara. Prandaj, është e nevojshme të zhvillohen instrumente që e transformojnë atë nga një nocion abstrakt në një mjet praktik për matjen e qëndrueshmërisë (Torres-Delgado & Palomeque, 2014). Për të mbështetur këtë proces, në dekadën e fundit ka pasur përpjekje të shumta nga komuniteti shkencor që synojnë ndërtimin e kornizave të integruara për matjen e zhvillimit të qëndrueshëm (Paracchini et al., 2011). (Macarena Lozano-Oyolaa,*, Francisco Javier Blancasa, Mercedes Gonzálezb, Rafael Caballerob)

Turizmi i qëndrueshëm është i lidhur ngushtë me turizmin etik (Weeden, 2002; Butcher, 2003). Turisti modern kërkon autenticitetin, integritetin dhe interesohet për etikën dhe pasojat e udhëtimit të tij (Hergesell, 2017). (Zuzana Kvítková*, Zdenka Petrů*, Petr Šauer, 2022)

Aktualisht, metodat që pranohen gjerësisht për matjen e qëndrueshmërisë janë të kufizuara (Hanley et al., 1999; OECD, 2000). Një numër i madh studimesh përdorin tregues për të përcaktuar nivelin e turizmit të qëndrueshëm në destinacionet e synuara. Megjithatë, këto studime mbeten kryesisht teorike, për shkak të kuantifikimit jo të plotë të treguesve. Kjo pengon ofrimin e udhëzimeve për integrimin e informacionit në politikëbërjen aktuale (Bell and Morse, 2001; Bosh, 2002; Dahkal and Imura, 2003; Farsari and Prastacos, 2002; Gudmundsson, 2003; Hezri, 2004; Innes and Booher, 2000). Ashtu siç citohet te: (Macarena Lozano-Oyolaa,*, Francisco Javier Blancasa, Mercedes Gonzálezb, Rafael Caballerob)

Gjithashtu, Këshilli Ndërkombëtar për Monumentet dhe Vendet (ICOMOS) luan një rol qendror në shprehjen e shqetësimeve për qëndrueshmërinë dhe turizmin. Ai gjithashtu vlerëson nëse këto shqetësime kontribuojnë ose ulin vlerën e monumenteve (Schmutz & Elliott, 2016). (Zuzana Kvítková*, Zdenka Petrů*, Petr Šauer, 2022)

Një nga organizmat më të njohur botëror në fushën e turizmit Global Sustainable Tourism Council (GSTC) prezantoi në vitin 2013 kriteret që një destinacion të konsiderohet i qëndrueshëm. Sipas kësaj organizate kriteret mund ti klasifikojmë në katër grupe: 1- Demostro menaxhim të qëndrueshëm destinacioni. 2- Maksimizo benefitet në komunitetin prites dhe minimizo efektet negative. 3- Maksimizo benefitet e komunitetit, vizitorëve dhe kultura; minimizo efektet

negative. 4- Maksimizo benefitet në mjedis dhe minimizo efektet negative (GSTC, 2018).

Ashtu si kuptohet edhe nga përkufizimet e mësipërme turizmi i qëndrueshëm ka të bëjë me përqasjen që kemi kur ndërmarrim veprime në një destinacion që kanë të bëjnë me menaxhimin, planifikimin e aktiviteteve dhe vizionin për të ardhmen. Këtu lind domosdoshmeria që destinacionet turistike kanë nevojë imediate për menaxhim profesional dhe nga organizata të specializuara.

Sipas UNWTO duke implementuar dhe duke ju përqasur konceptit të menaxhimit të destinacionit në mënyrë profesionale atëherë do të kemi këto benefite (World Tourism Organization, 2018):

- Krijimi i një avantazhi konkurrues
- Sigurimi i qëndrueshmërisë së turizmit
- Përhapja e përfitimeve të turizmit
- Përmirësimi i rendimentit turistik
- Ndërtimi i një identiteti të fortë dhe vibrant të markës

Përsa i përket Komunitetit Evropian në vitin 2016 prezantoi sistemin ETIS (Sistemin Evropian të Treguesve të Turizmit), i cili përmban 43 tregues kryesorë që janë përmbledhur në katër fusha kryesore, ashtu si citohet te (Peter Nientieda, Dritan Shutina): a) menaxhimi i destinacionit, b) vlera ekonomike; c) ndikimi social dhe kulturor; dhe d) ndikimi në mjedis. Gjithashtu, ETIS sugjeron disa tregues plotësues, për shembull, turizmin detar dhe bregdetar, turizmin e aksesueshëm dhe rrugët kulturore ndërkombëtare.

Të gjitha destinacionet prestigjioze në botë ja besojnë menaxhimin dhe marketingun e tyre organizatave të specializuara për turizmin që njihen si DMO (Destination Marketing Organization). Stafet e punës së tyre janë tepër të kualifikuar dhe të specializuar në fushën e turizmit në rang global. Për vendet në zhvillim si vendi yne ku sektori i turizmit është në fazat e zhvillimit dhe ka mungesë të specialistëve të fushës kjo do ishte një zgjidhje optimale pasi do kursente kohë dhe burime.

Ashtu si citohet te (Morrison, 2019): Destinations International (një nga asosacionet lider ndërkombëtare në menaxhimin e destinacioneve, me qendër në Washington) përmend këto benefite që vijnë nga DMO-të për vizitorët, bizneset e udhëtimit dhe planifikuesit (Destinations International, 2018) (International, 2018):

DMO ofron informacion rreth shërbimeve dhe faciliteteve në destinacion

DMO i kursen kohë dhe energji vizitorit

DMO ofron gjithë gamën e informacionit rreth destinacionit

Shumica e shërbimeve të ofruara nga DMO nuk kushtojnë asgjë.

Sipas Niñerola, Sánchez-Rebull & Hernández-Lara (2019, f. 1376), "qëndrueshmëria ekonomike kërkon efikasitetin e burimeve në mënyrë që të arrijë përfitime në afatgjatë". Mund të matet me shumëllojshmërinë e gjerë të treguesve të ndryshëm të klasifikuar në shtatë grupe (Organizata Botërore e

Turizmit, 2004): 1) Sezonaliteti (p.sh., okupimi, sezoni i pikut kundrejt shpatullave, etj.); 2) Rrjedhje (p.sh., mallra të importuara, të brendshme kundrejt rrjedhjeve të jashtme kundrejt rrjedhjeve të padukshme, etj.); 3) Punësimi (p.sh., aftësitë, qarkullimi, pagat, etj.); 4) Turizmi si kontribues në ruajtjen e natyrës (p.sh. financimi i ruajtjes, pjesëmarrja e turistëve në konservim, etj.); 5) Përfitimet ekonomike të komunitetit dhe destinacionit (p.sh. të ardhurat nga turizmi, kontributi i turizmit në ekonominë lokale, investimet, taksat, etj.); 6) Turizmi dhe zbutja e varfërisë (p.sh., SME-të, vetëpunësimi, mundësitë e të ardhurave, etj.); dhe 7) Konkurrueshmëria e bizneseve turistike (p.sh. raporti çmim-vlerë, diferencimi, specializimi, përfitimi afatgjatë, etj.)

Turizmi i qëndrueshëm, në kontekstin kulturor, është një element themelor për zhvillimin ekonomik të disa komuniteteve lokale. Ka shumë faktorë që mund të ndikojnë në suksesin e këtij lloji turizmi, por çdo veprim apo strategji e miratuar duhet të jetë e lidhur ngushtë me kënaqësinë e turistit. (Nuria Huete-Alcocer 1 Víctor Raúl López-Ruiz 1 and Adriana Grigorescu 2, 29 November 2019).

Ndërsa sipas Alastair M. Morrison, një personalitet i padiskutueshëm në fushën e Turizmit dhe menaxhimit të tyre: “Bazuar në shumë vite eksperience në këtë fushë, autori sugjeron 10 A-të si një set i dobishëm për të gjykuar për suksesin e një destinacioni turistik. Çdo njëra prej tyre fillon me shkronjen A (në anglisht)

1. *Awareness*, ka lidhje me nivelin e njohurive të vizitorit mbi destinacionin.
2. *Attractiveness*, sasia e atraksioneve dhe ganes së tyre në destinacion.
3. *Availability*, sa lehtë mund të rezervoni në destinacion.
4. *Access*, sa praktike dhe e lehtë është hyrja dhe dalja nga destinacioni.
5. *Appearance*, ky atribut mat përshtypjen që i ka lënë vizitorit destinacioni para dhe pas vizitës.
6. *Activities*, gama e aktiviteteve dhe eksperiencave që ofrohen në destinacion.
7. *Assurance*, ka lidhje me nivelin e sigurisë në destinacion.
8. *Appreciation*, ndjenja dhe niveli i mikpritjes dhe miqësisë nga ana e komunitetit në destinacion.
9. *Action*, ka të bëjë me egzistencën e një plan zhvillimi turistik dhe marketing afatgjatë mbi destinacionin.
10. *Accountability*, vlerësimi i performancës së destinacionit dhe kontrollit se sa përputhet me vizionin dhe objektivat. (Morrison, 2019)

Padyshim që 10 A-të e Morrison mund të konsiderohen si një model shumë praktik dhe i thjeshtë për të kuptuar dhe matur suksesin dhe qëndrueshmërinë e një destinacioni. Konciziteti i tyre duke përmbledhur indikatorët më kyç në destinacion mund të jetë një manual shumë i vlefshëm

për këdo që merret me menaxhimin e destinacioneve turistike dhe do të bëjë një vlerësim të shpejtë mbi performancën aktuale të destinacionit.

Literatura në këtë fushë është jashtëzakonisht e pasur dhe e pamundur për t'u ezauruar në një shkrim të vetëm por gjithsesi ashtu si kuptohet mund të konkludojmë, se: Qëndrueshmëria duhet arritur në aspektin ekonomik, pra, në maksimizimin e përfitimeve afatgjata për të gjitha palët, në aspektin shoqëror dhe kulturor ku vështirësia për matjen e këtyre treguesve është jashtëzakonisht e madhe për arsye se efektet shfaqen me shumë vonesë, dhe atij mjedisor ku duhet garantuar se keto burime do shfrytëzohen por njëkohësisht efektet negative do jenë minimale duke garantuar se ato do të jenë të mbrojtura dhe të konservuara për brezat e ardhshëm.

Indikatorët

Nga sa u përmend në literaturën e mësipërme do të ishte esenciale të qartësohet se çfarë kuptohet me një indikator dhe si mund ta përkufizojmë atë. Duke përkufizuar termat do të jemi në gjendje të identifikojmë indikatorët në një destinacion, gjë që do të na ndihmonte të matnim edhe nivelin e qëndrueshmërisë së tij.

Sipas WTO: “Indikatorët janë masa për ekzistencën ose përkeqësimi i çështjeve aktuale, sinjalet e situatave ose problemeve të ardhshme, masat e rrezikut dhe nevojën e mundshme për veprim, dhe mjetet për të identifikuar dhe matur rezultatet e veprimeve tona. Indikatorët janë grupe informacioni që zgjidhen zyrtarisht për t'u përdorur në baza të rregullta për të matur ndryshimet që janë të rëndësishme për zhvillimin dhe menaxhimin e turizmit” (World Tourism Organization, 2018)

Në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm për turizmin, treguesit janë informacione të serive kohore që janë strategjike për qëndrueshmërinë e një destinacioni, asetet e tij dhe në fund të fundit, fatet e turizmit (WTO).

Indikatorët konsiderohen si mjete të dobishme që lejojnë menaxherët e turizmit të diagnostifikojnë situatën e destinacionit dhe të identifikojnë dhe vlerësojnë çështjet që kërkojnë adresim për të përmirësuar nivelin e qëndrueshmërisë së aktiviteteve turistike Megjithatë, këto sisteme treguesish zakonisht nuk ofrojnë një udhëzues praktik se si të interpretoni informacionin dhe si ta integroni atë në vendimmarrje. (Macarena Lozano-Oyola*, Francisco Javier Blancasa, Mercedes Gonzálezb, Rafael Caballerob).

Ata janë pasqyrë e dinamikave në destinacion duke matur çdo ndryshim që ndodh për shkaqe të brendshme në vet destinacion apo për shkak të faktorëve të jashtëm që vjen si rezultat i ndryshimeve në makromjedis. Gjithmonë, në fokus janë ato ndryshimet që kanë lidhje me sektorin e turizmit duke abstrguar nga faktorët e tjerë.

Indikatorët mund të identifikohen në bazë nacionale, rajonale apo dhe sipas specifikave të vet destinacioneve dhe llojit të turizmit që praktikon një destinacion, si psh: turizëm bregdetar, malor, kulturor etj. Kjo do të

ndihmonte padyshim në planifikimin dhe menaxhimin e destinacioneve dhe të gjitha nivelet vendimmarrëse duke i furnizuar vendimmarrësit me lëndën e parë që është informacioni i përditësuar.

Gjithmon, puna për identifikimin e indikatorëve më sinjifikativ në një destinacion të caktuar fillon me çështjet më kryesore që e preokupojnë atë destinacion. Këtu lind edhe domosdoshmëria për studime dhe kërkime të vazhdueshme mbi destinacionet pasi dinamikat janë vazhdimisht të gjalla qoftë për shkak të faktorëve të brendshëm, por sidomos të atyre nga të jashtëm me qëllim identifikimin dhe dhënien prioritet të çështjeve kyçe që mund të kthehen në indikatorë.

Si rregull, çdo çështje e rëndësishme në destinacion mund të shndërrohet në indikator me kusht që: të kenë impakt domethënës mbi ecurinë e destinacioneve, të kemi mundësi ta matim dhe krahasojmë, të jenë efekte të qarta.

Ata mund të jenë **sasiore** duke variuar nga seri të dhënash, numra, përqindje, raporte krahasuese etj., ose **cilësore** të cilat mund të grumbullohen nga pyetësorë të hapur ose të mbyllur ku të anketuarit i kërkohet të jap përshtypje për një fenomen të caktuar që matet me shkallë, mund të kërkohet një intervistë e mbyllur ku i kërkohet me një po apo jo egzistencën e një fenomeni ose të qenit pjesë e një organizimi ose nëse egziston plan menaxhimi etj. Gjithashtu, përsa i përket indikatorëve cilësorë, mund ti kërkohet nëse destinacioni ka një indeksim apo është i rankuar diku.

Indikatorët kanë natyrë të ndryshme dhe rëndësia e tyre varion nga periudha në periudhë në varësi të dinamikave dhe stadi të zhvillimit të destinacionit. Duhet të theksohet se rankimi i tyre dhe prioriteti i tyre është procedurë komplekse dhe ka nevojë për ekspertë të fushës. Për pëcaktimin dhe dhënien e peshës specifike të secilit indikator duhet që të dihen objektivat afagjata, afatmesme dhe afatshkurtëra të destinacionit, stadi ku ndodhet destinacioni në raport me konkurentët, avantazhet dhe disavantazhet e tij, etj. Prej këtu lind nevoja për një plan menaxhimi dhe marketingu të destinacionit që do të shërbejë si referencë për të përcaktuar prioritetet. Përsa i përket natyrës së tyre ashtu dhe si u citua në literaturë ata mund të jenë:

Tregues ekonomik, si: kontributi i turizmit në PBB, të ardhurat e drejtpërdrejta nga turizmi, numri i bizneseve në destinacion, shpenzimet e turistëve, sezonaliteti, numri i vendeve të punës në sektorin e turizmit etj.

Tregues social-kulturor, si: numri i të punësuarve në sektorin e turizmit, numri i punonjësve të kualifikuar, përqindja e të ardhurave të komunitetit nga turizmi, sasia e investimeve dhe shërbimeve publike në destinacion, demografia etj.

Gjithashtu, në lidhje me atraksionet kulturore mund të kemi këta indikatorë, si: gjendja fizike e tyre, sasia e investimeve për t'i restauruar, shkalla e rijetëzimit të tyre, shkalla e degradimit etj.

Tregues mjedisore, si: Sasia e mbetjeve të ricikluara (menaxhimi i mbetjeve), sasia e ujit të konsumuar për turistë, sasia e energjisë që

konsumohet gjatë sezonit, shkalla e ndotjes nga aktiviteti turistik, niveli i ndotjes akustike, numri i makinave gjatë sezonit dhe pas sezonit që shkaktojnë ndotje ambjentale, gjendja e specieve të rrezikuara dhe si ka ndikuar aktiviteti turistik mbi to, shkalla e degradimit të mjedisve natyrore si rezultat i aktivitetit turistik etj.

Duhet përmendur se shumë nga autorët përmendin dhe një kategori të katërt që ka të bëjë me **indiktorët institucionale**. Ky dimension i referohet kapacitetit të institucioneve dhe qeverive për të transformuar nevojat në politika nëpërmjet metodave të koordinuara dhe efektive, me qëllim zbatimin e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të turizmit në një komunitet të caktuar. Qëllimi është të vlerësohen çështjet me të cilat merren agjentët lokalë, të tilla si krijimi i politikave, planifikimi, koordinimi dhe zbatimi me organet e tjera të regjistruara. (Macarena Lozano-Oyolaa,*, Francisco Javier Blancasa, Mercedes Gonzálezb, Rafael Caballerob)

Një tregues mund të zbatohet në praktikë vetëm nëse ekziston një mekanizëm i mundshëm për ta matur atë. Gjetja e masave adekuate është kritike në hartimin dhe përdorimin e treguesve, duke pasur parasysh se mbledhja dhe përpunimi i të dhënave duhet të jetë teknikisht dhe ekonomikisht i realizueshëm. (World Tourism Organization, 2018)

Diskutim dhe konkluzione

- Koncepti i qëndrueshmërisë së destinacioneve është një koncept kompleks dhe një objektiv që vazhdimisht ndryshon me dinamikën që ndodhin në destinacion. Sidoqoftë ne mund të themi me siguri se turizmi i qëndrueshëm ka të bëjë me periudhën afatgjatë të destinacionit dhe ka këto dimensione: ekonomik, social-kulturor dhe atë mjedisor pa neglizhuar atë institucional.
- Çdo destinacion që përfshihet nga fenomeni i turizmit do të ofrojë produktin e tij turistik, i cili përbëhet nga tërësia e atraksioneve të tij, aktiviteteve, shërbimeve dhe fasiliteve të tjera. Përdorimi i këtyre burimeve i siguron komunitetit, vizitorëve, investitorëve, operatorëve turistik dhe shtetit benefite të ndryshme në periudha të ndryshme, por gjithashtu, këto burime kanë një masë të caktuar shfrytëzimi dhe nëse nuk respektohet dhe tejkalohet masa atëhere këto burime do të shterojnë ose përkeqësohen dhe nuk do të trashëgohen tek brezat e tjerë.
- Qëndrueshmëria ka të bëjë me turizmin etik ku të gjithë pjesëmarrësit përfitojnë benefite, por njëkohësisht duhet të marrin përsipër përgjegjësitë për të respektuar palët e tjera dhe burimet natyrore, kulturore të destinacionit që i përkasin.
- Turizmi i qëndrueshëm nuk është një lloj turizmi por një përqsasje që synon të maksimizojë përfitimet për komunitetet lokale dhe vizitorët dhe gjithashtu, promovon mbrojtjen dhe shfrytëzimin me masë të burimeve natyrore dhe kulturore duke u siguruar që ato do të gëzohen dhe nga

brezat e ardhshëm si dhe minimizimin e efekteve negative në mjedis, ekonomi, shoqëri e kulturë.

- Për të gjykuar për suksesin dhe qëndrueshmërisë në çdo destinacion duhet të përzgjidhen dhe përcaktohen një set indikatorësh të rëndësishëm për të cilët do masin herë pas here performancën e destinacionit. Në rast se ka përkeqësim të indikatorëve atëherë duhen ndërmarrë politika proaktive të cilat do të ndihmojnë në përmirësimin e situatës dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të destinacionit.
- Indikatorët janë grupe informacioni që zgjidhen zyrtarisht për t'u përdorur në baza të rregullta për të matur ndryshimet që janë të rëndësishme për zhvillimin dhe menaxhimin e turizmit. Ata mund të ndahen në tre grupe: 1- Mjedisore, si: cilesia ajrit, ujit, biodiversiteti, konsumi i energjisë dhe burimeve të tjera, menaxhimi i mbetjeve. 2- Social – kulturorë, si: ruajtja e trashëgimisë kulturore fizike apo shpirtërore, turizmi masiv, minimizimi i ndikimeve negative si kriminaliteti, droga, prostitucioni. 3- Ekonomike, si: kontributi ekonomik i turizmit, rritja e punësimit, rritja e numrit të bizneseve, rritja e të ardhurave direkte dhe indirekte etj.
- Lloji i informacionit që indikatorët ofrojnë mund të jetë sasior ose cilësor në varësi të indikatorëve.
- Prioriteti dhe rëndësia e indikatorëve në një destinacion varion nga periudha në periudhë dhe nga stadi i zhvillimit të destinacionit turistik.
- Nga përfitimet kryesore të turizmit të qëndrueshëm është përmirësimi i imazhit të destinacionit, rrit ndërgjegjësimin për të gjitha palët dhe kontribuon në zhvillim të qëndrueshëm të destinacionit.
- Turizmi i qëndrueshëm është domosdoshmëri nëse duam të garantojmë zhvillim në periudha afatgjata të destinacionit. Ai nuk mund të arrihet pa pjesëmarrjen aktive të të gjitha palëve të përfshira në aktivitetin turistik që janë: komunitet, vizitor, shtet, operatorë turistik, investitorë dhe organizatat e tjera që ushtrojnë aktivitet në destinacionin turistik.

Rekomandime

- I. Për të përmirësuar qëndrueshmërinë duhet që destinacionet të kenë një plan menaxhimi dhe marketing, i cili do të jetë harta e rrugës për destinacionin. Ky do të ndihmojë vendimmarrësit në përcaktimin e objektivave afatgjata dhe në varësi të këtyre objektivave do të zhvillohen edhe prioritetet.
- II. Institucionet dhe individët e përfshirë në zhvillimin e politikave dhe menaxhimin e destinacionit duhet të kenë njohje të thellë të konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm përndryshe kjo do të kishte pasoja shumë të rënda në periudhat afatgjatë për destinacionin.
- III. Vendosja e objektivave dhe prioritetëve do të ndihmonte në matjen e performancës së destinacionit. Për këtë duhet që destinacionet të

përcaktojnë qartësisht se cilat janë çështjet kyçe për destinacionin e tyre dhe cilat janë ato me primaret për periudhën aktuale.

- IV. Për të arritur qëndrueshmëri duhet të rritet ndërgjegjësimi qoftë në nivel komuniteti, por edhe në nivel vizitorësh si dhe të promovohen praktikatat e gjelbëra dhe teknologji miqësore me mjedisin.

Literatura

Cernat & Gourdon, 2. (2007).

ColinMichael Hall, Stefan Gosling . (2015). *Food tourism and regional development: networks, products and trajectories*. Abingdon: Routledge.

Gaba, L. (2023). *Tourism Led Economic Recovery After Covid – 19 in South Albania*” . Tirana. doi:ISSN 2219-3200

GSTC. (2018). Retrieved from <http://www.gstcouncil.org/gstc-criteria/gstc-destination-criteria>

Ingeborg Matecic, Oliver Kesar, Danijela Ferjanic Hodak. (2022). UNDERSTANDING THE COMPLEXITY OF ASSESSING CULTURAL HERITAGE’S ECONOMIC IMPACT ON THE ECONOMIC SUSTAINABILITY OF A TOURISM DESTINATION: THE CASE OF SPLIT, CROATIA. *Orcid: https://orcid.org/0000-0002-3960-6750*.

International, D. (2018). Retrieved from <http://detsinationsinternational.org/about-destinations-international>

Macarena Lozano-Oyolaa,*, Francisco Javier Blancasa, Mercedes Gonzálezb, Rafael Caballerob. (n.d.). *susta*.

Macarena Lozano-Oyolaa,*, Francisco Javier Blancasa, Mercedes Gonzálezb, Rafael Caballerob. (n.d.). Sustainable tourism indicators as planning tools in cultural destinations.

Morrison, A. m. (2019). MARKETING AND MANAGING TOURISM DESTINATIONS. In *MARKETING AND MANAGING TOURISM DESTINATIONS* (p. 21). London and New York: Routledge.

Msc. Lutfi Gaba1, Prof. asoc. Lorenc Koçiu2. (2024). The Life Cycle of a Cultural Destination in a Developing Country. (p. 3). Tirane : University of Tirana.

Nuria Huete-Alcocer 1 Víctor Raúl López-Ruiz 1 and Adriana Grigorescu 2. (29 November 2019). Measurement of Satisfaction in Sustainable Tourism:.

OBT. (2004).

Peter Nientieda, Dritan Shutina. (n.d.). *Is ETIS a Viable Option for Fostering Sustainable Tourism?* Retrieved from <https://doi.org/10.32034/CP-TGAR-I01-07>

World Tourism Organization, 1. (n.d.).

World Tourism Organization, 1. (1993).

Zuzana Kvítková*, Zdenka Petrů*, Petr Šauer. (2022). Sustainability in smaller UNESCO sites from the entrepreneurs perpective. *Researchgate*.